

HUMAN  
RIGHTS  
HUMAN

**RAPORTI I SHOQËRISË  
CIVILE PËR TË  
DREJTAT E NJERIUT**

NË KOSOVË NË VITIN 2025

HUMAN  
RIGHTS

MAJ 2026

# PËRMBAJTJA

---

## **1. HYRJE**

---

## **2. KORNIZA METODOLOGJIKE**

---

## **3. KORNIZA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTAT E NJERIUT NË KOSOVË**

---

## **4. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**

---

## **5. PJESA A: TË DREJTAT CIVILE DHE POLITIKE**

---

- 5.1 . E drejta për jetën
- 5.2 . Ndalimi i torturës dhe trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues
- 5.3 . E drejta për liri dhe siguri personale
- 5.4 . E drejta për proces të drejtë gjyqësor dhe mjete juridike efektive
- 5.5. Liria e shprehjes dhe e mendimit, e drejta për informim dhe e drejta për privatësi
- 5.6. Liria e tubimit paqësor
- 5.7. Liria e asociimit
- 5.8. Liria e besimit, e ndërgjegjes dhe e fesë

## **6. PJESA B: TË DREJTAT EKONOMIKE, SOCIALE DHE KULTURORE**

---

- 6.1 Të drejtat e punës
- 6.2 E drejta për arsim
- 6.3. E drejta për kujdes shëndetësor
- 6.4. Të drejtat pronësore
- 6.5. Të drejtat kulturore

## **7. PJESA C: TË DREJTAT E PERSONAVE DHE GRUPEVE TË CAKTUARA**

---

- 7.1. Të drejtat e grave dhe barazia gjinore
- 7.2. Të drejtat e fëmijëve
- 7.3. Të drejtat e të rinjve
- 7.4. Të drejtat e personave me aftësi të kufizuara
- 7.5. Të drejtat e komuniteteve jo-shumicë
- 7.6. Të drejtat e personave LGBTIQ+
- 7.7. Personat në lëvizje

## **8. PJESA D: ÇËSHTJE TË NDËRLIDHURA/ÇËSHTJE SPECIFIKE LIDHUR ME TË DREJTAT E NJERIUT**

---

- 8.1. Drejtësia tranzicionale dhe të drejtat e njeriut
- 8.2. Korrupsioni dhe të drejtat e njeriut
- 8.3. Mjedisi dhe të drejtat e njeriut
- 8.4. E drejta për barazi dhe mosdiskriminim

# LISTA E TERMEVE DHE SHKURTESAVE

<b>Plani i Ahtisaarit (2007)</b>	Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës
<b>AGK</b>	Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës
<b>KiK</b>	Kuvendi i Kosovës
<b>PTH</b>	Prokuroria Themelore
<b>BSPK</b>	Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës
<b>CAT</b>	Konventa kundër Torturës dhe Trajtimit ose Ndëshkimit tjetër Mizor, Çnjerëzor apo Poshtëruës
<b>CEDAW</b>	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
<b>CERD</b>	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor
<b>KiE</b>	Këshilli i Evropës
<b>CPT</b>	Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit ose Ndëshkimit Çnjerëzor apo Poshtëruës
<b>KDF</b>	Konventa për të Drejtat e Fëmijës
<b>KDPAK</b>	Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara
<b>CRSV</b>	Dhuna seksuale e lidhur me konfliktin
<b>OSHC-të</b>	Organizata(t) e shoqërisë civile
<b>KEDNj</b>	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
<b>GJEDNj</b>	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
<b>QELSHM</b>	Qendra Evropiane për Lirinë e Shtypit dhe Medias
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>FCNM</b>	Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare
<b>ANJF</b>	Agjencia për Ndihmë Juridike Falas
<b>QeK</b>	Qeveria e Kosovës
<b>RrDNj</b>	Rrjeti i të Drejtave të Njeriut në Kosovë
<b>PNDKP</b>	Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike
<b>PNDESK</b>	Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore
<b>PZhBV</b>	Persona të zhvendosur brenda vendit
<b>KPM</b>	Komisioni i Pavarur i Mediave
<b>AIP</b>	Agjencia për Informim dhe Privatësi e Kosovës
<b>Konventa e Stambollit</b>	Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje
<b>AAK</b>	Agjencia e Akreditimit e Kosovës
<b>ASK</b>	Agjencia e Statistikave të Kosovës
<b>ShKK</b>	Shërbimi Korrektues i Kosovës
<b>KGJK</b>	Këshilli Gjyqësor i Kosovës

<b>PK</b>	Policia e Kosovës
<b>KPK</b>	Këshilli Prokurorial i Kosovës
<b>AKKVP</b>	Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës
<b>PKBGj</b>	Programi i Kosovës për Barazi Gjinore
<b>Shqiptar-K</b>	Shqiptar/e i/e Kosovës
<b>Ashkali-K</b>	Ashkali/ke i/e Kosovës
<b>Egjiptian-K</b>	Egjiptian/e i/e Kosovës
<b>Rom-K</b>	Rom/e i/e Kosovë
<b>Serb-K</b>	Serb/e i/e Kosovës
<b>LGBTI+</b>	Lezbike, gej, biseksualë, transgjjinorë, interseksualë+
<b>IpK</b>	Inspektorati i Punës i Kosovës
<b>MKRS</b>	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
<b>KKK</b>	Komisioni Komunal për Kthim
<b>MASHTI</b>	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
<b>MFPT</b>	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
<b>MPMS</b>	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
<b>MSH</b>	Ministria e Shëndetësisë
<b>MD</b>	Ministria e Drejtësisë
<b>KNPAK</b>	Këshilli Nacional për Personat me Aftësi të Kufizuara
<b>OJQ-të</b>	Organizata(t) joqeveritare
<b>MKP</b>	Mekanizmi Kombëtar Parandalues
<b>OBZhE</b>	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
<b>ZQM</b>	Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Mosdiskriminim
<b>OHCHR</b>	Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut
<b>IAPK</b>	Institucioni i Avokatit të Popullit të Kosovës
<b>OPCAT</b>	Protokolli Opsional i Konventës kundër Torturës dhe Trajtimit ose Ndëshkimit tjetër Mizor, Çnjerëzor apo Poshtëruar
<b>OSBE</b>	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
<b>IPK</b>	Inspektorati Policor i Kosovës
<b>PISA</b>	Programi për Vlerësim Ndërkombëtar të Nxënësve
<b>KOS</b>	Kisha Ortodokse Serbe
<b>PSK</b>	Prokuroria Speciale e Kosovës
<b>ATK</b>	Administrata Tatimore e Kosovës
<b>DUDNj</b>	Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut
<b>OKB</b>	Kombet e Bashkuara
<b>UNESCO</b>	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë
<b>UNHCR</b>	Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët
<b>UNICEF</b>	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
<b>UUESC</b>	Bashkimi i Unifikuar i Arsimit, Shkencës dhe Kulturës në Kosovë
<b>Komisioni i Venecias</b>	Komisioni Evropian për Demokraci përmes Ligjit
<b>GPPZh</b>	Grupi i Punës për Personat e Zhdukur
<b>OBSH</b>	Organizata Botërore e Shëndetësisë

## 1. HYRJE

1. Raporti i Shoqërisë Civile për të Drejtat e Njeriut në Kosovë paraqet një pasqyrë të situatës së të drejtave të njeriut në Kosovë gjatë vitit 2025. Ai përfshin çështjet dhe zhvillimet kryesore, shkeljet e të drejtave të njeriut si dhe sfidat për realizimin efektiv të tyre në praktikë. Raporti është hartuar bashkërisht nga organizatat e shoqërisë civile (OSHC) që veprojnë në një numër të larmishëm fushash të ndërlidhura me të drejtat e njeriut. Ky Raport synon të shërbejë si një mjet joqeveritar dhe i pavarur për vlerësimin e gjendjes së përgjithshme të të drejtave të njeriut në Kosovë, duke plotësuar kështu një boshllëk ekzistues në raportimin e përbashkët mbi të drejtat e njeriut në Kosovë në nivel vendor dhe ndërkombëtar, si dhe duke e forcuar bashkëpunimin dhe koordinimin ndërmjet OSHC-ve.

2. Raporti është i strukturuar në katër pjesë kryesore: **Pjesa A** i shqyrton të drejtat civile dhe politike, duke përfshirë të drejtën për ndalimin e torturës dhe trajtimit ose ndëshkimit mizor, çnjerëzor apo poshtëruës; të drejtën për liri dhe siguri të personit; të drejtën për një gjykim të drejtë dhe qasje në drejtësi; lirinë e shprehjes, mendimit dhe informimit si dhe të drejtën për privatësi; lirinë e tubimit paqësor; lirinë e asociimit, si dhe lirinë e besimit, fesë dhe ndërgjegjes. **Pjesa B** i mbulon të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore, siç janë e drejta për arsim; e drejta për kujdes shëndetësor; të drejtat e punës, si dhe e drejta pronësore, dhe përfundon me një pasqyrë të të drejtave kulturore. **Pjesa C** i shqyrton të drejtat e personave në pozita të cënueshme, siç janë të drejtat e fëmijëve, të rinjve, personave me aftësi të kufizuara, komuniteteve jo-shumicë, personave LGBTI+, si dhe personave në lëvizje. **Pjesa D** është pjesa e fundit, e cila shtjellon një sërë çështjesh ndërsektoriale dhe specifike të të drejtave të njeriut, siç janë drejtësia tranzicionale dhe të drejtat e njeriut, korrupsioni dhe të drejtat e njeriut, ndikimi i çështjeve mjedisore në raport me të drejtat e njeriut, si dhe e drejta për barazi dhe mosdiskriminim.

## 2. KORNIZA METODOLOGJIKE

3. Raporti i përbashkët i Shoqërisë Civile për të Drejtat e Njeriut 2025 ofron një pasqyrë të situatës së të drejtave të njeriut në Kosovë gjatë vitit 2025 nga perspektiva e shoqërisë civile. Dokumenti pasqyron fusha kyçe për një kuptim të thelluar të zhvillimit të të drejtave të njeriut në Kosovë në kontekstin e zhvillimit të saj të vazhdueshëm si shtet demokratik me vlera universale të të drejtave dhe lirive të njeriut. Metodologjia mbështetet në nevojën për një qasje me spektër të gjerë, e cila i ndërthur aspektet e politikave, praktikave dhe përvojës, dhe për rrjedhojë ofron një pasqyrë alternative të situatës së të drejtave të njeriut në Kosovë. Edhe pse raporti synon të jetë gjithëpërfshirës, duhet të pranohet se ekzistojnë kufizime lidhur me atë që është përfshirë.

4. Duke u mbështetur në metodologjinë e zhvilluar nga Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut (OHCHR) për zhvillimin e indikatorëve të të drejtave të njeriut, që

nga viti 2022 është përdorur një metodologji e rishikuar për hartimin e raportit. Në bazë të listave të indikatorëve të zhvilluar për secilën pjesë të të drejtave të njeriut, të dhënat e mbledhura nuk pasqyrojnë vetëm një përpjekje cilësore për ta kuptuar kontekstin, por janë gjithashtu rezultat i një përpjekjeje për ta matur gjendjen e të drejtave të njeriut në aspektin statistikor.

**5.** Procesi i hartimit të raportit është udhëhequr nga parimi i pjesëmarrjes dhe i pronësisë së plotë nga ana e OSHC-ve kryesore që veprojnë në fushën e të drejtave të njeriut në nivel lokal dhe kombëtar. Mbledhja e të dhënave për përpilimin e raportit të përbashkët të OSHC-ve është realizuar përmes disa qasjeve. Së pari, raporti është rezultat i kontributeve përkatëse të 42 OSHC-ve që punojnë në çështje të veçanta të të drejtave të njeriut. Përveç kësaj, për të dytin vit radhazi në procesin e hartimit të Raportit të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut, janë zhvilluar intervista me një numër OSHC-sh me qëllim të diskutimit të çështjeve specifike të të drejtave të njeriut dhe verifikimit të të dhënave të caktuara nga fushat e tyre përkatëse të ekspertizës. Kjo ka mundësuar grupimin e raportit në katër pjesë të përmendura më sipër, përkatësisht **Pjesa A, B, C dhe D**. Së fundi, ky raport është mbështetur në hulumtim të gjerë dokumentar. Për secilën nga pjesët përkatëse, janë grumbulluar të dhëna nga një sërë burimesh të besueshme. Për më tepër, raporti është rishikuar në tre faza të njëpasnjëshme të procesit të hartimit. Përmes një takimi konsultativ të organizuar nga Rrjeti për të Drejtat e Njeriut<sup>1</sup>, OSHC-të kontribuuese kanë pasur mundësinë që t'i diskutojnë gjetjet dhe të japin sugjerime, të cilat më pas janë përfshirë në raportin e përbashkët të OSHC-ve. Gjithashtu, procedurat konsultative janë mundësuar përmes korrespondencës elektronike ndërmjet OJQ-së YIHR KS dhe hulumtuesve të kontraktuar.

**6.** 42 OJQ-të e mëposhtme kanë kontribuar në këtë raport: Activism Roots, Qendra për Avokim për Kulturë Demokratike (ACDC), Advocacy Training & Resource Center (ATRC), Advancing Together (AT), Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK), Shoqata e Paraplegjikëve dhe Fëmijëve të Paralizuar të Kosovës (HANDIKOS), Balkan Green Foundation (BGF), Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese në Kosovë (BIRN Kosova), Qendra për Veprime Afirmative Sociale (CASA), Qendra për Barazi dhe Liri (CEL), Qendra për Informim dhe Përmirësim Social (QIPS), Civil Rights Program Kosovo (CRP/K), Durmish Aslano, DYLBERIZM, FollowUp, Forum Civil Peace Service (ZFD), GAP Institute, Grupit për Studime Juridike dhe Politike (GLPS), Hanuma NGO, Institute for Advocacy of Corrective Policies (IAPK), Qendra Kosovare për Studime Gjinore (QKSGJ), Kosovo Institute for Policy Research and Development (KIPRED), Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), Qendra për Rehabilitimin e Viktimave të Torturës në Kosovë (KRCT), Rrjeti i Grave të Kosovës (KWN), Kosovo Young Lawyers (KYL), Lëvizja FOL, Lëvizja Queer Studentore, Medica Gjakova, Missing Persons Resource Center (MPRC), Nisma e Re Sociale (NSI), OJQ AKTIV, Omladinska Parteska Aktivnost (OPA), Qendra për Informim, Kritikë dhe Aksion (QIKA), Rrjeti i Organizatave të Grave Rome, Ashkali dhe Egjiptiane të Kosovës (RROGRAEK), Save the Children Kosova/o, Syri i Vizionit, Terre des Hommes (Tdh), The Ideas Partnership, TOKA, Zëri i Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve në Kosovë (VoRAE), dhe Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut (YIHR KS).

<sup>1</sup> Rrjeti për të Drejtat e Njeriut (HRN) (2025). HRN është një rrjet prej shtatë organizatash që punojnë së bashku për të avancuar të drejtat e njeriut për të gjithë në Kosovë. Anëtarët e HRN-së janë: Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut – Kosovë (YIHR KS), Shoqata e Paraplegjikëve dhe Fëmijëve të Paralizuar të Kosovës HANDIKOS, Qendra për Barazi dhe Liri (CEL), Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), Qendra Kosovare për Studime Gjinore (QKSGJ), Nisma e Re Sociale (NSI), Voice of Roma, Ashkali and Egyptians (VoRAE). YIHR KS është themeluesi dhe Sekretariati i HRN-së. Ky raport është dorëzuar me mbështetjen financiare të Komponentës për të Drejtat e Njeriut në kuadër të Administratës së Përkohshme të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) dhe Zyrës së Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut (OHCHR).

## 3. KORNIZA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTAT E NJERIUT NË KOSOVË

7. Përkushtimi i Kosovës për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore është i ngulitur fort në Kushtetutën dhe legjislacionin e vendit, duke përdorur një qasje gjithëpërfshirëse tre pjesëshe. Së pari, Kushtetuta përfshin një numër të madh dispozitash të dedikuara për mbrojtjen e lirive themelore dhe të drejtave të njeriut. Neni 3 i Kushtetutës obligon në mënyrë të qartë autoritetet publike në Kosovë që të sigurojnë trajtim të barabartë para ligjit dhe respekt të pakompromis ndaj të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të njohura ndërkombëtarisht. Për më tepër, Neni 7 i Kushtetutës i përcakton parimet themelore të rendit kushtetues të Kosovës, duke theksuar vlera si barazia, respekti për të drejtat dhe liritë e njeriut dhe mosdiskriminimi, me një theks të veçantë në barazinë gjinore si parim themelor. Kapitulli II i Kushtetutës përcakton dispozita të detajuara për mbrojtjen e të drejtave civile dhe politike, duke përfshirë të drejtën për gjykim të drejtë, privatësinë, si dhe liritë e mendimit, shprehjes, tubimit paqësor, asociimit dhe lëvizjes. Ai gjithashtu garanton mbrojtje për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore, përfshirë të drejtën për arsim dhe lirinë e profesionit. Me rëndësi të veçantë është Neni 53, i cili kërkon që çdo interpretim i të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, siç garantohen nga Kushtetuta e Kosovës, të jetë në përputhje me praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

8. Së dyti, Kosova i ka përfshirë disa instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut në kornizën e saj ligjore vendore. Një përfshirje e tillë bazohet në Nenin 22 të Kushtetutës, i cili përcakton se nëntë instrumente të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) dhe të organizatave tjera rajonale për të drejtat e njeriut janë drejtpërdrejt të zbatueshme në Kosovë, duke ofruar kështu një bazë ligjore shtesë për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive të njeriut në Kosovë. Në shtator të vitit 2020, Kuvendi i Kosovës ndryshoi Nenin 22 për ta përfshirë Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit) në mesin e instrumenteve të të drejtave të njeriut që janë drejtpërdrejt të zbatueshme, duke shënuar një përparim të rëndësishëm për të drejtat e grave. Të gjitha këto instrumente të zbatueshme drejtpërdrejt kanë përparësi ndaj legjislacionit të Kosovës apo akteve të tjera të institucioneve publike në rast të konfliktit, një qëndrim juridik i konfirmuar edhe nga praktika gjyqësore e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës.<sup>2</sup> Edhe pse Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (PNDESK) nuk bën pjesë ndër instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut që janë drejtpërdrejt të zbatueshme në Kosovë, Kuvendi i Kosovës e ka miratuar Agjendën 2030 dhe 17 Objektivat e saj për Zhvillim të Qëndrueshëm me një rezolutë unanime më 24 janar 2018, duke ofruar një pikë hyrëse domethënëse për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore në Kosovë.

2 Gjykata Kushtetuese e Kosovës, rasti nr. [Kl207/19](#), paragrafet 105-111.

**9.** Pavarësisht rekomandimit pozitiv për anëtarësim të miratuar nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës (APKE) në prill të vitit 2024 përmes Opinione Nr. 302 (2024), kërkesa e Kosovës për t'u anëtarësuar në Këshillin e Evropës mbeti e pazgjidhur gjatë vitit 2025. Ndërkohë që APKE kishte theksuar se aspiratat e Kosovës për t'iu bashkuar organizatës meritonin një përgjigje pozitive dhe kishte vënë në pah përfitimet e mundshme nga qasja në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut për personat nën juridiksionin e Kosovës, vendimi përfundimtar nga Komiteti i Ministrave nuk u materializua. Deri në periudhën raportuese, në vitin 2025, Kosova mbeti jashtë organizatës dhe vazhdoi të ekzistojë një boshllëk në monitorim dhe llogaridhënie në lidhje me disa konventa të Këshillit të Evropës që janë drejtpërdrejt të zbatueshme sipas Nenit 22 të Kushtetutës.

**10.** Së treti, Kapitulli III i Kushtetutës ofron garanci ekskluzive dhe mbrojtje të veçantë për komunitetet jo-shumicë në Kosovë. Këto garanci konsiderohen si "të drejta specifike", përveç të drejtave të tjera të përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës, të cilat zbatohen ekskluzivisht për banorët që i përkasin të njëjtit grup kombëtar, etnik ose fetar, tradicionalisht të pranishëm në Kosovë.<sup>3</sup> Ndër disa klauzola të tjera më standarde të mbrojtjes, ky kapitull përfshin disa dispozita që sigurojnë masa afirmative në mbrojtjen politike, ekonomike dhe sociale të komuniteteve jo-shumicë në Kosovë.<sup>4</sup>

**11.** Kosova ka krijuar organe dhe mekanizma të dedikuar për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, siç janë Institucioni i Avokatit të Popullit, Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Mosdiskriminim (ZQM), Këshilli Presidencial për Demokraci, Grupi Koordinues Ndërmnistror për të Drejtat e Njeriut, Zyra e Komisionerit të Gjuhëve, Agjencia për Barazi Gjinore, Agjencia për Ndihmë Juridike Falas, Agjencia për Informim dhe Privatësi, si dhe Komiteti për të Drejtat e Njeriut i Kuvendit të Kosovës, si disa nga institucionet kryesore.

**12.** OSHC-të në Kosovë luajnë një rol qendror në monitorimin e zbatimit të kornizës së të drejtave të njeriut dhe në raportimin sistematik të mangësive dhe dështimeve institucionale. Raportet e tyre vjetore të përbashkëta përbëjnë një instrument kyç të llogaridhënies, i cili informon opinionin publik dhe vë në pah shqetësimet e grupeve dhe komuniteteve të ndryshme. Tradicionalisht, rekomandimet e nxjerra përmes këtij procesi u komunikohen zyrtarisht institucioneve përkatëse qendrore dhe lokale, duke shërbyer si bazë për llogaridhënie institucionale. Megjithëse çdo vit një numër i konsiderueshëm i rekomandimeve mbetet i paadresuar, përgjigjet institucionale tregojnë një progres të pjesshëm që e reflekton njohjen në rritje të monitorimit nga OSHC-të si një mekanizëm legjitim i llogaridhënies.

<sup>3</sup> Neni 57 i Kushtetutës.

<sup>4</sup> Shih si shembuj nenet 59, 60, 61 dhe 62 të Kushtetutës.

## 4. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

**13.** Periudha raportuese në vitin 2025 u karakterizua nga një bllokadë e zgjatur politike pas zgjedhjeve parlamentare, me vonesa në konstituimin e Kuvendit dhe formimin e institucioneve të reja, gjë që ndikoi në vazhdimësinë legjislative, llogaridhënien politike dhe vendimmarrjen në sektorë kyç. Kjo paralizë institucionale ndodhi paralelisht me kufizime gjithnjë e më të mëdha financiare që prekën organizatat e shoqërisë civile (OSHC-të), shumë prej të cilave vazhduan të veprojnë nën mbështetje të reduktuar nga donatorët dhe cikle të vonuara financimi. Kjo krijoi një sfond të një mjedisi të dobësuar të përgjithshëm të të drejtave të njeriut, me kapacitete të reduktuara për monitorimin dhe reagimin ndaj shqetësimeve të të drejtave të njeriut gjatë vitit 2025.

**14.** Në fushën e të drejtave civile dhe politike, Kosova vazhdoi të përballet me mangësi strukturore në mbrojtjen e të drejtës për jetë, trajtim njerëzor, liri, të drejtën për gjykim të drejtë, lirinë e shprehjes dhe llogaridhënien institucionale. Dhuna me bazë gjinore dhe femicidi mbetën shqetësime urgjente, me disa raste serioze gjatë periudhës raportuese që zbuluan dështime të vazhdueshme në zbatimin e masave mbrojtëse dhe në koordinimin institucional. Periudha raportuese u karakterizua gjithashtu nga procese të zgjatura gjyqësore dhe barriera gjuhësore në qasjen në drejtësi, si dhe nga niveli i ulët i pajtueshmërisë me rregullat institucionale, gjë që vazhdoi t'i minojë garancitë për gjykim të drejtë dhe mjetet juridike efektive.

**15.** Sa u përket të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore, periudha raportuese pasqyrojti progres të kufizuar krahas pabarazive të vazhdueshme të raportuara më herët. Qasja në kujdes shëndetësor cilësor, veçanërisht në shërbimet e shëndetit mendor, mbeti e pamjaftueshme në vitin 2025, ndërsa cenueshmëria socio-ekonomike vazhdoi të ndikojë në mënyrë disproporcionale tek komunitetet e margjinalizuara. Zbatimi i të drejtave në punë mbeti i dobët, me shqetësime të veçanta lidhur me kushtet e pasigurta të punës dhe mekanizmat joefektivë të inspektimit. Degradimi mjedisor, me ndotjen e rëndë të ajrit si një shqetësim i veçantë, vazhdon të ndikojë në të drejtën për shëndet dhe në të drejtën për jetë.

**16.** Të drejtat e disa kategorive vazhduan të kërkojnë mbrojtje urgjente dhe të fokusuar në vitin 2025. Gratë, fëmijët, personat me aftësi të kufizuara, personat LGBTI+, komunitetet jo-shumicë, të moshuarit dhe personat në lëvizje vazhduan të përballet me diskriminim dhe barriera në qasjen në shërbime. Këto përfshinin dhunën në baza gjinore, përjashtimin nga arsimit gjithëpërfshirës dhe punësimi, pabarazitë gjuhësore dhe përfaqësuese, barrierat në qasje fizike dhe institucionale, si dhe nivelin e ulët të besimit në institucionet publike.

**17.** Çështjet ndërsektoriale në vitin 2025 përfshinë drejtësinë tranzicionale, korrupsionin, pasojat e dëmshme klimatike dhe mosdiskriminimin. Progresi në trajtimin e çështjeve të trashëguara nga koha e luftës mbeti i kufizuar, me të mbijetuarit dhe komunitetet e prekura që vazhduan të përballet me vonesa në njohje, kompensime dhe mjete juridike efektive. Akuzat për korrupsion dhe zbatimi i ulët i rekomandimeve të organeve mbikëqyrëse vazhduan ta dobësojnë besimin në institucionet publike. Gjatë periudhës raportuese, presionet financiare mbi OSHC-të kufizuan më tej monitorimin dhe avokimin e pavarur, pavarësisht rolit të tyre qendror në dokumentimin e shkeljeve dhe avancimin e llogaridhënies institucionale.

# 5. PJESA A: TË DREJTAT CIVILE DHE POLITIKE

## 5.1 E drejta për jetën

**18.** E drejta për jetën, e cila përkufizohet si një e drejtë absolute, gëzon mbrojtjen më të gjerë në të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Ajo njihet në Nenin 3 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (DUDNJ), Nenin 6 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (PNDCP), dhe Nenin 2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Në përputhje me Nenin 6 të PNDCP, e drejta për jetë është “e drejta e lindur e çdo personi për jetë” dhe garanton që askush nuk mund të privohet “në mënyrë arbitrare nga jeta”. Për më tepër, Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Njeriut (UNHRC) thekson se nuk lejohet asnjë shmangie (derogim), edhe gjatë konfliktit të armatosur, gjendjeve të emergjencës publike apo krizave humanitare. Në vitin 2025, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut sqaroi se detyrimet pozitive të shteteve sipas Nenit 2 të KEDNJ shtrihen edhe në mbrojtjen e individëve nga dëmet mjedisore që rrezikojnë jetën. Në çështjen Cannavacciuolo dhe të tjerët kundër Italisë, Gjykata konstatoi shkelje të së drejtës për jetë për shkak të dështimit të zgjatur të autoriteteve për t’i parandaluar dhe për t’i adresuar rreziqet e njohura që vinin nga ndotja e rëndë mjedisore.<sup>5</sup>

**19.** Brenda kornizës kushtetuese të Kosovës, e drejta për jetë garantohet në Nenet 22 dhe 25 të Kushtetutës, ndërsa Neni 25 ndalon shprehimisht dënimin me vdekje, duke e përfruar Kosovën me standardet evropiane për të drejtat e njeriut. Detyrimi i shtetit në këtë drejtim nuk është vetëm negativ, duke ndaluar privimin arbitrar nga jeta, por është edhe pozitiv, pasi kërkon marrjen e masave të përshtatshme për të mbrojtur jetën e të gjithë personave që janë nën juridiksionin e tij.

**20.** Vlen të theksohet se edhe në vitin 2025, bartësit e detyrimeve dhe autoritetet përgjegjëse kanë vazhduar të demonstrojnë një qasje kryesisht reaktive ndaj femicidit në Kosovë.<sup>6</sup> Në të vërtetë, autoritetet vazhdojnë të përqendrohen kryesisht në raportim dhe ndjekje penale. Ky vlerësim mbështetet edhe në një studim të Grupit për Studime Juridike dhe Politike (GLPS), i cili identifikon mangësi sistematike të vazhdueshme, përfshirë mungesën e femicidit si vepër penale e veçantë, mosshfrytëzimin e mjaftueshëm të dispozitave për vrasje me motiv gjinor, koordinim të dobët institucional, mungesë të të dhënave të ndara sipas gjinisë, mungesë të mekanizmave të monitorimit si observatorët e femicidit, si dhe zbatim të kufizuar të masave mbrojtëse si monitorimi elektronik dhe kompensimi i viktimave.<sup>7</sup> Studimi gjithashtu dokumenton raste në të cilat dështimet e shtetit për t’i mbrojtur gratë janë njohur zyrtarisht nga Institucioni i Avokatit të Popullit dhe Gjykata Kushtetuese, duke nënvizuar se problemi nuk qëndron në mungesën e njohurive, por në mungesën e zbatimit. Në tërësi, këto gjetje konfirmojnë se, pavarësisht rritjes së dukshmërisë së femicidit dhe reagimit publik, përgjigjja e Kosovës mbetet e fragmentuar, e pamjaftueshme në aspektin ligjor dhe jokonistente në aspektin institucional, duke kërkuar jo vetëm reforma legjislative, por edhe zbatim të qëndrueshëm, sisteme të fuqishme të të dhënave, trajnime të synuara për aktorët e drejtësisë dhe sigurisë, si dhe mekanizma të dedikuar për monitorimin dhe parandalimin e femicidit.

5 Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (2025), [Rasti Cannavacciuolo dhe të tjerët kundër Italisë](#)

6 KWN (2025), [Zero Tolerance? Monitorimi i reagimit institucional ndaj dhunës me bazë gjinore në Kosovë.](#)

7 GLPS (2024), [Trajtimi institucional i rasteve të dhunës në familje 2023–2024.](#)

**21.** Në mungesë të vazhdueshme të një përgjigjeje shtetërore koherente dhe efektive, aktorët e shoqërisë civile në vitin 2025 mbetën kyç në përpjekjet e avokimit dhe koordinimit që synojnë parandalimin e femicidit dhe adresimin e faktorëve të tij strukturorë. Më 20 mars 2025, në Prishtinë u mbajt Forumi Barabar me titull “Strategji bashkëpunuese për t’i dhënë fund femicidit”, duke mbledhur mbi 30 pjesëmarrës, përfshirë përfaqësues të Policisë së Kosovës, Institucionit të Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës (IAPK), aktiviste për të drejtat e grave, si dhe përfaqësues të shoqërisë civile nga komunitetet shqiptarë, serb, romë, ashkali, egjiptian dhe komunitete të tjera. Forumi ofroi një hapësirë ndërinstitucionale dhe ndëretnike për ta shqyrtuar përhapjen e dhunës me bazë gjinore dhe femicidit në të gjitha komunitetet në Kosovë, si dhe për të formuluar strategji dhe rekomandime të përbashkëta për parandalim. Diskutimet riafirmuan se dhuna me baza gjinore shtrihet përtej ndarjeve etnike dhe sociale dhe se qasjet e qëndrueshme dhe bashkëpunuese mbeten thelbësore si për parandalimin, ashtu edhe për ofrimin e mbështetjes domethënëse dhe efektive për të mbijetuarit.<sup>8</sup>

**22.** Në vitin 2025, Gjykata e Apelit e ka lënë në fuqi dënimin me burgim të përjetshëm ndaj Edmond Lajqit, duke konfirmuar më 9 qershor 2025 se aktgjykimi i shkallës së parë i kishte vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë faktet e rastit dhe i kishte vlerësuar si duhet provat personale dhe materiale, përfshirë pranimin e fajësisë nga i akuzuari. Siç është raportuar më parë, Lajqi ishte dënuar me burgim të përjetshëm nga Gjykata Themelore në Pejë më 27 dhjetor 2024, pasi kishte pranuar fajësinë për vrasjen e bashkëshortes së tij, Gjyljeta Ukella, të kryer më 16 prill 2024 në Pejë. Gjykata e Apelit konstatoi se nuk ekzistojnë rrethana lehtësuese që do ta përjashtonin përgjegjësinë penale dhe konfirmoi se kualifikimi juridik i veprës dhe dënimi i shqiptuar ishin të justifikuar.<sup>9</sup> Sipas prokurorisë, vrasja ka ndodhur pas një historie të dhunës psikologjike dhe fizike të ushtruar nga kryesi ndaj viktimës, e cila ka kulmuar me vrasjen e saj me armë zjarri nga afërsia, duke i shkakuar vdekje të menjëhershme. Përveç dënimit për vrasje të rëndë, i pandehuri është shpallur fajtor edhe për mbajtje të paligjshme të armës.<sup>10</sup> Konfirmimi i dënimit me burgim të përjetshëm përbën një rast të rrallë të përfundimit gjyqësor në një rast femicidi. Për më tepër, në shkurt të vitit 2025, Gjykata e Apelit konfirmoi dënimin me burgim të përjetshëm ndaj Dardan Krivaqës për vrasjen e Marigona Osmanit, e cila humbi jetën si pasojë e lëndimeve jashtëzakonisht të rënda dhe brutale. Gjykata e Apelit e ka lënë në fuqi aktgjykimin e shkallës së parë të Gjykatës Themelore në Ferizaj.<sup>11</sup> Megjithatë, këto raste gjyqësore mbeten përjashtim, më shumë sesa dëshmi e një ndryshimi sistemik në përgjigjen e shtetit ndaj vrasjeve me bazë gjinore.<sup>12</sup>

**23.** Megjithatë, vendimet gjyqësore në rastet e Lajqit dhe Krivaqës, ndonëse pasqyrojnë dënime të duhura në vitin 2025, nuk shihen si masa parandaluese. Kjo dëshmohet nga një tjetër rast në tentativë i femicidit në nëntor të vitit 2025. Një grua në Gadime e Ulët (Lipjan) u sulmua brutalisht me sëpatë nga bashkëshorti i saj në një incident të klasifikuar nga prokuroria si vrasje e rëndë e mbetur në tentativë. Viktima mbijetoi dhe u shtrua në spital, ndërsa i dyshuari u arrestua pas një

8 CASA (2025), [Barabar Forum: Strategjitë bashkëpunuese për t’i dhënë fund femicidit](#).

9 RrGK (2025), [Një fije shprese dhe drejtësi për gratë e vrara në Kosovë](#).

10 RrGK (2025), [Reagimi i Rrjetit të Grave të Kosovës ndaj vrasjeve të fundit në Kosovë për shkak të armëve ilegale](#).

11 RrGK (2025), [Një fije shprese dhe drejtësi për gratë e vrara në Kosovë](#).

12 BetimiperDrejtësi (2025), <https://betimiperdrejtësi.com/apeli-verteton-denimin-me-burgim-te-perjetshem-ndaj-te-akuzuarit-per-vrasjen-e-bashkeshortes-se-tij-ne-peje/>

kërkimi intensiv. Në mënyrë kritike, sulmi ndodhi pavarësisht ekzistencës së një urdhri aktiv mbrojtës ndaj kryesit, duke nxitur shqetësim publik dhe kritika të ashpra nga organizatat për të drejtat e grave lidhur me dështimin në zbatimin efektiv të masave parandaluese. Rasti ilustron një boshllëk të vazhdueshëm midis kornizave ligjore formale dhe zbatimit të tyre në praktikë dhe thekson se, edhe kur gjykatat tregojnë ashpërsi pas kryerjes së veprës, mangësitë sistemike në mbrojtje dhe zbatim vazhdojnë t'i ekspozojnë gratë ndaj rrezikut ekstrem.<sup>13</sup>

**24.** Deri në vitin 2025, nuk është ndërmarrë asnjë ndjekje formale hetimore apo gjyqësore lidhur me vdekjen e një vajze katërvjeçare në Gjakovë në shkurt të vitit 2024. Siç është raportuar në raportin e OSHC-ve për vitin 2024, rasti ngriti shqetësime serioze lidhur me një dështim të mundshëm në kujdesin mjekësor dhe diskriminim të mundshëm etnik ndaj një fëmije nga një komunitet etnikisht i marginalizuar, duke nxitur disa OSHC, përfshirë anëtarë të HRN, të bëjnë thirrje për një hetim transparent dhe të plotë. Instituti i Mjekësisë Ligjore ka dorëzuar një raport në qershor të vitit 2024, i cili konstaton se fëmija ka vdekur si pasojë e një infeksioni në gjak.<sup>14</sup> Ky konstatim është kundërshtuar publikisht nga familja, e cila ka deklaruar se nuk beson që raporti i pasqyron rrethanat reale që kanë çuar në vdekjen e fëmijës. Edhe pse prindërit kanë raportuar lëndime të dukshme gjatë dërgimit të fëmijës në spital, raporti ka dalë me përfundimin se nuk janë identifikuar lëndime trupore. Mbyllja e mëvonshme e rastit, pavarësisht kundërshtimeve të prindërve, mund ta pasqyrojë një nivel të reduktuar të shqyrtimit nga autoritetet dhe një dobësim të llogaridhënies në rastet që përfshijnë një fëmijë nga një komunitet i marginalizuar.

**25.** Në vitin 2025, vetëvrasja mbetet një shqetësim serioz, me të dhënat e policisë që regjistrojnë 13 raste të vetëvrasjes gjatë nëntë muajve të parë të vitit, krahas një numri të lartë të thirrjeve në raste krizash dhe ndërhyrjeve online të trajtuara nga Qendra për Parandalimin e Vetëvrasjes Life-line. Këto shifra mund të jenë pjesërisht rezultat i mungesës së reagimit institucional, veçanërisht në mungesë të një kornize të dedikuar ligjore për parandalimin e vetëvrasjes.<sup>15</sup> Megjithatë në vitin 2024 një peticion i iniciuar nga OJQ QIPS dhe 15 OJQ të tjera, i cili i kërkonte Kuvendit të Kosovës hartimin e një Ligji për Parandalimin e Vetëvrasjes, është shoqëruar me masa të propozuara për parandalimin e vetëvrasjes, deri në vitin 2025 kjo ende nuk ka rezultuar në miratimin e një ligji specifik apo të një strategjie kombëtare që e adreson parandalimin e vetëvrasjes.

**26.** Në mesin e vitit 2025, jetëgjatësia në lindje në Kosovë është vlerësuar me 78.4 vjet, duke treguar një përmirësim të lehtë por të vazhdueshëm krahasuar me vitin paraprak 2024, kur shifra përkatëse ishte 78.20 vjet, që nënkupton një rritje prej 0.256 për qind gjatë periudhës njëvjeçare.<sup>16</sup>

**27.** Në vitin 2025, OJQ Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ngriti shqetësime se vdekja e një personi në Liqenin e Ujmanit më 27 korrik mund të përbëjë shkelje të detyrimit institucional për mbrojtjen e së drejtës për jetën. IKD argumenton se institucionet shtetërore nuk i kanë përmbushur obligimet e tyre ligjore për rregullimin dhe përcaktimin e zonave të notit, ndërkohë që njëkohësisht kanë promovuar Liqenin e Ujmanit si zonë rekreative, pavarësisht statusit të tij ligjor si burim i mbrojtur i ujit të pijshëm. Ata e kanë identifikuar mungesën e ndalimeve të qarta dhe masave të sigurisë, së bashku me komunikimin publik të pasaktë, si një rrezik të parashikueshëm për jetën, i

13 Syri (2025), [Arrestohet i dyshuari për sulmin me sëpatë ndaj bashkëshortës në një fshat të Lipjanit](#).

14 Indeksonline (2024), [Raporti i IML-së: Vdekja e vajzës 4-vjeçare në Gjakovë ishte natyrale, familja nuk e beson](#)

15 QIPS (2025), [Shërbimet e shëndetit mendor dhe kujdesit social në Kosovë](#).

16 Statbase (2025), [Jetëgjatësia në lindje në Kosovë](#).

cili kërkon hetim institucional sipas Nenit 2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.<sup>17</sup>

**28.** Në vitin 2025, ndotja e vazhdueshme e ajrit në Kosovë ngre shqetësime lidhur me detyrimin e shtetit për ta mbrojtur të drejtën për jetën. Vdekja e një ish-punëtori të minierës së qymyrit nga kanceri në mushkëri në Obiliq në vitin 2025, pas dekadash ekspozimi ndaj pluhurit toksik dhe emetimeve nga termocentralet përreth me qymyr, është lidhur drejtpërdrejt nga profesionistët mjekësorë me ndotjen afatgjatë mjedisore ndaj së cilës ai ishte ekspozuar.<sup>18</sup> Pavarësisht deklaratave institucionale për uljen e emetimeve, popullsia vazhdon të jetë e ekspozuar ndaj rreziqeve të parandalueshme për shëndetin si pasojë e ndotjes së rëndë të ajrit në Kosovë.<sup>19</sup>

## 29 Rekomandimet

- Kuvendi i Kosovës (KiK) duhet të ndërmarrë masa të menjëhershme për hartimin e një strategjie kombëtare për parandalimin e vetëvrasjes;
- Ministria e Punëve të Brendshme dhe Policia e Kosovës duhet të sigurojnë zbatimin efektiv të urdhrave mbrojtës në rastet e dhunës në familje, duke vendosur mekanizma të detyrueshëm për monitorim dhe reagim në kohë reale, përfshirë ndërhyrje të menjëhershme policore në rast të shkeljes;
- Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës duhet të zbatojë rregulloret detyruese mjedisore dhe të sigurojë publike për t'i parandaluar rreziqet e parashikueshme ndaj së drejtës për jetën.

## 5.2 Ndalimi i torturës, trajtimit mizor, çnjerëzor apo poshtëruar

**30.** Ndalimi i torturës dhe i trajtimit ose ndëshkimit mizor, çnjerëzor apo poshtëruar është një normë absolute e së drejtës ndërkombëtare. Ai është i sanksionuar në Nenin 5 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (DUDNJ), Nenin 7 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (PNDCP), Nenin 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), si dhe në Konventën kundër Torturës dhe Trajtimeve ose Ndëshkimeve të Tjera Mizore, Çnjerëzore apo Poshtëruese (CAT). Në nivel vendor, Neni 27 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës ndalon shprehimisht torturën dhe çdo formë të trajtimit ose ndëshkimit mizor, çnjerëzor apo poshtëruar. Natyra absolute dhe që nuk e lejon asnjë përjashtim e këtij ndalimi është konfirmuar nga Komiteti për të Drejtat e Njeriut (Komenti i Përgjithshëm nr. 20 (1992), PNDCP, neni 7). Komiteti kundër Torturës ka sqaruar më tej detyrimet e shteteve lidhur me zbatimin (Komenti i Përgjithshëm nr. 2 (2008)), dëmshpërblimin për viktimat (Komenti i Përgjithshëm nr. 3 (2012)) dhe parimin e moskthimit (Komenti i Përgjithshëm nr. 4 (2017)). Garancitë parandaluese dhe procedurale përforcohen përmes Protokollit Opsional të CAT-it (OPCAT), i cili kërkon monitorim të pavarur të vendeve të ndalimit përmes mekanizmave kombëtarë parandalues, si dhe përmes Protokollit të Stambollit (2022) dhe Rregullave Standarde Minimale të OKB-së për Trajtimin e të Burgosurve (Rregullat Nelson Mandela, 2015). Ndalimi i torturës përbën një normë imperative të së drejtës ndërkombëtare (jus cogens), e cila nuk lejon asnjë përjashtim në asnjë rrethanë dhe krijon detyrime erga omnes që janë

17 IKD (2025), [Instituti i Kosoves per drejtesi kerkon llogaridhenie per vdekjen tragjike ne liqenin Ujman](#).

18 Reuters (2025), [Kriza e ndotjes së ajrit në Ballkan kërcënon shëndetin publik dhe synimet për anëtarësim në BE](#).

19 Balkan Green Foundation (2025), [Helmi i Prishtinës që e bën çdo frymëmarrje një betejë](#).

të detyrueshme për të gjitha shtetet.

**31.** Në përputhje me Nenin 5 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (DUDNJ) dhe Nenin 27 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ndalimi i torturës dhe i trajtimit çnjerëzor apo poshtërues përfshin mbrojtjen e integritetit fizik dhe mendor, kushtet e ndalimit, përdorimin e forcës në mjedise me dhe pa privim lirie, si dhe reagimin e shtetit ndaj dhunës në familje dhe asaj në komunitet. Neni 3 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) vendos një detyrim absolut për shtetet jo vetëm që të përmbahen nga keqtrajtimi, por edhe të ndërmarrin masa pozitive për të parandaluar shkeljet, për të mbrojtur individët në rrezik dhe për të siguruar hetime të shpejta, të pavarura dhe efektive. Jurisprudenca e fundit e KEDNJ (2025) i ka riafirmuar këto detyrime pozitive, të cilat, në kuadër të rendit kushtetues të Kosovës, kërkojnë mekanizma efektivë parandalues, hetimorë dhe të llogaridhënies.<sup>20</sup>

**32.** Megjithëse korniza ligjore për parandalimin e torturës dhe keqtrajtimit ekziston, vazhdon të ketë mospërputhje në zbatimin e saj. Në veçanti, viti 2025 shënon dobësi në hetimin efektiv të ankesave dhe në përkthimin e garancive ligjore në praktikë. Në këtë drejtim, Mekanizmi Kombëtar Parandalues, i cili funksionon në kuadër të IAPK-së, ka realizuar 60 vizita të paparalajmëruara në vendet e ndalimit dhe ka nxjerrë rekomandime që theksojnë mangësi të vazhdueshme në kushtet e ndalimit, si dhe shqetësime serioze lidhur me mbrojtjen e personave me sëmundje mendore brenda sistemeve të drejtësisë dhe kujdesit social. Përveç personave me probleme të shëndetit mendor, ai e ka vlerësuar të nevojshme edhe marrjen e masave shtesë për t'i garantuar të drejtat e grupeve të cënueshme, duke i përfshirë gratë dhe komunitetet jo-shumicë.<sup>21</sup>

**33.** Në përputhje me rekomandimet e lartpërmendura, viti 2025 shënoi një sërë përpjekjesh për ngritjen e kapaciteteve të stafit korrektues dhe shëndetësor, me qëllim të përmirësimit të kushteve në institucionet korrektuese dhe forcimin e garancive kundër keqtrajtimit. Gjatë gjithë vitit, Këshilli i Evropës ka mbështetur ndërhyrje të shumta të synuara që e adresojnë kujdesin shëndetësor në burgje,<sup>22</sup> psikiatrinë forenzike dhe garancitë në institucionet e mbyllura. Këto e përfshijnë përmirësimin dhe zbatimin praktik të Procedurave Standarde të Operimit (PSO) për kujdesin shëndetësor në burgje dhe trajtimin psikiatrik forenzik,<sup>23</sup> me një theks të veçantë në pajtueshmërinë me Protokollin e Stambollit dhe mbrojtjen e personave të privuar nga liria. Aktivitetet specifike të trajnimit përfshijnë mekanizma të ndryshëm institucionalë, duke përfshirë anëtarë nga Shërbimi Korrektues i Kosovës (ShKK), ofrues të kujdesit shëndetësor në burgje, Institutin e Psikiatrisë Forenzike, inspektorët e burgjeve dhe Mekanizmin Kombëtar Parandalues kundër Torturës, dhe u fokusuan në dokumentimin dhe raportimin e keqtrajtimit, koordinimin ndërinstitutional, si dhe menaxhimin e grupeve të cënueshme, si personat me probleme të shëndetit mendor dhe të burgosurit ekstremistë të dhunshëm.<sup>24</sup> Ndërsa këto nisma tregojnë një ndërgjegjësim institucional në rritje dhe investim në profesionalizim, vetë shtrirja e tyre nënvizon shqetësime të vazhdueshme lidhur me kushtet e ndalimit, mekanizmat e llogaridhënies, si dhe nevojën për kapacitete të qëndrueshme parandaluese dhe hetimore, në mënyrë që garancitë ligjore kundër keqtrajtimit të real-

20 Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Këshilli i Evropës (2025), [Përmbledhje e jurisprudencës 2025](#).

21 Komisioni Evropian (2025), [Raporti i Kosovës 2025](#).

22 Këshilli i Evropës (2025), [Stafi i kujdesit shëndetësor mendor dhe i shërbimeve korrektuese në Kosovë ka përmirësuar njohuritë dhe aftësitë mbi kornizën procedurale në trajtimin e personave të privuar nga liria](#).

23 Këshilli i Evropës (2025), [Këshilli i Evropës mbështet Ministrinë e Shëndetësisë së Kosovës për të forcuar më tej ofrimin e kujdesit shëndetësor në burgje](#).

24 Këshilli i Evropës (2025), [Praktikuesit e burgjeve në Kosovë mësojnë nga kolegët e tyre për punën me të burgosurit e dhunshëm ekstremistë](#).

izohen efektivisht në praktikë brenda sistemit korrektues të Kosovës.<sup>25</sup>

**34.** Në këtë drejtim, OJQ Qendra Kosovare për Rehabilitimin e Viktimave të Torturës (QKMRT) vëren se, ndonëse në vitin 2024 Shërbimi Korrektues i Kosovës i ka ndarë 8 milionë euro për investime kapitale, përfshirë (i) ndërtimin e një objekti të ri korrektues për gratë në Lipjan, (ii) një objekt të ri korrektues në Prizren për qendrat e paraburgimit në rajonet e Prizrenit dhe Pejës, dhe (iii) renovimin e Institutit të Psikiatrisë Forenzike, asnjë nga këto projekte nuk ishte iniciuar apo përfunduar deri në vitin 2025.<sup>26</sup>

**35.** Vlen të theksohet se nga viti 2006 deri në qershor të vitit 2024, OJQ QKMRT kishte qasje për t'i monitoruar institucionet korrektuese në Kosovë. Megjithatë, në qershor 2024, Ministria e Drejtësisë (Shërbimi Korrektues) propozoi një marrëveshje të re monitorimi, të cilën OJQ QKMRT e refuzoi, duke e konsideruar si shkelje të misionit dhe mandatit të saj. Marrëveshja e re vendosi kufizime të reja, duke kërkuar që OJQ QKMRT t'i njoftojë paraprakisht autoritetet para se të kryejë vizita monitoruese, të marrë miratim paraprak nga të burgosurit, si dhe të përballet me pengesa shtesë burokratike për qasje në dosjet zyrtare të të burgosurve. Që nga marsi 2025, QKMRT e ka nënshkruar marrëveshjen e propozuar nga Ministria e Drejtësisë pavarësisht kufizimeve të lartpërmendura, pasi Ministria nuk ka shprehur gatishmëri për ndryshimin e saj. OJQ QKMRT paralajmëron se këto kufizime e dëmtojnë seriozisht monitorimin e pavarur të të drejtave të njeriut, duke ndikuar ndjeshëm në pasqyrimin e plotë të gjendjes së sistemit korrektues në Kosovë. Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës tani është i vetmi mekanizëm që ka autoritet për të kryer mbikëqyrje të tillë, ndërsa OJQ-të janë përjashtuar. Si rezultat, që nga marsi 2025, QKMRT e ka vazhduar monitorimin e kushteve të të drejtave të njeriut në institucionet korrektuese në Kosovë edhe me të gjitha kufizimet e përmendura. Memorandumi i Mirëkuptimit me Ministrinë e Drejtësisë do të skadojë në mars 2026 dhe mbetet e pasigurt nëse qeveria e ardhshme do të bëjë ndonjë ndryshim lidhur me kufizimet e vendosura në këtë memorandum aktual.<sup>27</sup>

**36.** OJQ QKMRT vëren se ankesat e të burgosurve kryesisht kanë të bëjnë me qasjen dhe cilësinë e shërbimeve shëndetësore. Pavarësisht sfidave të paraqitura nga Memorandumi i ri i Mirëkuptimit me Ministrinë e Drejtësisë lidhur me qasjen e QKMRT-së në institucionet korrektuese, vonesat në zbatimin e kësaj marrëveshjeje kanë ndikuar gjithashtu në praninë e monitoruesve të QKMRT-së në institucionet korrektuese gjatë vitit 2025, gjë që ka ndikuar edhe në mbulimin e situatës në institucionet korrektuese në Kosovë. Megjithatë, gjatë vitit 2025, OJQ QKMRT ka pranuar 79 thirrje nga të burgosurit që kanë shprehur ankesa të ndryshme, ku kanë dominuar rastet e vonesave në shqyrtimin e kërkesave për përdorimin e përfitimeve të ndryshme dhe për trajtim mjekësor.<sup>28</sup>

**37.** Në vitin 2025, QKMRT i ka regjistruar tre ankesa lidhur me përdorimin e forcës në institucionet korrektuese: një gjatë një vizite monitoruese në Burgun e Sigurisë së Lartë në Gërdovc në shtator 2025 dhe dy gjatë një vizite në Qendrën Korrektuese të Dubravës. Pavarësisht numrit të kufizuar të

25 Këshilli i Evropës (2025), [Këshilli i Evropës asiston autoritetet e Kosovës në forcimin e kapaciteteve institucionale për masat mbrojtëse kundër keqtrajtimit në burgje dhe institucione të tjera të mbyllura](#).

26 QKMRT (2026), kontribut për Raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

27 QKMRT (2026), kontribut për Raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

28 QKMRT (2026), kontribut për Raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

ankesave, mungesa e mekanizmave sistematikë dhe të vazhdueshëm të monitorimit kufizon një vlerësim gjithëpërfshirës të situatës. Në një plan më të gjerë, institucionet korrektuese në Kosovë kanë treguar përmirësime graduale në përafrimin e kushteve të ndalimit me standardet e të drejtave të njeriut në vitet e fundit, megjithëse boshllëqet në mbikëqyrje mbeten ende të dukshme.<sup>29</sup> OJQ QKMRT nuk ka marrë asnjë njoftim paraprak nga menaxhmenti i burgut lidhur me përdorimin e forcës në këto raste. Vetëm pasi ekipi monitorues e identifikoi dhe e raportoi incidentin, menaxhmenti reagoi, duke pohuar se forca e përdorur ishte e ligjshme dhe proporcionale në kuadër të kornizës ligjore në fuqi.<sup>30</sup>

**38.** Pavarësisht rritjes së numrit të të burgosurve me varësi nga droga që lidhet me veprat e tyre penale, OJQ QKMRT vëren se ata mbahen së bashku me popullatën e përgjithshme të burgjeve. Shërbimi Korrektues i Kosovës nuk ka një strategji të dedikuar apo programe të specializuara rehabilitimi për t'i adresuar nevojat e tyre për trajtim.<sup>31</sup>

**39.** Janë ngritur pretendime nga disa të burgosur se persona të privilegjuar po akomodohen në Pavijonin D në Qendrën Korrektuese të Dubravës, sipas QKMRT-së.<sup>32</sup> Fillimisht e themeluar si një institucion për persona me nevoja të veçanta, funksionalizimi i saj u vonua dhe kapaciteti i saj mbeti i kufizuar. Deri në vitin 2024, ajo ishte shëndërruar në një njësi që strehon ekskluzivisht persona të dënuar për periudha të përcaktuara rehabilitimi, me fokus në zhvillimin e aftësive dhe programe të strukturuar. QKMRT thekson se ky ndryshim përbën devijim nga qëllimi fillestar i pavijonit dhe reflekton mospërputhje të vazhdueshme në zbatimin e politikave korrektuese.

**40.** Në vitin 2025, sistemi i burgjeve në Kosovë vazhdoi ta adresojë ekstremizmin kryesisht përmes masave të rehabilitimit dhe çradikalizimit brenda institucioneve të tij të sigurisë së lartë, veçanërisht në Burgun e Dubravës dhe Burgun e Sigurisë së Lartë në Gërdovc.<sup>33</sup> Shërbimi Korrektues ka zbatuar një sërë programesh të dedikuara për personat e dënuar ose të dyshuar për vepra të lidhura me terrorizmin. Këto përfshijnë masa të rrepta të sigurisë të kombinuara me ndërhyrje psikosociale, si dhe trajnime të synuara për menaxhimin e zemërimit, kurrikula për çradikalizim dhe arsimim profesional, me qëllim të uljes së recidivizmit dhe të mbështetjes së riintegrit. Deri në periudhën raportuese, 168 persona kanë kaluar nëpër sistemin e burgjeve të Kosovës për vepra të lidhura me terrorizmin, ndërsa vetëm 16 prej tyre mbeten ende në paraburgim nën regjime të rritura sigurie, gjë që tregon një zhvendosje nga ndalimi në shkallë të gjerë drejt menaxhimit afatgjatë të riintegrit. Megjithatë, pavarësisht pjesëmarrjes në programe rehabilituese, autoritetet gjithashtu ballafaqohen me rezistencën e vazhdueshme të disa të burgosurve, e cila rrjedh nga bindje ideologjike të thella dhe të rrënjosura.

**41.** Në vitin 2025, Kosova dhe Danimarka e formalizuan bashkëpunimin e tyre për përdorimin e institucionit korrektues në Gjilan përmes nënshkrimit të një Marrëveshjeje Bashkëpunimi ndërmjet Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe Shërbimit të Burgjeve dhe Sprovës së Danimarkës.<sup>34</sup> Kjo marrëveshje operacionalizon traktatin dypalësh për transferimin e shtetasve të huaj të dënuar me dëbim në Danimarkë, i cili është ratifikuar në vitin 2024 dhe është dokumentuar tashmë në

29 QKMRT (2026), kontribut për Raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

30 QKMRT (2026), kontribut për Raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

31 QKMRT (2026), kontribut për Raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

32 QKMRT (2026), kontribut për Raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

33 Pristina Insight (2025), [Brenda burgjeve të Kosovës: programet e rehabilitimit synojnë mbështetjen e risocializimit](#).

34 Shërbimi Korrektues i Kosovës (2025), [Kosova dhe Danimarka nënshkruajnë marrëveshjen e bashkëpunimit](#).

raportin e OSHC-ve të vitit të kaluar. Marrëveshja e rregullon administrimin praktik të institucionit, përfshirë funksionimin e përditshëm dhe infrastrukturën, në përputhje me standardet e burgjeve daneze.<sup>35</sup> Ai e përcakton një model bashkëqeverisjeje, sipas të cilit burgu do të menaxhohet në mënyrë të përbashkët nga një guvernator i emëruar nga Danimarka dhe një drejtor i emëruar nga Kosova, me rreth 220 zyrtarë korrektues nga Kosova dhe staf shtesë danez, si dhe parashikon trajnime të gjera të personelit kosovar në përputhje me rregullat dhe praktikën e burgjeve daneze. Është me rëndësi të theksohet se Kosova mban përgjegjësi për kushtet në burgje, sigurinë dhe hetimet lidhur me vdekjet ose sjelljen e dyshuar të stafit korrektues. Kjo shpërndarje e fragmentuar e kompetencave mund ta rrezikojë dobësimin e llogaridhënies dhe mjeteve efektive juridike, si dhe t'i dobësojë garancitë kundër keqtrajtimit dhe shkeljeve të së drejtës për jetë brenda sistemit korrektues të Kosovës. Po ashtu, vlen të theksohet se kjo marrëveshje duket se po e vendos një precedent, me vende të tjera evropiane që po shqyrtojnë marrëveshje të ngjashme me Kosovën. Më konkretisht, në vitin 2025, Ministri i Drejtësisë së Belgjikës ka konfirmuar se Kosova po merret në konsideratë si një vend potencial për mbajtjen e të burgosurve, në kuadër të përpjekjeve për ta adresuar mbipopullimin në burgje dhe për t'i lehtësuar proceset e dëbimit (deportimit).<sup>36</sup>

**42.** Në Policinë e Kosovës, Procedurat Standarde të Operimit (PSO) e rregullojnë sjelljen e zyrtarëve gjatë hetimeve, marrjes në pyetje dhe mbajtjes së personave të arrestuar në paraburgim policor deri në 48 orë, duke i përfshirë garancitë kundër keqtrajtimit; këto PSO janë rishikuar dhe miratuar në vitin 2019. Llogaridhënia për sjellje të pahijshme rregullohet nga Udhëzimi Administrativ Nr. 04/2019 për Shkeljet Disiplinore, sipas të cilit shkeljet e lehta trajtohen nga Njësia për Standarde Profesionale, ndërsa shkeljet e rënda trajtohen nga Inspektorati Policor i Kosovës.

**43.** Pavarësisht kornizës ligjore të përshkruar më sipër, periudha raportuese e vitit 2025 tregon incidente të vazhdueshme të dhunës policore. Inspektorati Policor i Kosovës (IPK) ka rekomanduar në mënyrë të përsëritur suspendime dhe ka iniciuar hetime në përgjigje të rasteve që përfshijnë përdorim të tepruar të forcës, sjellje të pahijshme dhe vdekje në paraburgim. Në veçanti, ndërmjet prillit dhe gushtit 2025, IPK ka arrestuar ose rekomanduar suspendimin e disa zyrtarëve policorë nëpër komuna, përfshirë Kaçanik, Suharekë, Gjilan, Pejë dhe Klinë, duke përmendur abuzim me autoritetin, falsifikim të raporteve zyrtare ose përdorim të forcës ndaj të ndaluarve.<sup>37</sup> Në korrik të vitit 2025, tre zyrtarë policorë u suspenduan pas vdekjes së një të dyshuari në një stacion policor, një incident që tërhoqi vëmendje publike dhe nxiti një hetim nga Institucioni i Avokatit të Popullit.<sup>38</sup>

**44.** Në vitin 2025, informacioni i zbuluar përmes një raporti të brendshëm policor të shqyrtuar nga OJQ BIRN ka nxjerrë në pah dështime serioze dhe afatgjata institucionale brenda stacionit policor në Pejë, të cilat kanë implikime të drejtpërdrejta për parandalimin e keqtrajtimit dhe llogaridhënien për abuzim.<sup>39</sup> Raporti tregon se gjatë një periudhe dhjetëvjeçare, të paktën 197 kallëzime penale dhe 186 ankesa civile dhe disiplinore nuk janë përcjellë te prokuroria apo nuk janë trajtuar në mënyrë të brendshme. Mbajtja sistematike e dosjeve, e konfirmuar edhe nga hetimi në vazhdim i

35 Telegrafi (2025), [Dibrani: të burgosurit nga Danimarka pritet të vendosen në Gjilan në prill 2027.](#)

36 Belga (2025), [Belgjika shqyrton marrëveshje me Kosovën për burgjet e mbipopulluara.](#)

37 Insajderi (2025), [IPK arreston një zyrtar policor dhe rekomandon suspendimin e dy të tjerëve.](#)

38 Balkan Insight (2025), [Avokati i Popullit në Kosovë heton pretendimet për brutalitet policor pas vdekjes së një burri.](#)

39 BIRN (2025) i cituar në Balkan Insight (2025), [Stacioni i Policisë në Kosovë dështoi të trajtojë qindra raportime për vepra penale.](#)

IPK-së, tregon për dështime strukturore të cilat, ndonëse nuk dokumentojnë akte specifike torture, përfshijnë dështimin e zgjatur për të hetuar pretendime që lidhen me dhunë, sjellje të pahijshme dhe keqtrajtim.<sup>40</sup> Kjo ngre shqetësime serioze lidhur me efektivitetin e garancive kundër torturës dhe trajtimit apo ndëshkimit mizor, çnjerezor apo poshtëruës.

**45.** Më 23 maj 2025 në Mitrovicën e Veriut, një zyrtar i Policisë së Kosovës kapi për qafe një nxënës të shkollës së mesme nga komuniteti serb i Kosovës gjatë një parade tradicionale të maturës, pasuar nga një përleshje e shkurtër me disa zyrtarë policorë. Policia e ka pranuar incidentin dhe e ka justifikuar ndërhyrjen me “provokime” nga nxënësi. Megjithatë, policia nuk reagoi në mënyrë të ngjashme ndaj provokimeve të një individi shqiptar në një kafene aty pranë, duke e veçuar nxënësin serb.<sup>41</sup> Përveç këtij rasti, në vitin 2025 u shfaq edhe një rast tjetër i pretenduar i keqtrajtimit të një individi nga zyrtarët policorë gjatë arrestimit të tij në Soçanicë.<sup>42</sup>

**46.** Si rezultat i modeleve të vazhdueshme të keqtrajtimit policor dhe dobësive sistemike në mekanizmat e llogaridhënies, EULEX ka monitoruar dhe ka kryer një rishikim të 25 rasteve penale që përfshijnë zyrtarë policorë. Ky rishikim ka konstatuar se shumica e rasteve të dhunës kanë ndodhur jashtë ambienteve policore, ndonëse disa prej tyre janë regjistruar edhe brenda objekteve të ndalimit, dhe kanë përfshirë akte si shqelma, shuplaka dhe rrahje me shkopinj gome, përfshirë edhe ndaj të miturve.<sup>43</sup> Një përqindje e konsiderueshme e zyrtarëve të akuzuar i përkisnin njësive speciale policore, ndërsa veprimet hetimore shpesh janë vonuar, në disa raste për javë apo muaj, duke e cenuar efektivitetin e mbledhjes së provave dhe mbikëqyrjes gjyqësore. Si rezultat i këtyre gjetjeve, EULEX-i e ka rekomanduar vendosjen e kamerave trupore si masë parandaluese dhe si masë për rritjen e llogaridhënies, me qëllim të uljes së rrezikut të abuzimit dhe të forcimit të besimit publik në zbatimin e ligjit.<sup>44</sup>

## 47. Rekomandimet

- Ministria e Shëndetësisë dhe Shërbimi Korrektues i Kosovës duhet të krijojë shërbime të dedikuara të shëndetit mendor brenda institucioneve korrektuese, për të siguruar që të burgosurit me çrregullime të shëndetit mendor të marrin trajtim adekuat, të ndarë nga popullata e përgjithshme e të burgosurve;
- Ministria e Drejtësisë dhe Shërbimi Korrektues i Kosovës duhet ta rivendosin qasjen e parvarur të monitorimit në institucionet korrektuese, duke i hequr kushtet kufizuese që e cenojnë transparencën dhe llogaridhënien në menaxhimin e burgjeve;
- Inspektorati Policor i Kosovës duhet t’i forcojë mekanizmat e mbikëqyrjes brenda Policisë së Kosovës, duke siguruar hetime të shpejta dhe transparente në rastet e përdorimit të tepruar të forcës;
- Policia e Kosovës duhet të sigurojë sjellje jodiskriminuese dhe profesionale në ndërveprimet me komunitetet jo-shumicë.

40 ibid.

41 NSI (2026), kontribut për Raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

42 EULEX (2025), [Postim publik i EULEX-it në X](#).

43 Koha (2025), [EULEX rekomandon kamera në uniformat e policisë për të parandaluar keqtrajtimin](#).

44 Koha (2025), [EULEX rekomandon kamera në trup në uniformat e policisë për të parandaluar keqtrajtimin](#).

### 5.3 E drejta për liri dhe siguri personale

**48.** E drejta për liri dhe siguri personale mbrohet nga e drejta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, në veçanti në Nenin 9 të PNDCP dhe Nenin 5 të KEDNJ, të cilat e ndalojnë arrestimin dhe ndalimin arbitrar dhe kërkojnë ligjshmëri, mbikëqyrje gjyqësore dhe mjete juridike efektive. Siç është sqaruar nga Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Njeriut, liria dhe siguria përbëjnë një garanci të pandashme, që përfshin si mbrojtjen nga ndalimi i paligjshëm, ashtu edhe garancitë kundër abuzimit të pushtetit shtetëror. Në nivel vendor, Neni 29 i Kushtetutës së Kosovës kufizon heqjen e lirisë vetëm në situata të përcaktuara në mënyrë shteruese dhe e vendos atë nën kontroll gjyqësor, ndërsa rregullime të mëtejshme parashihen në Kodin e Procedurës Penale dhe në Kodin e Drejtësisë për të Mitur. Në vitin 2025, jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut riafirmoi rëndësinë qendrore të garancive të Nenit 5, veçanërisht nevojën për vlerësim individual, rishikim të shpejtë gjyqësor dhe mbrojtje të shtuar për personat e cenueshëm, standarde që mbeten drejtpërdrejt të zbatueshme në kornizën kushtetuese dhe ligjore të Kosovës.

**49.** Në vitin 2025, zbatimi i mbikëqyrjes elektronike sipas Ligjit Nr. 05/L-003 për Mbikëqyrjen Elektronike të Personave, Lëvizja e të Cilëve Kufizohet me Vendim të Gjykatës, kaloi nga një kornizë formale drejt përdorimit të kufizuar operacional. Duke u mbështetur në lansimin e sistemit të mbikëqyrjes elektronike në fund të vitit 2024, Policia e Kosovës raportoi se ndërmjet janarit dhe shtatorit 2025, byzylykët elektronikë u vendosën ndaj 30 personave, të gjithë burra dhe të përfshirë në raste të dhunës në familje, me përqendrimin më të lartë në rajonin e Prishtinës.<sup>45</sup> Në të njëjtën kohë, EULEX-i e ka mbështetur ngritjen e kapaciteteve institucionale përmes një punëtorie dyditore në prill 2025 për Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe Shërbimin Sprovues të Kosovës, me fokus në praktikën më të mira të mbikëqyrjes elektronike.<sup>46</sup> Megjithatë, shqetësime serioze vazhdojnë të ekzistojnë lidhur me transparencën, konsistencën dhe efektivitetin. Në një rast të profilit të lartë të femicidit të mbetur në tentativë në Lipjan, ku i dyshuari raportohej se kishte një urdhër aktiv mbrojtës, autoritetet nuk sqaruan nëse ishte vendosur mbikëqyrja elektronike. Kjo përbën një tregues të qartë të mungesës së shkëmbimit të informacionit dhe të masave të vlerësimit të rrezikut. Organizatat e shoqërisë civile kanë bërë thirrje për llogaridhënie institucionale dhe për një vlerësim publik të ndikimit të sistemit, duke e vënë në dukje mungesën e raporteve zyrtare që vlerësojnë nëse mbikëqyrja elektronike e ka forcuar në mënyrë efektive zbatimin e urdhrave mbrojtës apo e ka parandaluar përsëritjen e dhunës ndaj grave.

**50.** Në vitin 2025, dialogu formal i lehtësuar nga BE-ja ndërmjet Kosovës dhe Serbisë ka mbetur kryesisht i bllokuar, pa progres faktik. BE-ja vazhdon të organizojë diskutime përmes Përfaqësuesit të saj të Posaçëm, Peter Sørensen, dhe ka thirrur takime të kryenegociatorëve në Bruksel, ku janë trajtuar çështje si bashkëpunimi ekonomik dhe personat e zhdukur. Megjithatë, gjatë vitit 2025 nuk është arritur asnjë marrëveshje përparimtare.<sup>47</sup> Ndërsa qëndrimet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë mbeten të pandryshuara, situata në Kosovë është përkeqësuar nga ngërçi politik, i cili e ka karakterizuar klimën politike në vitin 2025 për shkak të dështimit të autoriteteve të Kosovës për ta

45 Dukagjini (2025), [30 burra të përfshirë në dhunë në familje u monitoruan me hallka elektronike](#).

46 Eulex (2025), [Futja e monitorimit elektronik në sistemin korrektues të Kosovës](#).

47 European Western Balkans (2025), [Sørensen priti një takim të gjatë me negociatorët e Serbisë dhe Kosovës, takimi i radhës në korrik](#).

konstituar Kuvendin e Kosovës, si dhe ndikimit të vazhdueshëm të masave kufizuese të BE-së të vendosura ndaj Kosovës.<sup>48</sup>

**51.** Situata e sigurisë në veri të Kosovës ka mbetur e paqëndrueshme që nga mesi i vitit 2022. Viti 2025 shënon vazhdimin e klimës së brishtë rreth Mitrovicës së Veriut. Në këtë drejtim, viti 2025 është karakterizuar nga modele të vazhdueshme të kontestimit të autoritetit dhe kontrollit territorial në komunat me shumicë serbe në veri të Kosovës. Paragrafët në vijim i përshkruajnë në detaje zhvillimet që kanë ndodhur në veri të Kosovës.

**52.** Në shkurt të vitit 2025, Policia e Kosovës e ka zhvilluar një operacion sigurie në fshatin Rodel, komuna Leposaviqit, pranë kufirit Kosovë - Serbi, gjatë të cilit në një shtëpi të braktisur është zbuluar një arsenal armësh, municionesh, pajisjesh ushtarake dhe uniformash. Në mesin e sendeve të sekuestruara ishin armë zjarri, fishekë, maska gazi, pajisje ushtarake, pajisje taktike, dokumentacion si dhe dhjetëra uniforma me shenjat e "Civilna Zaštita" ("Mbrojtja civile"), një strukturë paralele serbe e shpallur e paligjshme nga autoritetet e Kosovës. Sipas Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Policisë së Kosovës, ky zbulim përbën dëshmi se struktura paralele dhe të organizuara të sigurisë vazhdojnë të jenë aktive në veri të Kosovës.<sup>49</sup>

**53.** Prania e rrënjosur e armëve të paligjshme dhe kapaciteteve paramilitare brenda hapësirave civile vazhdon ta karakterizojë peizazhin e sigurisë në Mitrovicën e Veriut. Në qershor të vitit 2025, Policia e Kosovës e ka zhvilluar një operacion të koordinuar sigurie në një fshat të komunës së Zveçanit, i cili ka rezultuar me sekuestrimin e një sasive të konsiderueshme armësh të paligjshme dhe pajisjesh ushtarake. Operacioni është kryer pas informacioneve të inteligjencës që tregonin për praninë e armatimeve të fshehura dhe i ka përfshirë njësitë e Policisë së Kosovës në bashkëpunim me KFOR-in dhe EULEX-in.<sup>50</sup> Në mënyrë të veçantë, armët i'u zbuluan të fshehura nën tokë në tuba plastikë brenda një strukture të qëndrueshme dhe përfshinin armë zjarri, municione, granata dore dhe komponentë të armëve të rënda, politikanit serb Aleksandar Arsenijević, megjithëse nuk janë bërë publike detaje provuese lidhur me rastin.<sup>51</sup> Në shtator të vitit 2025, Policia e Kosovës ka zbuluar një sasi armësh të paligjshme, municionesh dhe pajisjesh të ngjashme në bodrumin e një ndërtese banimi pranë sheshit "Car Lazar" në Mitrovicën e Veriut, pas informacioneve të inteligjencës dhe një reagimi të shpejtë operativ. Sendet e sekuestruara përfshinin armë automatike dhe armë të gjata, municion, karikatorë, pranga dhe pajisje mbrojtëse, duke bërë që Prokurori i Shtetit të iniciojë procedura për mbajtje të paautorizuar të armëve, ndonëse në momentin e raportimit nuk ishte bërë asnjë arrestim.<sup>52</sup>

**54.** Për më tepër, në Zveçan, në prill të vitit 2025, është raportuar për një incident serioz sigurie kur dy granata dore janë hedhur ndaj ndërtesës së Postës së Kosovës pak pas mesnate, duke shkaktuar dëme materiale, por pa të lënduar. Sipas Policisë së Kosovës, njëra granatë ka shpërthyer, ndërsa tjetra ka mbetur e pashpërthyer brenda objektit, duke e detyruar evakuimin e banorëve përreth dhe një shpërthim të kontrolluar nga njësia e specializuar për çmontimin e mjeteve shpërthyes. Vendi i ngjarjes është siguruar nga policia, ndërsa Njësia Kundër Terrorizmit ka nisur veprime intensive hetimore për identifikimin e autorëve. Prokurori i Shtetit është njoftuar dhe ka udhëzuar

48 Prishtina insight (2025), [I dërguari i BE-së takon liderët e Kosovës, kërkon përparim në zbatimin e Marrëveshjes së Ohrit.](#)

49 Gazeta Express (2025), [Policia e Kosovës zbulon uniforma dhe municion në veri të vendit.](#)

50 Koha (2025), [Armë të sekuestruara në Zveçan, Sveçla thotë se u gjetën në objektin e një politikani serb.](#)

51 Koha (2025), [Armë të sekuestruara në Zveçan, Sveçla thotë se u gjetën në objektin e një politikani serb.](#)

52 Koha (2025), [Armë, municion dhe pajisje të paligjshme të sekuestruara në Mitrovicën e Veriut.](#)

që rasti të klasifikohet si “shkaktim i rrezikut të përgjithshëm”, duke e reflektuar seriozitetin e incidentit dhe implikimet e tij për sigurinë publike në Kosovë.<sup>53</sup>

**55.** Gjithashtu në prill të vitit 2025, agjencitë e sigurisë së Kosovës kanë zhvilluar një operacion të përbashkët gjatë dy ditëve (5–6 prill), i cili ka rezultuar me ndalimin e 16 personave që udhëtonin me katër automjete me targa serbe nga Kragujevci. Në mesin e tyre ishin katër pjesëtarë aktivë të shërbimeve të sigurisë së Serbisë. Katër të dyshuarit janë arrestuar në Gjakovë. Autoritetet raportuan se janë gjetur harta të Kosovës, fotografi të lidhura me incidentin në Banjskë, si dhe armë dhe pajisje të ndryshme. Kjo ka çuar në ndalimin e tyre për 48 orë me urdhër të prokurorit. Një tjetër grup prej 12 personash është ndaluar në Prizren, ku ata dyshohet se po qëndronin në Seminarin Teologjik Ortodoks, përfshirë dy zyrtarë aktivë të shërbimeve të sigurisë serbe të dyshuar për lidhje familjare ose profesionale me persona të përfshirë në incidente të dhunshme kundër Policisë së Kosovës. Autoritetet e Kosovës kanë deklaruar se përdorimi i një institucioni fetar mund të tregojë përpjekje për fshehjen e aktiviteteve ose nxitjen e tensioneve ndëretnike, ndërsa kanë theksuar se hetimet janë në vazhdim dhe publiku do të njoftohet për zhvillimet e mëtejshme.<sup>54</sup>

**56.** Në shtator të vitit 2025, Gjykata Themelore në Prishtinë ka urdhëruar 30 ditë paraburgim për një zyrtar të Policisë së Kosovës, nën dyshimin për spiunazh dhe veprime që e cenojnë rendin kushtetues të Kosovës. I dyshuari, Bojan Jevtić, një zyrtar policor i përkatësisë etnike serbe me origjinë nga Kamenica, dyshohet se ka zbuluar dokumente konfidenciale policore ndaj shërbimit shtetëror të inteligjencës së Serbisë, Agjencisë së Sigurisë dhe Informacionit (BIA). Sipas prokurorisë, materialet kanë të bëjnë me informacione të ndjeshme lidhur me strukturat e sigurisë dhe rendin kushtetues të Kosovës, megjithëse detajet nuk janë bërë publike për shkak të natyrës së klasifikuar të rastit. Hetimet e mëtejshme e lidhin transferimin e dyshuar të informacionit me një operacion të Policisë së Kosovës të zhvilluar në shtator 2023, menjëherë pas një sulmi të armatosur vdekjeprurës në veri të Kosovës, në të cilin ishte vrarë një zyrtar policor i Kosovës. Ndërsa mbrojtja ka kërkuar arrest shtëpiak dhe ka ofruar garanci financiare, gjykata ka vlerësuar se paraburgimi është i domosdoshëm. Rasti ngre shqetësime serioze lidhur me kërcënimet e brendshme, infiltrimin institucional dhe cenueshmëritë brenda sektorit të sigurisë në Kosovë, veçanërisht në kontekstin e zhvillimeve të sigurisë pas Banjskës dhe tensioneve të vazhdueshme rajonale.<sup>55</sup>

**57.** Më 7 qershor 2025, Arbnor Spahiu, ish-pjesëtar i Njësisë Speciale të Policisë së Kosovës, është arrestuar nga Serbia në pikën kufitare Horgosh, gjatë kthimit nga Austria, dhe është vendosur në paraburgim nga Gjykata e Lartë në Suboticë, nën dyshimin serb për vrasje të rënduar të dyshuar si e lidhur me sulmin në Banjskë të 23 shtatorit 2023.<sup>56</sup> Autoritetet e Kosovës i kanë hedhur poshtë këto pretendime, duke theksuar se Spahiu e kishte lënë Policinë e Kosovës në vitin 2022 dhe kishte qenë duke jetuar ligjërisht në Gjermani. Pas disa vazhdimeve të paraburgimit dhe angazhimit të vazhdueshëm diplomatik dhe ligjor nga institucionet e Kosovës, Spahiu u lirua pas rreth pesë muajsh në paraburgim dhe u kthye në Kosovë më 21 nëntor 2025.<sup>57</sup>

53 Gazeta Express (2025), [Dy granata dore u hodhën nga persona të panjohur, banorët u evakuuan – detaje nga shpërthimi në Zveçan.](#)

54 Indeksonline (2025), [Sveçla jep detaje të reja për serbët e arrestuar: 12 prej tyre në Prizren.](#)

55 Prishtina Insight (2025), [Zyrtar policor serb në Kosovë ndalohet nën dyshime për spiunazh.](#)

56 Balkan Insight (2025), [Kosova kërkon lirimin e ish-policit të ndaluar nga Serbia.](#)

57 BetimiperDrejtësi (2025), <https://betimiperdrejtësi.com/ish-polici-arbnor-spahiu-lirohet-nga-burgu-ne-serbi/>

**58.** Që nga 13 qershori 2025, autoritetet e Kosovës i kanë dëbuar pesë anëtarë të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë që jetonin në Kosovë, duke i justifikuar këto masa me arsye të sigurisë kombëtare, përfshirë dëbimin dhe, në disa raste, revokimin e shtetësisë në bazë të Ligjit për Shtetësinë, siç është konfirmuar nga Ministri në detyrë i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla. Zëdhënësi i BE-së ka reaguar duke theksuar se masa të tilla duhet të përdoren vetëm si mjet i fundit dhe duhet të ndjekin një proces të rregullt ligjor, në përputhje me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, veçanërisht Nenin 8 që kërkon vlerësime individuale dhe të bazuara në prova. BE-ja ka deklaruar se po e monitoron nga afër këtë çështje dhe ka bërë thirrje që autoritetet e Kosovës të sigurojnë respektimin e të drejtave themelore dhe qasjen në mjete juridike, qëndrim i mbështetur edhe nga ambasadat gjermane dhe italiane si dhe nga OSBE-ja.<sup>58</sup>

**59.** Një raport i fundit i vitit 2025 nga OJQ CASA konstaton se perceptimet e pasigurisë në mesin e serbëve-K në veri mbeten të larta dhe lidhen ngushtë me mosbesimin e thellë ndaj Policisë së Kosovës dhe Qeverisë. Raporti e lidh këtë me tërheqjen masive të policëve dhe stafit gjyqësor serb në fund të vitit 2022 dhe me sulmin në Banjskë në shtator 2023, duke vënë në dukje krijimin e një vakumi sigurie që është mbushur me dislokimin e zgjatur të njësive speciale policore, bazave të fortifikuara dhe forcave të reagimit të shpejtë. Të dhënat e anketave tregojnë se shumica e serbëve-K e vlerësojnë situatën e sigurisë si të pakënaqshme, raportojnë besim shumë të ulët në polici dhe në mekanizmat mbikëqyrës, dhe e identifikojnë praninë e shtuar të njësive speciale, kufizimet në furnizimet esenciale dhe krimin e organizuar si faktorët kryesorë të pasigurisë, ndërsa shprehin besim relativisht më të lartë tek KFOR-i. Tërheqja e zyrtarëve serbë ka krijuar një deficit të vazhdueshëm përfaqësimi në polici, të cilin përpjekjet për rekrutim nuk kanë arritur ta adresojnë.<sup>59</sup>

**60.** OJQ Nisma e Re Sociale (NSI) vëren se më 15 janar 2025, gjatë operacioneve që synonin institucionet e drejtuara nga Serbia në jug të lumit Ibër, Policia e Kosovës e ka ndaluar përkohësisht Kryetarin e Trupit të Përkohshëm Komunal të Lipjanit (Milan Joksimović) dhe tre punonjës, si dhe Kryetarin e Trupit të Përkohshëm Komunal të Vushtrrisë (Milan Kostić).<sup>60</sup>

**61.** Sipas NSI-së, në mbrëmjen e 6 marsit 2025, gjashtë të mitur (rreth moshës 14–16 vjeç) janë ndaluar nga Policia e Kosovës në pjesën veriore të Mitrovicës pas raportimeve për një përleshje ndëretnike mes grupeve të të rinjve. Grupi i ndaluar përbëhej nga katër djem serbë të Kosovës, një boshnjak dhe dy djem shqiptarë. Sipas policisë dhe informacioneve fillestare, të rinjtë janë ndaluar nën dyshimin për pjesëmarrje në një përleshje mes adoleshentëve serbë dhe shqiptarë. Megjithatë, pas shqyrtimit të pamjeve të kamerave të sigurisë, autoritetet kanë konstatuar se tre nga djemtë serbë nuk kishin qenë të përfshirë në incident dhe janë liruar pothuajse menjëherë. Njëri nga të miturit që mbeti në ndalim, një djalë boshnjak, më vonë ka pretenduar se është keqtrajtuar dhe është sulmuar fizikisht gjatë mbajtjes në stacion policor. Në deklaratën e tij, ai ka përshkruar se është ndaluar nga zyrtarët policorë, i janë vendosur prangat, është shtyrë përtokë, është goditur me shuplaka, grushte dhe shqelma, përfshirë goditje në kokë dhe brinjë gjatë marrjes në pyetje në një dhomë pa kamera. Ai ka deklaruar gjithashtu se dritat janë fikur dhe perdet janë mbyllur gjatë një pjese të këtij trajtimi të pretenduar, dhe se është detyruar që t'i japë emrat e të rinjve të tjerë me të cilët kishte qenë. Sipas tij, gjatë kësaj kohe nuk i është mundësuar qasja tek prindërit apo avokati. Më 8 mars 2025, incidenti ka nxitur një protestë publike në Mitrovicën e Veriut, e or-

58 Reporterit (2025), [BE: Përfshirja e pjesëtarëve të policisë serbe duhet të ishte zgjidhja e fundit](#).

59 CASA (2025), [Ndërtimi i besimit dhe forcimi i sigurisë përmes angazhimit të Policisë së Kosovës me komunitetin serb të Kosovës](#).

60 NSI (2026), kontribut për Raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

ganizuar nga prindërit e të miturve të ndaluar, përfshirë familjen e djalit boshnjak.<sup>61</sup>

**62.** Më 25 prill 2025, OJQ NSI ka vënë në dukje se grafiti me mbishkrimin “UÇK” është shfaqur në murin e një shtëpie në Gorazhdec në komunën e Pejës, një fshat me shumicë serbe të Kosovës.<sup>62</sup>

**63.** Më 7 maj 2025, OJQ NSI deklaroi se gjatë një ngjarjeje tradicionale fshatare në Rapçë, ku morën pjesë mijëra persona, Policia e Kosovës ka ndaluar një të mitur 17-vjeçar pasi ka vërejtur se ai mbante një bluzë me një hartë të Kosovës dhe mbishkrimin “Dragaš, Kosovo i Metohija” në alfabet cirilik. I riu është marrë në pyetje dhe më pas është liruar për t’u mbrojtur në liri.

**64.** Më 16 qershor 2025, Kryetari i Komunës së Kllokotit, Vladan Bogdanović, është ndaluar përkohësisht në pikën kufitare Dheu i Bardhë dhe është marrë në pyetje për rreth 2.5 orë, sipas NSI-së.

**65.** Më 28 qershor 2025, OJQ NSI ka vënë në dukje se në kuadër të përkujtimeve të Vidovdanit, Policia e Kosovës ka ndaluar një numër serbësh në disa ndërhyrje të veçanta. Fillimisht, në Graçanicë pranë Manastirit, Policia e Kosovës ka ndaluar V.P., i identifikuar si organizator i një grupi pelegrinësh nga Beogradi që kishte ardhur për të marrë pjesë në ceremonitë e Vidovdanit. Grupi raportoi se mbante bluza me ngjyrat kuqe, blu dhe bardhë me mbishkrimin “Serbia e Bashkuar” kur policia është afruar dhe ka kërkuar identifikim, para se ta ndalonte atë përpara manastirit.<sup>63</sup>

**66.** Ngjashëm, OJQ NSI vëren se gjatë përkujtimit të Vidovdanit në Graçanicë dhe në kompleksin memorial të Gazimestanit, Policia e Kosovës ka ndaluar një numër serbësh të Kosovës në disa ndërhyrje të veçanta. Ndalimet janë kryer pasi zyrtarët kanë gjetur individë në posedim ose duke shfaqur flamuj kombëtarë serbë, simbole të lidhura me sportin, si dhe veshje apo aksesore me simbole historike ose patriotike. Personat e ndaluar janë shoqëruar në stacionet policore për marrje në pyetje, ndërsa policia ka përmendur dyshime lidhur me nxitje të urrejtjes ose prishje të rendit publik. Disa nga të ndaluarit janë liruar pas marrjes në pyetje, ndërsa ndaj disa të tjerëve janë iniciuar procedura.<sup>64</sup>

**67.** Për më tepër, më 28 qershor 2025, pranë kompleksit memorial të Gazimestanit, Policia e Kosovës ka ndaluar Stefan Veljković, nënkryetar i partisë “Demokracia Serbe”, në prag të ceremonisë për Vidovdan. Ndalimi ka ardhur pasi policia ka identifikuar se Veljković mbante një bluzë me imazhin e kryetarit të partisë, Aleksandar Arsenijević. Në atë kohë, Arsenijević nuk ndodhej në Kosovë, pasi autoritetet kosovare raportohet se po e kërkonin në lidhje me armë të gjetura në një objekt të regjistruar në emrin e tij. Më vonë gjatë të njëjtës ditë, Veljković dhe disa anëtarë të tjerë të partisë, përfshirë Ivan Orlović, Aleksandar Acković, Zoran Obrenović dhe Aleksandar Lazović, janë ndaluar sërish nga policia pranë një rrethrotullimi në Vushtrri dhe janë dërguar në stacion policor. Sipas deklarimeve të tyre, nuk janë informuar për arsyet e ndalimit, nuk u është lejuar kontakti me avokat apo familjarë dhe janë marrë në pyetje për qëndrimet dhe aktivitetet e tyre politike, përf-

61 NSI (2026), kontribut për Raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

62 NSI (2026), kontribut për Raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

63 NSI (2026), kontribut për Raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

64 NSI (2026), kontribut për Raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

shirë kërkesa për të hapur telefonat mobil, të cilat i kanë refuzuar pa urdhër gjykatë. Grupi raportohet se është mbajtur për rreth gjashtë orë. Të gjithë të ndaluarit janë liruar më vonë të njëjtën natë pa akuza, gjopa apo vendime me shkrim, dhe sipas raportimeve u është thënë nga policia se ishin “të lirë për momentin”. Në kohën e raportimit nuk është dhënë asnjë shpjegim zyrtar lidhur me procedura të mundshme të mëtejshme.<sup>65</sup>

**68.** Më 1 shtator 2025, OJQ NSI raportoi se Policia e Kosovës ka ndaluar dy të mitur serbë-K, të moshës 15 dhe 16 vjeç, nga Zubin Potoku, pas një kontrolli të një autobusi shkollor që operonte në linjën Mitrovicë e Veriut–Zubin Potok. Djemtë janë ndaluar për shkak të mbishkrimeve dhe motiveve në bluzat që mbanin, të cilat policia i ka cilësuar si slogane dhe imazhe fyese, përfshirë “Çetnikët e Veriut” dhe “Ju luftoni, veriu do të digjet”, si dhe motive të lidhura me kulturën e tifozëve të “Crvena Zvezda” (Ylli i Kuq) të Beogradit. Të miturit janë dërguar në stacionin policor në Mitrovicën e Veriut dhe janë marrë në pyetje në prani të një punonjësi social, dhe më pas janë gjobitur për shfaqjen e asaj që policia e ka cilësuar si “përmbajtje të turpshme ose fyese”, përpara se të liroheshin.

**69.** Më 6 shtator 2025, OJQ NSI raportoi se Policia e Kosovës ka ndaluar Lazar Milosavljević, një banor serb-K i Leposaviqit, pasi ai kishte dalë nga shtëpia për të hedhur mbeturinat shtëpiake. Sipas raportimeve të mediave, policia e ka ndaluar atë për shkak se mbante një bluzë me imazhin e Princ Lazarit mbi një hartë të Kosovës dhe Metohisë, të cilën zyrtarët e kanë vlerësuar si përmbajtje të papërshtatshme ose provokuese. Milosavljević është dërguar në stacion policor për marrje në pyetje, ku rasti është trajtuar, dhe më pas është liruar.<sup>66</sup>

**70.** Më 6 shtator 2025, OJQ NSI ka raportuar se grafitë me mbishkrimet “UÇK” dhe “Adem Jashari” janë vërejtur pranë një kishe lokale në fshatin Batushë, në komunën Fushë Kosovës. Grafitet janë shkruar në një sipërfaqe në afërsi të drejtpërdrejtë të objektit kishtar dhe janë vërejtur nga banorët lokalë menjëherë pas shfaqjes së tyre. Më tej, më 10 shtator 2025, grafitë me mbishkrimin “UÇK” janë raportuar të jenë shkruar në asfaltin e një rruge lokale në fshatin Stanishor, në komunën e Novobërdës.

**71.** Natën e 18 shtatorit 2025, OJQ NSI vëren se Policia e Kosovës ka hyrë në kompleksin e KBC-së Kosovska Mitrovica, përfshirë edhe kabinën e sigurisë që shërben si për spitalin ashtu edhe për Qendrën e Shëndetit në Mitrovicën e Veriut. Sipas raportimeve, zyrtarët policorë kanë kryer kontroll të objektit në orët e vona të natës, duke qëndruar brenda kompleksit për një periudhë të kufizuar kohore. Në atë kohë nuk është publikuar asnjë informacion zyrtar lidhur me bazën e kontrollit, nëse është paraqitur ndonjë urdhër, apo nëse operacioni ka pasur për qëllim gjetjen e ndonjë sendi apo personi, si dhe nëse ka pasur ndalime.<sup>67</sup>

**72.** Më 8 tetor 2025, Policia e Kosovës ka ndaluar një djalë 15-vjeçar në Mitrovicën e Veriut pasi është vërejtur duke mbajtur një bluzë me mbishkrimin “Žandarmerija” dhe një emblemë serbe. Policia e Kosovës ka konfirmuar se i mituri është dërguar në stacion policor, është gjobitur me 300 euro për prishje të rendit dhe qetësisë publike, dhe më pas është liruar menjëherë.<sup>68</sup>

65 NSI (2026), kontribut për Raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

66 NSI (2026), kontribut për Raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

67 NSI (2026), kontribut për Raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

68 NSI (2026), kontribut për Raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

**73.** Më 22 tetor 2025, grafitet me mbishkrimin "UÇK" janë shfaqur në disa shtylla elektrike përgjatë rrugës në fshatin Dobërton, afër Lipjanit, pranë Shkollës Fillore "Knez Lazar". Grafitet ishin të dukshme në shtyllat përgjatë rrugës që shpie drejt fshatit fqinj Sllovi, dhe ndonëse shumë prej tyre më vonë janë mbuluar me bojë nga banorët lokalë me kërkesë të Policisë së Kosovës, mbishkrimi ka mbetur i dukshëm në të paktën dy shtylla.<sup>69</sup>

**74.** Më 2 dhjetor 2025, grafitet me mbishkrimin "UÇK" janë shkruar në ndërtesa të braktisura përgjatë rrugës kryesore Prishtinë - Rashkë, në zonën e Kërshit të Dudës, në kuadër të komunës së Mitrovicës së Veriut. Grafitet janë shfaqur në objekte pranë rrugës dhe janë dokumentuar në orët e mëngjesit nga vëzhgues lokalë dhe media.<sup>70</sup>

### 75. Rekomandimet

- Inspektorati Policor i Kosovës duhet të sigurojë mbikëqyrje dhe transparencë lidhur me operacionet policore, veçanërisht në veri të Kosovës, duke garantuar respektimin e rreptë nga Policia e Kosovës të procedurave ligjore që sigurojnë qasje të papenguar në përfaqësim ligjor për të gjithë personat e ndaluar;
- Inspektorati Policor duhet të iniciojë hetime të shpejta dhe transparente lidhur me pretendimet për ndalim të paligjshëm dhe keqtrajtim nga ana e zyrtarëve policorë, përfshirë rastet që përfshijnë të mitur dhe komunitete jo-shumicë.

69 NSI (2026), kontribut për Raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

70 NSI (2026), kontribut për Raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

## 5.4 E drejta për proces të drejtë gjyqësor dhe mjete juridike efektive

**76.** E drejta për një proces të drejtë gjyqësor dhe për mjete juridike efektive është e konsoliduar fuqishëm në të drejtën ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Ajo artikullohet fillimisht në nenin 10 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (DUDNJ), i cili e garanton të drejtën për një seancë të drejtë dhe publike, dhe përforcohet nga neni 8, i cili e afirmon të drejtën për një mjet juridik efektiv. Këto garanci janë të kodifikuara juridikisht në Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (PNDCP), veçanërisht në nenin 14 mbi të drejtën për gjykim të drejtë dhe nenin 2(3), i cili i obligon shtetet që të sigurojnë mjete juridike efektive dhe të zbatueshme. Fusha e këtyre detyrimeve është sqaruar më tej nga Komiteti për të Drejtat e Njeriut në Komentin e Përgjithshëm nr. 32 (2007) dhe Komentin e Përgjithshëm nr. 31 (2004). Në nivel rajonal, nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) sanksionojnë të drejta përkatëse, ndërsa Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut e ka theksuar rëndësinë thelbësore të qasjes në drejtësi, përfshirë domosdoshmërinë e ndihmës juridike në rrethana të caktuara (Airey kundër Irlandës, 1979). Udhëzime plotësuese ofrohen nga Parimet Bazë të OKB-së për Pavarësinë e Gjyqësorit, ndërsa detyrime paralele riafirmohen në instrumente sektoriale si Konventa kundër Torturës dhe Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor.

**77.** Këto garanci ndërkombëtare janë të inkorporuara drejtpërdrejt në rendin juridik të brendshëm dhe janë detyruese për të gjitha autoritetet publike. Kushtetuta e garanton të drejtën për një proces të drejtë gjyqësor përmes nenit 30 mbi të drejtat e të akuzuarit dhe nenit 31 mbi të drejtën për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, ndërsa neni 32 përcakton të drejtën për mjete juridike efektive kundër akteve gjyqësore dhe administrative që i cenojnë të drejtat ose interesat individuale. Këto mbrojtje kushtetuese operacionalizohen përmes një kuadri të gjerë legjislativ që i rregullon procedurat penale, civile dhe administrative, përfshirë Kodin e Procedurës Penale (Nr. 08/L-032), Kodin Penal (Nr. 06/L-074), Ligjin për Procedurën Kontestimore (Nr. 03/L-006) dhe Ligjin për Konfliktet Administrative (Nr. 08/L-182), të cilat së bashku e rregullojnë drejtësinë procedurale, qasjen në drejtësi dhe sigurimin e mjeteve juridike në të gjitha fushat e së drejtës.

**78.** Pas publikimit të Udhëzuesit të parë Praktik mbi Kriteret e Pranueshmërisë për referime individuale nga Gjykata Kushtetuese, në bashkëpunim me OJQ-në Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), në vitin 2024, si një mjet për t'u ndihmuar aplikuesve dhe praktikuesve ligjorë në përmbushjen e kërkesave procedurale sipas Kushtetutës dhe Rregullores së Punës së Gjykatës, Gjykata ka vazhduar ta mbështesë qasjen në drejtësi përmes publikimit të buletineve të rregullta të jurisprudencës dhe vendimeve individuale. Për periudhën 2025, përmbledhje të praktikës gjyqësore janë vënë në dispozicion për periudha që përfshijnë janar - mars 2025 dhe më tej, duke e reflektuar shqyrtimin e vazhdueshëm të të drejtave kushtetuese dhe mjeteve juridike nga ana e saj.<sup>71</sup> Megjithëse këto masa mund të mos kontribuojnë drejtpërdrejt në komponentin substancial të së drejtës për një proces të drejtë gjyqësor apo për mjete juridike efektive, ato e përmirësojnë qartësinë procedurale dhe qasjen në drejtësinë kushtetuese nga një perspektivë praktike.

**79.** Raporti i mëparshëm i OShC-ve e dokumentoi ndryshimin e vitit 2024 të Ligjit Nr. 04/L-017 për Ndihmë Juridike Falas, përfshirë zgjerimin e ndihmës juridike falas për gazetarët si dhe zhven-

71 Gjykata Kushtetuese, [Vendimet e publikuara gjate muajit Shkurt 2025.](#)

dosjen institucionale të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas nën Ministrinë e Drejtësisë.<sup>72</sup> Në një raport të vitit 2025 mbi zbatimin e standardeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Kosovë, OJQ-ja Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) e vlerëson funksionimin në praktikë të ndihmës juridike falas, duke konstatuar se qasja në përfaqësim ligjor në gjykatat e Kosovës është përgjithësisht e lartë dhe në masë të madhe në përputhje me standardet për një proces të drejtë gjyqësor, veçanërisht në procedurat penale.<sup>73</sup> Megjithatë, raporti ngre shqetësime serioze lidhur me pavarësinë institucionale të agjencisë, duke përfunduar se varësia e saj nga Ministria e Drejtësisë është në kundërshtim me garantitë kushtetuese dhe jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut<sup>74</sup>, dhe se Draft Dokumenti i Konceptit i vitit 2024 nuk arrin t'i adresojë në mënyrë adekuate rreziqet e politizimit apo ta garantojë autonominë e ofrimit të ndihmës juridike falas.<sup>75</sup>

**80.** Një raport i OJQ-së IKD mbi drejtësinë civile në Kosovë për vitin 2025 ilustron më tej se kohëzgjatja e tepruar e procedurave mbetet një nga pengesat kryesore për gëzimin efektiv të së drejtës për një proces të drejtë gjyqësor në praktikë. Bazuar në analizën e 200 aktgjykimeve të shkallës së parë, raporti ka konstatuar se kohëzgjatja mesatare e rasteve civile në Gjykatat Themelore ishte afërsisht 875 ditë, me dallime të konsiderueshme ndërmjet gjykatave; kohëzgjatja më e gjatë mesatare është regjistruar në Gjykatën Themelore në Prishtinë, e ndjekur nga ajo në Mitrovicë. Raporti gjithashtu ka gjetur se procedurat në Gjykatën e Apelit zgjasin mesatarisht 611 ditë, të llogaritura nga nxjerrja e aktgjykimit të shkallës së parë deri te vendimi i apelit. Të marra së bashku, këto të dhëna tregojnë se një rast civil, nga iniciimi deri në përfundimin e tij me vendim të formës së prerë, zgjat mesatarisht rreth 1,451 ditë. Këto vonesa ngrenë shqetësime serioze lidhur me pajtueshmërinë me standardin kushtetues dhe të Konventës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm dhe konfirmojnë se procedurat civile të zgjata vazhdojnë ta cenojnë qasjen efektive në drejtësi dhe sigurinë juridike në Kosovë.<sup>76</sup>

**81.** Në shqyrtimin e zbatimit të jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Kosovë, të përmendur më sipër, OJQ IKD ka konstatuar se kohëzgjatja mesatare e procedurave civile, e llogaritur nga paraqitja e padisë deri në nxjerrjen e aktgjykimit të shkallës së parë, arrin në 1,546 ditë. Këto vonesa ngrenë shqetësime serioze lidhur me pajtueshmërinë me të drejtën për gjykim të drejtë brenda një afati të arsyeshëm.<sup>77</sup> Përveç kësaj, raporti i IKD-së ka gjetur se në procedurat penale, koha mesatare ndërmjet iniciimit të procedurave përmes ngritjes së aktakuzës në rastet penale ose padisë në rastet civile dhe administrative, deri në nxjerrjen e aktgjykimit të shkallës së parë, është 1,256 ditë, që përkon me pothuajse tre vjet e gjysmë.

**82.** Sipas raportit të vitit 2025 të OJQ-së IKD mbi drejtësinë civile, gjyqësori ka shënuar progres të matshëm në uljen e numrit të lëndëve civile të pazgjidhura, por ngarkesa e përgjithshme mbetet e lartë dhe vazhdon të ndikojë në efikasitetin e procedurave. Në vitin 2025, gjykatat në të trija nivelet kanë nisur vitin me 139,858 lëndë civile të pazgjidhura dhe e kanë përfunduar me 129,641

72 HRN (2025), [Raporti i Shoqërisë Civile për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2024](#).

73 IKD (2025), [Zbatimi i jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Kosovë](#).

74 IKD (2021), "Politizimi kundër kushtetutës së Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas (FLA)".

75 IKD (2024), "Eksperimenti mbi ndihmën juridike falas".

76 IKD (2026), "Drejtësia civile në Kosovë 2025".

77 IKD (2025), [Zbatimi i jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Kosovë](#).

lëndë të pazgjidhura, që do të thotë se gjyqësori ka zgjidhur 10,219 lëndë më shumë sesa ka pranuar gjatë vitit. Megjithatë, raporti konstaton se kjo ulje nuk është e mjaftueshme për t'i adresuar në mënyrë substanciale lëndët e pazgjidhura ekzistuese. Ndërsa të gjitha Gjykatat Themelore kanë performuar pozitivisht duke zgjidhur më shumë lëndë sesa kanë pranuar, Gjykata e Apelit nuk ka ndjekur të njëjtin trend, duke zgjidhur 8,384 lëndë më pak sesa ka pranuar dhe duke e rritur kështu ngarkesën e saj. Raporti gjithashtu thekson se Gjykata Themelore në Prishtinë mbetet më e ngarkuara, me ngarkesë të konsiderueshëm të lëndëve edhe në Prizren dhe Gjakovë.<sup>78</sup>

**83.** Në lidhje me realizimin e së drejtës për një proces gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm, Ministria e Drejtësisë (MD) më parë ka publikuar për konsultim publik Projektligjin për Realizimin e së Drejtës për një Proces Gjyqësor brenda një Afati të Arsyeshëm. Sipas OJQ-së IKD, ky projektligj në formën e publikuar nuk e adreson në mënyrë adekuate problemin strukturor të vonesave të tepruara gjyqësore. IKD e ka kritikuar projektligjin për vendosjen e afateve fikse prej tre vitesh për procedurat e shkallës së parë dhe prej dy vitesh për procedurat e shkallës së dytë, duke argumentuar se standarde të tilla uniforme janë në mospërputhje me praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila kërkon vlerësim të individualizuar në varësi të rrethanave të secilit rast.<sup>79</sup> IKD-ja ka vlerësuar më tej se kriteret e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut janë trajtuar si standarde dytësore dhe jo si standarde qendrore, duke ngritur shqetësime lidhur me pajtueshmërinë me nenin 53 të Kushtetutës, i cili kërkon që të drejtat e njeriut të interpretohen në përputhje me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Gjatë periudhës raportuese, nuk ka pasur informacione të qarta publike lidhur me avancimin e mëtejshëm, rishikimin apo miratimin e projektligjit pas procesit të konsultimit. Prandaj, IKD-ja ka theksuar se reforma efektive në këtë fushë kërkon masa më të gjera ndërinstitucionale që i adresojnë vonesat sistemike gjyqësore dhe sigurojnë harmonizim me standardet evropiane për të drejtat e njeriut.<sup>80</sup>

**84.** Megjithë reformat e vazhdueshme të brendshme në sistemin gjyqësor gjatë vitit 2025, të cilat e synojnë rritjen e efikasitetit, transparencës dhe kapaciteteve institucionale, këto masa nuk janë përkthyer në mbrojtje efektive të së drejtës për gjykim të drejtë apo qasje në mjete juridike efektive në praktikë. Ky boshllëk në zbatim pasqyrohet në gjetjet e Institucionit të Avokatit të Popullit të Kosovës (IAPK), i cili në raportimin e tij vjetor për vitin 2025 ka identifikuar mangësi të vazhdueshme strukturore që ndikojnë në qasjen në drejtësi. Në vitin 2025, IAPK ka pranuar 1,669 ankesa, që përfshijnë 2,687 qytetarë, ku pjesa më e madhe lidhet me të drejtën për mjete juridike (203 ankesa) dhe të drejtën për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm (122 ankesa). Gjykatat kanë qenë ndër institucionet më shpesh të përfshira, duke përbërë 353 ankesa, krahas ministrive dhe administratës (680 raste) dhe komunave (254 raste). Gjatë periudhës raportuese, IAPK ka hapur 591 hetime, përfshirë 40 raste ex officio, dhe i ka mbyllur 689 raste. Megjithatë, përgjegjshmëria institucionale ka mbetur e dobët: nga 678 rekomandimet e lëshuara në vitin 2025, vetëm 18 për qind janë zbatuar. Këto të dhëna tregojnë pengesa të vazhdueshme për mjetet juridike efektive, nivel të ulët të pajtueshmërisë me mekanizmat mbikëqyrës dhe mangësi të vazhdueshme në zbatimin praktik të garancive për gjykim të drejtë.<sup>81</sup> Në mënyrë të veçantë, numri i ankesave shënon rritje krahasuar me periudhën raportuese paraprake (me gjithsej 1,349 ankesa).<sup>82</sup>

78

Ibid.

79

IKD (2024), [E drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm: çështje kushtetuese me projektligjin aktual.](#)

80

IKD(2025), [Zbatimi i jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Kosovë.](#)

81

IAPK (2025), [Avokati i Popullit prezantoi një vit pune para mediave.](#)

82

HRN (2025), [Raporti i Shoqërisë Civile për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2024.](#)

**85.** Në përputhje me standardet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, të drejtat gjuhësore përbëjnë një pjesë integrale të së drejtës për një proces të drejtë gjyqësor, veçanërisht në garantimin që palët të mund të marrin pjesë në mënyrë efektive në procedura. Gjetjet e monitorimit të IKD-së për vitin 2025 tregojnë se, në përgjithësi, gjykatat në Kosovë i kanë respektuar të drejtat gjuhësore të palëve gjatë zhvillimit të procedurave. Megjithatë, raporti identifikon mangësi strukturore që ndikojnë në efektivitetin praktik të këtyre të drejtave, veçanërisht sa i përket qasjes në materiale ligjore të përkthyer dhe konsistencës së ofrimit të tyre. Ndërsa përkthimi gjatë seancave gjyqësore në masë të madhe sigurohet, boshllëqet në përkthimin e dokumenteve dhe burimeve më të gjera ligjore mund ta kufizojnë ende ushtrimin e plotë dhe efektiv të të drejtave gjuhësore, siç kërkohet nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.<sup>83</sup>

**86.** Në vitin 2025, mediumi KALLXO.com, i lidhur me BIRN, ka raportuar për një rast që ka ngritur shqetësime serioze lidhur me paanshmërinë gjyqësore dhe mbrojtjen efektive të së drejtës për një proces të drejtë gjyqësor dhe mjete juridike efektive. Në shtator 2025, KALLXO.com ka publikuar një incizim audio që përfshin gjyqtaren Naime Krasniqi-Jashanica dhe prokuroren Edina Jupolli, në të cilin ato dëgjohen duke diskutuar një rast në vazhdim për dhunë në familje me të akuzuarin, duke përdorur gjuhë që është perceptuar si e favorshme ndaj të pandehurit dhe si nënvlerësuese ndaj kredibilitetit të viktimës.<sup>84</sup> Incizimi i ka vënë në pikëpyetje parimet e pavarësisë gjyqësore, paanshmërisë së prokurorisë dhe barazisë së mjeteve, veçanërisht në kontekstin e procedurave për dhunë në familje, ku viktimat kërkojnë mbrojtje të shtuar procedurale. Incidenti e ilustron mënyrën se si paragjykimi i perceptuar dhe komunikimi joformal nga aktorët gjyqësorë mund ta minojnë besimin në drejtësinë e procedurave dhe ta pengojnë qasjen në mjete juridike efektive.<sup>85</sup>

**87.** Përveç rastit të përmendur më sipër, OJQ BIRN ka ndërmarrë monitorim të vazhdueshëm sistematik të procedurave gjyqësore në rastet komplekse dhe të profilit të lartë, duke kontribuar në transparencë dhe në mbikëqyrje publike si mekanizma mbështetës për garantimin e së drejtës për një proces të drejtë gjyqësor dhe mjete juridike efektive.<sup>86</sup> Përmes raportimit të detajuar mbi gjykimet për krime luftime, rastet e vrasjeve dhe procedura të tjera me interes të lartë publik, përfshirë gjykimin e Sllagjan Trajkoviç dhe seancat lidhur me masakrën e Reçakut, OJQ BIRN dhe platforma e saj hulumtuese KALLXO.com i kanë dokumentuar dinamikat e sallës së gjyqit, praktikën e administrimit të provave, zhvillimet procedurale dhe arsyetimin gjyqësor.<sup>87</sup> Megjithëse një raportim i tillë nuk përbën në vetvete një mjet juridik, ai luan një rol të rëndësishëm në ekspozimin e mënyrës se si garancitë e gjykimin të drejtë zbatohen në praktikë, veçanërisht në rastet sensitive që përfshijnë krime të rënda dhe përgjegjësi historike.

**88.** Në vitin 2025, OJQ IKD ka publikuar një raport monitorimi mbi procedurat gjyqësore në Departamentin Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe në Gjykatën Themelore në Prishtinë Dega në Graçanicë, i bazuar në vëzhgimin e 226 seancave gjatë një periudhe shtatëmuajore,

83 IKD (2025), [Zbatimi i jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Kosovë](#).

84 Kallxo (2025), [Raportimi i Kallxo.com për skandalin e gjyqtarës dhe prokurorës, Haxhiu: I bëj thirrje autoriteteve që të ndërmarrin masa urgjente](#).

85 BIRN (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

86 ibid.

87 ibid.

kryesisht në raste që prekin komunitetin serb. Raporti i identifikon mangësitë gjuhësore si një pengesë strukturore e përsëritur për efikasitetin procedural dhe qasjen e barabartë në drejtësi. Në Departamentin Special, 16 nga 97 seanca të monitoruara (16.5 për qind) janë shtyrë, kryesisht për shkak të mungesës ose vonesës në përkthimin e dokumenteve të lëndës, pavarësisht pranisë së vazhdueshme të përkthyesve gjatë seancave dhe futjes së përkthimit simultan në fillim të vitit 2025. Sfida të ngjashme janë vërejtur edhe në Degën e Graçanicës, ku 18 nga 129 seanca (rreth 14 për qind) janë shtyrë, përfshirë raste civile të shtyra për shkak të mungesës së përkthyesve dhe dokumentacionit të papërkthyer. Përtej vonesave procedurale, IKD-ja e thekson mungesën e vazhdueshme të përkthimit të materialeve kryesore ligjore në gjuhën serbe, përfshirë aktgjykimet dhe komentet ligjore, duke e karakterizuar këtë si një pengesë sistematike për ushtrimin efektiv të të drejtave për një proces të drejtë gjyqësor dhe mjete juridike efektive. Raporti rekomandon ndërhyrje të synuara, përfshirë rritjen e financimit, forcimin e kapaciteteve të përkthimit, mekanizmat e kontrollit të cilësisë, përmirësimin e koordinimit administrativ dhe përkthimin dhe publikimin sistematik të vendimeve gjyqësore në gjuhën serbe.<sup>88</sup>

**89.** Në qershor 2025, OJQ ACDC e ka prezantuar një hulumtim mbi përfshirjen e komuniteteve jo-shumicë në profesionet e lira juridike në Kosovë, duke theksuar nën-përfaqësim të theksuar të komunitetit serb. Gjetjet tregojnë se vetëm 1 nga 137 noterë aktivë, 34 nga 1,456 avokatë të licencuar (2.33 për qind), dhe asnjë përmbarues nuk vjen nga komuniteti serb, përfshirë edhe në komunat me shumicë serbe në veri të Kosovës. Raporti identifikon barrierat strukturore dhe administrative në qasje, përfshirë procedura të paqarta të përzgjedhjes, mungesë të arsytimit në vendimet e emërimit, mbështetje të pamjaftueshme gjuhësore dhe mungesë të masave afirmative pavarësisht kandidatëve të kualifikuar. Ai përfundon se përjashtimi i vazhdueshëm i komuniteteve jo-shumicë nga profesionet publike juridike cenon barazinë para ligjit, qasjen efektive në drejtësi dhe besimin në institucionet ligjore.<sup>89</sup>

**90.** Në vitin 2025, financimi për Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas është rritur për 26,000 euro, ose afërsisht 5 për qind.<sup>90</sup> Kjo rritje e vogël pasqyron një vazhdimësi në raport me vitet e mëparshme, më shumë sesa një reformë substanciale. Nga një perspektivë strukturore, kjo nënkupton gjithashtu se qasja faktike në përfaqësim ligjor mbetet e nënfinancuar, duke ndikuar veçanërisht tek individët në gjendje të cenueshme ekonomike.

88 IKD (2025), [Efikasiteti gjyqësor në praktikë dhe të drejtat gjuhësore në sistemin gjyqësor](#).

89 ACDC (2025), [Konferencë mbi përfshirjen e komuniteteve jo-shumicë në profesionet e lira ligjore në Kosovë](#).

90 GAP (2025), [Projektbuxheti 2025: analiza e të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore](#)

VITI	2025 <sup>91</sup>	2024	2023	2022	2021	2020
<b>BUXHETI I QEVERISË NË EURO</b>	563,418	537,831	444,170	443,995	439,298	422,699

**Figura 1: Buxheti qeveritar për ndihmën juridike në Kosovë ndërmjet viteve 2020 dhe 2025**

**91.** Në vitin 2025, OJQ KOMF dhe UNICEF kanë publikuar një raport mbi mangësitë në zbatimin praktik të masave të diversionit në sistemin e drejtësisë për të mitur në Kosovë, pavarësisht legjislacionit të tij progresiv.<sup>92</sup> Raporti thekson se, megjithëse Kodi i Drejtësisë për të Mitur i jep përparësi masave të diversionit si përgjigja kryesore ndaj fëmijëve në konflikt me ligjin, një numër i konsiderueshëm rastesh vazhdojnë të trajtohen përmes procedurave formale gjyqësore, me deri në gjysmën e tyre që mbeten të pazgjidhura brenda të njëjtit vit. Përveç kësaj, gjetjet tregojnë praktika jo të njëtrajtshme të prokurorive në Prokuroritë Themelore, mangësi në koordinimin ndërinstitucional dhe raste të zbatimit të gabuar procedural. Raporti gjithashtu thekson qasje të kufizuar në shërbime rehabilituese, gjë që e kufizon disponueshmërinë e mjeteve jogjyqësore dhe, rrjedhimisht, të drejtën e të miturve për mjete juridike efektive në praktikë.<sup>93</sup>

**92.** Në lidhje të ngushtë me raportin e përshkruar më sipër, në prill 2025, një grup pune që vepron brenda Policisë së Kosovës me mbështetjen e OJQ-së KOMF e ka finalizuar Procedurën Standarde të Veprimit (PSV) dhe formularin shoqëruar për zbatimin e masës së diversionit të njohur si "Paralajmërimi Policor". Sipas Kodit të Drejtësisë për të Mitur, kjo masë mund të shqiptohet ndaj të miturve në konflikt me ligjin që janë kryerës të parë të veprave penale të dënueshme me gjobë ose me burgim deri në tre vjet. Paralajmërimi policor jepet nga një zyrtar policor me autorizimin e prokurorit të shtetit për të mitur. Miratimi i kësaj procedure përbën një hap konkret drejt forcimit të praktikave të diversionit në vitin 2025, me qëllim të shmangies së procedurave formale gjyqësore, mbështetjes së rehabilitimit dhe riintegritimit të të miturve në komunitet, si dhe uljen e recidivizmit.<sup>94</sup>

**93.** EULEX-i e ka identifikuar përdorimin e tepruar dhe rutinor të paraburgimit si një shqetësim sistemik në rastet e lidhura me krime lufte, ku Gjykata Themelore në Prishtinë shpesh e justifikon paraburgimin vetëm mbi bazën e shtetësisë së dyfishtë të të dyshuarit dhe rrezikut të supozuar të ikjes.<sup>95</sup>

91 GAP (2025), [Projektbuxheti 2025: analiza e të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore \(shiko tabelën në faqen 13 për një krahasim midis vitit 2024 dhe 2025\)](#).

92 UNICEF (2025), [Zbatimi i masave të diversionit brenda sistemit të drejtësisë për të mitur](#).

93 UNICEF (2025), [Zbatimi i masave të diversionit brenda sistemit të drejtësisë për të mitur](#).

94 KOMF (2025), [KOMF mbështet hartimin e procedurës standarde të veprimit për "vërejtjen policore"](#).

95 EULEX (2025), Raport monitorimi i drejtësisë.

#### 94. Rekomandimet

- Ministria e Drejtësisë duhet ta sigurojë pavarësinë institucionale të Agjencisë për Ndhimë Juridike Falas duke e larguar varësinë e saj nga Ministria dhe duke vendosur garanci ligjore dhe operacionale që e parandalojnë ndërhyrjen politike në ofrimin e ndihmës juridike;
- Ministria e Drejtësisë duhet ta rishikojë Projektligjin për të Drejtën për Gjykim brenda një Afati të Arsyeshëm për të siguruar përputhje të plotë me standardet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke i shmangur afatet fikse dhe uniforme dhe duke aplikuar në vend të tyre kritere të individualizuara vlerësimi bazuar në rrethanat specifike të secilit rast;
- Kuvendi, Qeveria dhe zyrtarët publikë duhet të përmbahen nga komentimi i rasteve në zhvillim, vendimeve gjyqësore dhe punës së gjyqtarëve dhe prokurorëve individualë, me qëllim të ruajtjes së pavarësisë gjyqësore dhe besimit të publikut në sistemin e drejtësisë.

#### 5.5 Liria e shprehjes dhe mendimit, e drejta për informim dhe e drejta për privatësi

**95.** Liria e mendimit dhe shprehjes është një e drejtë themelore e njeriut e njohur në nenin 19 të DUDNJ-së, e cila përfshin të drejtën për të mbajtur mendime dhe për të kërkuar, marrë dhe shpërndarë informacione përmes çdo mjeti. Kjo mbrojtje është e sanksionuar në formë detyruese juridike në nenin 19 të PNDCP-së, i cili garanton si të drejtën absolute për të pasur mendim pa ndërhyrje, ashtu edhe lirinë e kushtëzuar të shprehjes. Siç është sqaruar nga Komiteti për të Drejtat e Njeriut në Komentin e Përgjithshëm nr.34 (2011), çdo kufizim i shprehjes duhet të përmbushë kritere strikte të ligjshmërisë, domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit dhe lejohet vetëm për mbrojtjen e të drejtave ose reputacionit të të tjerëve, apo interesave si siguria kombëtare, rendi publik, shëndeti publik ose morali. Garanci të ngjashme përcaktohen në nenin 10 të KEDNJ-së, sipas të cilit kufizimet lejohen vetëm kur parashikohen me ligj dhe janë të domosdoshme në mënyrë të demonstrueshme në një shoqëri demokratike. Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, veçanërisht çështja Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar (1976), ka pohuar në mënyrë të qëndrueshme se liria e shprehjes shtrihet edhe ndaj ideve dhe informatave që ofendojnë, trondisin ose shqetësojnë.

**96.** Në kuadrin ligjor të Kosovës, këto standarde ndërkombëtare janë detyruese dhe garantohen në nenin 40 të Kushtetutës, si dhe në një sërë ligjesh të tjera. Këto përfshijnë Ligjin Nr. 04/L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës, Ligjin Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, Ligjin Nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, Ligjin Nr. 04/L-137 për Mbrojtjen e Burimeve të Gazetarisë, Ligjin Nr. 03/L-118 për Tubimet Publike, Ligjin Nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve, Ligjin Civil Nr. 02/L-65 Kundër Shpifjes dhe Fyerjes, si dhe Ligjin Nr. 02/L-31 për Lirinë Fetare në Kosovë, ndër të tjera. Në përgjithësi, legjislacioni i Kosovës për lirinë e shprehjes dhe ligjet për media janë në përputhje me standardet e Këshillit të Evropës dhe me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

**97.** Një zhvillim i rëndësishëm kushtetues lidhur me lirinë e shprehjes dhe pavarësinë e medias në Kosovë në vitin 2025 ka ndodhur me qëllim të kufizimit të tejkalimit legjislativ në rregullimin e sektorit të medias. Më 30 prill 2025, Gjykata Kushtetuese e Kosovës e ka shfuqizuar Ligjin për Komisionin e Pavarur të Mediave (KPM), duke konstatuar se disa dispozita të tij i cenonin garancitë

kushtetuese për lirinë e medias dhe pavarësinë rregullatore. Gjykata ka vlerësuar se procedurat për propozimin e anëtarëve të KPM-së, kriteret për shkarkimin e kryesuesit dhe anëtarëve, si dhe rregullimi i sanksioneve e ekspozonin Komisionin ndaj ndikimit të padrejtë politik. Po ashtu, ajo e ka riafirmuar kërkesën e detyrueshme që të paktën pesë nga njëmbëdhjetë anëtarët e KPM-së të jenë gra, duke e trajtuar përfaqësimin gjinor si standard juridik detyrues dhe jo si preferencë politike. Vendimi ka ardhur pas një kundërshtimi të vazhdueshëm trevjeçar nga profesionistë të medias dhe aktorë të shoqërisë civile, të udhëhequr nga juristja e medias Flutura Kusari, Asociaçioni i Gazetarëve të Kosovës dhe organizata vendore e ndërkombëtare, të cilët vazhdimisht kishin paralajmëruar se ligji do ta cenonte pluralizmin mediatik dhe autonominë rregullatore.<sup>96</sup> Zhvillimet e mëvonshme gjyqësore e kanë theksuar më tej paqëndrueshmërinë institucionale lidhur me KPM-në. Një vendim i Gjykatës Supreme i datës 17 qershor 2025, që e shfuqizoi zgjedhjen e Kryesuesit të Bordit të KPM-së, i ka përforcuar shqetësimet për parregullsi procedurale dhe deficite të qeverisjes brenda Komisionit.<sup>97</sup> Në vitin 2025, OJQ IKD i ka kundërshtuar me sukses veprimet e KPM-së lidhur me ndryshimet në Rregulloren e Punës dhe zgjedhjen pasuese të Kryesuesit të saj. KPM-ja i kishte miratuar dhe i kishte zbatuar ndryshimet rregullative në të njëjtën ditë, duke e mundur zëvendësimin e parakohshëm të kryesuesit në detyrë. Gjykata Themelore ka konstatuar se ky proces i ka shkelur garancitë themelore procedurale, përfshirë transparencën dhe kërkesat për konsultim publik, dhe e ka shpallur të paligjshëm vendimin për zgjedhjen e kryesuesit.<sup>98</sup> Rrjedhimisht, Gjykata Supreme e Kosovës e ka mbështetur kërkesën e OJQ IKD dhe i ka shfuqizuar ndryshimet në Rregulloren e Punës, duke e konfirmuar se KPM-ja kishte vepruar jashtë kufijve të ligjit.<sup>99</sup>

**98.** Një regres i dukshëm në lirinë e shprehjes në Kosovë është dokumentuar në vitin 2025 përmes mekanizmave ndërkombëtarë të monitorimit.<sup>100</sup> Sipas Indeksit Botëror të Lirisë së Shtypit 2025 të publikuar nga Reporterët pa Kufij (RSF), Kosova e ka shënuar rënien më të theksuar në Ballkan, duke rënë me 24 pozita nga vendi i 75-të në vitin 2024 në vendin e 99-të nga 180 shtete në vitin 2025, që përbën renditjen më të ulët në më shumë se një dekadë.<sup>101</sup> Reporterët pa Kufij (RSF) ia atribuojnë këtë rënie rregullimit të politizuar të medias, përdorimit të padive strategjike kundër pjesëmarrjes publike (SLAPP), kufizimeve në qasjen në informacion publik dhe rreziqeve të vazhdueshme për sigurinë e gazetarëve, duke theksuar se, megjithëse peizazhi mediatik në Kosovë mbetet i larmishëm, zhvillimi i tij është i kufizuar nga një treg i vogël dhe i segmentuar. Shqetësimi i veçantë është ngritur lidhur me presionin e vazhdueshëm politik dhe retorikën armiqësore të drejtuar ndaj gazetarëve. Këto gjetje janë pasqyruar edhe në nivel lokal nga Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës, i cili e ka cilësuar renditjen si alarmuese dhe e ka lidhur atë me një mjedis të zgjatur politik armiqësor ndaj mediave.<sup>102</sup> Në këtë drejtim, OJQ FOL tregon se format e kërcënimeve ndaj gazetarëve janë bërë më të shpërndara dhe më të vështira për t'u adresuar, veçanërisht në hapësirën digjitale.<sup>103</sup>

96 Qendra Evropiane për Lirinë e Shtypit dhe Medias (QELShM), në postimin e saj të datës 24 prill 2025: "Kosova: mirëpresim vendimin e Gjykatës Kushtetuese për ligjin e medias"

97 Safe Journalists 2025, [AJK mirëpret vendimin e Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e Ligjit për KPM-në.](#)

98 Betimi per Drejtesi (2025), <https://betimiperdrejtesi.com/ikd-fiton-rastin-ndaj-kpm-se-gjykata-themelore-shpall-te-paligjshem-vendi-min-per-zgjedhjen-e-kryetarit-te-kpm-se/>

99 Betimi per Drejtesi (2025), <https://betimiperdrejtesi.com/supremja-aprovon-kerkesepadine-e-ikd-se-shfuqizohet-ndryshimi-i-rregullores-se-punes-se-kpm-se/>

100 AGK (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

101 Balkan Insight (2025), [Raporti i RSF: Liria e medias në rënie në shumicën e vendeve të Ballkanit.](#)

102 AGK (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

103 FOL (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

**99.** Në vend që të merrej me përmbajtjen faktike të raportit të Reporterëve pa Kufij (RSF), debati politik që pasoi publikimin e tij në vitin 2025 u shndërrua në një çështje përgjegjësie, ku Kryeministri në detyrë ia atribuoi rënien sektorit të mediave në vend se autoriteteve publike.<sup>104</sup>

**100.** Në këtë kontekst, Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) ka shprehur shqetësim serioz të përsëritur gjatë vitit 2025 lidhur me atë që e cilëson si një fushatë të vazhdueshme nga partia më e madhe parlamentare, Vetëvendosje, e drejtuar kundër transmetuesit privat kombëtar Klan Kosova. Sipas AGK-së, deklaratat publike të zyrtarëve të lartë të partisë, përfshirë thirrjen e Sekretarit të Përgjithshëm të partisë drejtuar anëtarëve për bojkotimin e transmetuesit, kanë kontribuar në krijimin e një mjedisi armiqësor ndaj këtij mediumi.<sup>105</sup> Në këtë kontekst, AGK i ka bërë thirrje Vetëvendosjes që t'i ndalojë praktikën që e cenon lirinë e medias dhe lirinë e shprehjes dhe të përmbahet nga retorika që mund ta rrezikojë sigurinë e gazetarëve.<sup>106</sup>

**101.** Në të njëjtën periudhë, Klan Kosova ka iniciuar procedurë gjyqësore kundër Kryeministrit në detyrë Albin Kurti, duke paraqitur më 16 maj 2025 një padi për shpifje në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Transmetuesi pretendon se referimet e përsëritura publike të Kurtit gjatë fushatës zgjedhore të shkurtit 2025, ku mediumi u cilësua si "Klan Serbia" dhe u sugjerua lidhje me interesa serbe, përbëjnë deklaratat shpifëse dhe dëmtuese për reputacionin, të amplifikuara përmes tubimeve publike dhe shpërndarjes mediatike përkatëse. Rasti mbështetet në Ligjin Civil Nr. 02/L-65 Kundër Shpifjes dhe Fyerjes,<sup>107</sup> kërkon njohje gjyqësore të deklaratave si të paligjshme, tërheqje publike dhe kërkimfalje, si dhe kompensim për dëmet materiale dhe jomateriale. Padia përbën një institucionalizim të mëtejshëm të tensioneve ndërmjet udhëheqjes politike dhe transmetuesit në një mjedis mediatik tashmë të polarizuar.

**102.** Shqetësuese më tej është mënyra se si bllokada politike në Kosovë ka ndikuar në transmetuesin publik Radio Televizioni i Kosovës (RTK) në vitin 2025. Si pasojë e ngërçit të zgjatur parlamentar, kësti i dytë i ndarjes vjetore shtetërore për RTK nuk është disbursuar në korrik 2025, ashtu siç ishte paraparë në buxhet. Kjo i atribuohet faktit se RTK bie nën mbikëqyrje parlamentare; si e tillë, fondet duhej fillimisht të kalonin përmes miratimit procedural të Komisionit për Buxhet të Kuvendit dhe më pas të ishin subjekt i alokimit nga Ministria e Financave. Megjithatë, meqë Kuvendi nuk është konstituuar, pjesa më e madhe e buxhetit të parashikuar për RTK ka mbetur e paarritshme, duke i rrezikuar pagesat e pagave të më shumë se 700 punonjësve.<sup>108</sup> Si pasojë, punonjësit e RTK-së kanë iniciuar protesta gjatë gushtit 2025,<sup>109</sup> dhe në nëntor 2025.<sup>110</sup> Në fund të nëntorit, Qendra Evropiane për Lirinë e Shtypit dhe Medias (QELSHM), Federata Evropiane e Gazetarëve (FEG) dhe Instituti Ndërkombëtar i Shtypit (INSH) i kanë bërë thirrje Kryeministrit në detyrë që ta miratojë dhe ta transferojë urgjentisht buxhetin e RTK-së për ta siguruar pagesën e pagave të prapambetura.<sup>111</sup> Ky reagim ndërkombëtar u përputh dhe rezonoi me thirrjet vendore për veprim.<sup>112</sup> Megjithatë, deri në fund të nëntorit, Qeveria në detyrë e Kosovës e zgjidhi përkohësisht çështjen duke

104 Koha (2025), [Kurti: Problemi janë pronarët e mediave dhe mungesa e profesionalizmit](#).

105 AGK (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

106 AGK (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

107 Kuvendi i Kosovës (2025), [Ligji Nr. 02/L-65 për të Drejtën Civile kundër Shpifjes dhe Fyerjes](#).

108 Prishtina Insight (2025), [Bllokada parlamentare në Kosovë lë transmetuesin pa fonde të mjaftueshme](#).

109 Balkan Insight (2025), [Punëtorët kërkojnë: jepni fondet për transmetuesin publik të Kosovës](#).

110 Balkan Insight (2025), [Stafi i transmetuesit publik të Kosovës proteston për pagat e papaguara](#).

111 Safe Journalists (2025), [Kosovë: EFJ dhe partnerët i bëjnë thirrje qeverisë të lirojë buxhetin e RTK-së dhe të mbrojnë lirinë e medias](#).

112 AGK (2026) dhe GLPS (2026), kontribute përkatëse për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

alokuar fonde përmes kursimeve të buxhetit shtetëror.<sup>113</sup>

**103.** Sa i përket transmetuesit publik RTK, Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) ka ngritur shqetësime lidhur me largimin e gjashtë gazetarëve të RTK-së nga rolet e tyre në ekran pa njoftim paraprak, duke e cilësuar vendimin si arbitrar dhe si tregues të censurës. Ai e ka vlerësuar këtë masë si reagim ndaj pavarësisë editoriale të gazetarëve dhe kritikës së brendshme, duke i ritheksuar shqetësimet për ndikimin politik mbi menaxhmentin e RTK-së.<sup>114</sup> AGK-ja ka bërë thirrje që vendimi të tërhiqet dhe ka shprehur mbështetje për gazetarët në ndjekjen e hapave të mëtejshëm.<sup>115</sup>

**104.** Në përputhje me raportin e RSF-së për vitin 2025, një publikim i Human Rights Watch i të njëjtit vit dokumenton mbrojtje të dobët për gazetarët që përballen me ngacmime të vazhdueshme, sulme dhe forma të ndërhyrjes politike. Duke përdorur të dhëna nga AGK-ja, raporti evidenton 54 incidente ndaj gazetarëve gjatë periudhës raportuese, përfshirë një sulm fizik, një kërcënim me vdekje dhe 15 raste që përfshijnë ngacmim, gjuhë urrejtjeje dhe fushata shpifëse me origjinë nga aktorët politikë.<sup>116</sup> Veçanërisht, kjo e ka përfshirë edhe qarkullimin e përmbajtjeve mediatike të manipuluar me inteligjencë artificiale, të cilat i paraqisnin në mënyrë të rreme gazetarët sikur po i fyenin aktorët politikë, duke rezultuar kështu me komente armiqësore në internet gjë që kontribuon në rreziqe të mundshme për gazetarët.<sup>117</sup>

**105.** Në tetor 2025, OJQ IKD-ja reagoi publikisht ndaj deklaratave të bëra nga Faton Peci, deputet i Kuvendit, ministër në detyrë dhe në atë kohë kandidat për kryetar të Mitrovicës së Jugut, i cili, pas raportimeve në ditën e zgjedhjeve, përmendi publikisht gazetarë dhe përfaqësues të mediave dhe i akuzoi ata për kryerje të veprave penale në lidhje me raportimin e tyre.<sup>118</sup> OJQ IKD-ja vlerësoi se formulimi publik i akuzave penale ndaj gazetarëve mbi bazën e raportimit të tyre përbën presion të panevojshëm dhe rrezikon të prodhojë një efekt frikësues ndaj mediave kritike dhe të pavarura.

**106.** Në vazhdim të mbrojtjes së gazetarëve në Kosovë, një raport i fundit i Rrjetit të Grave Gazetare të Kosovës, i publikuar në vitin 2025, tregon se, pavarësisht përfaqësimit të tyre të lartë në sektorin e medias, gazetaret vazhdojnë të përballen me rreziqe të shtuara për sigurinë në një mjedis që tashmë karakterizohet nga pabarazi strukturore ndaj grave.<sup>119</sup> Sipas raportit, mungesa e politikave të përshtatura të sigurisë e përkeqëson më tej ekspozimin e tyre ndaj rrezikut.<sup>120</sup>

**107.** OJQ FOL ka deklaruar se gazetarët dhe punonjësit e mediave gjatë kësaj periudhe janë përballur me sulme fizike dhe kërcënime të drejtpërdrejta; presion politik dhe ndërhyrje në punën editoriale; padi strategjike (SLAPP) me qëllim të frikësimit dhe pengimit të raportimit; sulme dhe fushata denigruese në rrjetet sociale; si dhe kërcënime që e prekin jetën private dhe familjare të

113 Betimi për Drejtësi (2025), [Sindikata e Punëtorëve të RTK-së mirëpret vendimin për pagat: Greva mund të rikthehet nëse në janar hasim në situata të tilla.](#)

114 AGK (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

115 AGK (2025), [AGK dënon fuqishëm largimin arbitrar të gjashtë gazetarëve të RTK-së nga ekran.](#)

116 Koha (2025), [Human Rights Watch: Kosova ka mbrojtje të dobët për gazetarët.](#)

117 Safe Journalists (2025), [Kërcënime të tjera ndaj gazetarëve: Lirim Mehmetaj.](#)

118 IKD (2025), [Akuzat ndaj gazetarëve për raportimet zgjedhore janë presion ndaj mediave: QNJ-IKD ofron mbrojtje ligjore.](#)

119 AGK (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

120 Rrjeti i Grave Gazetare të Kosovës (2025), [Pozita dhe siguria e gazetareve në Kosovë.](#)

gazetarëve. Vetëm në tetë muajt e parë të vitit 2025 (janar–gusht), janë regjistruar 29 incidente të reja që përfshijnë gazetarë (përfshirë raste me kërcënime serioze), gjë që përbën një tregues të qartë të presionit të vazhdueshëm ndaj mediave.<sup>121</sup> Si AGK-ja ashtu edhe FOL e kanë theksuar veçmas pamjaftueshmërinë e reagimit institucional në këto raste.

**108.** Sa u përket gazetarëve serbë-K, në qershor 2025 në Gorazhdec (komuna e Pejës), rasti i gazetarit Damjan Portić nga Radio Gorazhdevac ka ngritur shqetësime. Gazetari kishte shkuar për ta dokumentuar largimin e grafitëve nga një mur pranë kishës lokale. Gjatë ngjarjes, ku ishin të pranishëm punëtorë të angazhuar nga komuna dhe zyrtarë të Policisë së Kosovës, Portić u përball me dy policë me uniformë dhe dy të tjerë civilë, të cilët e identifikuan dhe më pas e ngacmuan verbalisht, duke i kërkuar në mënyrë të përsëritur që “të largohej prej këtu” dhe të linte vendin e ngjarjes, pavarësisht se punimet zhvilloheshin në një hapësirë publike. Sipas rrëfimit të tij, njëri nga policët gjithashtu u përpoq ta pengonte në fotografimin ose filmimin e procesit të largimit, duke iu referuar një ligji, pa i dhënë një shpjegim të qartë pse nuk mund ta regjistronte aktivitetin. Portić ka deklaruar se ishte identifikuar si gazetar, por megjithatë ishte urdhëruar të largohej dhe ishte penguar në mbulimin e ngjarjes.<sup>122</sup>

**109.** Monitorimi nga OJQ AKTIV dhe Demokracia në Veprim (DV) gjatë proceseve zgjedhore përgjatë vitit 2025 ka treguar mangësi të vazhdueshme në transparencën institucionale, përfshirjen dhe qasjen e barabartë në informacione për komunitetet jo-shumicë. Gjetjet tregojnë mungesë të vazhdueshme të fushatave të synuara për edukimin dhe informimin e votuesve nga këto komunitete, së bashku me mangësi të përsëritura gjuhësore në disponueshmërinë, saktësinë dhe kohëzgjatjen e informacionit zgjedhor në gjuhën serbe. Janë identifikuar boshllëqe të konsiderueshme në qasjen në ueb-faqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), përfshirë seksione jofunksionale në faqen në gjuhën serbe pak para zgjedhjeve, duke ngritur shqetësime për qasje të barabartë në informacione thelbësore. Pavarësisht një buxheti prej 11 milionë eurosh, KQZ-ja nuk e kishte zbatuar Rekomandimin nr. 5 të Misionit të BE-së për Vëzhgimin e Zgjedhjeve lidhur me informacionin zgjedhor të qashtëm dhe gjithëpërfshirës para zgjedhjeve lokale, gjë që e pasqyron një reagim të kufizuar institucional ndaj rekomandimeve të mëparshme. Shqetësime shtesë janë ngritur nga refuzimi fillestar i KQZ-së për akreditimin e gazetarëve nga mediat në gjuhën serbe, vendim i cili më pas u ndryshua, por që megjithatë ngriti pyetje lidhur me transparencën dhe mbikëqyrjen mediatike. Këto mangësi të përsëritura rrezikojnë ta minojnë besimin publik, ta dekurajojnë pjesëmarrjen politike të komuniteteve jo-shumicë dhe ta dobësojnë perceptimin e legjitimitetit dhe gjithëpërfshirjes së institucioneve demokratike.<sup>123</sup>

**110.** Përveç shqetësimeve për sigurinë e gazetarëve, dezinformimi, informacioni i rremë dhe ndarjet e vazhdueshme ndëretnike vazhdojnë ta karakterizojnë peizazhin digjital të Kosovës në vitin 2025.<sup>124</sup> Në këtë drejtim, presidenti i Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës (AGK) ka tërhequr vëmendjen e mediave ndaj mediave në gjuhën serbe që transmetojnë nga Beogradi, të cilat shpesh shpërndajnë dezinformata dhe gjuhë ksenofobike ndaj Kosovës.<sup>125</sup> Në mënyrë të ngjashme, gazetarët e mediave serbe shpesh janë objekt i gjuhës shpifëse në mediat digjitale

121 FOL (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

122 NSI (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

123 AKTIV (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

124 OSBE (2025), [Përtej lajmeve të rreme: avancimi i edukimit mediatik për një shoqëri të informuar.](#)

125 The Fix (2025), [Grupet për lirinë e shtypit i bëjnë thirrje qeverisë së Kosovës të marrë masa për mbrojtjen e gazetarëve.](#)

të Kosovës.<sup>126</sup> Një nismë e OSBE-së për t'i kundërshtuar problemet e vazhdueshme përgjatë vijave etnike dhe fusha të tjera relevante në peizazhin mediatik ka rezultuar me një raport të titulluar "Beyond Fake News: Advancing media and information literacy for an informed society" ("Përtej lajmeve të rreme: Avancimi i edukimit mediatik dhe informativ për një shoqëri të informuar"). Veçanërisht, raporti përfshin gjashtë përmblendhje politikash me qëllim të ofrimit të një pasqyre të sfidave specifike të karakterit të edukimit medial në Kosovë dhe të adresimit të këtyre sfidave.<sup>127</sup> Përmblendhjet e politikave gjithashtu trajtojnë (4) ndikimin e mizogjinisë dhe stereotipizimit, (5) nevojën për edukimin mediatik të studentëve për t'u mbrojtur nga rreziqet online dhe manipulimi komercial, si dhe (6) rëndësinë e kuptimit të përdorimit dhe kufizimeve të mjeteve të inteligjencës artificiale për verifikimin e fakteve dhe luftimin e dezinformimit.<sup>128</sup>

**111.** E drejta për privatësi është e ngulitur fuqishëm në të drejtën ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, veçanërisht në nenin 12 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (DUDNJ), i cili e ndalon ndërhyrjen arbitrare në privatësinë, familjen, shtëpinë ose korrespondencën e individit, si dhe në nenin 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), i cili e garanton të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare. Në nivel kushtetues në Kosovë, kjo e drejtë garantohet përmes nenit 36, i cili i referohet në mënyrë të theksuar privatësisë dhe jetës familjare, përfshirë mbrojtjen e të dhënave personale (neni 36.4) dhe fshehtësinë e korrespondencës (neni 36.3). Në kuadrin legjislativ, këto garanci kushtetuese operacionalizohen kryesisht përmes dy ligjeve: Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike. Agjencia për Informim dhe Privatësi (AIP) e Kosovës është autoriteti i pavarur mbikëqyrës përgjegjës për mbikëqyrjen e pajtueshmërisë së institucioneve publike me këto ligje.

**112.** Në qershor 2025, AIP, me mbështetjen e Këshillit të Evropës, finalizoi Projektligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale nga Institucionet e Zbatimit të Ligjit.<sup>129</sup> Ky proces legjislativ e synon përafrimin e kornizës ligjore të Kosovës me Direktivën e BE-së për Zbatimin e Ligjit (Direktiva (BE) 2016/680). Projektligji vendos një bazë rregullative vendore për përpunimin e të dhënave personale nga autoritetet e zbatimit të ligjit, duke u mbështetur në standarde ndërkombëtare, përfshirë Konventën për Krimin Kibernetik (Konventa e Budapestit).<sup>130</sup> Përfundimi i tij e krijon bazën për forcimin e garancive institucionale dhe për bashkëpunim më efektiv ndërkufitar në luftimin e krimit kibernetik dhe trajtimin e provave elektronike, në varësi të harmonizimit me legjislacionin vendor dhe të miratimit formal.<sup>131</sup>

**113.** Megjithatë, pavarësisht bazave legjislative, viti 2025 shënoi mangësi në përputhshmërinë me ligjin nga institucione të ndryshme publike. Më konkretisht, AIP ka vendosur gjoba në shumën totale prej 110,000 eurosh (gjatë periudhës 2024–2025) për publikimin e paligjshëm të të dhënave

126 Balkan Insight (2025), [Objektiva të lehtë: Abuzimi digjital ndaj gazetarëve serbë në Kosovë](#).

127 OSBE (2025), [Përtej lajmeve të rreme: avancimi i edukimit mediatik për një shoqëri të informuar](#).

128 ibid.

129 Këshilli i Evropës (2025), [Projekti Octopus – Veprimi CYBERKOP: finalizimi i Projektligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale nga institucionet e zbatimit të ligjit në Kosovë](#).

130 Këshilli i Evropës (2026), Konventa për Krimin Kibernetik (Konventa e Budapestit, ETS nr. 185) dhe protokollet e saj, <https://www.coe.int/en/web/cybercrime/the-budapest-convention>

131 Këshilli i Evropës (2025), [Projekti Octopus – Veprimi CYBERKOP: finalizimi i Projektligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale nga institucionet e zbatimit të ligjit në Kosovë](#).

personale në internet. Rastet kanë përfshirë zbulimin e numrave personalë të identifikimit të qytetarëve, numrave të telefonit, adresave të banimit dhe diagnozave mjekësore.<sup>132</sup>

**114.** Një tjetër gjobë nga AIP iu shqiptua Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK) në janar 2025, për shkak se KPK nuk kishte ofruar qasje në dokumente publike të kërkuara nga OJQ Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD). Kërkesa e OJQ IKD datonte nga tetori 2024 dhe kishte të bënte me qasje në të dhëna statistikore mbi numrin e aktakuzave të ngritura nga prokurorët e Prokurorisë Speciale të Kosovës (PSRK) gjatë periudhës 2021–2024, së bashku me rezultatet përkatëse të rasteve dhe ankesat. Pas mosreagimit të KPK-së, IKD-ja parashtroi ankesë në AIP në nëntor 2024. Kjo rezultoi në një paralajmërim dhe një afat shtatëditor për PSRK-në për ta përmbushur kërkesën, ndërsa më 8 janar 2025 u njoftua edhe vendosja e një sanksioni administrativ. Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK) kërkoi një muaj shtesë për nxjerrjen e të dhënave, por meqë AIP vlerësoi se kjo kërkesë nuk kishte bazë ligjore, urdhëroi KPK-në ta paguajë një gjobë prej 3,000 euro brenda 30 ditësh, përmes Vendimit Nr. Gj-1001/2024, në bazë të nenit 33 (3) të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike.<sup>133</sup>

**115.** Në vazhdim të çështjes së privatësisë së të dhënave, një dokument politikash i OJQ BIRN për vitin 2025 tregon se mbrojtja e të dhënave në fushën e telekomunikacionit në Ballkanin Perëndimor në përgjithësi, përfshirë edhe Kosovën në veçanti, nuk është e harmonizuar në mënyrë të kënaqshme me standardet në zhvillim të Bashkimit Evropian. Në Kosovë, Ligji Nr. 04/L-109 për Komunikimet Elektronike rregullon ruajtjen e të dhënave. Megjithatë, dokumenti gjen se në të gjithë Ballkanin Perëndimor, përfshirë Kosovën, ruajtja e të dhënave të trafikut dhe metadatave është e përhapur dhe e pakufizuar, ndërsa mekanizmat e mbikëqyrjes mbeten të dobët. Në Kosovë veçanërisht, mbikëqyrja përshkruhet si e fragmentuar ndërmjet disa trupave, përkatësisht rregullatorit të telekomunikacionit dhe autoriteteve për mbrojtjen e të dhënave. Kjo ngre çështje lidhur me llogaridhënien dhe koordinimin ndërinstucional.<sup>134</sup>

**116.** Në vijim të çështjes së telekomunikacionit, më 31 tetor 2025, KALLXO.com publikoi një humltim mbi rreziqet e blerjes së telefonave të përdorur në Kosovë.<sup>135</sup> Artikulli tregoi se tregu i telefonave të përdorur shpesh funksionon në mënyrë informale, në “tregun e zi”, pa procedura të rrepta për fshirjen e sigurt të të dhënave personale, duke e rritur ndjeshëm rrezikun që informacionet private të blerësve të rikuperohen ose keqpërdoren nëse nuk zbatohen masat e duhura të mbrojtjes së privatësisë. Ekspertët dhe zyrtarët për mbrojtjen e privatësisë këshilluan qytetarët që t’i fshijnë me kujdes të dhënat e tyre dhe rekomanduan përdorimin e bizneseve të licencuara për t’i reduktuar rreziqet.<sup>136</sup>

**117.** Përveç ankesave që lidhen me telekomunikacionin, AIP ka raportuar një rritje të ankesave gjatë vitit 2025 lidhur me instalimin dhe përdorimin e sistemeve të mbikëqyrjes me video që mund të cenojnë të drejtat e privatësisë së qytetarëve. Deri në fillim të dhjetorit 2025, Agjencia për Informim dhe Privatësi ka kryer 155 inspektive, të cilat kanë rezultuar me 51 ankesa të qytetarëve, përfshirë inspektive në 16 biznese në prill 2025, ku shumica janë gjetur jo në përputhje me kërke-

132 Prishtina Insight (2025), [Institucionet e Kosovës gjobiten me 110.000 euro për shkelje të privatësisë së qytetarëve.](#)

133 Gazeta Express (2025), [AIP gjobit KPK-në me 3 mijë euro për mos ofrim të qasjes në dokumente publike për IKL.](#)

134 Balkan Insight (2025), [Në udhëkryq: politikat e ruajtjes së të dhënave në Ballkanin Perëndimor në kuadër të standardeve të ndryshueshme të BE-së.](#)

135 Kallxo (2025), [Rreziku nga shitblerja e telefonave të përdorur.](#)

136 BIRN (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

sat ligjore që e rregullojnë përpunimin e të dhënave personale të kapura përmes kamerave të sigurisë. Në ushtrimin e funksioneve të saj mbikëqyrëse, AIP ka pranuar kufizime serioze, duke pasur vetëm gjashtë inspektorë përgjegjës për mbikëqyrjen e mbrojtjes së të dhënave personale.<sup>137</sup>

**118.** OJQ BIRN dhe KALLXO.com raportuan se AIP e ka urdhëruar Shkollën “Zenel Hajdini” në Prishtinë që ta ndalojë mbledhjen e të dhënave personale të nxënësve përmes aplikacionit të mesazheve Viber.<sup>138</sup> Artikulli shpjegoi se një ankesë e prindërve kishte zbuluar se shkolla po kërkonte informacione të ndjeshme përmes Viber-it, ndërsa AIP konstatoi se përdorimi i këtij aplikacioni nuk i përmbushte standardet ligjore të mbrojtjes së të dhënave, duke kërkuar që shkolla të kalonte në metoda më të sigurta për trajtimin e të dhënave personale.<sup>139</sup>

**119.** Në vazhdim të çështjes së mbrojtjes së të dhënave, Platforma CiviKos, në bashkëpunim me AIP dhe Institutin për Teknologji dhe Shoqëri (ITS), ka publikuar një Udhëzues praktik dhe shumëgjuhësh për Mbrojtjen e të Dhënave për Organizatat e Shoqërisë Civile. Dokumenti është hartuar për t’u ndihmuar aktorëve të shoqërisë civile në forcimin e përputhshmërisë me kornizën e mbrojtjes së të dhënave në Kosovë, duke ofruar udhëzime operacionale mbi përpunimin e ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave personale të përfituesve, anëtarëve dhe partnerëve. Rëndësia e tij qëndron në adresimin e boshllëqeve të kapaciteteve brenda sektorit joqeveritar në një kohë të ekspozimit të shtuar digjital dhe rreziqeve për sigurinë e të dhënave.<sup>140</sup>

**120.** Në vitin 2025, vazhduan shqetësimet lidhur me zbatimin efektiv të Ligjit Nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, i cili parashikon masa mbrojtëse kundër veprimeve hakmarrëse ndaj personave që raportojnë shkelje, përfshirë shkarkimin nga puna, degradimin ose masa të tjera të dëmshme në punësim. Në maj 2025, Shyqeri Krasniqi, auditor i brendshëm në Komunën e Fushë Kosovës, deklaroi se ishte suspenduar dhe më pas shkarkuar pas raportimit të parregullsive në prokurimin publik lidhur me ndërtimin dhe renovimin e sallave të sportit, me investime rreth 830,000 euro gjatë viteve 2018–2020 dhe 313,000 euro shtesë për renovime, si dhe shpenzime të mëtejshme të raportuara në vitin 2024 pavarësisht defekteve strukturore të vazhdueshme. Krasniqi kishte dorëzuar dokumentacion në prokurori në vitin 2023, duke çuar në hetime të paktën njëmbëdhjetë persona, nëntë prej tyre zyrtarë publikë; megjithatë, ai pretendon se menjëherë pas publikimit të gjetjeve të tij në prill 2025, ka marrë vlerësime të përshpejtuara dhe të parregullta të performancës, të cilat sipas tij janë përdorur për ta justifikuar shkarkimin e tij.<sup>141</sup> Ky rast ndjek shqetësimet e mëhershme, përfshirë shkarkimin dhe rikthimin e pjesshëm në detyrë të një tjetër zyrtari raportues në çështjen e prokurimit të rezervave shtetërore.<sup>142</sup>

## 121. Rekomandimet

- Policia e Kosovës dhe Prokuroria duhet ta sigurojnë hetimin efektiv të të gjitha kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve, duke i trajtuar këto raste me prioritet dhe duke iniciuar

137 Balkan Insight (2025), [Kamerat e sigurisë po shtohen në Kosovë – dhe ankesat për privatësi po rriten](#).

138 Kallxo (2025), [Shkolla nuk guxon të mbledhë të dhëna private për nxënësit duke përdorur “Viber”-in](#).

139 BIRN (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

140 Platforma Civikos (2025), [Udhëzues për mbrojtjen e të dhënave për organizatat e shoqërisë civile](#).

141 Prishtina Insight 2025, [Sinjalizuesi akuzon komunën e Kosovës për shkarkim hakmarrës pas ekspozimit të korrupsionit](#).

142 Koalicioni i Evropës Juglindore për Mbrojtjen e Sinjalizuesve (2025), [Flit dhe të mbyllet goja: si Kosova mbron të dyshuarit dhe ndëshkon sinjalizuesit](#).

hetime ex officio;

- Policia e Kosovës dhe Prokuroria duhet gjithashtu t'i operacionalizojnë mekanizmat e reagimit të shpejtë në rastet që i përfshijnë gazetarët, përfshirë ndërhyrjen në situata me rrezik emergjent;
- Ministria e Drejtësisë duhet të vendosë garanci ligjore kundër keqpërdorimit të procedurave gjyqësore ndaj gazetarëve (SLAPP), duke e përfshirë rishikimin e kornizës ligjore për t'i parandaluar paditë abuzive dhe për ta siguruar mbrojtjen e lirisë së shprehjes.

## 5.6 Liria e tubimit paqësor

**122.** E drejta për tubim paqësor garantohet në nivel ndërkombëtar në nenin 20 të DUDNJ-së dhe është e detyrueshme juridikisht sipas nenit 21 të PNDCP-së, i cili lejon kufizime vetëm kur ato janë të ligjshme, të nevojshme dhe proporcionale në një shoqëri demokratike, për qëllime legjitime si siguria kombëtare, rendi publik ose mbrojtja e të drejtave të të tjerëve. Në Komentin e Përgjithshëm nr. 37 (2020), Komiteti për të Drejtat e Njeriut ka sqaruar se tubimet mund të marrin forma të ndryshme, përfshirë edhe tubimet online, dhe e ka theksuar detyrimin pozitiv të shteteve për t'i lehtësuar dhe mbrojtur tubimet paqësore. Në kuadër të kornizës evropiane, neni 11 i KEDNJ-së mbron në mënyrë të ngjashme lirinë e tubimit dhe të organizimit, parim i përforcuar nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në çështjen Plattform “Ärzte für das Leben” kundër Austrisë (1988), e cila ka theksuar se shtetet jo vetëm që duhet të përmbahen nga ndërhyrja, por edhe të ndërmarrin masa të arsyeshme për ta mundësuar zhvillimin e tubimeve pa pengesa. Kjo e drejtë forcohet më tej në nenin 5(d)(ix) të CERD-it, duke e siguruar barazinë në ushtrimin e saj, si dhe në nenin 7 të CEDAW-it, i cili e garanton pjesëmarrjen e barabartë të grave në shoqata dhe në jetën publike.

**123.** Në Kosovë, kjo e drejtë është e sanksionuar në nenin 43 të Kushtetutës, i cili e garanton “të drejtën për të organizuar tubime, protesta dhe demonstrata dhe të drejtën për të marrë pjesë në to”. Korniza ligjore e specifikon më tej këtë mbrojtje përmes Ligjit Nr. 08/L-166 për Tubimet Publike, Ligjit Nr. 04/L-076 për Policinë dhe Kodit Penal Nr. 06/L-074.

**124.** Në maj 2025, disa OSHC organizuan dhe morën pjesë në protesta lidhur me ngërçin e vazhdueshëm politik në Kosovë. Një protestë simbolike para Kuvendit të Kosovës u organizua për ta denoncuar bllokadën politike pas zgjedhjeve parlamentare të shkurtit. Aktivistët vendosën 120 karrige të zbrazëta jashtë ndërtesës së Kuvendit, secila duke e përfaqësuar një vend në legjislaturë. Karriget mbanin pankarta me mesazhe si “Pse ju kemi zgjedhur?”, “Politikanët e kanë ndalur orën” dhe “Kuvendi nuk është funksional—ju lutemi provoni më vonë”, duke e artikuluar pakënaqësinë e publikut me paralizën institucionale. Karrigia e caktuar për Kryetarin e Kuvendit mbante vetëm fjalën “Mjaft”. Pranë karrigeve ishin vendosur orë të vogla për ta nënvizuar kohën e humbur që nga zgjedhjet dhe dështimin e vazhdueshëm për ta konstituuar një Kuvend funksional.<sup>143</sup>

**125.** Në mes të ngërçit të zgjatur parlamentar, në korrik 2025, një protestë simbolike jashtë Kuvendit të Kosovës tërhoqi vëmendjen e publikut ndaj krizës institucionale, ku avokati Arianit

Koci solli katër gomarë në hyrje të ndërtesës së Kuvendit, duke e paraqitur hapur këtë veprim si koment mbi udhëheqjen politike dhe dështimin e vazhdueshëm të deputetëve për ta zgjedhur Kryetarin e Kuvendit. Në atë kohë, më shumë se 50 tentativa votimi kishin dështuar, ndërsa Gjykata Kushtetuese kishte vendosur një afat 30-ditor për konstituimin e Kuvendit. Protesta e Kocit, e shoqëruar me akte të tjera simbolike, përfshirë prerjen e flokëve para ndërtesës, u bë simbol i pakenaqësisë së gjerë publike me paralizën institucionale.

**126.** Përveç ngërçit parlamentar, veteranët e luftës në Kosovë protestuan kundër Dhomave të Specializuara të Kosovës (KSK) përmes një demonstrate të mbajtur në gusht 2025. Mijëra veteranë të luftës u mbledhën në Prishtinë për të protestuar kundër KSK-së, duke pretenduar paragjykim institucional dhe padrejtësi në ndjekjen penale të ish-udhëheqësve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Protesta u organizua nga shoqata e veteranëve, të cilët shprehën mbështetje për katër ish-zyrtarë të lartë të UÇK-së që ndodheshin në paraburgim para gjykatës. Protestuesit e karakterizuan tribunalin si një mekanizëm që e shtrembëron narrativën e çlirimit të Kosovës dhe e minon legjitimitetin e luftës së armatosur. Nuk u raportuan incidente të dhunshme. Mobilizimi pasqyron vazhdimin e kontestimeve shoqërore mbi proceset e drejtësisë tranzicionale dhe tensionin e perceptuar midis mekanizmave ndërkombëtarë të llogaridhënies dhe kornizave dominuese të kujtesës kombëtare.<sup>144</sup>

**127.** Më 8 mars 2025, Dita Ndërkombëtare e Gruas në Kosovë u shënuar me një marsh protestues në Prishtinë, i organizuar nga kolektivi “Marshojmë S’festojmë” nën sloganin “Marshojmë për njëra-tjetrën”. Marshimi u zhvillua nga Sheshi “Zahir Pajaziti” deri te ndërtesa e Qeverisë, ku organizatorët paraqitën kërkesa ndaj institucioneve përgjegjëse për parandalimin dhe adresimin e dhunës me bazë gjinore. I zhvilluar në kontekstin e vazhimit të femicidit, dhunës në familje, përdhunimeve dhe pabarazisë strukturore gjinore, protesta i rikujtoi disa vrasje dhe tentativa vrasjeje të grave të regjistruara gjatë vitit të mëparshëm, duke i theksuar dështimet e përsëritura institucionale në parandalim dhe mbrojtje.<sup>145</sup>

**128.** Në maj 2025, punëtorët e pastrimit në Prishtinë protestuan para ndërtesës së komunës për shkak të pagave të papaguara dhe borxheve të mbetura që lidhen me mosmarrëveshjen ndërmjet Komunës së Prishtinës dhe Kompanisë Rajonale të Mbeturinave “Pastrimi”. Kompania e kishte pezulluar mbledhjen e mbeturinave që nga 14 maji, duke e përmendur bllokimin e pagesave në vlerë prej 2.7 milionë eurosh, mungesën e karburantit dhe pamundësinë financiare për ta vazhduar operimin, gjë që rezultoi me grumbullim të konsiderueshëm të mbeturinave në kryeqytet. Gjatë periudhës raportuese, nuk ishte arritur ende një marrëveshje përfundimtare, ndërsa Prokuroria Themelore në Prishtinë e autorizoi mbledhjen e provave lidhur me dëmet e mundshme mjedisore që mund të kenë ardhur nga dështimi i zgjatur i shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave.<sup>146</sup>

**129.** Në maj 2025, qindra pronarë dhe përfaqësues biznesesh i bllokuan rrugët kryesore hyrëse në Prishtinë në shenjë proteste ndaj vendimit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRRE), i cili

144 AP News (2025), [Veteranët e Kosovës protestojnë kundër një gjykate të mbështetur nga BE-ja që po ndjek ish-luftëtarët e pavarësisë.](#)

145 KWN (2025), [Duke marshuar për njëri-tjetrin.](#)

146 KALLXO (2025), [Punëtorët e “Pastrimit” protestë para Komunës së Prishtinës, Rama: Askush nuk do të mbetet pa punë.](#)

kërkonte që kompanitë me më shumë se 50 punonjës dhe me qarkullim vjetor mbi 10 milionë euro të furnizoheshin me energji elektrike në tregun e hapur nga 1 qershor 2025. Kjo masë u hoqi atyre qasjen në tarifën e subvencionuara shtetërore. Përfaqësuesit e bizneseve deklaruan se reforma mund t'i rrisë kostot e energjisë deri në 200 për qind, me disa parashikime për trefishim të shpenzimeve vjetore për energji. Ata kërkuan një periudhë tranzitore njëvjeçare për të mundësuar investime në infrastrukturë të energjisë së ripërtëritshme. Rregullatori e paraqiti reformën si pjesë të angazhimeve për liberalizimin e tregut, të lidhura me procesin e anëtarësimit të Kosovës në BE. Kryeministri në detyrë Albin Kurti refuzoi shtyrjen, duke argumentuar se vazhdimi i subvencioneve do ta zhvendoste barrën financiare nga rreth 1,200 kompani te konsumatorët familjarë. Reforma u zhvillua në një kontekst energjetik strukturalisht të brishtë: Kosova prodhon mbi 90 për qind të energjisë elektrike nga termocentrale të vjetruara me qymyr, mbetet e varur nga importet për t'i mbuluar mungesat në furnizim dhe ka shpenzuar 114 milionë euro për import të energjisë në vitin 2024.<sup>147</sup>

**130.** Më 14 qershor 2025, parada vjetore e krenarisë u mbajt në Prishtinë si pjesë e Javës së Krenarisë e organizuar nga "Prishtina Pride" nën sloganin "Asnjë hap prapa", duke i bashkuar pjesëmarrësit në një marshim publik që kërkonte barazi, dinjitet dhe mbrojtje më të fortë të të drejtave të personave LGBTI+ në Kosovë.<sup>148</sup>

**131.** Raportet nga mediat lokale serbe deklarojnë se më 28 qershor 2025, gjatë përkujtimit të Vidovdanit në Graçanicë, një kolonë automjetesh ka kaluar pranë Manastirit të Graçanicës duke shfaqur flamuj kombëtarë shqiptarë dhe duke përdorur vazhdimisht boritë e makinave. Ngjarja ka ndodhur në një datë me rëndësi të lartë simbolike për komunitetin serb të Kosovës dhe është perceptuar nga disa aktorë lokalë si provokuese.<sup>149</sup>

### 132. Rekomandimet

- Policia e Kosovës duhet ta sigurojë lehtësimin dhe mbrojtjen e të gjitha tubimeve paqësore duke i zbatuar në mënyrë strikte parimet e ligjshmërisë dhe proporcionalitetit, si dhe duke u përmbajtur nga çdo formë e frikësimit;
- Ministria e Punëve të Brendshme duhet të miratojë dhe zbatojë udhëzime të qarta operationale për menaxhimin e tubimeve publike dhe praktika të qarta policore jodiskriminuese;
- Kuvendi i Kosovës duhet ta sigurojë konstituimin me kohë dhe funksionimin efektiv të institucioneve legjislative, me qëllim të parandalimit të ngërceve të zgjatura politike që e minojnë pjesëmarrjen demokratike dhe kontribuojnë në protesta të përsëritura publike.

147 Reuters (2025), [Bizneset në Kosovë bllokojnë rrugët për shkak të rritjes së çmimit të energjisë](#).

148 Prishtina Pride (2025), [Java e Krenarisë 2025](#).

149 NSI (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

## 5.7 Liria e asociimit

**133.** Liria e asociimit është një komponent thelbësor i kornizës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Ajo njihet në nenin 20 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (DUDNJ), përfshirë ndalimin në nenin 20(2) të anëtarësismit të detyruar. Kjo e drejtë është detyruese juridikisht sipas nenit 22 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (PNDKP), i cili garanton lirinë për të formuar dhe për t'u bashkuar në shoqata, përfshirë sindikatat, me kufizime vetëm kur ato parashikohen me ligj dhe janë të domosdoshme në një shoqëri demokratike. Komiteti për të Drejtat e Njeriut, në Komentin e Përgjithshëm nr. 25 (1996), e ka lidhur lirinë e asociimit me pjesëmarrjen politike dhe në çështjet publike. Mbrojtjet specifike të punës janë të kodifikuara në Konventën nr. 87 të ILO-s (1948) dhe Konventën nr. 98 (1949). Në nivel rajonal, neni 11 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) e mbron këtë të drejtë, ndërsa Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) në çështjen Demir dhe Baykara kundër Turqisë (2008) ka theksuar se negocimi kolektiv bën pjesë në thelbin e saj, dhe në Wilson, National Union of Journalists dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar (2002) ka konfirmuar se mbrojtja nga diskriminimi anti-sindikal është pjesë integrale e ushtrimit të saj. Mosdiskriminimi në gëzimin e kësaj të drejte garantohet më tej në nenin 7(c) të CEDAW dhe nenin 5(d)(ix) të CERD. Në plotësim të këtyre instrumenteve detyruese, Udhëzimet e Përbashkëta të Komisionit të Venecias dhe OSBE/ODIHR për Lirinë e Asociimit (2014) ofrojnë standarde autoritative për pajtueshmërinë legjislative dhe institucionale.

**134.** Liria e asociimit garantohet përmes nenit 44 të Kushtetutës së Kosovës, i cili e përfshin të drejtën për “të themeluar një organizatë pa leje” (neni 44.1) dhe të drejtën për të themeluar sindikata (neni 44.2). Përveç këtyre mbrojtjeve kushtetuese, një sërë ligjesh dhe aktesh nënligjore e rregullojnë më tej ushtrimin e kësaj të drejte, përfshirë legjislacionin që i rregullon OJQ-të, marrëdhëniet e punës dhe sindikatat.

**135.** Ligji Nr. 06/L-043 për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare rregullon më tej të drejtën kushtetuese për t'u asociuar pa pasur nevojë për leje. I njohur si Ligji për OJQ-të, ky legjislacion krijon një mjedis më të përmirësuar juridik për organizatat joqeveritare duke i hequr kufizimet për banorët e huaj dhe duke futur forma të reja ligjore me afate të shkurtuara për regjistrim. Siç është përshkruar në raportin e mëparshëm të OSHC-ve për vitin 2024, Ligji Nr. 08/L-244 ka ndryshuar dhe plotësuar Ligjin Nr. 06/L-043 për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare në vitin 2024, duke e futur kështu të drejtën formale të ankesës kundër vendimeve përfundimtare administrative.<sup>150</sup> Ky mekanizëm u operacionalizua në vitin 2025 përmes Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2025 të miratuar nga Ministria e Punëve të Brendshme.<sup>151</sup>

**136.** Për më tepër, Ligji Nr. 04/L-011 për Organizimin e Sindikatave në Kosovë dhe Ligji Nr. 03/L-212 i Punës e rregullojnë të drejtën e organizimit sindikal në kuadër të sektorit publik dhe privat të punësimit. Ligji për OJQ-të zbatohet për të gjitha llojet e organizatave joqeveritare, përfshirë organizatat bazë. Udhëzimi Administrativ Nr. 12/2022 për Regjistrimin, Funksonimin dhe Çregjistrimin e Organizatave Joqeveritare i përcakton gjithashtu procedurat për regjistrimin, funksionimin dhe

150 HRN (2025), [Raporti i Shoqërisë Civile për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2024](#).

151 YIHR (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

çregjistrimin e instituteve si një formë e re organizative e OJQ-ve e njohur nga Ligji për OJQ-të. Regjistri publik i OJQ-ve duhet të përditësohet dhe të sigurojë që sistemi elektronik i OJQ-ve në Kosovë të jetë plotësisht i besueshëm.

**137.** Duke e pasqyruar periudhën raportuese të vitit 2024, viti 2025 nuk e solli miratimin e Strategjisë së Qeverisë për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile (2026–2031), pavarësisht përpjekjeve të vazhdueshme të Zyrës për Qeverisje të Mirë (ZQM) dhe Platformës OJQ CiviKos për finalizimin e saj. Kjo vonesë e vazhdueshme, e shoqëruar me mosaktivitetin e Këshillit për Bashkëpunim të Qeverisë me Shoqërinë Civile gjatë gjithë vitit, ngre shqetësime lidhur me angazhimin e Qeverisë së Kosovës për nxitjen e një bashkëpunimi domethënës me organizatat e shoqërisë civile në Kosovë. Mungesa e një strategjie të përditësuar e thekson më tej stagnimin në bashkëpunimin institucional, duke e kufizuar efektivitetin e pjesëmarrjes së shoqërisë civile në proceset e hartimit të politikave publike.<sup>152</sup>

**138.** Në tetor 2025, një grup i OSHC-ve i ka dërguar një letër të përbashkët António Costa-s, Ursula von der Leyen, Kaja Kallas dhe Aivo Orav, duke e kërkuar heqjen e plotë të masave kufizuese të vendosura ndaj Kosovës në vitin 2023 pas tensioneve në veri të vendit. Në letrën e tyre, OSHC-të argumentuan se këto masa kishin ndikuar negativisht në procesin e integritit evropian të Kosovës. Në përgjigjen e saj pasuese në dhjetor 2025, Komisioni Evropian njoftoi për tërheqjen e pjeshme të masave.<sup>153</sup>

**139.** Në vitin 2025, Save the Children Kosova publikoi Manualin për Funksonimin e Kuvendeve Komunale të Drejtuara nga Fëmijët (KKDF),<sup>154</sup> duke e konsoliduar kështu mbi një dekadë praktikë në mbështetjen e pjesëmarrjes së fëmijëve në nivel lokal. Manuali operacionalizon të drejtën e fëmijëve për pjesëmarrje, përfshirë të drejtën për t'i shprehur mendimet dhe për t'u dëgjuar, si dhe e forcon realizimin praktik të së drejtës për tubim në strukturat e qeverisjes komunale. Ai ofron udhëzime të strukturuar për krijimin, organizimin dhe integrimin institucional të KKDF-ve, duke i pozicionuar ato si mekanizma formalë të përfaqësimit kolektiv të fëmijëve në vendimmarrjen lokale. Manuali rekomandon gjithashtu pronësi më të qartë institucionale nga komunat, harmonizim me Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës dhe përfshirjen e përfaqësuesve të KKDF-ve në ekipet komunale për të drejtat e fëmijëve, duke i adresuar boshllëqet në Udhëzimin Administrativ (QRK) Nr. 06/2022. Në përgjithësi, publikimi përfaqëson një hap konkret në vitin 2025 drejt institucionizimit të të drejtave të pjesëmarrjes dhe tubimit të fëmijëve në nivel lokal.<sup>155</sup>

**140.** Klima për lirinë e asociimit mbeti formalisht e garantuar në vitin 2025; megjithatë, monitorimi nga OJQ NSI raportoi incidente frikësimi që kishin në shënjestër anëtarë të komunitetit serb të Kosovës të angazhuar në asociim politik. Këto përfshinin hedhjen e një kokteji molotov më 26 janar 2025 në Ranillug në shtëpinë familjare të Aleksandra Popović, anëtare e Komisionit Komunal Zgjedhor e lidhur me Listën Serbe; shpimin e gomave të automjetit privat të Milan Kostić, kryetar i Autoritetit të Përkohshëm të Vushtrrisë dhe kandidat i Listës Serbe, gjatë natës mes 1 dhe 2 shkurtit 2025; si dhe djegien e një automjeti privat që i përkiste një familjari të Časlav Sofronijević, kandidat i Listës Serbe për asamblenë komunale, më 22 gusht 2025 në Zveçan.<sup>156</sup>

152 Civikos (2026), [Punëtori e Grupit të Punës në kuadër të hartimit të Strategjisë për Bashkëpunim Qeveri-Shoqëri Civile 2026–2031](#).

153 Indeks online (2025), [Letër i dërgohet BE-së për heqjen e masave ndaj Kosovës](#).

154 Save the Children Kosova/o (2025), [Manuali për funksionimin e kuvendeve komunale të udhëhequra nga fëmijët](#).

155 Save the Children Kosova/o (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

156 NSI (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

**141.** Gjatë periudhës raportuese, OJQ AKTIV u përball me një seri sulmesh publike dhe përpjekjesh për diskreditim që mund të karakterizohen si një fushatë e koordinuar shpifëse në një mjedis politikisht të polarizuar. Gjatë një periudhe tremujore, tre incidente të ndara kishin në shënjestër organizatën dhe anëtarët e Platformës Empirika përmes pretendimeve të pabazuara dhe narrativave mediatike shpifëse, duke kontribuar në një klimë armiqësore informative dhe duke i rritur presionet reputacionale dhe operacionale. Në të paktën një rast, mekanizmat vetërregullues të mediave konfirmuan shkelje të standardeve profesionale, duke theksuar mungesën e bazës faktike për disa pretendime. Fushata detyroi AKTIV-in të ridrejtojë kohë dhe burime të konsiderueshme drejt menaxhimit të krizës, sqarimeve publike dhe angazhimit me mekanizmat mbikëqyrës, duke ndikuar kështu në zbatimin e projekteve dhe duke e kufizuar pjesëmarrjen e hapur në proceset e dialogut, veçanërisht në komunitetet më të vogla. Në mënyrë më të gjerë, një targetim i tillë rrezikon të krijojë një efekt frenues ndaj aktorëve të shoqërisë civile që punojnë në çështje të ndjeshme, përfshirë të drejtat e pakicave dhe marrëdhëniet ndëretnike, si dhe mund të kontribuojë në ngushtimin e hapësirës qytetare dhe dialogut demokratik.<sup>157</sup>

#### 142. Rekomandimet

- Qeveria e Kosovës duhet ta operacionalizojë Strategjinë për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile dhe Planin e saj të Veprimit pas miratimit, duke e përfshirë në mënyrë kuptimplote shoqërinë civile në proceset e vendimmarrjes;
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal duhet të institucionalizojë Kuvendet Komunale të Drejtuar nga Fëmijët (KKDF) në strukturat e vendimmarrjes komunale;
- Policia e Kosovës dhe Prokuroria duhet t'i hetojnë dhe t'i ndjekin penalisht format e frikësimit dhe dhunës të drejtuar ndaj individëve të angazhuar në aktivitete politike dhe në aktivitete të shoqërisë civile.

### 5.8 Liria e besimit, e ndërgjegjes dhe e fesë

**143.** Liria e besimit, ndërgjegjes dhe fesë garantohet sipas nenit 18 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (DUDNJ) dhe është juridikisht detyruese sipas nenit 18 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (PNDCP), i cili e mbron të drejtën për të zgjedhur një fe ose besim sipas zgjedhjes personale dhe për ta shprehur atë individualisht ose në bashkësi me të tjerët. Komiteti për të Drejtat e Njeriut, në Komentin e Përgjithshëm nr. 22 (1993), ka sqaruar se liria e mendimit dhe besimit është absolute dhe nuk mund të kufizohet, ndërsa kufizimet mund të zbatohen vetëm ndaj shfaqjes së jashtme të fesë ose besimit dhe duhet të jenë të parashikuara me ligj dhe rreptësisht të domosdoshme dhe proporcionale. Gjithashtu, neni 9 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) e garanton këtë të drejtë, duke lejuar kufizime vetëm kur ato janë të nevojshme në një shoqëri demokratike për sigurinë publike, rendin publik, shëndetin, moralin ose mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve. Kjo e drejtë përforcohet më tej nga neni 5(d)(vii) i Konventës Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor (CERD), si dhe nga neni

2 i Deklaratës së OKB-së të vitit 1992 për të Drejtat e Personave që u përkasin Pakicave Kombëtare ose Etnike, Fetare dhe Gjuhësore, i cili e afirmon dimensionin kolektiv të lirisë fetare dhe të drejtën e pakicave për ta ushtruar fenë e tyre pa diskriminim.

**144.** Në nivel kushtetues në Kosovë, liria e besimit, ndërgjegjes dhe fesë garantohet sipas nenit 38, i cili e mbron të drejtën për të pasur, ndryshuar dhe shprehur një fe ose besim, individualisht ose në bashkësi me të tjerët, dhe përfshin të drejtën për të mos u detyruar të bashkohesh në një bashkësi fetare ose ta zbulosh përkatësinë tënde fetare. Dimensioi kolektiv i kësaj të drejte përforcohet më tej nga neni 59(1), i cili i garanton të drejtat e komuniteteve për ta shprehur, ruajtur dhe zhvilluar kulturën e tyre dhe për t'i mbrojtur elementet thelbësore të identitetit, përfshirë fenë. Kosova përcaktohet si shtet laik sipas nenit 8, që kërkon neutralitet institucional në çështjet e besimit fetar; ky parim është rikonfirmuar edhe nga Gjykata Kushtetuese në rastin e Arjeta Halimit,<sup>158</sup> ku Gjykata theksoi se autoritetet publike janë të detyruara ta respektojnë dhe ta ruajnë neutralitetin e shtetit në çështjet fetare.

**145.** Ashtu si në periudhën e mëparshme raportuese, edhe në vitin 2025 miratimi i Projektligjit për Lirinë Fetare mbeti i pazgjidhur. Megjithëse projektligji ishte miratuar nga Qeveria në vitin 2023 me qëllimin e deklaruar për përditësimin e kornizës ligjore për lirinë fetare dhe përmirësimin e përputhshmërisë me standardet kushtetuese dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, ai nuk u përfshi në Agjendën Legjislative të Qeverisë për vitin 2024 dhe nuk është miratuar nga Kuvendi. Reforma pritej të sqaronte statusin juridik të bashkësive fetare, përfshirë njohjen e qartë të të drejtave që lidhen me pronësinë dhe marrjen me qira të pronës, administrimin financiar, marrëdhëniet e punësimit dhe themelimin e institucioneve humanitare dhe arsimore, si dhe ta parashihte krijimin e një komisioni për trajtimin e çështjeve praktike dhe përcaktimin e kriterëve për regjistrimin e bashkësive të reja fetare në Kosovë.

**146.** Kosova i ka themeluar 43 Zona të Veçanta të Mbrojtura në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-039 për Zonat e Veçanta të Mbrojtura, me qëllim të mbrojtjes së objekteve me rëndësi fetare dhe kulturore, veçanërisht atyre të lidhura me Kishën Ortodokse Serbe. Këto zona ofrojnë mbrojtje të shtuar ligjore kundër aktiviteteve që mund ta dëmtojnë ose ta cenojnë mjedisin historik, kulturor apo natyror dhe janë subjekt i mbikëqyrjes së vazhdueshme të sigurisë nga një njësi e specializuar policore multietnike. Megjithëse gjatë vitit 2025 nuk u raportuan shkelje të mëdha të sigurisë apo incidente në shkallë të gjerë në këto zona, u regjistruan raste të izoluara vandalizmi, përdhosjeje dhe kontestimi publik lidhur me identitetin historik të disa objekteve fetare, duke ngritur shqetësime të vazhdueshme për ruajtjen e trashëgimisë fetare.

**147.** Në vitin 2025, bashkëjetesa ndërfaqetare në Kosovë është sfiduar gjithnjë e më shumë nga fushata të koordinuara dezinformimi që e kanë instrumentalizuar fenë për të nxitur tensione ndëretnike dhe politike, sipas Prishtina Insight.<sup>159</sup> Hetimet nga Prokuroria Speciale dhe institucionet kundër terrorizmit konfirmuan se ideologjitë radikale fetare, të cilat qarkullojnë kryesisht përmes platformave online, vazhduan të përdoren për të përhapur gjuhë të urrejtjes, për të nxitur përçarje ndërmjet grupeve myslimane dhe për të paraqitur incidente të izoluara pranë objekteve të Kishës Ortodokse Serbe si persekutim sistematik fetar. Për më tepër, media të lidhura me shtetin rus dhe zyrtarë serbë amplifikuan narrativa që paraqisnin institucionet e Kosovës si armiqtësore ndaj Kishës

158 Gjykata Kushtetuese, (2011) <https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2017/11/BULETINI-2011-SHQ.pdf>

159 Prishtina Insight (2026), [Si dezinformimi minon tolerancën ndërfaqetare në Kosovë.](#)

Ortodokse Serbe, përfshirë pretendime të ekzagjeruara ose të pabazuara lidhur me shkatërrimin e varrezave dhe provokime të supozuara pranë vendeve fetare.<sup>160</sup>

**148.** Temat fetare janë instrumentalizuar gjithashtu në periudha të ndryshme gjatë zgjedhjeve lokale të vitit 2025 dhe zgjedhjeve të hershme parlamentare, veçanërisht në debatet rreth të drejtave të personave LGBTI+, shamisë dhe “vlerave familjare”, duke e reflektuar vazhdimësinë e përdorimit të fesë si mjet polarizues politik. Ndërsa këto dinamika nuk kanë paraqitur shkelje strukturore të lirisë së fesë, ato kanë kontribuar në krijimin e një atmosfere në të cilën dezinformimi, stigmatizimi dhe narrativat gjeopolitike të jashtme e tensionojnë ekuilibrin ndërfaqetare në Kosovë.<sup>161</sup>

**149.** Gjykata Supreme e ka refuzuar padinë që e kërkonte shfuqizimin e nenit 3 të Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2014 të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, duke e konfirmuar kështu autoritetin e Ministrisë për ta rregulluar sjelljen e nxënësve, përfshirë kodet e veshjes, në shkollat publike. Padia, e paraqitur nga Rrjeti i Grave për Zhvillim Profesional “Arrita”, argumentonte se ndalimi i “uniformave fetare” kufizonte në mënyrë të paligjshme të drejtat kushtetuese të vajzave për liri besimi dhe shprehje fetare, duke iu referuar rasteve të shumta kur nxënëset ishin përjashtuar ose u ishte ndaluar ndjekja e mësimin për shkak të mbajtjes së shamisë islame, përfshirë një rast të dokumentuar në shkollën e mesme “Bedri Pejani” në Pejë. Gjykata konstatoi se kërkesa ishte e pabazuar, duke arsyetuar se udhëzimi administrativ në fjalë ishte nxjerrë në bazë të autorizimit të qartë ligjor dhe për këtë arsye ishte në përputhje me normat më të larta juridike, duke theksuar se kufizimet në shfaqjen e fesë janë të lejuara kur parashikohen me ligj dhe justifikohen nga konsiderata të rendit publik dhe të drejtave të të tjerëve, sipas neneve 38 dhe 55 të Kushtetutës.<sup>162</sup>

**150.** Në vitin 2025, konvertimet fetare nga Islami në Katolicizëm në Kosovë morën vëmendje të mediave ndërkombëtare, përfshirë mbulimin nga The New York Times, e cila raportoi për ceremonitë e pagëzimit në Llapushnik dhe Podujevë, si dhe për shfaqjen e një lëvizjeje të vogël aktiviste që e përkufizon konvertimin si një “kthim” në identitetin e krishterë shqiptar para-osman. Ky fenomen është paraqitur më pak si një ndryshim demografik dhe më shumë si një diskurs i ndërlidhur me identitetin, i lidhur me nacionalizmin dhe orientimin evropian të Kosovës, me liderët politikë, në veçanti Kryeministrin në detyrë, që e theksojnë karakterin laik të shtetit,<sup>163</sup> dhe zyrtarët fetarë që paralajmërojnë kundër politizimit të besimit.<sup>164</sup>

**151.** Në gusht 2025, OJQ BIRN Kosova transmetoi një intervistë ekskluzive në emisionin “KALLXO Përnime” me Dr. Tarek Al-Jahari, ekspert në studimet islame.<sup>165</sup> Në intervistë, Dr. Al-Jahari e diskutoi fenomenin e ekstremizmit të dhunshëm tek të rinjtë nga Kosova, duke i shpjeguar faktorët ideologjikë, socialë dhe ekonomikë që kontribuojnë në radikalizim. Ai e trajtoi keqpërdorimin e teksteve fetare nga lëvizje ekstremiste, përfshirë interpretime me ndikim vahabist, dhe theksoi

160 Prishtina Insight (2026), [Si dezinformimi minon tolerancën ndërfaqetare në Kosovë.](#)

161 Prishtina Insight (2026), [Si dezinformimi minon tolerancën ndërfaqetare në Kosovë.](#)

162 CNA (2025), [Gjykata Supreme refuzon padinë për shaminë islame në shkollat e Kosovës.](#)

163 Balkan web (2025), [Albin Kurti për New York Times: Për identitetin shqiptar, feja nuk ka qenë kurrë parësore.](#)

164 Indeks Online (2025), [NYT për konvertimet në Kosovë.](#)

165 Kallxo (2025), [Intervistë me Dr. Al-Jahari.](#)

parimet e Islamit për pluralizëm, bashkëjetesë dhe respekt ndaj shtetit dhe sundimit të ligjit. Intervista gjithashtu vuri në pah sfidat e parandalimit dhe rehabilitimit, duke e theksuar rëndësinë e edukimit gjithëpërfshirës fetar, angazhimit komunitar dhe identifikimit të hershëm të narrativave radikale.<sup>166</sup>

**152.** OJQ NSI raporton se viti 2025 u karakterizua nga një sërë incidentesh që i prekin objektet fetare ortodokse serbe, varrezat dhe pelegrinët në Kosovë. Incidentet e raportuara përfshinin thyerje dhe vjedhje në kisha dhe kapella në rajonin e Gjilanit, dëmtimin e hermitazhit të Shën Pjetrit të Korishës gjatë punimeve ndërtimore në afërsi, heqjen e flamujve të Kishës Ortodokse Serbe në Rahovec dhe Lipjan, përdhosjen e përsëritur të varrezave ortodokse në Rahovec, Prishtinë dhe Plemetin, si dhe hyrje të përsëritura të paautorizuara dhe kryerje ritesh fetare në Kishën e Shën Kryeengjëllit Mihail në Rakitnicë nga një individ i panjohur nga Kisha Ortodokse Serbe. OJQ NSI gjithashtu e raportoi ndalimin e përkohshëm të një grupi pelegrinësh serbë të Kosovës që udhëtonin drejt vendeve fetare në Gjakovë dhe Prizren, përfshirë paraburgimin e katër personave që më vonë u liruan pas një vendimi të Gjykatës Supreme, si dhe pezullimin e punimeve të renovimit në Kishën e Lindjes së Hyjlindëses në Gorazhdec pas presioneve dhe kërcënimeve të pretenduara.<sup>167</sup>

### 153. Rekomandimet

- Kuvendi i Kosovës duhet ta miratojë pa vonesë Projektligjin për Lirinë Fetare dhe ta qartësojë statusin juridik dhe të drejtat e bashkësive fetare, përfshirë çështjet e pronës dhe funksionimit institucional;
- Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Policia e Kosovës duhet ta sigurojnë zbatimin efektiv të Ligjit për Zonat e Veçanta të Mbrojtura, duke i parandaluar ndërtimet e paautorizuara dhe duke i hetuar rastet e vandalizmit dhe përdhosjes;
- Qeveria e Kosovës duhet ta adresojë instrumentalizimin e fesë në narrativat dezinformuese që nxisin tensione ndëretnike dhe ndërfeetare.

166 BIRN (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

167 NSI (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

## 6. PJESA B: TË DREJTAT EKONOMIKE, SOCIALE DHE KULTURORE

### 6.1 Të drejtat e punës

**154.** Të drejtat e punës janë të bazuara në nenin 23 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (DUDNJ), i cili afirmon të drejtën për punë, zgjedhjen e lirë të punësimit, kushte të drejta dhe të favorshme pune, si dhe mbrojtjen nga papunësia. Këto garanci janë të kodifikuara në nenet 6–8 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (PIDESK), të cilat mbrojnë të drejtën për punë, kushte të drejta dhe të favorshme pune, si dhe të drejtën për të formuar dhe për t'u bashkuar në sindikata. Ndalimi i punës së detyruar ose të detyrueshme është i sanksionuar në nenin 4 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) dhe është përforcuar më tej nga Konventa nr. 29 e ILO-s (Konventa për Punën e Detyruar, 1930) dhe Konventa nr. 105 e ILO-s (Konventa për Heqjen e Punës së Detyruar, 1957).

**155.** Në nivel kushtetues, e drejta për punë në Kosovë është e sanksionuar në nenin 49.1 të Kushtetutës, i cili e garanton të drejtën për punë, lirinë e organizimit, të drejtën për të themeluar sindikata dhe ndalimin e punës së detyruar. Neni 51 parashikon gjithashtu mbrojtje bazike sociale në rast papunësie, ndërsa neni 61 siguron përfaqësim të drejtë të komuniteteve në punësimin publik. Megjithëse PIDESK dhe konventat relevante të ILO-s nuk janë inkorporuar formalisht në kornizën kushtetuese, ato vazhdojnë t'i përbëjnë standardet ndërkombëtare të aplikueshme. Korniza ligjore që i operacionalizon këto garanci përfshin Ligjin Nr. 03/L-212 për Punën, Ligjin Nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, si dhe Ligjin Nr. 04/L-011 për Organizimin e Sindikatave, të cilët i rregullojnë marrëdhëniet e punës dhe të drejtat sindikale në sektorin publik dhe privat.

**156.** Që nga viti 2025, ndryshimet në Ligjin Nr. 03/L-212 për Punën nuk janë miratuar, dhe projektligji i paraparë më herët në programin legjislativ të Qeverisë për vitin 2023 mbetet i papërfshirë në agjendat pasuese. Dështimi i vazhdueshëm për të rishikuar Ligjin e Punës të vitit 2012, parvarësisht avokimit të mëhershëm nga shoqëria civile, lë të pazgjidhura shqetësime afatgjata lidhur me mbrojtjen e punëtorëve, sigurinë juridike dhe përafrimin me standardet evropiane të punës.<sup>168</sup> Përveç kësaj, Qeveria e Kosovës nuk arriti të përmbyllë në vitin 2025 projektligjin e paraparë për Inspektoratin e Punës, ashtu siç ishte parashikuar në programin legjislativ për vitin 2024. Para vitit 2021, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale luante një rol të pazëvendësueshëm në hartimin dhe zbatimin e politikave sociale, mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve, dialogun social ndërmjet punëdhënësve dhe sindikatave, si dhe në ofrimin e shërbimeve sociale për grupet më të cenueshme të qytetarëve. Përmes kësaj ministrie, shteti administronte skema të ndryshme pensionale dhe të asistencës sociale që mbulonin qindra mijëra qytetarë, nga pensionistët kontribuues deri te familjet që përfitojnë asistencë sociale dhe personat me aftësi të kufizuara.<sup>169</sup> Për më tepër,

<sup>168</sup> HRN (2025), [Raporti i Shoqërisë Civile për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2024](#).

<sup>169</sup> KLI (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025..

ajo kishte përgjegjësi të drejtpërdrejtë për çështje të ndjeshme si përkujdesja për veteranët e luftës, familjet e dëshmorëve, të mbijetuarit e dhunës seksuale gjatë luftës dhe kategori të tjera të prekura nga lufta e viteve 1998–1999. Pas shuarjes së MPMS-së dhe transferimit të kompetencave të saj në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, ndodhi një ndryshim thelbësor në qasjen ndaj çështjeve sociale.<sup>170</sup> Në vend të zhvillimit të politikave afatgjata dhe gjithëpërfshirëse, qasja e re është fokusuar pothuajse ekskluzivisht në shpërndarjen e mjeteve financiare. Kjo qasje teknike dhe fiskale e ka marginalizuar funksionin social të shtetit, duke e reduktuar mirëqenien në transferta buxhetore të njëanshme, të bëra pa konsultim, pa analiza të ndikimit dhe pa përfshirjen e grupeve të interesit.<sup>171</sup> Shkrirja e MPMS-së me Ministrinë e Financave gjithashtu ka kontribuar në dështimin për përmbushjen e agjendës legjislative në fushën sociale. Ligje kyçe si Ligji për Punën, Ligji për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë dhe Ligji për Inspektoratin e Punës ose janë anashkaluar ose janë tërhequr pa shpjegim. Nga 12 projektligjet e planifikuara për periudhën 2021–2024, vetëm katër janë miratuar, dhe edhe ato janë kaluar përmes procedurave të përshpejtuara pa konsultim publik, duke rezultuar në sfida ligjore para Gjykatës Kushtetuese.<sup>172</sup>

**157.** Në nivel institucional, Inspektorati i Punës i Kosovës funksionon si autoriteti kryesor administrativ përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit dhe fuqizimit të legjislacionit të punës në praktikë. Mandati i tij shtrihet në mbikëqyrjen e marrëdhënieve të punës, respektimin e standardeve në vendin e punës dhe sigurinë dhe shëndetin në punë, në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë. Përtej kornizës bazë të rregullimit të punës, Inspektorati ushtron autoritet mbikëqyrës edhe sipas disa ligjeve sektoriale, përfshirë Ligjin Nr. 04/L-156 për Kontrollin e Duhanit (i ndryshuar në vitin 2022), Ligjin Nr. 04/L-219 për të Huajt, Ligjin Nr. 03/L-019 për Aftësimin Profesional, Rehabilitimin dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, si dhe Ligjin Nr. 02/L-81 për Mbrojtjen dhe Promovimin e Ushqyerjes me Gji. Në këtë kuptim, Inspektorati i Punës vepron si një trupë zbatuese ndërsektoriale në kryqëzimin e standardeve të punës, rregullimit të shëndetit publik, kontrollit të punësimit në kontekst migracioni dhe detyrimeve të mbrojtjes sociale. Legjislacioni për punën, sigurinë në vendin e punës dhe inspektimin mbetet i vjetërsuar dhe i pa harmonizuar me direktivat e Bashkimit Evropian dhe konventat e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO). Kjo përfshin mospërputhje në standardet për kontratat afatshkurtra, barazinë gjinore, inspektimin efektiv dhe mbrojtjen nga diskriminimi. Kosova vazhdon të funksionojë me një Ligj për Inspektoratin e Punës që daton nga periudha e UNMIK-ut dhe një Ligj për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë të vitit 2013, pavarësisht se në vitin 2024 janë raportuar 505 lëndime në vendin e punës dhe 12 raste me fatalitet. Me vetëm 54 inspektorë që mbikëqyrin mbi 70,000 biznese aktive, situata paraqet një rrezik serioz për jetën e punëtorëve. Dështimi për ta operacionalizuar Këshillin Nacional për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë e ka thelluar këtë krizë.<sup>173</sup>

**158.** Në vitin 2025, OJQ KLI identifikoi dështime sistemike në dialogun social dhe mbrojtjen kolektive të punës. Këshilli Ekonomik dhe Social (KES) ka mbetur jofunksional që nga prilli i vitit 2023 dhe gjatë gjithë vitit 2025, për shkak të mosreformimit të tij nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, duke i penguar procedurat ligjore për përcaktimin e pagës minimale dhe duke e pamundësuar përfundimin e Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive. OJQ KLI gjithashtu raportoi dështimin për të përmbyllur marrëveshje kolektive me sindikata të mëdha, përfshirë ndërprerjen

170 KLI (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025..

171 KLI (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025..

172 KLI (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

173 KLI (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

e marrëveshjes në sektorin e arsimit me SBASHK-un dhe mosnënshkrimin e marrëveshjes në sektorin e shëndetësisë. OJQ KLI përfundon se këto mangësi e minojnë mbrojtjen e punës, llogaridhënien institucionale dhe përafrimin me standardet evropiane të dialogut social.<sup>174</sup>

**159.** Nga janari i vitit 2025 e tutje, rritjet e pagave në sektorin publik të projektuara para zgjedhjeve të vitit 2024 u zbatuan, duke shtuar në fazën e parë një rritje prej 55 EUR bruto në pagat e të gjithë punonjësve të financuar nga buxheti.<sup>175</sup> Një rritje shtesë prej 55 EUR bruto, e paraparë të hynte në fuqi në fazën e dytë të planit në korrik 2025, u implementua në gusht 2025 për punonjësit e sektorit publik.<sup>176</sup>

**160.** Pavarësisht se u raportua përmbyllja e rritjes së planifikuar prej 110 EUR bruto në sektorin publik në gusht 2025, prapsepapë Sindikata e Punëtorëve të Administratës Tatimore të Kosovës e kundërshtoi publikisht këtë pretendim, duke pohuar se shumica e anëtarëve të saj nuk e kanë përjetuar një rritje efektive të pagës. Sindikata ia atribuoi këtë mospërputhje mosmiratimit të Rregullores për Sistematizimin e Vendeve të Punës dhe problemeve strukturore brenda kornizës së klasifikimit të pagave. Ky debat i pasqyron tensionet ndërmjet ndryshimeve formale të koeficientëve dhe ndikimit të tyre të diferencuar në institucione të ndryshme publike.<sup>177</sup>

**161.** Në qershor 2025, Qeveria e Kosovës në detyrë e miratoi një vendim për rritjen e përfitimeve mujore të lehonisë nga 170 EUR në 325.9 EUR, duke e përafruar këtë përfitim me vlerën neto të pagës minimale të rishikuar dhe duke përfaqësuar një rritje prej 91.7 për qind. Ky përfitim paguhet për gjashtë muaj pas lindjes së fëmijës, duke arritur në 1,955 EUR për këtë periudhë; kur kombinohet me shtesën universale për fëmijë prej së paku 20 EUR në muaj (120 EUR për gjashtë muaj), mbështetja totale shtetërore gjatë gjashtë muajve të parë tejkalon 2,000 EUR për fëmijë. Qeveria gjithashtu e njoftoi përcaktimin e një page mesatare referuese për llogaritjen e një përfitimi shtesë tremujor për nënat e punësuar në masën 50 për qind të pagës mesatare (rreth 319.5 EUR në muaj), duke e plotësuar kompensimin ligjor prej 70 për qind të lehonisë të ofruar nga punëdhënësit.<sup>178</sup>

**162.** Gjatë gjithë vitit 2025, punëtorët në sektorë të ndryshëm në Kosovë u angazhuan në protesta dhe greva të përsëritura duke kërkuar paga më të larta, pagesa me kohë të pagave dhe përmirësim të kushteve të punës. Mobilizime u regjistruan si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat, përfshirë punonjësit e kompanisë rajonale të menaxhimit të mbeturinave "Pastrimi", punëtorët e hekurudhave të Trainkos dhe Infrakos, punonjësit e sigurisë fizike në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK), punonjësit e KOSTT-it, punëtorët teknikë në sektorin privat, stafin e Komunës së Prishtinës, punëtorët e transmetuesit publik RTK, punonjësit e Trafikut Urban në Prishtinë, si dhe punëtorët e KEK-ut.<sup>179</sup> Ankesat kryesore përfshinin paga të ulëta në raport me inflacionin, vonesa në ekzekutimin e pagave, mospagesa të orëve shtesë dhe ndërrimeve të natës, pasiguri në punë lidhur me ndërprerjen e kontratave, si dhe kërkesa për rregullime strukturore si paga e 13-të dhe

174 Telegrafi (2025), : [Dita e Punës: KLI gjen Kosovën me probleme të vjetra, vdekje në vendin e punës, ligje të vjetruara dhe institucione jofunksionale.](#)

175 Reporteri (2025), [Po zbatohen rritjet e pagave në sektorin publik, 55 euro më shumë.](#)

176 Koha (2025), [Sindikata e ATK-së i quan të pavërteta deklaratat e Muratit për rritjen e pagës prej 110 euro.](#)

177 Koha (2025), [Sindikata e ATK-së i quan të pavërteta deklaratat e Muratit për rritjen e pagës prej 110 euro.](#)

178 Koha.net (2025), <https://www.koha.net/arberi/rritten-shtesat-per-lehona>

179 Tëvë (2026), [Punëtorët në Kosovë edhe në vitin 2025 protestuan për paga më të larta.](#)

rritja e pagës minimale. Disa protesta rezultuan me ndërprerje të përkohshme të punës që i prekën shërbimet publike, përfshirë operacionet hekurudhore dhe transportin urban, ndërsa demonstrata të zgjatura si protesta katërmujore e stafit të sigurisë në QKUK përfundoi me rikthimin në punë të punëtorëve të prekur.<sup>180</sup> Siç u përmend në seksionin mbi të drejtën për tubim të lirë, një protestë e rëndësishme në këtë drejtim ishte greva e punëtorëve të pastrimit në maj 2025, e mbajtur para ndërtesës komunale të Prishtinës. Punëtorët e Kompanisë Rajonale të Mbeturinave “Pastrimi” e cilësuan pjesërisht bllokimin e mjeteve financiare si arsye për protestën. Sipas punëtorëve, mungesa e financimit çoi në ndërprerje të plotë të operacioneve, ndërsa disa prej tyre deklaruan se nuk mund të punonin për shkak të mungesës së burimeve bazike, si karburanti për automjetet e grumbullimit të mbeturinave.<sup>181</sup>

**163.** Në kontekstin e pakënaqësisë strukturore të vazhdueshme lidhur me mjaftueshmërinë e pagave, Qeveria e Kosovës miratoi projektbuxhetin për vitin 2026 në tetor 2025, duke e parashikuar një rritje të fazuar të pagës minimale (në 425 EUR nga janari 2026 dhe në 500 EUR nga korriku 2026), rregullime të pensioneve dhe rritje të shtesave për fëmijë.<sup>182</sup>

**164.** Sipas Eurobarometrit Standard të BE-së (Pranverë 2025), pasiguria ekonomike mbetet shqetësimi kryesor publik në Kosovë. Gjashtëdhjetë për qind e të anketuarve e vlerësuan situatën ekonomike kombëtare si “shumë të keqe”, ndërsa vetëm 18 për qind shprehën optimizëm lidhur me përmirësimin ekonomik gjatë vitit 2025.<sup>183</sup> Përveç kushteve socio-ekonomike të brishta në Kosovë gjatë vitit 2025, të përkeqësuar nga ngërçi politik, kjo mund të lidhet pjesërisht edhe me shkallën e papunësisë. Në realitet, normat e papunësisë në Kosovë vazhdojnë të luhaten rreth 10.9 për qind në grupmoshën 15–64 vjeç<sup>184</sup> Barra nuk ishte e shpërndarë në mënyrë të barabartë, pasi gratë vazhduan të përballen me shkallë dukshëm më të lartë të papunësisë, duke arritur në 18.5 për qind krahasuar me 7.5 për qind te burrat.<sup>185</sup>

**165.** Në vitin 2025 (ndërmjet janarit dhe shtatorit), Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka pranuar 331 raportime për punësim të padeklaruar përmes platformës së saj anonime online. Megjithatë, përdorimi i kufizuar i këtij mjeti online për zbatimin e të drejtave të punës pasqyrohet edhe në shifra: vetëm 14 raste nga 331 kanë të bëjnë me punëtorë që kanë raportuar vetë punëdhënësit e tyre.<sup>186</sup> Duhet theksuar se rreth 35 për qind e punësimit total mbetet informal.<sup>187</sup>

**166.** Zbatimi i Ligjit Nr. 03/L-019 për Aftësimin Profesional, Rehabilitimin dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara mbetet në mënyrë strukturore i mangët në vitin 2025. Megjithëse ligji i obligon punëdhënësit në sektorin publik dhe privat të rezervojnë një vend pune për personat me aftësi të kufizuara për çdo 50 punonjës, pajtueshmëria vazhdon të jetë e kufizuar dhe kryesisht formale. OJQ HANDIKOS thekson në kontributin e saj për raportin e vitit 2025 se punëdhënësit shpesh i shpërfillin kualifikimet profesionale, ndërsa zbatimi nga Inspektorati i Punës nuk ka rezultuar në respektim sistematik të këtij obligimi. Obligimi i kuotës sipas Ligjit për Zyrtarët Publikë po ashtu zbatohet në mënyrë të pamjaftueshme në institucionet publike, të cilat nuk po e përm-

180 Tëvë (2026), [Punëtorët në Kosovë edhe në vitin 2025 protestuan për paga më të larta.](#)

181 Kosova Post (2025), [Punëtorët e “Pastrimit” protestojnë para Komunes së Prishtinës.](#)

182 Tëvë (2026), [Punëtorët në Kosovë edhe në vitin 2025 protestuan për paga më të larta.](#)

183 Indeks online (2025), [Eurobarometri i BE-së: ekonomia, papunësia dhe kostoja e jetesës, shqetësimet kryesore të kosovarëve.](#)

184 ASK (2026), [Papunësia dhe shkalla e papunësisë sipas gjinisë, grup mosha 15-64 2024/TM4.](#)

185 ASK (2026), [Papunësia dhe shkalla e papunësisë sipas gjinisë, grup mosha 15-64 2024/TM4.](#)

186 Prishtina Insight (2025), [Administrata Tatimore e Kosovës lufton ekonominë informale përmes mjeteve online.](#)

187 Prishtina Insight (2025), [Administrata Tatimore e Kosovës lufton ekonominë informale përmes mjeteve online.](#)

bushin rolin e tyre shembullor. Sipas HANDIKOS-it, edhe kur ndodh punësimi, personat me aftësi të kufizuara shpesh privohen nga kushte të përshtatshme të punës.<sup>188</sup>

**167.** Në tetor 2025, Qendra për Litigim Strategjik (QLS), një platformë e OJQ GLPS, paraqiti një padi duke e kërkuar shfuqizimin e Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr. 05/2015 për procedurat e raportimit, pezullimit të pagesave dhe kthimit të mjeteve në rastet e keqpërdorimit të pensioneve. CSL vlerësoi se ky Udhëzim, i cili ka qenë në fuqi për më shumë se një dekadë, ka cenuar vazhdimisht të drejtat e mijëra pensionistëve në mbarë vendin. Megjithëse çështja u trajtua përfundimisht përmes një rasti individual, Gjykata Supreme e Kosovës i konfirmoi këto pretendime dhe nxori një vendim duke i shfuqizuar dispozitat e aktit nënligjor që nuk ishin në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti.<sup>189</sup>

**168.** Në vitin 2025, vdekjet në vendin e punës në Kosovë mbetën alarmuese, me disa raste fatale të lidhura me sektorin e ndërtimit të regjistruara në kuadër të shqetësimeve më të gjera për sigurinë në punë. Ndërmjet janarit dhe tetorit 2025, burimet sindikale raportuan 26 vdekje në vendin e punës, 68 për qind e të cilave ndodhën në sektorin privat të ndërtimit, ndërsa të dhënat e Inspektoratit të Punës raportuan të paktën 13 vdekje dhe rreth 412 aksidente në vendin e punës gjatë së njëjtës periudhë, shumë prej tyre të rënda. Në disa lokacione specifike, u dokumentuan grupe rastesh fatale, përfshirë rastet në Gjakovë dhe Istog në korrik 2025, kur tre punëtorë ndërtime humbën jetën në incidente të ndara, duke kontribuar në një trend në rritje krahasuar me vitet e mëparshme. Këto shifra i nënvizojnë boshllëqet e vazhdueshme rregullatore dhe të zbatimit në sigurimin e kontratave të detyrueshme ligjërish, trajnimeve për sigurinë dhe masave mbrojtëse për punëtorët e ndërtimit.<sup>190</sup>

**169.** Qendra për Litigim Strategjik (QLS) e publikoi raportin “Siguria dhe Shëndeti në Punë – Një analizë e (jo)efikasitetit të Inspektoratit Qendror të Punës”, i cili nxjerr në pah shqetësime të vazhdueshme lidhur me sigurinë në vendin e punës në Kosovë. Pavarësisht rritjes së numrit të inspektorëve dhe shtimit të konsiderueshëm të aktiviteteve inspektuese, aksidentet në punë, përfshirë lëndimet e lehta, lëndimet e rënda dhe rastet fatale, mbeten në nivele shqetësuese. Raporti thekson se një pjesë e madhe e këtyre incidenteve ndodh në sektorin e ndërtimit, i cili vazhdon të paraqesë rrezikun më të lartë për punëtorët. Megjithatë, ai vëren një mospërputhje në prioritetet e inspektimit, pasi Inspektorati Qendror i Punës duket se fokusohet më shumë në sektorë me rrezik relativisht më të ulët, në vend që të adresojë në mënyrë adekuate sektorin e ndërtimit, ku nevoja për mbikëqyrje është më kritike.<sup>191</sup>

**170.** Në kontributin e saj për raportin aktual të vitit 2025, OJQ BIRN thekson prioritetizimin e të drejtave të punës përmes raportimit të vazhdueshëm investigativ mbi shkeljet në sektorë të ndryshëm. Përmes gazetarisë së bazuar në fakte dhe monitorimit institucional, ajo ka ndihmuar si në dokumentimin e situatës në terren, ashtu edhe në ofrimin e një platforme për punëtorët dhe sindikatat. Në vijim të raportimit të saj, OJQ BIRN ka zhvilluar fushata të synuara ndërjegjësimi, ka

188 HANDIKOS (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

189 GLPS (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

190 Telegrafi (2025), [Këtë vit 26 punëtorë kanë vdekur në vendin e punës](#).

191 GLPS (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

prodhuar mbi 35 raporte televizive dhe debate, si dhe ka ofruar trajnime për gazetarë, ndërkohë që ka mbledhur më shumë se 480 ankesa të qytetarëve për shkelje të të drejtave të punës përmes platformës së saj të raportimit. Këto ankesa kanë rezultuar në gjoba ndaj mbi 50 kompanive dhe në rishikimin e kontratave të punës që kanë prekur më shumë se 1,000 punëtorë. Disa hetime të thelluara kanë nxitur gjithashtu ndjekje institucionale, përfshirë veprime nga Prokuroria e Shtetit, duke e forcuar llogaridhënien dhe zbatimin e standardeve të punës në Kosovë.<sup>192</sup>

**171.** OJQ ATRC, në partneritet me Fondacionin Jahjaga dhe OJQ BIRN Kosova, e kanë zbatuar projektin “Të drejtat e punës për të gjithë” si një iniciativë e koordinuar për të forcuar llogaridhënien institucionale dhe përputhshmërinë me legjislacionin për të drejtat e punës në Kosovë. Projekti kombinon një sërë aktivitetesh për ta rritur raportimin e shkeljeve të të drejtave të punës dhe për ta përmirësuar përgjigjen institucionale ndaj abuzimeve në vendin e punës. Këto përfshijnë avokimin për politika publike, hulumtimin mbi punësimin informal dhe punëtorët e cenueshëm, inspektime të përbashkëta me institucionet mbikëqyrëse, gazetari investigative dhe fushata ndërgjegjësimi publik.<sup>193</sup>

## 172. Rekomandimet

- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve duhet ta rikonstitujë dhe ta operacionalizojë Këshillin Ekonomik dhe Social;
- Qeveria e Kosovës duhet t’i japë prioritet ndryshimit të Ligjit të Punës duke e rikthyer atë në agjendën legjislative për vitin 2026 dhe duke siguruar konsultime të gjera me palët e interesit për ta harmonizuar me standardet evropiane dhe nevojat e tregut të punës;
- Inspektorati i Punës duhet të kryejë inspektime të rregullta në sektorët me rrezik të lartë dhe të zbatojë standardet e detyrueshme të sigurisë përmes sanksioneve të menjëhershme për t’i parandaluar vdekjet në vendin e punës;
- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve duhet t’i forcojë mekanizmat kundër punës së padeklaruar duke i rritur inspektimet dhe duke i mbrojtur sinjalizuesit në raportimin e rasteve të punësimit informal.

## 6.2 E drejta për arsim

**173.** E drejta për arsim është e sanksionuar në nenin 26 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (UDHR), i cili garanton se secili ka të drejtë për arsim dhe kërkon që arsimi fillor të jetë falas. Neni 13 i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (PNDESK) ofron kornizën më gjithëpërfshirës të traktatit, duke e vendosur arsimin fillor të detyrueshëm dhe falas, si dhe duke kërkuar që arsimi i mesëm dhe i lartë të bëhen gradualisht të qashtëm dhe falas. Në nivel rajonal, neni 2 i Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) ndalon mohimin e së drejtës për arsim dhe kërkon respektimin e bindjeve fetare dhe filozofike të prindërve. Në çështjen Kjeldsen, Busk Madsen dhe Pedersen kundër Danimarkës (1976), Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) sqaroi se, ndonëse shtetet duhet të respektojnë bindjet e prindërve, arsimi duhet të mbetet objektiv, kritik dhe pluralist. Garanci plotësuere ofrohen nga

192 BIRN (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

193 ATRC (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

nenet 28 dhe 29 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës (KDF), të cilat e theksojnë arsimin fillor falas dhe edukimin që synon zhvillimin e plotë të personalitetit të fëmijës dhe respektin për të drejtat e njeriut; neni 10 i Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW), që garanton të drejta të barabarta për gratë në arsim; si dhe neni 5(d)(v) i Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor (CERD), që ndalon diskriminimin racor në qasjen në arsim.

**174.** Në kuadrin legjislativ të Kosovës, e drejta për arsim është e garantuar me Kushtetutë. Neni 47 i Kushtetutës siguron të drejtën për arsim themelor falas dhe qasje të barabartë në arsim për të gjithë individët, në përputhje me nevojat dhe aftësitë e tyre specifike. Neni 59, në kuadër të kapitullit për të Drejtat e Komuniteteve dhe Anëtarëve të Tyre, garanton më tej për komunitetet jo-shumicë të drejtën për të marrë arsim në gjuhën e tyre amtare aty ku kjo gjuhë është në përdorim zyrtar. Ky garantim rikonfirmohet dhe operacionalizohet në Ligjin Nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Kosovë, i cili e mbron përdorimin e gjuhëve të komuniteteve si gjuhë mësimore në arsimin fillor dhe të mesëm. Organizimi më i gjerë institucional i arsimit publik fillor dhe të mesëm rregullohet me Ligjin Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitatet e Republikës së Kosovës, ndërsa kuadri i arsimit të lartë rregullohet me Ligjin Nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë.

**175.** Zbatimi i Ligjit Nr. 08/L-153 për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme ka filluar me pilotimin e kurrikulave të reja për vitin akademik 2023/2024. Ky ligj rregullon standardet e ofrimit të arsimit cilësor dhe e bën arsimin parashkollor të detyrueshëm nga viti 2024. Sipas Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), ligji “vendos themelet për rritjen dhe zhvillimin e më të vegjëlve”. Megjithatë, deri më tani, UNICEF Kosova raporton se qasja në arsimin parashkollor në Kosovë mbetet dukshëm nën standardin evropian prej 96 për qind, si dhe më e ulët se mesatarja rajonale.

**176.** Sektori i arsimit u përball me kufizime të konsiderueshme buxhetore dhe presion financiar gjatë vitit 2025. Në Prishtinë, Drejtoria e Arsimit e përshkroi situatën financiare për komunat si një “bllokadë buxhetore” nga Ministria e Financave, duke e kufizuar qasjen në buxhetin e miratuar komunal për arsimin në vlerë prej 37 milionë euro.<sup>194</sup> Në reflektim të kësaj situatë, ekspertët e arsimit theksojnë se gjatë vitit 2025 nuk janë ndërmarrë reforma sistemore thelbësore në sektorin e arsimit, pavarësisht debatit të gjerë publik. Problemet e vazhdueshme e përfshijnë mungesën e llogaridhënies në rekrutimin e mësimeve, ngecjen e përpjekjeve për digjitalizim dhe zhvillimin e kufizuar të aftësive praktike tek nxënësit.<sup>195</sup>

**177.** Pavarësisht kufizimeve financiare me të cilat u përball sektori gjatë vitit 2025, në kryeqytetin e Prishtinës arsimi me orar të plotë u zgjerua nga pesë në shtatë shkolla, duke i përfshirë edhe pesë fshatra. Ky zgjerim e ka rritur mbulimin e nxënësve nga 3,100 në mbi 5,000 nxënës.<sup>196</sup> Në vitin pasues, pritet që ky numër të rritet ndjeshëm.

194 Telegrafi (2025), [Suksese të pjesshme dhe sfida të mëdha: bilanci i arsimit në Kosovë për vitin 2025](#).

195 ibid.

196 Telegrafi (2025), [Suksese të pjesshme dhe sfida të mëdha: bilanci i arsimit në Kosovë për vitin 2025](#).

**178.** Pavarësisht zgjerimit gradual të qasjes në arsimin me orar të plotë, arkitektura e përgjithshme e mundësive arsimore në vitin 2025 vazhdon të mbetet prapa sistemeve të krahasueshme në Evropë. Sipas UNICEF-it, një fëmijë i lindur sot në Kosovë pritet të arrijë vetëm 57 për qind të potencialit të tij të plotë të produktivitetit, kryesisht për shkak të mangësive në arsim dhe shëndetësi. Rezultatet në të nxënë mbeten të dobëta, me rezultatet e Kosovës në PISA që vazhdimisht janë nën mesataren e OECD-së, ndërsa vetëm 15 për qind e nxënësve e arrijnë nivelin bazë të aftësive në matematikë, çka tregon për mangësi të konsiderueshme në aftësitë themelore.<sup>197</sup>

**179.** Përveç dallimeve rajonale, ndarjet arsimore vazhdojnë të ekzistojnë edhe përgjatë vijave etnike në Kosovë, me pasojë afatgjata sociale dhe ekonomike, veçanërisht për fëmijët nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Ndërsa regjistrimi në arsimin fillor arrin në 96 për qind në Kosovë, vijueshmëria bie me moshën dhe është dukshëm më e ulët në këto komunitete etnike. Ndër fëmijët romë-K, ashkali-K dhe egjiptianë-K, vetëm 84 për qind janë të regjistruar në arsimin fillor, ndërsa regjistrimi në nivelin e mesëm bie në 31 për qind, krahasuar me 87 për qind në nivel të përgjithshëm në Kosovë.<sup>198</sup>

**180.** Qasja në arsim mbetet e kufizuar edhe për fëmijët me aftësi të kufizuara. Një opinion i publikuar në maj 2025, i organizuar në bashkëbisedim me shefen e UNICEF-it dhe Ambasadorin e Finlandës, theksoi se 8 për qind e fëmijëve në Kosovë të moshës 2–17 vjeç përjetojnë vështirësi funksionale, të cilat përkeqësohen nga sistemi arsimor, i cili vazhdon të mos ketë mekanizma adekuat të arsimit gjithëpërfshirës. Këto mangësi variojnë nga infrastruktura e përshtatur deri te shërbimet e specializuara dhe mbështetja individuale në mësim, duke e kufizuar pjesëmarrjen e barabartë në arsim.<sup>199</sup>

**181.** Një raport i Deutsche Welle ka nxjerrë në pah problemin sistemik me të cilin fëmijët me dëmtime në dëgjim në Kosovë vazhdojnë të përballen gjatë qasjes në arsimin gjithëpërfshirës në vitin 2025. Raporti e dokumenton mungesën e gjuhës së shenjave si gjuhë mësimore në shkollat publike, duke evidentuar dy çështje kryesore: mbështetjen e kufizuar institucionale dhe vazhdimin e stigmatizimit social rreth shurdhësisë. Së pari, pavarësisht rreth 5,000 personave të shurdhër dhe 4,500 personave me dëmtime në dëgjim në Kosovë, gjuha e shenjave mbetet jashtë kurrikulës formale. Deri më tani, vetëm 16 përkthyes të certifikuar të gjuhës së shenjave janë të punësuar në institucionet publike, prej të cilëve vetëm tre veprojnë në sistemin arsimor. Në nivel institucional, pavarësisht përkushtimit të Kosovës për arsim gjithëpërfshirës dhe zhvillimit të materialeve përkatëse mësimore nga Shoqata Kosovare e të Shurdhërve (ShKSh), si dhe Fjalorit të Gjuhës së Shenjave (2012), vendi ende nuk ka një plan gjithëpërfshirës për integrimin e gjuhës së shenjave në arsimin e rregullt. Së dyti, stigma sociale rreth gjuhës së shenjave mbetet e pranishme. Mundësitë arsimore për fëmijët pengohen veçanërisht nga rezistenca e prindërve, e lidhur me keqkuptimin se përdorimi i gjuhës së shenjave mund ta pengojë zhvillimin e të folurit. Megjithatë, Shoqata Kosovare e të Shurdhërve thekson se mungesa e mësimin të gjuhës së shenjave mund të kontribuojë në performancë të dobët akademike dhe në vështirësi të integritit social.<sup>200</sup>

197 UNICEF (2025), [Arsimi në Kosovë: drejt përfshirjes, barazisë dhe gatishmërisë digjitale.](#)

198 UNICEF (2025), [Arsimi në Kosovë: drejt përfshirjes, barazisë dhe gatishmërisë digjitale.](#)

199 UNICEF (2025), [Arsimi në Kosovë: drejt përfshirjes, barazisë dhe gatishmërisë digjitale.](#)

200 DW (2025), [Kosovë: fëmijët me dëmtime në dëgjim përballen me vështirësi në shkollë.](#)

**182.** Pavarësisht shtrirjes së lartë të internetit, Kosova u rendit e dyta nga fundi ndër 35 sisteme arsimore pjesëmarrëse në Studimin Ndërkombëtar për Shkrim-leximin Kompjuterik dhe Informativ (ICILS). Performanca mesatare e Kosovës bie në kontrast të theksuar me mesataren prej 520 pikësh të vendeve me performancën më të lartë, duke reflektuar mangësi serioze në kompetencat digjitale. Ndarja digjitale prek në mënyrë disproporcionale nxënësit nga familjet me të ardhura më të ulëta, duke e kufizuar qasjen e tyre në aftësi që janë gjithnjë e më të domosdoshme për pjesëmarrje në tregun e punës.<sup>201</sup> Në këtë drejtim, OJQ Qendra Kosovare për Arsim (KEC) gjithashtu ka vërejtur pabarazi në qasjen kuptimplotë digjitale për komunitetet e cënueshme në zonat rurale dhe në familjet me disavantazhe socio-ekonomike.<sup>202</sup>

**183.** Një studim monitorues i OJQ BIRN në vitin 2025 ka treguar se shkollat përballen me zbatim joefektiv të ndalimit të gjatë për përdorimin e telefonave të mençur. Ky ndalim shpesh nuk respektohet, ndërsa drejtorët komunalë i pranojnë kufizimet e shkollave për ta zbatuar atë, ndërsa Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) mban qëndrimin se zbatimi i tij u takon komunave dhe inspektorateve shkollore. Në vitin 2025, debati është zhvendosur gjithashtu nga ndalimi drejt reformës rregullatore. Ekspertë të arsimit, përfshirë përfaqësues të OJQ ETEA dhe Universitetit të Prishtinës, kanë bërë thirrje për zëvendësimin e ndalimit të përgjithshëm me politika të strukturuar për përdorim të përgjegjshëm të mediave dhe teknologjisë digjitale. Ata argumentojnë se përdorimi i gjerë i telefonave të mençur nga nxënësit, mesatarisht tre orë në ditë, nuk shoqërohet me diskutime të mjaftueshme mbi temat mediatike në shkolla, pasi vetëm 30 për qind e mësimit angazhohen në shkrim-lexim digjital.<sup>203</sup>

**184.** Si problemet strukturore, ashtu edhe ato përmbajtësore me tekstet shkollore vazhduan të jenë të pranishme gjatë vitit 2025 dhe janë raportuar nga disa autoritete komunale. Në këtë drejtim, në Prizren u evidentuan mangësi të theksuara në shpërndarjen dhe cilësinë e teksteve shkollore në shkollat që funksionojnë në tre gjuhë mësimi (shqip, turqisht dhe boshnjakisht). Gabimet përmbajtësore në tekstet shkollore dhe mospërputhja e tyre me metodologjitë bashkëkohore pedagogjike e pasqyrojnë mungesën e veprimit adekuat qeveritar për rishikimin e tyre, pavarësisht fillimit të projektit për rishikimin e teksteve shkollore në vitin 2023.<sup>204</sup>

**185.** Zbatimi i Politikës për Mbrojtjen e Fëmijës në institucionet parauniversitare mbështetet nga Save the Children Kosova përmes partnerit të saj, OJQ Syri i Vizionit. OJQ Syri i Vizionit e ka mbështetur zbatimin e kësaj politike duke i forcuar kapacitetet e 35 pikave fokale për mbrojtjen e fëmijës në shkolla përmes një trajnimi të akredituar 36-orësh të miratuar nga MASHTI. Trajnimi i ka rritur aftësitë e pjesëmarrësve për identifikimin, parandalimin dhe reagimin ndaj shkeljeve të të drejtave të fëmijës, ndërsa secili pjesëmarrës e ka hartuar një plan veprimi në nivel shkolle për operacionalizimin e politikës. Përveç kësaj, janë mbajtur takime koordinuese ndërmjet drejtorëve të shkollave, Qendrave për Punë Sociale (QPS) dhe policisë në tetë komuna, duke i përfshirë mbi 200 pjesëmarrës dhe duke e nxitur dialogun ndër-institucional dhe llogaridhënien për mbrojtjen e fëmijëve.<sup>205</sup>

201 UNICEF (2025), [Arsimi në Kosovë: drejt përfshirjes, barazisë dhe gatishmërisë digjitale](#).

202 KEC (2025), [Përmbledhje politike: përfshirja digjitale në Kosovë](#).

203 BIRN (2025), [Ndalimi i telefonave në shkollat e Kosovës shkelet, kërkohen reforma](#).

204 Telegrafi (2025), [Suksese të pjesshme dhe sfida të mëdha: bilanci i arsimit në Kosovë për vitin 2025](#).

205 BIRN (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

**186.** Pavarësisht përpjekjeve të shoqërisë civile, siç është theksuar më lart, efektiviteti i mekanizmave për mbrojtjen e fëmijëve dhe strukturave mbikëqyrëse në mjediset arsimore mbetet shqetësues. Më konkretisht, në vitin 2025 u raportuan akuza shtesë ndaj logopedit Iljasa Fazliu, pas raportimit investigativ të “Betimi për Drejtësi”. Janë regjistruar disa ankesa me shkrim nga praktikantë dhe prindër lidhur me sjelljen e tij në Shërbimin e Logopedisë në kuadër të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (SHSKUK). Ankesat e datuara gjatë muajve shkurt, mars, qershor dhe shtator 2025 përshkruajnë mungesa të përsëritura nga seancat e planifikuara të terapisë, delegimin e përgjegjësive terapeutike të praktikantë të pambikëqyrur, si dhe sjellje të papërshtatshme ndaj fëmijëve pacientë. Këto zhvillime kanë ndodhur pavarësisht rastit të mëparshëm në vitin 2024, i cili ishte i lidhur me procedura penale për keqtrajtimin e një fëmije trevjeçar me autizëm.<sup>206</sup>

**187.** Pas një hulumtimi të KALLXO.com mbi dhunën fizike dhe keqtrajtimin e të paktën dy fëmijëve nga një edukatore në një çerdhe private në Ferizaj, Inspektorati i Përgjithshëm i Arsimit zhvilloi një hetim dhe nxori një vendim për mbylljen e institucionit, pasi çerdhja po funksiononte edhe pa licencë.<sup>207</sup> Rasti i dyshuar i keqtrajtimit ishte raportuar në Policinë e Kosovës nga prindërit, duke rezultuar në ndalimin e të dyshuarës për 48 orë. Më pas, Prokuroria Themelore në Ferizaj ka iniciuar hetime mbi dyshimet për veprat penale “Keqtrajtimi ose braktisja e fëmijës” dhe “Lëndimi i lehtë trupor”, si dhe ka kërkuar paraburgim; megjithatë, Gjykata Themelore e ka vendosur masën e arrestit shtëpiak prej një muaji.<sup>208</sup>

**188.** Shqetësimet lidhur me të drejtën për arsim kanë të bëjnë gjithashtu me qasjen e barabartë dhe jodiskriminuese në bursat publike meritore në nivel universitar në Kosovë. Më 3 shkurt 2025, dy studentë të Fakultetit të Mjekësisë në Universitetin e Prishtinës, të cilët fillimisht ishin përjashtuar nga “bursa elitare” e Ministrisë së Arsimit, pavarësisht se i plotësonin të gjitha kriteret e përshtatshmërisë, u përfshinë dhe u shpërblyen me bursë pas ankesave formale dhe raportimit publik nga KALLXO.com.<sup>209</sup> Studentët ishin lënë jashtë listës së dhjetorit 2024; megjithatë, verifikimi i mëvonshëm i të dhënave të tyre akademike konfirmoi përshtatshmërinë e tyre, duke rezultuar në përfshirjen e tyre në listën përfundimtare të miratuar në fund të janarit 2025. Për më tepër, më 22 dhjetor 2025, edhe 18 studentë të tjerë të mjekësisë në Universitetin e Prishtinës u pajisën me të njëjtën bursë pas shqyrtimit publik dhe verifikimit të rasteve, i cili dëshmoi se edhe ata i kishin plotësuar kriteret e përcaktuara, por fillimisht ishin përjashtuar.<sup>210</sup>

### 189. Rekomandimet

- Qeveria e Kosovës dhe MASHTI duhet ta sigurojnë zbatimin e plotë të politikave të arsimit gjithëpërfshirës duke alokuar fonde të mjaftueshme për shërbime mbështetëse, mësimdhënës të specializuar dhe teknologji ndihmëse, me qëllim rritjen e qasjes për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe ata nga komunitetet e margjinalizuara;
- MASHTI duhet të zgjerojë qasjen në arsimin në fëmijërinë e hershme duke e siguruar zbatimin e plotë të arsimit parashkollor të detyrueshëm, duke i përfshirë edhe fëmijët nga komunitetet e margjinalizuara;
- MASHTI duhet ta sigurojë mbrojtjen efektive të fëmijëve brenda institucioneve arsimore

206 Koha (2025), Betimi për Drejtësi. [Iljasa Fazliu – logopedja e paprekshme.](#)

207 BIRN (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

208 KALLXO (2025), [Pas raportimit të KALLXO.com, Inspektorati e mbyll kopshtin privat të fëmijëve në Ferizaj.](#)

209 KALLXO (2025), [Pas raportimit të KALLXO.com, MASHTI ua ndan 18 studentëve të Mjekësisë bursën elitare.](#)

210

duke i forcuar mekanizmat e inspektimit dhe mbikëqyrjes, duke i zbatuar kërkesat për licencim dhe duke ndërmarrë veprime të menjëhershme në rastet e dhunës, abuzimit ose neglizhencës nga stafi arsimor.

### 6.3 E drejta për kujdes shëndetësor

**190.** Korniza ndërkombëtare e së drejtës për shëndet është e bazuar në nenin 25 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (DUDNJ), e cila e garanton të drejtën për një standard të përshatshëm jetese të domosdoshëm për shëndetin dhe mirëqenien, përfshirë qasjen në ushqim, veshmbathje, strehim dhe kujdes mjekësor. Ky themel normativ shtjellohet më tej në nenin 12 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (PNDESK), i cili e njeh të drejtën e secilit për standardin më të lartë të arritshëm të shëndetit fizik dhe mendor dhe obligon shtetet të ndërmarrin masa për parandalimin, trajtimin dhe kontrollin e sëmundjeve, si dhe krijimin e kushteve që sigurojnë qasje në shërbime mjekësore për të gjithë. Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) e ka zgjeruar më tej kuptimin konceptual të kësaj të drejte duke e përkufizuar shëndetin si “gjendje e mirëqenies së plotë fizike, mendore dhe sociale dhe jo vetëm mungesë e sëmundjes apo paaftësisë”, një përkufizim që ka ndikuar ndjeshëm në diskursin ndërkombëtar të të drejtave të njeriut. Edhe pse Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) nuk e parashikon në mënyrë eksplicite një të drejtë të veçantë për shëndetin, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) e ka interpretuar mbrojtjen e shëndetit përmes jurisprudencës së saj në kuadër të nenit 2 (e drejta për jetën), nenit 3 (ndalimi i torturës dhe trajtimit çnjerëzor ose degradues) dhe nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare), duke vendosur kështu detyrime pozitive për shtetet për ta mbrojtur integritetin fizik dhe mendor të individëve.

**191.** Kuadri legjislativ që e rregullon të drejtën për shëndet në Kosovë është i bazuar në nenin 51 të Kushtetutës së Kosovës, i cili e garanton shëndetin dhe mbrojtjen sociale. Ky kuadër është avancuar ndjeshëm me miratimin në maj 2022 të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-249 për Sigurimin Shëndetësor, i cili e rregullon më tej themelimin dhe funksionimin e sigurimeve shëndetësore publike nën Qeverinë e Kosovës. Arkitektura më e gjerë ligjore plotësohet nga Ligji Nr. 04/L-125 për Shëndetësinë, Ligji Nr. 02/L-78 për Shëndetin Publik, Ligji Nr. 02/L-76 për Shëndetin Riprodhues, Ligji Nr. 06/L-042 për Gjakun dhe Komponentët e Gjakut, si dhe Ligji Nr. 02/L-200 për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve Ngjitëse, të cilët së bashku i strukturojnë dimensionet institucionale dhe materiale të qeverisjes së shëndetit në Kosovë. Gjatë periudhës raportuese të vitit 2025, Projektligji për Parandalimin e Vetëvrasjes dhe Projektligji për Shëndetin Mendor nuk janë miratuar ende.

**192.** Themelet e forta legjislative të Kosovës ende nuk janë përkthyer plotësisht në një realitet që e garanton funksionimin e plotë të të gjitha segmenteve të sektorit të shëndetit publik. Në këtë drejtim, megjithatë, është me rëndësi të theksohet se të dhënat e publikuara në vitin 2025 nga organizata amerikane e analizave Gallup tregojnë një rritje të konsiderueshme të vlerësimit subjektiv të jetës gjatë dekadës së fundit në Kosovë. Numri i të anketuarve që deklarojnë se “po jetojnë mirë” ose “po përparojnë” është rritur nga 11 për qind në vitin 2014 në 51 për qind në vitin

2024. Megjithatë, duhet theksuar se ky indeks bazohet në vetëvlerësim subjektiv dhe jo në tregues objektivë makroekonomikë si rritja e GDP-së, normat e punësimit apo performanca institucionale.

**193.** Sa i përket performancës institucionale të përmendur më lart, OJQ Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) publikoi në vitin 2025 një raport mbi transparencën e buxhetit shëndetësor për t'i analizuar ndarjet buxhetore të Kosovës për shëndetësi për vitin 2025. Krahasuar me alokimin prej 345 milionë euro për sektorin e shëndetësisë në vitin 2024, buxheti qendror për shëndetësi në vitin 2025 u rrit vetëm në mënyrë modeste, duke arritur në rreth 352 milionë euro. Edhe pse kjo reflekton një rritje nominale të vazhdueshme gjatë viteve të fundit, ajo nuk tregon një ndryshim të rëndësishëm strukturor në prioritetet e shpenzimeve apo në mekanizmat e llogaridhënies.<sup>211</sup> Në këtë drejtim, raporti i OJQ GLPS gjithashtu nxjerr në pah mangësi të vazhdueshme në transparencën buxhetore, me proceset që mbeten kryesisht të brendshme dhe jo objekt i konsultimeve publike. Si pasojë, matja e performancës e bazuar në rezultate mbetet e vështirë dhe, në mënyrë të kundërt, llogaridhënia institucionale mbetet në thelb e paadresuar.<sup>212</sup>

**194.** Përpjekjet kanë vazhduar gjatë vitit 2025 për zhvillimin e një Sistemi të Integruar Kombëtar të Informacionit Shëndetësor, siç parashihet në Strategjinë e Sektorit të Shëndetësisë 2025–2030. Megjithatë, sistemi mbetet vetëm pjesërisht funksional, pasi ende nuk ka arritur ndërveprueshmëri të plotë ndërmjet niveleve të ndryshme të kujdesit shëndetësor. Si rezultat, ofruesit e shërbimeve shëndetësore vazhdojnë të mbështeten ndjeshëm në regjistrime në letër dhe mekanizma të fragmentuar të raportimit, të cilat e pengojnë mbledhjen e të dhënave në kohë reale dhe ofrimin e shërbimeve të koordinuara në funksion të nevojave të shëndetit publik.<sup>213</sup>

**195.** Në lidhje me paragrafin e mëparshëm, në shkurt 2025, Ministria e Shëndetësisë (MSH) miratoi një Plan Veprimi për Sigurinë Shëndetësore, i cili u integrua në Strategjinë e Sektorit të Shëndetësisë 2025–2030 pas një Vlerësimi të Përbashkët të Jashtëm të realizuar nën ombrellën e OBSH-së.<sup>214</sup> Plani miraton një qasje ndërsektoriale të koordinimit ndërmjet autoriteteve të shëndetësisë, bujqësisë, mjedisit dhe menaxhimit të emergjencave. Fokusi i tij është në mbikëqyrjen e sëmundjeve ngjithëse, rezistencën antimikrobike, zbulimin e kërcënimeve ndërkufitare dhe gatishmërinë për emergjenca.

**196.** Ligji për Sigurimin e Detyrueshëm Shëndetësor, i miratuar nga Kuvendi i Kosovës në vitin 2024, është bllokuar gjatë vitit 2025 për shkak të një referimi nga partia politike PDK në Gjykatën Kushtetuese, lidhur me pretendimet për shkelje procedurale në mesin e dhjetorit 2024, duke e pezulluar zbatimin efektiv të tij deri në nxjerrjen e një vendimi. Si pasojë, gjatë gjithë vitit 2025, Kosova ka vazhduar të funksionojë pa një skemë funksionale të sigurimeve shëndetësore publike, duke e lënë pjesën dërrmuese të qytetarëve të përballen vetë me kostot e kujdesit shëndetësor.<sup>215</sup>

**197.** Largimi i vazhdueshëm i profesionistëve shëndetësorë ndikon në të drejtën për shëndet brenda kufijve të Kosovës. Në vitin 2025, 90 mjekë kanë kërkuar certifikata të gjendjes së mirë nga Oda e Mjekëve të Kosovës, një dokument i nevojshëm për punësim jashtë vendit, ndërsa 192 infermierë kanë aplikuar për dokumentacion profesional pranë Odës së Infermierëve të Kosovës.

211 GLPS (2025), [Fonde publike, shëndet publik: rishikimi i transparencës së buxhetit shëndetësor në Kosovë](#).

212 GLPS (2025), [Fonde publike, shëndet publik: rishikimi i transparencës së buxhetit shëndetësor në Kosovë](#).

213 Prishtina Insight (2025), [Nga letra në algoritme: a mund ta shërojë inteligjenca artificiale sistemin shëndetësor të Kosovës?](#)

214 WHO (2025), [Kosova forcon sigurinë shëndetësore përmes bashkëpunimit ndërsektorial](#).

215 Reporterit (2025), [Historia e gjatë dhe e ndërlikuar e sigurimeve shëndetësore në Kosovë: ligji i bllokuar në Gjykatën Kushtetuese](#).

Edhe pse këto shifra paraqesin një rënie të lehtë krahasuar me vitet e mëparshme,<sup>216</sup> largimi i vazhdueshëm i personelit mjekësor, edhe pse në vetvete pasqyron pakënaqësi strukturore me kushtet e punës dhe pagat, ndikon drejtpërdrejt në shërbimet shëndetësore dhe e përkeqëson cilësinë e kujdesit në Kosovë.<sup>217</sup>

**198.** Sipas të dhënave të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike (IKShPK), sëmundjet kardiovaskulare mbetën shkaku kryesor i vdekjeve në Kosovë në vitin 2025, të ndjekura nga kanceri. Sëmundjet respiratore u renditën si shkaku i tretë dhe i katërt kryesor i vdekshmërisë.<sup>218</sup> Shërbimet e kardiologjisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës raportohet se vazhdojnë të funksionojnë me kapacitet të plotë, duke reflektuar presion të vazhdueshëm mbi kujdesin terciar. Specialistët e onkologjisë theksojnë se, megjithëse incidenca e kancerit është rritur gjatë dekadës së fundit, vitet e fundit tregojnë shenja stabilizimi, me kancerin e gjirit që mbetet forma më e përhapur. Si sëmundjet kardiovaskulare ashtu edhe kanceri po prekin gjithnjë e më shumë grupmosha më të reja, duke treguar ndryshime në modelet epidemiologjike dhe rreziqe të shtuara për shëndetin publik. Implikimet nga perspektiva e së drejtës për shëndet janë të qarta: infrastruktura e përshtatshme shëndetësore dhe kapacitetet e fuqisë punëtore duhet t'i përgjigjen në mënyrë efektive barrës në rritje të sëmundjeve kronike.

**199.** Në vitin 2025, Kosova regjistroi 31 raste të reja me HIV/AIDS dhe gjashtë vdekje të lidhura me AIDS. Kjo paraqet një rritje të rasteve në Kosovë, pavarësisht se vendi mbetet i klasifikuar zyrtarisht si me prevalencë të ulët, me nivele të përgjithshme infeksioni nën 1 për qind në popullatën e përgjithshme. Të dhënat epidemiologjike të paraqitura nga Ministria e Shëndetësisë (MSH) dhe Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike (IKShPK) tregojnë se grupi më i prekur mbeten burrat (82 për qind), veçanërisht ata të moshës 25–34 vjeç, me transmetim që ndodh kryesisht përmes kontaktit heteroseksual dhe homoseksual. Ndërsa autoritetet kanë njoftuar vazhdimin e zbatimit të sistemit digjital të mbikëqyrjes së sëmundjeve ngjitëse (SMSN) dhe pilotimin e planifikuar të shpërndarjes së profilaksisë para ekspozimit (PrEP) në institucionet e kujdesit parësor shëndetësor në vitin 2026, zyrtarët njëkohësisht kanë pranuar kufizime buxhetore që ndikojnë në programet për HIV.<sup>219</sup>

**200.** Sistemi publik i shëndetit mendor mbeti i nënfinancuar gjatë vitit 2025. Të dhënat zyrtare të Ministrisë së Shëndetësisë tregojnë se burimet njerëzore në shërbimet e shëndetit mendor janë dukshëm nën mesataren evropiane, duke përfshirë vetëm 49 psikiatër, 9 psikologë, 1 punonjës social, 281 infermierë dhe shtatë këshilltarë psikosocialë. Si pasojë, shumë individë që kërkojnë ndihmë për shëndetin mendor detyrohen t'i drejtohen sektorit privat të kujdesit shëndetësor, i cili është më i kushtueshëm, duke e bërë qasjen në shërbime të shëndetit mendor një privilegj të kufizuar për qytetarët me mundësi financiare.<sup>220</sup>

**201.** Qasshmëria fizike dhe infrastruktura e përshtatshme përbëjnë një detyrim kyç për garantimin e së drejtës për shëndet. Në këtë drejtim, pas raportimit të KALLXO.com për një rrugë të papërfun-

216 HRN (2025), [Raporti i Shoqërisë Civile për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2024](#).

217 Gazeta Express (2025), [Mbi 90 mjekë dhe 192 infermierë u larguan nga Kosova në vitin 2025](#).

218 Indeks online (2025), [Sëmundjet e zemrës dhe kanceri kryesojnë listën e vdekjeve në Kosovë](#).

219 Kosova Press (2025), [Gjashtë vdekje këtë vit nga HIV dhe 31 raste të reja](#).

220 Kosovo 2.0 (2025), [Premtimet e partive politike për shëndetin mendor](#).

duar që çonte drejt Qendrës së Kujdesit Parësor Shëndetësor “Nexhat Çuni” (QKMF) në Mitrovicën e Jugut, punimet për riparim filluan më 23 janar 2025. Qendra, e cila ka kushtuar rreth 6,016,953 euro, ishte inauguruar më 6 janar 2025, por rruga e saj e qasjes nuk ishte ende e përfunduar. Drejtori komunal i shëndetësisë, Fahri Shabani, sqaroi se projekti i rrugës, parkingut dhe infrastrukturës përreth kishte filluar edhe para inaugurimit, por ishte ndërprerë për shkak të kushteve të këqija atmosferike.<sup>221</sup>

**202.** Qasshmëria fizike e infrastrukturës shëndetësore mbetet një pengesë e rëndësishme për personat me aftësi të kufizuara. Në vitin 2018, u ngrit një padi për diskriminim kundër Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (SHSKUK) mbi bazën e paarritshmërisë arkitektonike; deri në vitin 2025, ky rast mbetet i pazgjidhur, duke reflektuar vonesa të zgjata gjyqësore në adresimin e barrierave strukturore. Përtej qasjes fizike, personat me aftësi të kufizuara vazhdojnë të përballen me pengesa sistematike në sigurimin e barnave të nevojshme dhe shërbimeve të specializuara, kryesisht për shkak të mungesës së një skeme funksionale të sigurimeve shëndetësore dhe boshllëqeve në ofrimin e shërbimeve. Sipas OJQ HANDIKOS dhe avokatëve të tjerë të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, këto mangësi kanë detyruar disa familje të kërkojnë trajtim shëndetësor jashtë vendit, duke e zhvendosur në praktikë detyrimin e shtetit për të garantuar kujdes shëndetësor të qasshëm dhe adekuat brenda sistemit të vet.<sup>222</sup>

**203.** Në vitin 2025, vazhdojnë shqetësimet lidhur me qëndrueshmërinë dhe zbatimin efektiv të programit të financuar nga qeveria për pajisjet ndihmëse për personat me aftësi të kufizuara, i cili fillimisht u alokua në vitin 2023 nën përgjegjësinë e Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (SHSKUK). Megjithatë në vitin 2025 u krijua një linjë e dedikuar buxhetore, sfidat e raportuara në procedurat e prokurimit dhe shpërndarjes e kanë kufizuar dorëzimin në kohë të teknologjive ndihmëse për përfituesit. Për më tepër, ky alokim është projektuar si një masë e përkohshme dyvjeçare, duke krijuar pasiguri për financimin e vazhdueshëm përtej afatit fillestar.<sup>223</sup>

**204.** Përveç infrastrukturës, qasja në ujë të sigurt dhe kanalizim adekuat përbën një komponent thelbësor të detyrimeve që burojnë nga e drejta për shëndet. Në vitin 2025, një raport i Prishtina Insight dokumentoi ndotjen e vazhdueshme të lumit Drini i Bardhë. Ndotja e lumit përkeqësohet nga ujërat e zeza komunale të patrajtuara nga disa komuna, shkarkimet industriale, rrjedhjet bujqësore dhe nxjerrja ilegale e zhavorrit. Për më tepër, rreth 125,000 ekonomi familjare dhe biznese në pellgun e lumit i shkarkojnë ujërat e zeza në përrrenj që derdhen në lumë, duke ndikuar në cilësinë e ujit për rreth 400,000 banorë. Pavarësisht investimeve të pjesshme komunale në impiante për trajtimin e ujërave të zeza, mbulimi mbetet i kufizuar, ndërsa kapacitetet e zbatimit janë të pamjaftueshme dhe shumica e rasteve të shkeljeve rezultojnë me gjopa ose dënime me kusht.<sup>224</sup> Përveç ndotjes së lumit, një krizë e përsëritur e ujit të pijshëm e ka prekur kryeqytetin e Prishtinës dhe komunat përreth gjatë vitit 2025. Për të tretin vit radhazi, burimi kryesor i ujit për mbi 100,000 banorë, Liqeni i Badocit, është ndotur me përqendrime të larta të manganit. Krahas kufirit të lejuar prej 0.05 mg/L, nivelet e matura kanë arritur nga 0.117 mg/L deri në 0.250 mg/L, duke i detyruar banorët të mbështeten në burime alternative të ujit të pijshëm.<sup>225</sup>

221 BIRN (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

222 HANDIKOS (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

223 HANDIKOS (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

224 Prishtina Insight (2025), [Një deponi në rrjedhë: lumi dikur i pastër në Kosovë shndërrohet në eksportues të ndotjes](#).

225 Prishtina Insight (2025), [Mos e pini!: Prishtina kërkon zgjidhje afatgjata për furnizimin me ujë pas niveleve të larta të manganit](#).

## 205. Rekomandimet

- Kuvendi i Kosovës duhet të mundësojë përfundimin e shqyrtimit kushtetues dhe pasimin e Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm Shëndetësor, drejt krijimit të një sistemi funksional të sigurimeve shëndetësore publike dhe lehtësimit të barrës financiare të vetë qytetarëve për shërbimet mjekësore;
- Ministria e Shëndetësisë (MSH) duhet ta operacionalizojë një Sistem plotësisht të Integruar të Informacionit Shëndetësor dhe ta forcojë fuqinë punëtore në sektorin shëndetësor përmes masave të synuara për mbajtjen e stafit;
- Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Ministria e Shëndetësisë duhet të sigurojnë qasje në ujë të sigurt duke i zbatuar obligimet për trajtimin e ujërave të zeza, duke e adresuar ndotjen e burimeve të ujit të pijshëm dhe duke vendosur sanksione për shkeljet mjedisore që ndikojnë në shëndetin publik.

## 6.4 Të drejtat pronësore

**206.** Standardet ndërkombëtare për të drejtat e banimit dhe pronësisë bazohen në nenet 17 dhe 25 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (DUDNJ) dhe nenin 11 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (PNDESK), të cilat e njohin të drejtën e pronës dhe të drejtën për banim adekuat si pjesë të së drejtës për një standard të përshtatshëm jetese. Në Komentin e Përgjithshëm nr. 4 (1991), Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore sqaroi se banimi adekuat shkon përtej strehimit dhe përfshin sigurinë e pronësisë, banueshmërinë, përbalueshmërinë, qasshmërinë, lokacionin e përshtatshëm dhe përshtatshmërinë kulturore. Në Komentin e Përgjithshëm nr. 7 (1997), ai më tej afirmoi se dëbimet e detyruara janë prima facie të papajtueshme me PNDESK, përveç në rrethana të jashtëzakonshme dhe vetëm nëse shoqërohen me garanci të rrepta procedurale. Në nivel rajonal, neni 1 i Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) mbron gëzimin paqësor të pasurisë, të cilin Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) e ka interpretuar gjerësisht për t'i përfshirë asetet, të drejtat dhe pritshmëritë legjitime të pronësisë, duke kërkuar që çdo ndërhyrje ta ndjekë një qëllim legjitim dhe ta ruajë një balancë të drejtë ndërmjet interesit publik dhe atij individual, siç është përcaktuar në çështjet Sporrong dhe Lönnroth kundër Suedisë (1982) dhe James dhe Të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar (1986). Megjithatë GJEDNJ nuk garanton shprehimisht të drejtën për banim, Gjykata e ka zgjeruar mbrojtjen përmes neneve 3 dhe 8, duke vendosur në çështjet Yordanova kundër Bullgarisë (2012) dhe Winterstein kundër Francës (2013) se dëbimet e komuniteteve romë dhe atyre udhëtuese me vendbanim të gjatë, pa justifikim të mjaftueshëm apo garanci procedurale, përbëjnë shkelje të së drejtës për respektimin e jetës private dhe familjare.

**207.** Të drejtat pronësore në Kosovë janë të mbrojtura në mënyrë kushtetuese në nenet 46 dhe 156 të Kushtetutës, të cilat e garantojnë të drejtën për pronë dhe e ndalojnë privimin arbitrar të të drejtave pronësore. Kushtetuta gjithashtu e obligon Qeverinë e Kosovës që ta lehtësojë rikthimin e ligjshëm të pronës, veçanërisht në raport me personat e zhvendosur brenda vendit (PZHBV) dhe të kthyerit. Korniza më e gjerë ligjore përcaktohet nga Ligji Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe

të Drejtat e Tjera Sendore; Ligji Nr. 08/L-052 që ndryshon dhe plotëson Ligjin Nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës (AKKVP); Ligji Nr. 05/L-010 për AKKVP; Ligji Nr. 2002/5 për Themelimin e Regjistrimit të Drejtave të Pronës së Paluajtshme; Ligji Nr. 03/L-007 për Procedurën Jokontestimore; Ligji Nr. 2004/26 për Trashëgiminë; Ligji Nr. 05/L-020 për Barazinë Gjinore; Ligji Nr. 2004/32 për Familjen; Ligji Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme; si dhe Rregullorja Nr. 01/2018 për Kthimin e Personave të Zhvendosur dhe Zgjidhjet e Qëndrueshme. Së bashku, këto instrumente e përbëjnë arkitekturën formale ligjore që e rregullon pronësinë, regjistrimin, kthimin e pronës, trashëgiminë, barazinë gjinore në marrëdhëniet pronësore dhe shpronësimin në Kosovë.

**208.** Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës (AKKVP) shërben si organi qendror mbikëqyrës përgjegjës për zbatimin dhe ekzekutimin e legjislacionit për të drejtat pronësore. Ajo i trajton kërkesat pronësore dhe i verifikon të drejtat e shfrytëzimit mbi pronën e paluajtshme, përfshirë asetet rezidenciale dhe komerciale. Mandati i saj shtrihet edhe në zgjidhjen e kontesteve pronësore që burojnë nga konflikti i viteve 1998–1999, veçanërisht kërkesat që lidhen me personat e zhvendosur brenda vendit (PZHBV) dhe të kthyerit.

**209.** Gjykata Kushtetuese e Kosovës e ka anuluar, për herë të dytë, Ligjin për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificuar, duke e shfuqizuar vendimin e Kuvendit të datës 5 dhjetor 2024 me të cilin ishte miratuar versioni i rishikuar i ligjit. Gjykata, me shumicë votash, konstatoi se ligji ishte miratuar përmes procedurave të përshpejtuara legjislative që e kanë anashkaluar shqyrtimin e zakonshëm parlamentar, përfshirë shqyrtimin në komisione dhe garancitë procedurale, duke i shkelur standardet kushtetuese. Ndërsa vendimi i mëparshëm i vitit 2024 ishte përqendruar në shqetësime substanciale, veçanërisht në aplikimin retroaktiv dhe mungesën e garancive të mjaftueshme lidhur me barrën e provës në çështjet që i prekin të drejtat pronësore sipas nenit 46 të Kushtetutës dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të GJEDNJ, vendimi i vitit 2026 u fokusua në antikushtetutshmërinë procedurale, duke theksuar se legjislacioni që e zgjeron autoritetin shtetëror mbi pronën private duhet t'i respektojë në mënyrë strikte kërkesat kushtetuese të procesit legjislativ. Vendimi nuk i përjashton mekanizmat e ardhshëm për verifikimin e pasurisë, por thekson se masat kundër korrupsionit duhet të jenë në përputhje me procesin e rregullt ligjor dhe me garancitë kushtetuese për mbrojtjen e gëzimit paqësor të pronës.<sup>226</sup>

**210.** Në dhjetor 2025, Kuvendi Komunal i Prishtinës e miratoi një vendim për aprovimin e një liste të veçantë të pronave të paluajtshme komunale të dedikuara për alokim në vitin pasues. Më 31 dhjetor 2025, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal inicioi një rishikim të detyrueshëm të ligjshmërisë së aktit, duke ngritur shqetësime lidhur me përputhshmërinë me legjislacionin në fuqi. Ky rishikim u fokusua në mangësi procedurale, përfshirë mospublikimin e listës së përgjithshme dhe asaj të veçantë të pronave, si dhe mungesën e të dhënave të kërkuara kadastrale dhe të shfrytëzimit. Fillimi i kontrollit të ligjshmërisë para përfundimit të vitit kalendarik e reflekton mbikëqyrjen e vazhdueshme institucionale të menaxhimit të pronës komunale dhe e nënvizon rëndësinë e respektimit të procedurave në alokimin e aseteve të paluajtshme publike.<sup>227</sup> Gjatë vitit 2024, OJQ Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) e ka paraqitur një padi administrative kundër Kuvendit Komunal të Prishtinës, duke e kontestuar ligjshmërinë e një vendimi për shkëmbimin e

226 The Kosovo Dispatch (2026), [Gjykata Kushtetuese sërish pezullon ligjin për Byronë e Verifikimit të Pasurisë, paralajmëron kundër ligjbërjes së nxituar.](#)

227 KALLXO (2026), [MAPL shpall të paligjshëm vendimin e komunës së Prishtinës për Listen e pronave për dhënie në shfrytëzim.](#)

pronës komunale. Vendimi i kontestuar përfshinte transferimin e një parcele të madhe toke publike në Çagllavicë tek individë privatë, në këmbim të parcelave private dukshëm më të vogla. OJQ IKD e ka kërkuar anulimin e vendimit dhe pezullimin e ekzekutimit të tij, duke argumentuar se procesi ishte i shoqëruar me shkelje të rënda ligjore, përfshirë moszbatimin e dispozitave relevante ligjore, parregullsi procedurale dhe vlerësim të pasaktë të fakteve. Gjykata Themelore e ka urdhëruar pezullimin e ekzekutimit të vendimit të kontestuar, duke konstatuar se zbatimi i tij mund të shkaktonte dëm të riparueshëm dhe se pezullimi shërbente për mbrojtjen e interesit publik.<sup>228</sup> Paralelisht, rishikimi i ligjshmërisë nga autoritetet qendrore rezultoi në pezullimin e ekzekutimit të vendimit dhe kthimin e çështjes në Kuvendin Komunal për rishqyrtim. Këto zhvillime e theksojnë rëndësinë e garancive gjyqësore dhe administrative në parandalimin e disponimit potencialisht të paligjshëm të aseteve publike. Rasti e ilustron rolin e padive strategjike dhe mbikëqyrjes institucionale në forcimin e llogaridhënies, sigurimin e pajtueshmërisë me sundimin e ligjit dhe mbrojtjen e pronës publike dhe interesit të gjerë publik në qeverisjen lokale.<sup>229</sup>

**211.** Qendra për Litigim Strategjik (QLS), një platformë e OJQ GLPS, e ka paraqitur një padi duke e kërkuar shfuqizimin e një akti nënligjor normativ, përkatësisht Rregullores për Organizimin dhe Përdorimin e Parkingjeve në Komunën e Prishtinës. Rregullorja përmbante dispozita të paligjshme që i cenonin në mënyrë të vazhdueshme garancitë kushtetuese të së drejtës së pronës dhe lirisë së lëvizjes. Për më tepër, çështja prekte drejtpërdrejt të drejtën për shërbime publike të barabarta dhe efektive, si dhe të drejtën për trajtim të drejtë administrativ, të mbrojtura si nga legjislacioni vendor ashtu edhe nga standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Rasti i iniciuar nga QLS rezultoi me një vendim të favorshëm nga Gjykata Supreme e Kosovës, e cila i shfuqizoi dispozitat e rregullores që nuk ishin në përputhje me parimin e ligjshmërisë.<sup>230</sup>

**212.** Sipas OSCE Property Rights Monitor (Raporti i OSBE-së për Monitorimin e të Drejtave Pronësore) (Edicioni 12, janar–qershor 2025), gjatë periudhës raportuese nuk janë regjistruar raste të reja të okupimit të paligjshëm të pronës së paluajtshme që i prekin komunitetet e cënueshme. Megjithatë, raporti thekson se janë identifikuar 11 raste shpronësimi që prekin parcela në pronësi të anëtarëve të komunitetit serb në rajonin e Gjilanit, gjë që tregon ndërhyrje të vazhdueshme shtetërore në të drejtat pronësore përmes mekanizmave të shpronësimit. Për më tepër, raporti tregon se 36 familje (34 familje serbe-K dhe 2 familje rome) kanë përfituar nga banimi social gjatë vitit 2025, ndërsa në nivel vendi janë paraqitur 2,120 kërkesa për legalizimin e ndërtimeve pa leje, pa u raportuar legalizim i ndërtimeve në tokë të okupuar ilegalisht që i përket komuniteteve jo-shumicë.<sup>231</sup>

**213.** Në mesin e vitit 2025, zbatimi i vendimeve përfundimtare të përcaktimit të të drejtave pronësore të pronës në Mitrovicën e Veriut ka rezultuar me disa dëbime. Më 23 korrik 2025, Policia e Kosovës ka asistuar në dëbimin e familjes Janjićijević nga një banesë në Mitrovicën e Veriut, duke vepruar në bazë të një urdhri ekzekutimi të lëshuar nga Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës (AKKVP) në favor të një kërkuesi tjetër. Sipas raportimeve mediatike, familja e

228 IKD (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025

229 IKD (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025

230 GLPS (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

231 OSBE (2025), [Monitoruesi i të Drejtave Pronësore](#).

kishte blerë banesën dekada më parë nga kompania Trepça dhe kishte jetuar aty për gati 30 vjet. Familja ka deklaruar se posedonte dokumentacion që dëshmonte transaksionin dhe se nuk ishte në dijeni për ndonjë vendim përfundimtar gjyqësor negativ në kohën kur u ekzekutua dëbimi. Megjithëse një njoftim 30-ditor ishte lëshuar në mars 2025, familja ka theksuar se gjendja e rëndë shëndetësore e disa anëtarëve të saj e ka pamundësuar përmbushjen vullnetare të këtij afati.<sup>232</sup>

**214.** Më 8 gusht 2025, u realizua një dëbim i dytë në Mitrovicën e Veriut që e përfshinte familjen Kuprešanin, në bazë të një urdhri ekzekutimi të lëshuar nga Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës (AKKVP), me asistencën operacionale të Policisë së Kosovës. Familja, përfshirë një nënë të vetme me tre fëmijë, u largua nga një banesë në zonën Rudarske Çete. Sipas deklaratave të dhëna për media, banesa i ishte ndarë familjes në vitin 2003 nga autoritetet lokale gjatë administratës së UNMIK-ut, ndërsa banorët raportuan se kishin marrë vetëm një periudhë të shkurtër kohore për t'u larguar pasi nisi ekzekutimi i vendimit.<sup>233</sup> Si në rastin e korrikut 2025, dëbimi ka rezultuar nga pretendime pronësore konkurruese të zgjidhura përmes mekanizmit të verifikimit të pronës pas konfliktit.

**215.** Mundësia për përballimin e kostos së banimit në Kosovë ka mbetur një shqetësim strukturor, pavarësisht zgjerimit të vazhdueshëm të stokut të banesave. Në vitin 2025, në Prishtinë, çmimet e qirave për banesa njëdhomëshe variojnë nga rreth 225 euro deri mbi 300 euro në muaj, krahas një page mesatare neto prej 552 euro, gjë që ushtron presion të konsiderueshëm mbi punëtorët e rinj dhe familjet me të ardhura të mesme. Çmimet e pasurive të paluajtshme janë rritur me rreth 20–30 për qind në vitet e fundit, me disa lagje ku çmimet janë rritur nga 720 €/m<sup>2</sup> në vitin 2014 në mbi 1,300 €/m<sup>2</sup> aktualisht.<sup>234</sup>

**216.** Një raport i publikuar së fundmi nga OJQ GLPS, i cili i analizon sfidat e grave në realizimin e të drejtave pronësore në Kosovë dhe është zhvilluar nga perspektiva e monitorimit gjyqësor gjatë periudhës fundi i vitit 2024 deri në mesin e vitit 2025, tregon se gratë mbeten dukshëm të nënpërfaqësuar në pronësinë e pasurisë në Kosovë.<sup>235</sup> Në terma numerike, ato bashkëmbajnë afërsisht 19.8 për qind të pronave të regjistruara në nivel vendi në Kosovë. Sa u përket kontest-eve pronësore, përfshirë trashëgiminë, pasurinë bashkëshortore dhe raste të tjera të ndërlydhura, monitorimi i OJQ GLPS tregon ekzistencën e joefikasiteteve procedurale që ndikojnë në aftësinë e grave për të gëzuar vendime gjyqësore në kohë.<sup>236</sup> Raporti thekson se praktikatat e trashëgimisë vazhdojnë të formësohen nga norma patriarkale dhe praktika diskriminuese, ku gratë shpesh heqin dorë nga të drejtat e tyre për shkak të presionit social, përjashtimit nga procedurat ose pranimit vetëm të pjesëve simbolike në vend të të drejtës së plotë ligjore. Ai identifikon gjithashtu mangësi strukturore brenda gjyqësorit, përfshirë kapacitete të kufizuara institucionale, mungesë të stafit dhe grumbullim të lëndëve, të cilat kontribuojnë në vonesa dhe transparencë të reduktuar, veçanërisht përmes publikimit të kufizuar të aktgjykimeve. Nga 172 seanca të monitoruara, një numër i konsiderueshëm u shty ose u anulua për shkak të mungesës së gjyqtarëve, ekspertëve ose palëve, ndërsa disa raste mbetën të pazgjidhura për vite me radhë. Në 24 raste ku u mat kohëzgjatja e procedurave, u deshën mesatarisht rreth katër vite (1,454 ditë) që një kërkesë të fillonte të trajtohej nga gjykata, një vonesë që rrezikon ta minojë besimin në gjyqësor dhe t'i dekurajojë

232 NSI (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

233 NSI (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

234 Kosovo 2.0 (2025), [Banesat jo aq të përballueshme në Ballkan](#).

235 GLPS (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

236 GLPS (2025), [Sfidat e grave në realizimin e të drejtave pronësore në Kosovë: perspektivë nga monitorimi gjyqësor](#)

gratë nga ndjekja e të drejtave të tyre pronësore.<sup>237</sup>

**217.** Gjatë vitit 2025, një numër incidentesh që i kanë prekur familjet serbe-K kanë ngritur shqetësime lidhur me mbrojtjen efektive të të drejtave pronësore dhe sigurinë e banimit. Në veçanti, më 2 janar 2025, objekte ndihmëse bujqësore që i përkisnin familjes pesëanëtarëshe Đokić në Radevë (komuna e Lipjanit) u shkatërruan nga një zjarr i shkaktuar, sipas raportimeve, nga persona të panjohur. Më 6 shkurt 2025, posterët e fushatës së Listës Serbe u dëmtuan në murin e një shtëpie private në pronësi të Nikola Janković në Bushincë (komuna e Kamenicës), ndërsa më 9 shkurt 2025, shtëpia e familjes Đorić në Lipjan u qëllua me gurë gjatë festimeve paszgjedhore, duke shkaktuar dëme materiale. Më 17 qershor 2025, në Leposaviq, një punonjës komunal raportohet se ka ndryshuar bravën e banesës së Slobodan Spajić, i cili kishte jetuar aty në kuadër të një programi të Komisarijatit serb për personat e zhvendosur. Incidentet e tjera përfshijnë detonimin e një mjeti shpërthyes më 17 gusht 2025 jashtë ambienteve në pronësi të Miloš Perović në Zubin Potok, duke shkaktuar dëme të konsiderueshme materiale, si dhe një raportim për thyerje dhe hyrje me forcë më 14 dhjetor 2025 në shtëpinë e familjes Gačić në Uglare pranë Fushë Kosovës.<sup>238</sup>

### 218. Rekomandimet

- Ministria e Drejtësisë (MD) dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) duhet ta sigurojnë zbatimin efektiv të të drejtave pronësore të grave duke vendosur verifikim të detyrueshëm të përfshirjes së grave në procedurat pronësore dhe duke publikuar të dhëna të ndara sipas gjinisë për pronësinë;
- Policia e Kosovës dhe Prokuroria duhet t'i hetojnë dhe t'i ndjekin penalisht të gjitha incidentet që e prekin pronën dhe sigurinë e komuniteteve jo-shumicë, përfshirë dëmtimin dhe ndërhyrjen e paligjshme në pronë;
- Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës duhet të sigurojë që të gjitha vendimet për dëbim të shoqërohen me dokumentacion të verifikuar të pronësisë, njoftim minimal prej 30 ditësh dhe arsyetim me shkrim që i adreson rrethanat e banorëve, veçanërisht në rastet që përfshijnë banim afatgjatë dhe familje të cënueshme.

237 GLPS (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

238 NSI (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

## 6.5 Të drejtat kulturore

**219.** Standardet ndërkombëtare i njohin të drejtat kulturore si pjesë thelbësore të dinjitetit njerëzor dhe zhvillimit personal. Nenet 22 dhe 27 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (DUDNJ) e afrojnë të drejtën e secilit për t'i gëzuar të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore të nevojshme për dinjitet dhe për të marrë pjesë lirshëm në jetën kulturore, për t'i shijuar artet dhe për të përfituar nga përparimi shkencor, duke i mbrojtur njëkohësisht interesat morale dhe materiale të autorëve. Në nivel traktatesh, neni 15 i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (PNDESK) e garanton të drejtën për të marrë pjesë në jetën kulturore dhe për të përfituar nga përparimi shkencor, ndërsa neni 27 i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (PNDKCP) mbron të drejtat kulturore, fetare dhe gjuhësore të pakicave. Deklarata e OKB-së për të Drejtat e Personave që u Përkasin Pakicave Kombëtare ose Etnike, Fetare dhe Gjuhësore (1992) i forcon këto dimensione kolektive. Instrumentet plotësuese të UNESCO-s, përfshirë Deklaratën Universale mbi Diversitetin Kulturor (2001) dhe Konventën për Ruajtjen e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale (2003), nënvizojnë detyrimet e shteteve për ta ruajtur dhe promovuar trashëgiminë kulturore. Së fundmi, Rezoluta 58/4 e Këshillit të të Drejtave të Njeriut (2025) riafirmoi se kufizimet në pjesëmarrjen në jetën kulturore dhe në qasjen në trashëgiminë kulturore mund ta dëmtojnë kohezionin social, dialogun dhe paqen. Të drejtat kulturore konsolidohen më tej përmes jurisprudencës dhe të drejtës zakonore ndërkombëtare. Në vendimin Temple of Preah Vihear (Kamboxhia kundër Tajlandës) (2013), Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (GJND) theksoi detyrimet e shteteve për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të lidhur me vendet e Trashëgimisë Botërore, duke afirmuar rëndësinë e saj juridike në të drejtën ndërkombëtare. Parimet e Draftit të Komisionit të së Drejtës Ndërkombëtare (KDN) të vitit 2022 mbi mbrojtjen e mjedisit në lidhje me konfliktet e armatosura gjithashtu njohin mbrojtjen e trashëgimisë kulturore si pjesë të detyrimeve ndërkombëtare, disa prej të cilave reflektojnë të drejtën zakonore ndërkombëtare. Paralelisht, Studimi i Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq mbi të Drejtën Zakonore Humanitare Ndërkombëtare (Rregullat 38–40) identifikon mbrojtjen e pronës kulturore si normë të konsoliduar zakonore.

**220.** Kosova nuk është anëtare e UNESCO-s. Më 4 gusht 2015, Kosova aplikoi për anëtarësim dhe e deklaroi pranimin e Kushtetutës së UNESCO-s. Megjithëse Bordi Ekzekutiv rekomandoi pranimin më 22 shtator 2015, Konferenca e Përgjithshme e refuzoi aplikimin më 9 nëntor 2015, pasi nuk u arrit shumica e kërkuar prej dy të tretash (92 vota pro, 50 kundër dhe 29 abstenime). Si rrjedhojë, konventat dhe deklaratat e UNESCO-s nuk janë drejtpërdrejt detyruese në Kosovë. Megjithatë, ato përbëjnë standarde ndërkombëtare autoritative, me të cilat Kosova në përgjithësi zgjedh ta harmonizojë kornizën e saj të brendshme ligjore dhe politike.

**221.** Në përputhje me standardet ndërkombëtare të përshkruara më sipër, korniza kushtetuese dhe ligjore e Kosovës ofron mbrojtje të qartë për të drejtat kulturore dhe trashëgiminë kulturore. Neni 59 i Kushtetutës garanton të drejtën e anëtarëve të komuniteteve për të shprehur, ruajtur dhe zhvilluar kulturën e tyre, si dhe për t'i ruajtur elementet thelbësore të identitetit të tyre, përfshirë fenë, gjuhën, traditat dhe kulturën, si dhe të drejtën për të themeluar shoqata kulturore, artistike, shkencore dhe arsimore. Neni 9 e njejtë gjithashtu trashëgiminë kulturore dhe fetare si pjesë integrale të trashëgimisë së Kosovës dhe imponon detyrë të veçantë për shtetin që të sigurojë mbrojtje efektive të vendeve dhe monumenteve me rëndësi kulturore dhe fetare për komunitetet. Ky mandat kushtetues zbatohet përmes Ligjit Nr. 02/L-88 për Trashëgiminë Kulturore, i cili adopton një përkufizim të gjerë që e përfshin trashëgiminë në kuptimin arkitekturor, arkeologjik, të

luajtshëm dhe shpirtëror. Për më tepër, në vitin 2024, Kosova ka miratuar edhe Ligjin Nr. 08/L-245 për Artin dhe Kulturën, i cili e përcakton politikën kulturore në Kosovë dhe i rregullon kushtet për themelimin dhe administrimin e institucioneve publike të artit dhe kulturës.

**222.** Gjatë periudhës raportuese, një Projekt i vazhdueshëm për Industrinë Kreative i zbatuar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në bashkëpunim me ministritë relevante të Kosovës ka mbështetur zhvillimin e ekonomisë kreative të Kosovës përmes masave që synojnë forcimin e kornizës ligjore dhe politike dhe zgjerimin e mundësive të punësimit në sektorin kreativ. Projekti gjithashtu ka synuar t'i përmirësojë aftësitë e të rinjve, grave dhe burrave përmes edukimit formal dhe joformal, të rrisë qasjen në financa dhe mundësi kërkimore për industrinë kreative, si dhe ta mbështesë zhvillimin komunal përmes planifikimit strategjik, iniciativave lokale kreative dhe turizmit kulturor.<sup>239</sup>

**223.** Në vitin 2025, Ambasadori i BE-së në Kosovë, Aivo Orav, riafirmoi rëndësinë e ruajtjes dhe mbrojtjes së trashëgimisë kulturore dhe fetare të të gjitha komuniteteve dhe theksoi mekanizmat ekzistues institucionalë, përfshirë Njësinë e Policisë së Kosovës për Mbrojtjen e Objekteve Fetare dhe Kulturore, e cila ofron siguri të vazhdueshme fizike për kishat dhe manastiret ortodokse serbe. Në këtë drejtim, duhet theksuar se KFOR-i vazhdon gjithashtu të ofrojë siguri 24-orëshe për Manastirin e Deçanit (Visoki Dečani) si pjesë e mandatit të tij për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, në koordinim me Policinë e Kosovës dhe EULEX-in.<sup>240</sup> Orav theksoi gjithashtu rolin e Ligjit për Zonat e Veçanta Mbrojtëse në themelimin e Këshillit për Zbatim dhe Monitorim (Këshilli për Zbatim dhe Monitorim (KZM)). Në veçanti, KZM-ja bashkëkryesohet nga BE-ja dhe shërben si mekanizëm për zgjidhjen e kontesteve ndërmjet autoriteteve qendrore dhe lokale dhe Kishës Ortodokse Serbe. Sipas Orav, gjatë vitit 2025 janë bërë përpjekje të shtuara për riaktivizimin e punës së KZM-së.<sup>241</sup>

**224.** Më 23 korrik 2025, një rit fetar katolik romak është raportuar se është zhvilluar në vendin arkeologjik të manastirit mesjetar ortodoks serb Bogorodica Hvostanska në fshatin Studenicë, komuna Istog. Sipas një deklaratë zyrtare të Dioqezës së Rashkës dhe Prizrenit, ky rit është kryer pa dijeninë, pëlqimin apo përfshirjen e Kishës Ortodokse Serbe, e cila e konsideron këtë lokalitet pjesë të trashëgimisë së saj kanonike. Dioqeza ka ngritur shqetësime se akti është zhvilluar në një zonë të mbrojtur të trashëgimisë kulturore dhe fetare dhe ka theksuar se nuk ka pasur koordinim paraprak me autoritetin kishtar përkatës. Në deklaratë theksohet se statusi i vendit si zonë e veçantë mbrojtëse sipas legjislacionit për trashëgimi mund të jetë cenuar nga aktiviteti fetar i paautorizuar.<sup>242</sup>

239 UNDP (2026), [Projekti i industrive kreative](#).

240 KFOR (2025), [Ushtarët italianë që mbrojnë trashëgiminë kulturore të Manastirit të Deçanit](#).

241 Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian në Kosovë (2025), [Orav: BE-ja dëshiron një zgjidhje të qëndrueshme për komunitetin serb në Kosovë](#).

242 NSI (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

**225.** Në vitin 2025, janë raportuar disa incidente që prekin simbolet e identitetit kulturor dhe historik serb në Kosovë, duke ngritur shqetësime lidhur me mbrojtjen e shprehjes kulturore dhe trashëgimisë së komunitetit. Më 18 gusht 2025, një shenjë në alfabet cirilik që përmbante Dhjetë Urdhëresat dhe kishte qëndruar në hyrje të Mitrovicës së Veriut për më shumë se dy dekada, u gjet e hequr. Më 21 gusht 2025, flamuri serb u raportua se ishte hequr dhe prerë nga një kompleks përkujtimor në Goraždevac, i dedikuar viktimave lokale, përfshirë ata të vrarë gjatë bombardimeve të NATO-s në vitin 1999 dhe sulmit në lumin Bistricë në vitin 2003. Më vonë, më 3 dhjetor 2025, busti i Bogdan Radenković, një aktivist politik dhe kulturor serb i fillimit të shekullit XX, i lindur pranë Zveçanit, u hoq nga vendndodhja e tij e gjatë në qendër të Zveçanit, ku kishte qenë i vendosur për më shumë se 20 vjet. Së bashku, këto ngjarje ilustronë ndjeshmërinë e vazhdueshme rreth shenjave simbolike kulturore dhe implikimet e tyre për gëzimin e të drejtave kulturore nga komuniteti serb.

#### **226. Rekomandimet**

- Ministria e Kulturës dhe Turizmit duhet të sigurojë respektim të rreptë të masave mbrojtëse në Zonat e Veçanta Mbrojtëse përmes autorizimit paraprak për çdo aktivitet fetar ose kulturor dhe vendosjes së sanksioneve për ndërhyrjet e paautorizuara në vendet e mbrojtura;
- Policia e Kosovës duhet të hetojë dhe të raportojë publikisht për incidentet që përfshijnë heqjen ose dëmtimin e simboleve kulturore dhe fetare, duke siguruar llogaridhënie dhe mbrojtje të shprehjes kulturore për të gjitha komunitetet.

## 7. PJESA C: TË DREJTAT E PERSONAVE DHE GRUPEVE TË CAKTUARA

### 7.1 Të drejtat e grave dhe barazia gjinore

**227.** Mbrojtja e të drejtave të grave në Kosovë është e bazuar në të drejtën ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe në inkorporimin e saj kushtetues. Në bazë të nenit 22 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare drejtpërdrejt të zbatueshme kanë përparësi ndaj legjislacionit vendor. Këto përfshijnë CEDAW dhe Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit), të dyja drejtpërdrejt të aplikueshme, si dhe PNDKP (nenet 2, 3, 23 dhe 26) dhe GJEDNJ (neni 14 dhe Protokolli nr. 12). Edhe pse nuk përmendet shprehimisht në Kushtetutë, Rezoluta 1325 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së për Gratë, Paqen dhe Sigurinë ndikon në kuadrin legjislativ duke theksuar pjesëmarrjen e grave në ndërtimin e paqes dhe mbrojtjen në situata konflikti. Përtej traktateve detyruese, të drejtat e grave përforcohen edhe përmes angazhimeve politike. Deklarata e Pekinit dhe Platforma për Veprim (1995), së bashku me proceset e saj të rishikimit periodik, më së fundmi Pekin +30 (2025), krijon një kornizë gjithëpërfshirëse politike në dymbëdhjetë fusha kritike, përfshirë dhunën ndaj grave, konfliktet e armatosura dhe vendimmarrjen. Udhëzime shtesë normative burojnë nga Deklarata e OKB-së për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave (1993) dhe Agjenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, në veçanti Objektivi 5 për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave.

**228.** Në nivel kushtetues, neni 24 garanton barazinë para ligjit dhe ndalon diskriminimin mbi çdo bazë, përfshirë racën, ngjyrën, gjininë, gjuhën, fenë, bindjet politike ose të tjera, origjinën kombëtare apo sociale, përkatësinë me ndonjë komunitet, pasurinë, statusin ekonomik ose social, orientimin seksual, lindjen, aftësinë e kufizuar ose çdo status tjetër personal. Kjo garanci kushtetuese zbatohet përmes një sërë aktesh ligjore specifike që reflektojnë standardet ndërkombëtare për barazinë gjinore dhe të drejtat e grave. Këto përfshijnë Ligjin Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore, Ligjin Nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi, si dhe Ligjin Nr. 08/L-185 për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Bazë Gjinore, i cili zëvendësoi Ligjin Nr. 03/L-182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje në tetor 2023. Për më tepër, Kodi Penal Nr. 06/L-074 mbron gratë duke kriminalizuar përdhunimin në bazë të mungesës së pëlqimit (neni 227), dhunën në familje (neni 248), martesën e detyruar (neni 239), trafikimin dhe shfrytëzimin e qenieve njerëzore (neni 165), si dhe ngacmimin seksual, duke krijuar kështu një kornizë ligjore kundër dhunës dhe detyrimit me bazë gjinore.

**229.** Sa i përket qeverisjes institucionale, Agjencia për Barazi Gjinore (ABGJ) përbën mekanizmin kryesor të ngarkuar me mbikëqyrjen e zbatimit të drejtë të politikave gjinore në Qeverinë e Kosovës. Në këtë drejtim, ABGJ, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, është angazhuar në hartimin e Programit për Barazi Gjinore 2025–2035, megjithatë ky dokument ende nuk ka përfunduar në kohën e përgatitjes së raportit të OSHC-ve. ABGJ është një aktor kyç në adresimin e sfidave dhe në

promovimin e progresit drejt barazisë gjinore në nivel politikash.<sup>243</sup>

**230.** Strehimoret në Kosovë e përbëjnë mekanizmin kryesor institucional për mbrojtjen e grave që janë viktime të dhunës në familje dhe trafikimit të qenieve njerëzore. Aktualisht, tetë strehimore për dhunë në familje dhe një strehimore për viktimat e trafikimit ofrojnë një kapacitet total prej 97 vendesh të disponueshme.<sup>244</sup> Sipas statistikave të Ministrisë së Drejtësisë për periudhën janar -dhjetor 2025, shtatë strehimore kanë akomoduar 160 gra dhe 181 fëmijë gjatë kësaj periudhe, duke treguar një kërkesë të vazhdueshme për shërbime mbrojtëse, megjithëse kapacitetet mbeten nën standardet dhe rekomandimet ndërkombëtare.<sup>245</sup> Në aspektin e qasjes, strehimoret janë të hapura për gratë me status të paqartë të qëndrimit dhe pa dokumentacion, gratë me aftësi të kufizuara fizike, si dhe gratë e moshuara. Një strehimore e specializuar për të mbijetuarat e trafikimit ka një kapacitet prej 10 shtretërisht, ndërsa një tjetër institucion që mbështet fëmijët e mbijetuar të abuzimit dhe dhunës në familje ofron 12 shtretër. Në fund, një strehimore e veçantë funksionon për viktimat me rrezik të lartë të trafikimit dhe ofron 25 shtretër.<sup>246</sup>

**231.** Sipas të dhënave të Policisë së Kosovës, nga janari deri në dhjetor 2025, numri total i rasteve të dhunës në familje të raportuara në Policinë e Kosovës ishte 2,815.<sup>247</sup> Shumica e viktimave në këto raste ishin gra. Siç tregon tabela më poshtë, katër vitet e fundit janë karakterizuar nga një rritje e rasteve të raportuara, e cila në mënyrë të dukshme është stabilizuar në vitin 2025. Ky trend në rritje mund të reflektojë një sërë faktorësh, përfshirë gatishmëri më të madhe ose qasje të përmirësuar në mekanizmat e raportimit, identifikim më të avancuar institucional të rasteve, ose një rritje substanciale të incidencës së dhunës.

Viti	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Rastet e DhF	1915	2069	2200	2273	2638	2959	2815

**Figura 2: Rastet e dhunës në familje (DhF) sipas Policisë së Kosovës**

**232.** Në mënyrë të veçantë, lidhur me regjistrimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje nga autoritetet institucionale, siç është ilustruar më sipër, një raport i publikuar së fundmi nga OJQ Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) me titull Zero Tolerancë, i cili monitoron përgjigjen institucionale ndaj dhunës me bazë gjinore (DhBGj), tregon mangësi në kuptimin institucional.<sup>248</sup> Raporti konstaton se zyrtarët policorë shpesh e ngatërrojnë dhunën me bazë gjinore (DhBGj) me dhunën në familje, duke mos ndikuar vetëm në përzierjen e numrit të rasteve, por edhe në ngushtimin e kuptimit konceptual dhe të përgjigjes institucionale ndaj të dy shkeljeve.<sup>249</sup> Në komentet e tyre për Raportin e Vendit të Komisionit Evropian për vitin 2025, OJQ Qendra për Studime Gjinore në Kosovë (QKSGJ) dhe OJQ Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) gjithashtu theksojnë mungesën e mjaftueshme të mbështetjes me qasje të përqendruar te të mbijetuarat.<sup>250</sup> Sa i përket përgjigjes

243 QKSGJ (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

244 RrGK (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

245 Ministria e Drejtësisë (2026), [Databaza për evidentimin e rasteve të dhunës në familje](#).

246 QKSGJ (2026), input for the joint CSO report on Human Rights in Kosovo in 2025.

247 Ministria e Drejtësisë (2026), [Databaza për evidentimin e rasteve të dhunës në familje](#).

248 RrGK (2025), [Tolerancë zero: monitorimi i përgjigjes institucionale ndaj dhunës me bazë gjinore](#).

249 RrGK (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

250 QKSGJ (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

institucionale, raporti vjetor i OJQ GLPS me titull Performanca dhe Mangësitë: Trajtimi institucional i dhunës në familje në vitin 2025 analizon trajtimin e rasteve të dhunës në familje nga Policia e Kosovës, Prokuroria dhe gjyqësori gjatë vitit 2025. Raporti gjen se, ndonëse janë ngritur 1,901 aktakuza, gjykatat kanë zgjidhur vetëm 56 për qind të rasteve, me një kohëzgjatje mesatare prej 281 ditësh për rast. Në 87 për qind të rasteve të zgjidhura, gjykatat kanë shqiptuar dënime; megjithatë, vetëm një e treta kanë rezultuar me burgim efektiv, ndërsa 85 për qind e të akuzuarve janë deklaruar fajtorë. Monitorimi i 830 seancave gjyqësore ka zbuluar gjithashtu se 260 prej tyre janë shtyrë, kryesisht për shkak të mungesës së palëve. Raporti identifikon gjithashtu një sërë shkeljesh procedurale dhe mangësish, përfshirë regjistrim të pasaktë të procedurave, moskaktim të përfaqësimit ligjor ex officio pavarësisht kërkesave, mosdhënie të dosjeve të lëndëve palëve nga prokuroria, vazhdim të seancave pa i përmbushur detyrimet ligjore, si dhe trajtim të pamjaftueshëm të viktimave gjatë paraqitjes së tyre si dëshmitare.<sup>251</sup>

**233.** Veçanërisht, i njëjti raport i OJQ RrGK (2025) tregon se, pavarësisht përmirësimit të mekanizmave të reagimit ndër vite, fajësimi i viktimave, shkeljet e konfidencialitetit dhe përpjekjet për të pajtuar të mbijetuarat me autorët e dhunës vazhdojnë të jenë dukuri të përhapura në mjediset institucionale.<sup>252</sup> Një incizim audio i publikuar nga KALLXO.com në shtator 2025 ilustron këto shqetësime strukturore. Incizimi zbuloi një diskutim privat midis një gjyqtari dhe një prokurori në një rast të dhunës në familje, në të cilin ata diskutonin strategji për ta kufizuar pjesëmarrjen e viktimës në procedurat gjyqësore. Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) më pas e ka pezulluar gjyqtarin, duke iniciuar një rishikim disiplinor.<sup>253</sup>

**234.** Një tjetër rast serioz i tentim-femicidit në nëntor 2025 vë në pah dështimin e vazhdueshëm të masave mbrojtëse të destinuara për t'i mbrojtur individët në rastet e dhunës në familje. Një burrë me inicialet K.E. u arrestua në Gadime, Lipjan, nën dyshimin për vrasje të rënduar në tentativë sipas nenit 183 të Kodit Penal, pasi dyshohet se kishte sulmuar ish-bashkëshorten e tij me sëpatë; në mënyrë kritike, i dyshuari ishte nën një Urdhër Mbrojtjeje aktiv në kohën e sulmit. Viktima u transportua për trajtim mjekësor dhe prokuroria konfirmoi klasifikimin e veprës penale. Sipas OJQ RrGK, rasti ngre shqetësime serioze lidhur me monitorimin dhe zbatimin efektiv të Urdhrave të Mbrojtjes, veçanërisht duke pasur parasysh se këto masa synojnë të parandalojnë pikërisht këtë lloj dhune me pasoja fatale.<sup>254</sup> Për më tepër, në Fushë Kosovë një grua u godit me thikë dhe u plagos rëndë në atë që autoritetet e kanë klasifikuar gjithashtu si "vrasje e rënduar në tentativë". Policia ka arrestuar të fejuarin e viktimës, me të cilin ajo bashkëjetonte, nën dyshimin për përfshirje në sulm.<sup>255</sup>

**235.** Në fillim të vitit 2025, Ministria e Drejtësisë prezantoi një linjë telefonike emergjente të specializuar, e cila synon të ofrojë ndihmë të menjëhershme për viktimat e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Më 29 janar 2025, Ministri i Drejtësisë nënshkroi Draft-Udhëzimet që themelonin këtë linjë telefonike, e cila është e dizajnuar për të ofruar mbështetje të shpejtë, kon-

251 GLPS (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

252 RrGK (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

253 Prishtina Insight (2025), [Mos e lër të flasë: gjyqtari pezullohet pas zbulimeve për tentim heshenjeje të viktimës së abuzimit.](#)

254 Betimi për Drejtësi (2025), [Arrestohet i dyshuari se tentoi me sëpatë ta privonte nga jeta bashkëshorten e tij.](#)

255 Betimi për Drejtësi (2025), [Therret me thikë një grua në Fushë-Kosovë, arrestohet i fejuari i saj.](#)

fidenciale dhe të sigurt. Më pas, më 26 shkurt 2025, Qeveria e miratoi Udhëzimin Administrativ, duke e formalizuar zbatimin institucional të linjës telefonike si pjesë e infrastrukturës shtetërore për mbështetjen e viktimave.

**236.** Raporti për Trafikimin e Personave për Kosovën i vitit 2025 identifikoi 14 viktima të trafikimit, prej të cilave 7 ishin të shfrytëzuara për qëllime seksuale dhe 7 për shfrytëzim pune.<sup>256</sup> Ekspertët dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile theksojnë vazhdimin e shfrytëzimit të individëve për qëllime të shfrytëzimit seksual në apartamente private dhe motele, si dhe kritikojnë dobësitë institucionale në identifikimin e viktimave dhe mekanizmat e mbrojtjes. Grupet më të cenueshme ndaj këtij fenomeni përfshijnë gratë, fëmijët, migrantët dhe personat që jetojnë në kushte të rënda ekonomike, ndërsa Kosova shpesh funksionon si vend transit, por edhe si hapësirë e shfrytëzimit të brendshëm.<sup>257</sup>

**237.** Në vitin 2025, një rast që përfshin dyshime për ngacmim seksual nga një punonjës i Policisë së Kosovës është bërë objekt hetimi nga Inspektorati Policor i Kosovës (IPK). Punonjësi i Policisë së Kosovës është ndaluar nën dyshimin se ka ngacmuar seksualisht një nxënëse të mitur për një periudhë dyjavore pranë një objekti shkollor. Duke vepruar në koordinim me Prokurorinë Themelore në Prizren, autoritetet kanë urdhëruar ndalimin 48-orësh të të dyshuarit, ndërsa IPK-ja ka rekomanduar pezullimin e tij në pritje të procedurave të mëtejshme.<sup>258</sup> Rasti gjithashtu pasqyron shqetësime më të gjera institucionale të identifikuar nga OJQ RrGK në raportin e saj Zero Tolerancë të vitit 2025, i cili gjeti se zyrtarët policorë shpesh e minimizojnë ngacmimin seksual, priren ta justifikojnë sjelljen e kryerësve dhe shpesh nuk arrijnë t'i njohin dinamikat e pushtetit, abuzimin psikologjik dhe kontrollin shtrëngues që janë të natyrshme në raste të tilla. Raporti gjithashtu vuri në dukje një tendencë për t'i nënvlerësuar përvojat e të mbijetuarave, veçanërisht në mungesë të lëndimeve fizike të dukshme, duke treguar boshllëqe të vazhdueshme në kuptimin institucional dhe reagimin ndaj dhunës me bazë gjinore.<sup>259</sup>

**238.** Në vitin 2025, diskursi online mizogjinist mbeti një pengesë e rëndësishme për pjesëmarrje të grave në politikë në Kosovë. Monitorimi i realizuar nga OJQ Instituti Demokracia për Zhvillim (D4D) gjatë periudhës zgjedhore në shkurt 2025 dokumentoi sulme sistematike seksiste ndaj kandidatëve dhe deputeteve gra, përfshirë poshtërimin, delegjitimitimin dhe përpjekjet e koordinuara për ta dëmtuar besueshmërinë e tyre. Këto modele tregojnë se gratë në politikë vazhdojnë të përballen me forma përjashtimi që shtrihen përtej institucioneve dhe në hapësirën digjitale publike.<sup>260</sup>

**239.** Gratë në veri të Kosovës në përgjithësi nuk raportojnë raste për shkak të mungesës së besimit në polici, gjë që tregon drejtpërdrejt për nënraportim të konsiderueshëm, sipas OJQ ACDC. Një grup joformal i grave ka mbledhur rreth 30 dëshmi gjatë vitit 2024 dhe ka dorëzuar një letër me 415 nënshkrime të KFOR-i. Në kontrast, një zyrtar policor ka deklaruar se vetëm tre raste të ngacmimit seksual janë iniciuar zyrtarisht në vitin 2025 (deri në fund të majit), duke theksuar një mospërputhje të madhe midis përvojave të jetuara dhe të dhënave zyrtare. Në nivel më të gjerë shoqëror, një raport rajonal/ekspert tregon se 29 për qind e grave kanë raportuar përjetimin e

256 QKSGJ (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

257 Bota Sot (2025), [Mbi 60 raste të trafikimit me njerëz. Arrestohen 120 persona.](#)

258 Telegrafi (2025), [Zyrtar civil i policisë arrestohet, dyshohet për ngacmim seksual të një të miture pranë shkollës.](#)

259 RrGK (2025), [Tolerancë zero? Monitorimi i përgjigjes institucionale ndaj dhunës me bazë gjinore.](#)

260 D4D (2025), [Dezinformimi me bazë gjinore dhe gjuha mizogjene në mediat online.](#)

ngacmimit seksual, duke sugjeruar një bazë të gjerë të rasteve të raportuara ose të raportuara në mënyrë joformale krahasuar me të dhënat administrative. Statistikat zyrtare institucionale në nivel të Kosovës ekzistojnë, por nuk janë të ndara në mënyrë sistematike sipas komunave veriore në burimet publike të disponueshme. Për shembull, një dokument zyrtar i raportimit për vitin 2023 evidenton 33 raste të raportuara të ngacmimit seksual dhe 25 raste të zgjidhura në nivel të Kosovës, pa ndarje sipas komunave.<sup>261</sup>

**240.** Qasja në kujdesin gjithëpërfshirës mjekësor pas përdhunimit në Kosovë mbetet e kufizuar dhe jo mjaftueshëm e institucionalizuar deri në vitin 2025. Ndërsa aborti lejohet sipas ligjeve për shëndetin riprodhues dhe shërbimet e përgjithshme shëndetësore ofrojnë trajtim fillestar mjekësor dhe testime për IST, nuk ekziston një program shtetëror plotësisht funksional që siguron referim sistematik, rehabilitim psiko-social afatgjatë, apo ofrim të standardizuar të kontracepsionit emergjent dhe profilaksisë për IST për të mbijetuarat e përdhunimit. Veçanërisht, profilaksia pas ekspozimit (PEP) për HIV, një komponent standard ndërkombëtar i kujdesit pas sulmit seksual, nuk është e disponueshme në sistemin publik shëndetësor, ndërsa qendra e planifikuar e referimit për rastet e dhunës seksuale në Institutin e Mjekësisë Ligjore nuk ishte ende plotësisht funksionale në vitin 2025.<sup>262</sup>

**241.** Qëndrimet publike ndaj barazisë gjinore ofrojnë një prizëm të rëndësishëm për t'i vlerësuar bazat shoqërore të reformave ligjore dhe institucionale. Një anketë e realizuar në qershor 2025 nga OJQ Social Impact Think-Tank / Instituti për Ndikim Social (SIT), në bashkëpunim me Fondin e Kombeve të Bashkuara për Popullsinë (UNFPA), ka analizuar perceptimet e 305 burrave dhe grave në zonat urbane dhe rurale të Kosovës mbi barazinë gjinore, rolet gjinore, stereotipet dhe dhunën me bazë gjinore. Ndërsa më shumë se 90 për qind e të anketuarve kanë refuzuar idenë se gratë duhet ta durojnë dhunën në familje për ta ruajtur unitetin familjar, gjetjet gjithashtu zbulojnë vazhdimësinë e qëndrimeve që i fajësojnë viktimat dhe prirjeve për t'i justifikuar autorët e dhunës, duke e theksuar kështu boshllëkun midis refuzimit formal të dhunës dhe normave gjinore thellësisht të rrënjosura në shoqëri.<sup>263</sup>

**242.** Në qershor 2025, Ministria e Shëndetësisë (MSH) miratoi një vendim për rritjen e shtesave të lehonisë dhe të fëmijëve, duke e bërë masën të zbatueshme menjëherë për të gjitha nënat e reja, pavarësisht statusit të punësimit. Për nënat e papuna, shtesa e lehonisë arrin në 1,955.4 euro, e disbursuar në 315.9 euro në muaj për gjashtë muaj, në shtesë të shtesës për fëmijë prej 240 eurosh të paguar me 20 euro në muaj për dymbëdhjetë muaj, duke arritur gjithsej 2,195.4 euro në vitin e parë për çdo fëmijë. Për nënat e punësuar, përveç marrjes së 70 për qind të pagës së rregullt gjatë pushimit të lehonisë, shteti ofron pagesa shtesë prej 325.9 euro në muaj për tre muajt e parë dhe 319.5 euro në muaj për tre muajt pasues, së bashku me të njëjtën shtesë për fëmijë prej 240 eurosh në vit, duke arritur gjithsej 2,176.2 euro mbështetje shtetërore në vitin e parë për çdo fëmijë.<sup>264</sup> Veçanërisht, Ligji i Punës ende nuk ishte ndryshuar gjatë periudhës raportuese, pavarësisht

261 ACDC (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

262 QKSGJ (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

263 SIT (2025), [Raport kërkimor ndërgjeneracional: opinionet publike mbi temat gjinore – stereotipet, dhuna me bazë gjinore dhe barazia gjinore](#).

264 QeK (2025), [Vendimet e mbledhjes së 261 të të Qeverisë](#).

shqetësimeve të vazhdueshme lidhur me dispozitat për pushimin e lehonisë.<sup>265</sup>

**243.** Pavarësisht rritjes së përfitimeve të sigurisë sociale për nënat, pabarazitë gjinore vazhdojnë ta karakterizojnë tregun e punës në Kosovë. Një raport i fundit i Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), i cili analizon tregun e punës dhe gjininë në Kosovë, dokumenton vazhdimësinë e pjesëmarrjes së ulët të grave në fuqinë punëtore, e cila qëndron nën 20 për qind dhe, si e tillë, është ndër më të ulëtat në Evropë. Përveç pabarazive strukturore, raporti ia atribuon pjesërisht këtë normë të vazhdueshme të ulët të pjesëmarrjes së grave në tregun e punës punës së papaguar të kujdesit në familje.<sup>266</sup> Për më tepër, është identifikuar edhe boshllëku gjinor në paga, ku gratë fitojnë 0.74 euro për çdo 1 euro të fituar nga burrat.<sup>267</sup>

**244.** Pabarazia gjinore është gjithashtu e shtresëzuar në aspekt hapësinor, me një ndarje të theksuar urbane kundrejt asaj rurale. Gratë në zonat rurale të Kosovës vazhdojnë të përballen me barriera strukturore në ushtrimin e të drejtave pronësore dhe të tokës, pavarësisht garancive formale të barazisë gjinore në kuadrin ligjor. Në maj dhe qershor 2025, u mbajtën tre punëtori këshilluese ligjore në Prishtinë, Prizren dhe Istog, në kuadër të një projekti për fuqizimin e grave rurale, të zbatuar bashkërisht nga Organizata e Kombeve të Bashkuara për Ushqim dhe Bujqësi (FAO) dhe UN Women, duke mbledhur mbi 130 noterë të licencuar dhe zyrtarë të kadastrave komunale. Iniciativa synonte forcimin e interpretimit dhe zbatimit me ndjeshmëri gjinore të ligjeve për pronën dhe trashëgiminë, promovimin e bashkëpronësisë dhe adresimin e sfidave të vazhdueshme të lidhura me praktikën diskriminuese të trashëgimisë, nivelin e ulët të njohurive ligjore dhe qasjen e kufizuar në ndihmë juridike në komunitetet rurale.<sup>268</sup>

**245.** Përveç kontekstit urban kundrejt atij rural, gratë nga komunitetet etnike joshqiptare përballen me kufizime më të thella strukturore në të gjitha segmentet e shoqërisë. Kjo përfshin pjesëmarrjen e tyre të kufizuar në strukturat vendimmarrëse, përfshirë anëtarësimin në partitë politike, siç është vërejtur nga OJQ RrGK.<sup>269</sup> Diskriminimi në shërbimet shëndetësore dhe në mundësitë e punësimit i privon në mënyrë disproporcionale gratë nga komunitetet romë, ashkali dhe egjiptiane nga të drejtat socio-ekonomike që gëzojnë komunitetet e tjera.<sup>270</sup>

**246.** Në qershor 2025, u mbajt Forumi i 3-të Ndërkombëtar për Gratë, Paqen dhe Sigurinë në Prishtinë, me temën “Kodi i Sigurisë për Gjeneratën Tonë”. Forumi mbledhi aktorë të ndryshëm për ta diskutuar rolin e grave në ndërtimin e paqes, drejtësinë dhe sigurinë kolektive. Diskutimet u fokusuan në forcimin e pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje, avancimin e drejtësisë për të mbi jetuarat e dhunës seksuale gjatë konfliktit, si dhe promovimin e qasjeve gjithëpërfshirëse ndaj paqes dhe sigurisë.<sup>271</sup>

## 247. Rekomandimet

- Policia e Kosovës duhet t’i zbatojë urdhrat mbrojtës në të gjitha rastet e dhunës në familje duke vendosur monitorim elektronik të detyrueshëm për kryerësit me rrezik të lartë dhe

265 IKD (2024), [Ligji i ri i punës. Në mes të nevojave dhe kërkesave për ndryshim.](#)

266 FNM (2025), [Tregu i punës dhe gjinia në Republikën e Kosovës.](#)

267 Projekti Borgen (2025), [Lufta kundër hendekut gjinor të pagave në Kosovë: përpjekje dhe nisma.](#)

268 FAO (2025), [Forcimi i rrugëve ligjore për të drejtat e tokës dhe pronës për gratë rurale në Kosovë.](#)

269 RrGK (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

270 QKSGJ (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

271 Lidhja Ndërkombëtare e Grave për Paqe dhe Liri (2025), [Rimendimi i sigurisë kolektive: pikat kryesore nga Forumi i tretë ndërkombëtar për Gratë, Paqen dhe Sigurinë.](#)

duke kryer kontrole të dokumentuara të përputhshmërisë brenda 48 orëve nga lëshimi i tyre;

- Kuvendi i Kosovës (KiK) duhet ta kriminalizojë femicidin si vepër penale të veçantë dhe të rëndë, me udhëzime të detyrueshme për dënime minimale dhe me dënime të shtuara;
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) duhet ta sigurojë trajtimin e duhur të rasteve të dhunës në familje duke kërkuar që të gjitha seancat të përfshijnë përfaqësim ligjor për viktimat, t'i ndalojë praktikatat e pajtimit dhe të publikojë të dhëna tremujore mbi kohëzgjatjen e rasteve, shtyrjet dhe rezultatet e dënimeve;
- Ministria e Drejtësisë duhet ta operacionalizojë linjën emergjente kombëtare për dhunën me baza gjinore duke siguruar mbulim 24/7, procedura të standardizuara referimi dhe raportim publik mbi numrin e thirrjeve të pranuar dhe rastet e referuara te institucionet;
- Ministria e Shëndetësisë duhet ta krijojë një sistem plotësisht funksional të kujdesit pas përdhunimit duke siguruar disponueshmërinë e kontracepsionit emergjent, trajtimit për IST dhe profilaksisë pas ekspozimit për HIV (PEP) në të gjitha spitalet publike, së bashku me referim të standardizuar në shërbime të mbështetjes psiko-sociale.

## 7.2 Të drejtat e fëmijëve

**248.** Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës (CRC), e cila e përkufizon fëmijën si çdo person nën moshën 18 vjeç, është drejtpërdrejt e zbatueshme në Kosovë në përputhje me nenin 22 të Kushtetutës dhe ka përparësi ndaj legjislacionit vendor. Komiteti për të Drejtat e Fëmijës, në Komentin e Përgjithshëm Nr. 13 (2011), kërkon nga shtetet që të ndërmarrin masa efektive ligjore, administrative, sociale dhe arsimore për mbrojtjen e fëmijëve nga të gjitha format e dhunës, ndërsa Komenti i Përgjithshëm Nr. 5 (2003) e thekson domosdoshmërinë e planeve kombëtare të veprimit, burimeve të mjaftueshme dhe trajnimit profesional për të siguruar zbatim të plotë. Instrumente të tjera të inkorporuara përmes nenit 22 i forcojnë më tej këto detyrime, përfshirë Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (PNDKP) (neni 24), i cili garanton mbrojtje të veçantë për fëmijët, si dhe CEDAW-in, i cili i adreson rreziqet e shtuara me të cilat përballen vajzat në kontekste diskriminimi dhe dhune me bazë gjinore. Në nivelin e OKB-së, Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 73/155 (2018) dhe Rezoluta e Këshillit për të Drejtat e Njeriut 34/16 (2017) kërkojnë gjithashtu integrimin e të drejtave të fëmijëve në kornizat kombëtare të zhvillimit dhe realizimin efektiv të tyre në praktikë.

**249.** Përveç instrumenteve ndërkombëtare të përmendura më sipër, mbrojtja e të drejtave të fëmijëve garantohet edhe me nenin 50 të Kushtetutës së Kosovës, i cili e afirmon mirëqenien e fëmijëve, barazinë dhe mbrojtjen nga dhuna, keqtrajtimi dhe shfrytëzimi. Ky kuadër kushtetues plotësohet nga Ligji Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, i cili parashikon masa mbrojtëse kundër abuzimit fizik, psikologjik dhe emocional, neglizhencës dhe shfrytëzimit në mjedise institucionale dhe private. Megjithëse kuadri ligjor i Kosovës është në përgjithësi i harmonizuar me acquis të BE-së dhe standardet ndërkombëtare, zbatimi i tij mbetet i dobët.<sup>272</sup>

**250.** Mekanizmat institucionalë të themeluar sipas Ligjit Nr. 06/L-084 përfshijnë Komitetin Ndërmintor për të Drejtat e Fëmijës pranë Zyrës së Kryeministrit, si dhe struktura koordinuese në nivel qendror dhe lokal. Save the Children Kosova thekson se vonesat në formimin e Kuvendit dhe të Qeverisë së Kosovës (QeK) përbënë një pengesë të rëndësishme për angazhimin institucional lidhur me të drejtat e fëmijëve dhe pjesëmarrjen e tyre gjatë vitit 2025.<sup>273</sup> Pavarësisht paqëndrueshmërisë institucionale, dy zhvillime kryesore institucionale u iniciuan deri në një masë. Këto paraqiten në paragrafët në vijim.

**251.** Zhvillimi i parë i rëndësishëm lidhur me sistemin e mbrojtjes së fëmijëve dhe mbrojtjes sociale në Kosovë gjatë vitit 2025 është vlerësimi ex-post i Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës. Gjetjet e këtij vlerësimi mbeten ende për t'u publikuar, sipas Save the Children Kosova, e cila ka marrë pjesë në grupin punues dhe ka kontribuar me të dhëna dhe rekomandime.<sup>274</sup> Nga ana tjetër, Ligji Nr. 08/L-255 për Shërbimet Sociale dhe Familjare, i miratuar në vitin 2024, mbetet vetëm pjesërisht i zbatuar deri më sot, me vetëm gjashtë udhëzime administrative të miratuara. Save the Children Kosova aktualisht po e mbështet hartimin edhe të gjashtë udhëzimeve të tjera, prej të cilave tre janë ende në formë drafti.<sup>275</sup>

**252.** Zhvillimi i dytë i rëndësishëm në nivel institucional lidhet me procesin e hartimit të Strategjisë së re për të Drejtat e Fëmijës (2026–2031) nga Zyra për Qeverisje të Mirë pranë Zyrës së Kryeministrit (ZQM), së bashku me Planin e saj të Veprimit (2026–2028). Save the Children Kosova thekson se ka pasur përfshirje që në fazat shumë të hershme të procesit të hartimit, përfshirë konsultimet me grupe të udhëhequra nga fëmijët, gjatë të cilave fëmijët i kanë artikulluar shqetësimet dhe prioritetet kryesore lidhur me mirëqenien, pjesëmarrjen dhe mbrojtjen e tyre. Kjo qasje përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt integritit më sistematik të pjesëmarrjes së fëmijëve në proceset kombëtare të vendimmarrjes.

**253.** Sa i përket forcimit të strukturave për pjesëmarrjen e fëmijëve, Save the Children Kosova publikoi një Manual për Funkcionimin e Kuvendeve Komunale të Udhëhequra nga Fëmijët (shih gjithashtu seksionin më sipër mbi të drejtën për tubim).<sup>276</sup> Manuali është i rëndësishëm, ndër të tjera, sepse bazohet në më shumë se një dekadë përvojë në mbështetjen e pjesëmarrjes së fëmijëve në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile dhe komunat. Ai shërben njëkohësisht për dy qëllime: së pari, si një burim praktik për komunat, shkollat dhe aktorët e tjerë lokalë për ta forcuar përfshirjen e fëmijëve në vendimmarrjen lokale; dhe së dyti, si udhëzues për komunat që synojnë të krijojnë struktura të tilla.

**254.** Në vitin 2025, zbatimi i Politikës për Mbrojtjen e Fëmijës në arsimin parauniversitar u forcua përmes masave të synuara të ngritjes së kapaciteteve. Save the Children në Kosovë (SCIK), në partneritet me "Syri i Visionit", mbështeti 35 pika fokale të caktuara për mbrojtjen e fëmijëve përmes një trajnimit të akredituar prej 36 orësh, të miratuar nga Ministria e Arsimit, duke i rritur kapacitetet e tyre për identifikimin, parandalimin dhe reagimin ndaj shkeljeve të të drejtave të fëmijëve. Secili pjesëmarrës e ka hartuar një plan veprimi në nivel shkolle për ta lehtësuar zbatimin e politikës. Paralelisht, u mbajtën takime koordinuese në tetë komuna ndërmjet drejtorëve të shkollave, Qen-

273 Save the Children Kosova (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

274 Save the Children Kosova (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

275 Save the Children Kosova (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

276 Save the Children Kosova (2025), [Manuali për funksionimin e komunave të udhëhequra nga fëmijët](#).

drave për Punë Sociale dhe policisë, duke i angazhuar mbi 200 pjesëmarrës dhe duke e forcuar bashkëpunimin ndërinstytucional dhe mekanizmat e llogaridhënies brenda sistemit të mbrojtjes së fëmijëve.<sup>277</sup>

**255.** Gjithashtu e rëndësishme në aspektin e mbrojtjes sociale është rritja prej 50 për qind e shtesave mujore për fëmijë, e shpallur nga Qeveria e Kosovës (QeK) në nëntor 2025. Masa u prezantua në kuadër të paketës buxhetore të shtetit për vitin 2026, e miratuar në tetor 2025, dhe u paraqit si përpjekje për forcimin e mbrojtjes sociale dhe rritjen e mbështetjes për familjet, veçanërisht ato me të ardhura të ulëta.

**256.** Pavarësisht këtyre përpjekjeve në vitin 2025, OJQ KOMF e thekson vazhdimësinë e mangësive strukturore që e dëmtojnë mbrojtjen e fëmijës në fusha të ndryshme, përfshirë shërbimet sociale, shëndetësinë dhe arsimin. Kjo vlen veçanërisht në nivel komunal. Para zgjedhjeve për kryetarë komunash, KOMF vuri në dukje se Qendrat për Punë Sociale mbeten të mbingarkuara në mënyrë kritike, me një zyrtar që në komuna të mëdha trajton rreth 350 raste aktive në vit. Për më tepër, infrastruktura e qasshme për fëmijët me aftësi të kufizuara mungon në më shumë se gjysmën e Qendrave për Punë Sociale.<sup>278</sup>

**257.** Ngjashëm, në sektorin e shëndetësisë, treguesit e ushqyerjes me gji dhe imunizimit mbeten të ulët, sipas KOMF, me vetëm 32 për qind të të porsalindurve që ushqehen me gji brenda orës së parë të lindjes dhe vetëm 29 për qind e foshnjave nën gjashtë muaj që ushqehen ekskluzivisht me gji. Për më tepër, deri në vitin 2025, mbulimi me imunizim nuk është rikthyer ende në nivelet para pandemisë.<sup>279</sup> Këto gjetje duhet të shihen gjithashtu në kontekstin e barrierave sociale dhe strukturore, përfshirë stigmat e vazhdueshme rreth ushqyerjes me gji, mbështetjen e kufizuar në vendin e punës dhe sfidat në realizimin praktik të të drejtave të punës që lidhen me pushimet për ushqyerje me gji sipas Ligjit të Punës të Kosovës.<sup>280</sup>

**258.** Në vitin 2025, qasja në shërbimet shëndetësore për fëmijët me aftësi të kufizuara mbetet e kufizuar ndjeshëm, sipas OJQ HANDIKOS. Mangësitë e vazhdueshme në mbulimin me sigurime shëndetësore, disponueshmëria e kufizuar e shërbimeve të specializuara dhe vështirësitë në qasjen ndaj barnave esenciale vazhdojnë ta dëmtojnë ofrimin e kujdesit adekuat. Këto barrierat sistematike vendosin një barrë disproporcionale mbi familjet, disa prej të cilave kërkojnë trajtim jashtë vendit për shkak të mungesës së shërbimeve gjithëpërfshirëse dhe të qasshme brenda Kosovës.<sup>281</sup>

**259.** Në arsimin në fëmijëri të hershme, vetëm 15 për qind e fëmijëve të moshës 3–4 vjeç janë të regjistruar në programe parashkollore. Barrierat në qasje vazhdojnë për fëmijët e marginalizuar dhe fëmijët me aftësi të kufizuara (shih gjithashtu seksionin më sipër mbi të drejtën për arsim). Nga 1,044 institucione arsimore, vetëm 609 janë fizikisht të qasshme për fëmijët me aftësi të kufizuara. Numri i asistentëve mbështetës në klasa mbetet i pamjaftueshëm, duke i detyruar disa

277 Save the Children Kosova (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

278 Gazeta Express (2025), [KOMF u drejton propozime kandidatëve për kryetarë komunash për mbrojtjen e fëmijëve](#).

279 Gazeta Express (2025), [KOMF u drejton propozime kandidatëve për kryetarë komunash për mbrojtjen e fëmijëve](#).

280 RrGK (2022), [Diskriminimi me bazë gjinore dhe puna në Kosovë](#).

281 HANDIKOS (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

familje ta financojnë privatisht ndihmën shtesë.<sup>282</sup>

**260.** Raportimet për abuzim ndaj fëmijëve, përfshirë dhunën seksuale dhe dhunën ndaj femijeve brenda familjeve, vazhduan të regjistrohen dhe të hetohen nga Policia e Kosovës gjatë vitit 2025. Pas referimit, rastet vlerësohen nga Qendrat për Punë Sociale dhe shqyrtohen përmes Tryezës për Menaxhimin e Rasteve (CMR). Sistemi CMR, i mbështetur dhe i fuqizuar nga OJQ Terre des Hommes, synon ta përmirësojë koordinimin ndërinstucional dhe cilësinë e shërbimeve.<sup>283</sup>

**261.** Në maj të vitit 2025, një mësuese e klasës së parë në një shkollë private në Prishtinë e inçizoi një nxënës gjastëvjeçar në mënyrë të dyshuar seksualisht degraduese duke e përdorur telefonin e saj celular dhe ua transmetoi pamjet prindërve të fëmijës, të cilët më pas e raportuan çështjen në polici. U nisën procedurat penale dhe e dyshuara u lirua në pritje të hetimeve të mëtejshme sipas kushteve të rregullta procedurale.<sup>284</sup>

**262.** Për më tepër, gjetjet nga një anketë e OJQ BIRN në vitin 2025 tregojnë mbrojtje të pamjaftueshme të të drejtave të fëmijëve në sferën digjitale. Mungesa e aplikacioneve të kontrollit prindëror, së bashku me përmbajtjen e dëmshme online, i ekspozojnë fëmijët ndaj situatave të cënueshme dhe rreziqeve të prekshme. Në dhjetor 2025, një vajzë 13-vjeçare në Istog pësoi lëndime gjatë një "Superman Challenge", një trend vetëlëndimi që ka çuar në dëmtimin e fëmijëve të moshës shkollore. Përveç kësaj, fëmijët po ekspozohen gjithnjë e më shumë ndaj përmbajtjes së dëmshme në hapësirën digjitale, si bullizmi, përdorimi i gjuhës së papërshtatshme dhe imazhet e papërshtatshme. Si rezultat, aktorët e shoqërisë civile bëjnë thirrje për edukim më të fokusuar mbi sigurinë digjitale dhe potencialisht për sisteme të kontrollit prindëror të mbikëqyrura nga shteti në Kosovë.<sup>285</sup>

**263.** Fëmijët nga komunitetet romë, ashkali dhe egjiptiane mbeten të pozicionuar në mënyrë strukturore në margjinat e sferës socio-ekonomike dhe kulturore të Kosovës. Ndërsa shkalla e pjesëmarrjes në shkollim në nivel kombëtar i afrohet universalitetit, trajektorët arsimore brenda këtyre komuniteteve tregojnë një model të theksuar të braktisjes në nivelet e njëpasnjëshme të arsimit: vijueshmëria bie nga 84 për qind në arsimin fillor në 63 për qind në arsimin e mesëm, dhe bie ndjeshëm në 31 për qind në arsimin e lartë. Përtej arsimit, fëmijët nga këto komunitete vazhdojnë të përballen me diskriminim sistemik në fusha kyçe të jetës shoqërore, përfshirë arsimin, kujdesin shëndetësor dhe qasjen eventuale në mundësitë e punësimit më vonë në jetë.<sup>286</sup>

**264.** Mospagesa e shtesave për fëmijë ndaj anëtarëve të komuniteteve jo-shumicë është shfaqur si një shqetësim i rëndësishëm, duke e nxitur një letër rekomandimi zyrtare nga Institucioni i Avokatit të Popullit. Rreth 400 familje, me më shumë se 800 fëmijë, janë prekur nga kjo praktikë administrative arbitrare. Familjeve u është kërkuar të paraqiten në Agjencinë e Statistikave për t'u regjistruar, një kërkesë që Avokati i Popullit e ka vlerësuar si të pajustificuar në rekomandimin e tij. Për më tepër, familjeve u është kërkuar të dorëzojnë dokumente të ndryshme, përfshirë dëshmi të vijueshmërisë në shkollë, të dhëna për vaksinim dhe të dhëna të tjera personale. Është me rëndësi të theksohet se këto shifra nuk e përfaqësojnë numrin e plotë të individëve të prekur, por vetëm

282 Gazeta Express (2025), [KOMF u drejton propozime kandidatëve për kryetarë komunash për mbrojtjen e fëmijëve](#).

283 Terre des Hommes (TdH) (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

284 Sinjali (2025), Ekskluzive: [Skandal në shkollën ISP në lagjen Marigona – mësuesja incizon nxënësin 6-vjeçar duke prekur organin gjental](#).

285 BIRN (2025), [Kënd lojërash digjital: udhëzimi prindëror online ende nuk është normë në Kosovë](#).

286 UNICEF (2025), [Vlerësimi i efektivitetit të masave për mbrojtjen e fëmijëve viktimë ose dëshmitarë të dhunës](#).

ata që e kanë raportuar zyrtarisht problemin.<sup>287</sup>

**265.** Përveç diskriminimit të thelluar strukturor dhe përjashtimit nga pjesëmarrja në jetën shoqërore, fenomeni kulturor i martesave të hershme në komunitetet romë, ashkali dhe egjiptiane e kufizon zhvillimin shoqëror të fëmijëve. Në këtë drejtim, një raport i publikuar në qershor 2025 nga Zyra për Qeverisje të Mirë (ZQM), në bashkëpunim me OJQ Voice of Roma, Ashkali and Egyptians (VoRAE), OJQ Terre des hommes dhe HEKS/EPER, ka ofruar të dhënat më të fundit empirike mbi martesat e hershme. I titulluar *Anketa Kombëtare mbi Martesat e Hershme në komunitetet romë, ashkali dhe egjiptiane në Kosovë*, studimi ka anketuar 196 të mitur (13–18 vjeç) dhe 178 të rritur (18–40 vjeç) në 19 komuna, me qëllim të vlerësimit të shtrirjes dhe karakteristikave të praktikave joformale të martesave të hershme. Gjetjet e konfirmojnë vazhdimësinë e martesave të hershme pavarësisht ndalimit të tyre të qartë sipas ligjit të Kosovës dhe, në mënyrë thelbësore, e theksojnë natyrën e paregjistruar të këtyre bashkimeve. Si rezultat, ato i privojnë institucionet nga një kuptim i plotë i shtrirjes së fenomenit dhe nga mekanizmat e duhur të zbatimit për parandalimin e martesave të hershme.<sup>288</sup>

### 266. Rekomandimet

- Qeveria e Kosovës (QeK) duhet ta finalizojë dhe ta miratojë Strategjinë për të Drejtat e Fëmijës (2026–2031) dhe Planin e saj të Veprimit (2026–2028) deri në mesin e vitit 2026, si dhe të publikojë raporte vjetore të progresit me tregues të matshëm për zbatimin e saj;
- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve duhet ta rrisë numrin e stafit në Qendrat për Punë Sociale për të percaktuar një ngarkesë maksimale të rasteve për çdo zyrtar dhe të ndajë buxhet për infrastrukturë të qasshme për fëmijët me aftësi të kufizuara në të gjitha komunat;
- Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) duhet ta sigurojë mbrojtjen e fëmijëve në mjediset arsimore duke vendosur protokolle të detyrueshme të raportimit për abuzim, duke kryer inspektime të rregullta në shkollat publike dhe private, si dhe duke e futur edukimin për sigurinë digjitale në të gjitha shkollat fillore.

## 7.3 Të drejtat e të rinjve

**267.** Kushtetuta e Kosovës nuk i njeh në mënyrë eksplicite të rinjtë si kategori të veçantë mbajtëse të të drejtave, duke iu referuar vetëm të drejtës për të votuar në moshën 18 vjeç në zgjedhjet lokale dhe kombëtare. Megjithatë, në gusht 2024, hyri në fuqi Ligji Nr. 08/L-264 për Rininë, i cili krijon një kornizë formale ndërinstucionale dhe ndërsektoriale me qëllim të vendosjes së të rinjve në qendër të prioritetëve shtetërore. Ligji themelon Komisionin Shtetëror për Rininë, të kryesuar nga Kryeministri dhe të krijuar me vendim të Qeverisë, si mekanizmi më i lartë koordinues për zbatimin e politikave rinore. Komisioni ka mandat të mblidhet dy herë në vit për t'i percaktuar fushat prioritare, për të propozuar grupe punuese ndërsektoriale, për t'i koordinuar institucionet relevante dhe

287 ACDC (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

288 TdH (2025), [Anketë kombëtare për martesat e hershme në komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë](#).

për të raportuar mbi zbatimin e politikave rinore, përfshirë mbikëqyrjen e Strategjisë Shtetërore për Rininë dhe planeve të saj vjetore, me pjesëmarrjen e Këshillit Qendror Rinor në rol këshillimor, avokues dhe monitorues.

**268.** Njëkohësisht, Strategjia për Rininë 2024–2032 e angazhon Qeverinë për fuqizimin e të rinjve dhe integrimin e tyre në një shoqëri gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme. Ligji gjithashtu e formalizon më tej Këshillin Qendror Rinor si një platformë për bashkëpunim ndërmjet institucioneve qendrore, këshillave lokale, organizatave rinore dhe grupeve joformale të të rinjve.

**269.** Në Ditën Ndërkombëtare të Rinisë 2025, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe UNICEF Kosova bashkëorganizuan një tryezë të rrumbullakët me fokus fuqizimin e të rinjve, duke i theksuar reformat përfshirë këshillat rinorë dhe Ligjin e ri për Rininë si pjesë e agjendës institucionale për pjesëmarrjen e të rinjve. Të rinj aktivistë dhe përfaqësues institucionalë diskutuan rëndësinë e krijimit të mekanizmave përmes të cilëve të rinjtë mund të ndikojnë në politika dhe vendimmarrje. Pavarësisht strukturave politike ekzistuese, përfshirja kuptimplotë e të rinjve në vendimmarrje mbeti e kufizuar në shumë procese komunale dhe kombëtare gjatë vitit 2025, me shumë të rinj që e raportojnë atë si një angazhim më shumë konsultativ sesa vendimmarrës.<sup>289</sup>

**270.** Në raportin e prillit 2025 *Emigrimi dhe tregu i punës në Kosovë: Potenciali i pashfrytëzuar i fuqisë punëtore joaktive*, OJQ GAP Instituti thekson të rinjtë si një pikë qendrore të krizës në zhvillim të tregut të punës në Kosovë. Ndërsa emigrimi në shkallë të gjerë po e zbraz fuqinë punëtore aktive, grupi i të rinjve brenda vendit mbetet në mënyrë strukturale i nënpunësuar. Nga rreth 1.1 milion individë në moshë pune, 57 për qind (613,000) janë ekonomikisht joaktivë, dhe ndër ta janë 78,000 të rinj të klasifikuar si NEET (jo në arsim, punësim apo trajnim), që përbëjnë 30 për qind të të rinjve, norma më e lartë në Ballkanin Perëndimor dhe dukshëm mbi mesataren e BE-së prej 9.9 për qind. Raporti i GAP-it vë në dukje se të rinjtë janë njëkohësisht në rrezik më të lartë emigrimi dhe një rezervë pune e brendshme e paintegruar, përjashtimi i së cilës, nëse nuk adresohet, do t'i thellojë mungesat në tregun e punës.<sup>290</sup> Fleta e të dhënave për Kosovën 2025 (Kosovo Fact Sheet 2025) vëren se papunësia e të rinjve ka mbetur e lartë në 19.5 për qind, me një pjesë të konsiderueshme të vendeve të punës të pasigurta dhe informale, duke kontribuar më tej në pasigurinë ekonomike të të rinjve dhe duke i kufizuar mundësitë për punë të qëndrueshme.<sup>291</sup>

**271.** Në vazhdim të raportit të GAP-it, papunësia e të rinjve në Kosovë mbetet strukturalisht e lartë në vitin 2025, pavarësisht zbatimit të skemës së subvencionimit të pagave të Qeverisë "SuperPuna", e lansuar në shkurt 2023 dhe më pas e zgjeruar për të rinjtë deri në moshën 29 vjeç. Deklaratat e Qeverisë tregojnë se mbi 9,300 të rinj kanë përfituar nga "SuperPuna", ndërsa deri në dhjetor 2025 janë regjistruar 448 vende aktive të punës.<sup>292</sup> Në vitin 2025, mbrojtja sociale në Kosovë vazhdoi të luajë një rol kritik në mbështetjen e familjeve dhe të rinjve, por boshllëqet strukturore vazhduan të ndikojnë në sigurinë socio-ekonomike të të rinjve, veçanërisht atyre që po kalojnë në jetesë të pavarur në moshën madhore.<sup>293</sup>

289 Kosovo Young Lawyers (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

290 GAP (2025), [Emigrimi dhe tregu i punës në Kosovë: potenciali i pashfrytëzuar i fuqisë punëtore joaktive](#).

291 Kosovo Young Lawyers (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

292 Kosovo 2.0 (2025), [Superpuna: Qysh po shkon?](#)

293 Kosovo Young Lawyers (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

**272.** Në kuadër të projektit “Fuqizimi i të Rinjve për Punësim Gjithëpërfshirës”, OJQ Terre des Hommes (TdH) Kosovë realizoi një hartëzim dhe vlerësim të nevojave mbi përfshirjen ekonomike të të rinjve të cenusshëm në Komunën e Prizrenit në vitin 2025. Raporti analizon barrierat strukturore për punësim ndër të rinjtë e cenusshëm dhe përfshin kontribut të drejtpërdrejtë nga të rinjtë për t’i identifikuar fushat prioritare të ndërhyrjes. Ndërsa vlerësimi fokusohet kryesisht në përfshirjen ekonomike, faktorët më të gjerë kontekstualë mbeten gjithashtu relevantë.<sup>294</sup>

**273.** Në Kosovë, cenusshmëria e të rinjve vazhdon të ndërthuret me elemente stresuese psikosociale të lidhura me trashëgimitë e paskonfliktit dhe efektet socio-ekonomike të periudhës së COVID-19, sipas OJQ TdH në vitin 2025. Edhe pse shkalla e përgjithshme e vetëvrasjeve në Kosovë mbetet relativisht e ulët krahasuar me rajone të tjera, evidencat në dispozicion tregojnë shqetësime të vazhdueshme lidhur me shëndetin mendor të adoleshentëve, përfshirë rritjen e raportimeve për ankth, depresion dhe mendime vetëvrasëse. Këta faktorë strukturorë dhe psikosocialë e përforcojnë nevojën për politika të integruara të punësimit që e adresojnë si aktivizimin ekonomik, ashtu edhe mirëqenien e të rinjve.<sup>295</sup> Për më tepër, qasja në shërbime formale të fokusuara tek të rinjtë mbetet e kufizuar, veçanërisht jashtë qendrave urbane të Kosovës. Sistemi shëndetësor i Kosovës në përgjithësi vazhdoi të përballet me kufizime në përmbushjen e nevojave për shëndetin mendor të të rinjve, ndërsa gjatë periudhës raportuese nuk ishte zbatuar asnjë strategji gjithëpërfshirëse kombëtare për shëndetin mendor të të rinjve.<sup>296</sup>

**274.** Në vitin 2025, plani operacional pranveror i Policisë së Kosovës përfshinte veprime taktike për identifikimin e fëmijëve dhe të rinjve në situata rruge si viktima potenciale të trafikimit ose shfrytëzimit, përfshirë shtrirjen në terren dhe inspektime të përbashkëta të lokaleve me autoritetet e tjera. Reagimet e shoqërisë civile në vitin 2025 përfshinë ankesa formale nga organizata për të drejtat e njeriut, të cilat kërkuan opinione nga Institucioni i Avokatit të Popullit dhe UNICEF-i lidhur me sjelljen e policisë në incidente që përfshijnë të rinjtë, duke ngritur shqetësime për mbrojtjen e privatësisë dhe dinjitetit të të rinjve.<sup>297</sup>

**275.** Vlerësimi i gatishmërisë identifikoi aspekte pozitive të sistemit, si kriteret e gjera të përshatshmërisë dhe kornizat e qarta procedurale për shpërndarjen e përfitimeve. Megjithatë, ai gjithashtu konkludoi se mbulimi mbetet i kufizuar në raport me popullsinë në nevojë dhe se politikat ekzistuese mund të mos i arrijnë plotësisht të rinjtë që kalojnë nga kujdesi i varur ose ata që nuk mbulojnë nga përfitimet e bazuara në familje.<sup>298</sup>

**276.** I njëjti vlerësim i gatishmërisë i UNICEF-it për vitin 2025 gjeti se, ndonëse ekzistojnë skema të mëdha të transferimeve sociale, mekanizmat e koordinimit ndërmjet programeve (p.sh. SAS dhe CAS) dhe reagimi emergjent mbeten të pazhvilluara, duke mundësuar ulje të efektivitetit gjatë goditjeve dhe periudhave të stresit socio-ekonomik. Kjo i prek drejtpërdrejt të rinjtë e rritur kur e humbasin mbështetjen familjare ose përballen me papunësi apo situata krize. Raporti gjithashtu

294 Terre des Hommes (TdH) Kosovë (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

295 Terre des Hommes (TdH) Kosovë (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

296 Kosovo Young Lawyers (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

297 Kosovo Young Lawyers (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

298 Kosovo Young Lawyers (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

theksoi se kriteret kufizuese të pranueshmërisë dhe përfitimet me normë fikse kontribuojnë në ndikim të kufizuar në uljen e varfërisë dhe në sigurinë ekonomike të të rinjve, veçanërisht në rastet kur familjet me të rinj përballen me cenueshmëri shumëdimensionale (p.sh. familje të mëdha ose ato në zona rurale).<sup>299</sup>

**277.** Për më tepër, në vitin 2025, Institucioni i Avokatit të Popullit ka lëshuar rekomandime lidhur me pezullimin e pagesave të shtesave për fëmijë për disa përfitues për shkak të procedurave të verifikimit të dokumentacionit, duke vënë në dukje parregullsi administrative që kanë shkaktuar vonesa ose qasje të pabarabartë në përfitime. Gjatë gjithë vitit 2025, skema e shtesave për fëmijë raportohet se nuk është rikthyer pas pezullimit të saj në shtator 2024, me pasoja të vazhdueshme për grupet e cenueshme. Informacionet e disponueshme tregojnë se komunitetet jo-shumicë, veçanërisht banorët serb-K, rom-K dhe goran-K në komunat veriore, mbeten të ndikuara në mënyrë disproporcionale.<sup>300</sup> Këto shqetësime u reflektuan në një tryezë të rumbullakët të mbajtur më 12 qershor 2025, e organizuar nga OJQ ACDC dhe e mbajtur me pjesëmarrjen e Agjencisë së Statistikave të Kosovës, Institucionit të Avokatit të Popullit dhe anëtarëve të komuniteteve të prekura.<sup>301</sup>

**278.** Së fundi, boshllëqet e paadresuara në dizajnin dhe zbatimin e mbrojtjes sociale, përfshirë kufizimet e mbulimit, barrierat e përshtatshmërisë dhe reagimin e paqëndrueshëm ndaj goditjeve, e rrisin cenueshmërinë socio-ekonomike të të rinjve, veçanërisht atyre që kanë dalë nga arsimi formal ose janë të papunë. Këto boshllëqe e kufizojnë qasjen e të rinjve në të ardhura të qëndrueshme, shërbime shëndetësore dhe arsimore dhe e rrisin rrezikun e varfërisë dhe marginalizimit.<sup>302</sup>

### 279. Rekomandimet

- Komisioni Shtetëror për Rininë duhet të operacionalizohet përmes të paktën dy seancave formale në vit dhe përmes përfshirjes së përfaqësimit rinor në proceset e vendimmarrjes;
- Ministria e Shëndetësisë (MSH) duhet të zhvillojë një program kombëtar për shëndetin mendor të të rinjve, i cili përfshin krijimin e shërbimeve të qasshme të bazuara në komunitet në të gjitha komunat;
- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve duhet të sigurojë qasje të barabartë dhe të pandërprerë në përfitimet sociale për fëmijë dhe të rinj duke i eliminuar barrierat administrative dhe duke i rikthyer pagesat e pezulluara të shtesave për fëmijë, përfshirë në komunitetet jo-shumicë.

299 Kosovo Young Lawyers (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

300 ACDC (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

301 Kosovo Young Lawyers (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

302 Kosovo Young Lawyers (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

## 7.4 Të drejtat e personave me aftësi të kufizuara

**280.** Mbrojtja e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në Kosovë është e kornizuar brenda një sistemi më të gjerë instrumentesh ndërkombëtare dhe rajonale të të drejtave të njeriut. Në nivel ndërkombëtar, Konventa e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (CRPD) përcakton standarde gjithëpërfshirëse mbi dinjitetin, autonominë, mosdiskriminimin dhe pjesëmarrjen e plotë; megjithatë, CRPD-ja nuk është inkorporuar në nenin 22 të Kushtetutës si instrument ndërkombëtar i të drejtave të njeriut me zbatim të drejtpërdrejtë. Detyrime të tjera detyruese burojnë nga Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (PNDCP), i cili e ndalon diskriminimin (neni 2), e garanton barazinë para ligjit (neni 26) dhe e mbron pjesëmarrjen politike pa diskriminim, përfshirë në bazë të aftësisë së kufizuar (neni 25), si dhe nga Konventa për të Drejtat e Fëmijës (CRC), neni 23 i së cilës njeh të drejtën e fëmijëve me aftësi të kufizuara për një jetë të plotë dhe dinjitoze dhe kërkon që shtetet të ofrojnë kujdes dhe ndihmë të veçantë. Në nivel rajonal, ndonëse Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) nuk i referohet shprehimisht aftësisë së kufizuar, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) ka interpretuar dispozita si neni 14 (mosdiskriminimi), neni 5 (liria dhe siguria), neni 8 (jeta private dhe familjare) dhe neni 3 (ndalimi i trajtimit çnjerëzor ose degradues) në mënyrë që të përfshijnë mbrojtje të lidhura me aftësinë e kufizuar. Karta Sociale Evropiane (e Rishikuar), në nenin 15, garanton shprehimisht të drejtat e personave me aftësi të kufizuara për pavarësi, integrim shoqëror dhe pjesëmarrje në jetën e komunitetit.

**281.** Në nivel vendor, korniza kushtetuese dhe legjislative e Kosovës i pasqyron këto standarde, por i mungon harmonizimi i qartë dhe sistematik. Neni 22 i Kushtetutës inkorporon disa instrumente ndërkombëtare të të drejtave të njeriut si ligj drejtpërdrejt të zbatueshëm; megjithatë, CRPD-ja nuk është përfshirë ndër to. Në rastin KO 207/22, Gjykata Kushtetuese e Kosovës në mënyrë unanime konstatoi se amendamenti i propozuar kushtetues për të shtuar CRPD-në në nenin 22 ishte në përputhje me Kapitujt II dhe III të Kushtetutës dhe nuk i zvogëlonte të drejtat themelore ekzistuese, duke i theksuar parimet e Konventës për dinjitetin, autonominë, mosdiskriminimin dhe detyrimet pozitive. Megjithatë, Kuvendi i Kosovës dështoi në tetor 2023 t'i sigurojë votat e nevojshme për ndryshimin e Kushtetutës dhe, pavarësisht vlerësimit pozitiv të Gjykatës, nuk u ndërmor asnjë përpjekje e re në vitin 2025.<sup>303</sup> Paralelisht me këtë boshllëk kushtetues, të drejtat e personave me aftësi të kufizuara rregullohen përmes legjislacionit sektorial, duke e përfshirë Ligjin Nr. 2003/23 për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuara; Ligjin Nr. 03/L-022 për Mbështetjen Materiale për Familjet e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara të Përhershme; Ligjin Nr. 05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave me Paraplegji dhe Tetraplegji; si dhe Ligjin Nr. 04/L-092 për Personat e Verbër, të cilat së bashku ofrojnë një bazë ligjore të fragmentuar, por funksionale për mbrojtjen e personave me aftësi të kufizuara.

**282.** Në nivel politikash, një Strategji e re për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (2025–2030) është miratuar në vitin 2025 së bashku me Planin e saj të Veprimit (2025–2027). Strategjia parasheh tre objektiva strategjike kryesore, të cilat përfshijnë: (1) përmirësimin e cilësisë dhe

efektivitetit të shërbimeve sociale, (2) avancimin e arsimit gjithëpërfshirës dhe mundësive për zhvillim profesional, dhe (3) përmirësimin e qasjes në infrastrukturë. E harmonizuar me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim 2030, mbetet të vlerësohet se si këto objektiva do të realizohen gjatë periudhës pesëvjeçare që ajo parasheh.<sup>304</sup>

**283.** Në vitin 2025, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve e miratoi Rregulloren Nr. 01/2025 për Funksonimin e Komisionit Mjekësor-Social, e cila sjell ndryshime strukturore në sistemin e njohjes së statusit të aftësisë së kufizuar. Ndryshimi më i rëndësishëm është eliminimi i rivlerësimit periodik të detyrueshëm për personat e verbër. Më parë, personat me dëmtim të përhershëm dhe të pakthyeshëm të shikimit duhej t'i nënshtroheshin rivlerësimeve të përsëritura mjekësore për ta ruajtur statusin e tyre ligjor dhe qasjen në përfitime. Në rregulloren e re, kjo kërkesë është hequr, duke iu përgjigjur më në fund avokimit të kahershëm të organizatave të shoqërisë civile, të cilat argumentonin se rivlerësimi ishte i panevojshëm nga ana mjekësore dhe ngarkues për përfituesit.<sup>305</sup>

**284.** Paralelisht me këtë, procedurat për personat me paraplegji dhe tetraplegji janë modernizuar, duke e përfshirë edhe futjen e mekanizmave elektronikë të aplikimit, çka shënon një hap drejt digjitalizimit të proceseve të vlerësimit të aftësisë së kufizuar. Nëse kjo reformë do ta përmirësojë konsistencën dhe do ta përshpejtojë qasjen në përfitime, do të varet nga zbatimi dhe mbikëqyrja e saj. Megjithatë, në letër, kjo përbën një nga përmirësimet procedurale më substanciale të miratuara në vitin 2025 në fushën e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.

**285.** Një vëzhgim veçanërisht i rëndësishëm është ngritur nga OJQ HANDIKOS, e cila raportoi se paqëndrueshmëria institucionale gjatë vitit 2025, e përkeqësuar nga periudhat e njëpasnjëshme zgjedhore, ka ndërprerë ndjeshëm komunikimin me akterët kryesorë qeveritarë. Sipas HANDIKOS-it, tranzicioni i zgjatur politik dhe ndryshimet në përgjegjësitë administrative kanë kufizuar angazhimin e qëndrueshëm me ministritë dhe vendimmarrësit përgjegjës për zbatimin e politikave për aftësinë e kufizuar. Kjo paqëndrueshmëri thuhet se ka ndikuar në proceset e konsultimit, ka vonuar koordinimin për iniciativat strategjike dhe ka dobësuar ndjekjen e angazhimeve të mbetura pezull.<sup>306</sup>

**286.** Sfidat lidhur me qasjen e barabartë të personave me aftësi të kufizuara vazhduan gjatë periudhave zgjedhore.<sup>307</sup> Një rast veçanërisht i rëndësishëm lidhur me mohimin e së drejtës së votës për një person me sindromën Down u evidentua gjatë zgjedhjeve lokale të nëntorit 2025. Më 9 nëntor 2025, drejtori i OJQ-së Down Syndrome Kosova shprehu shqetësime se disa persona me aftësi të kufizuara ishin penguar ta ushtrojnë të drejtën e tyre për të votuar gjatë zgjedhjeve lokale. Në një rast konkret të raportuar në një vendvotim në lagjen Ulpiana (shkolla "Hasan Prishtina"), një person me sindromën Down u privua nga e drejta për të votuar, pavarësisht se kishte marrë pjesë më parë në zgjedhjet nacionale më 9 shkurt 2024 dhe në zgjedhjet lokale më 12 tetor 2025, si dhe posedonte zotësi juridike. Sipas deklaratës, mohimi është bazuar në zbatimin e një "udhëzuesi zyrtar për votuesit që kërkojnë asistencë" të hartuar rishtazi (nëntor 2025).<sup>308</sup>

304 ZQM – Zyra e Kryeministrit (2025), [Strategjia për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara 2025–2030](#).

305 Indeks Online (2025), [Miratohet rregullorja që eliminon procedurën e rivlerësimit për personat e verbër](#).

306 HANDIKOS (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

307 HANDIKOS (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

308 KQZ (2025), [Votimi me asistencë](#).

**287.** Situata në Kosovë mbetet veçanërisht e vështirë për personat me aftësi të kufizuara, të cilët vazhdojnë të përbëjnë një nga grupet më të varfra dhe më të marginalizuara në shoqëri.<sup>309</sup> Veçanërisht, numri i përfituesve të pensioneve të aftësisë së kufizuar të lidhura me punën u ul me 26.8 për qind në shtator 2025 krahasuar me shtatorin e 2024, duke përfaqësuar një rënie të konsiderueshme brenda një viti të vetëm. Në të njëjtën kohë, megjithatë, u regjistruan rritje në skema të tjera të lidhura me aftësinë e kufizuar, përfshirë pensionet për personat me paraplegji dhe tetraplegji (+9.0 për qind), mbështetjen financiare për familjet me fëmijë me aftësi të kufizuara (+8.5 për qind), pensionet e përgjithshme për aftësinë e kufizuar (+4.0 për qind) dhe kompensimin për personat e verbër (+1.9 për qind).<sup>310</sup>

**288.** Pas Ditës Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara në dhjetor 2025, një sërë intervistash dhe fushatash ndërgjegjësuere u transmetuan në televizion dhe u shpërndanë në rrjetet sociale, duke përfshirë diskutime mbi punësimin gjithëpërfshirës të personave me aftësi të kufizuara në Kosovë.<sup>311</sup> Diskutimet theksuan kushtet e mangëta të punësimit në Kosovë, të cilat e kufizojnë qasjen e personave me aftësi të kufizuara për të marrë pjesë në mënyrë domethënëse në tregun e punës. OJQ HANDIKOS konfirmon se legjislacioni shpesh injorohet në mënyrë sistematike, ndërsa lehtësimi institucional si për punëdhënësit ashtu edhe për punëmarrësit mbetet veçanërisht i vështirë. Pengesat kryesore të identifikuar përfshijnë mungesën e mjaftueshme të monitorimit dhe sanksioneve, nivelin e ulët të ndërgjegjësimit institucional në sektorin publik dhe privat, si dhe stigmën e vazhdueshme shoqërore, ku që të gjitha kontribuojnë në përjashtimin e një numri të madh të personave me aftësi të kufizuara nga punësimi kuptimplotë.<sup>312</sup> Kjo vlen veçanërisht për gratë me aftësi të kufizuara në Kosovë, të cilat përballen me barriera shtesë si për shkak të aftësisë së kufizuar ashtu edhe të paragjyqimeve gjinore.<sup>313</sup>

**289.** Përveç përjashtimit sistematik nga mundësitë e punësimit, personat me aftësi të kufizuara mbeten të integruar në mënyrë të pamjaftueshme në sistemin arsimor. Vetëm 12 për qind e fëmijëve me aftësi të kufizuara në moshë shkollë, rreth 5,300 nga një vlerësim prej 43,000 fëmijësh, janë të regjistruar në shkollë, duke e vendosur Kosovën dukshëm nën standardet ndërkombëtare për arsimin gjithëpërfshirës. Siç është theksuar më lart në pjesën për të drejtën në arsim, situata është edhe më e rënduar për fëmijët e shurdhër në veçanti. Sipas studimit më të fundit të Këshillit të Evropës (2023), pothuajse 100 për qind e fëmijëve të shurdhër në Kosovë nuk zotërojnë shkathtësi bazike të shkrim-leximit. Edhe pse një dokument konceptual për Gjuhën e Shenjave është hartuar në bashkëpunim me Zyrën e Kryeministrit për Qeverisje të Mirë në kuadër të Strategjisë për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2025–2030, ai mbetet ende në fazë konceptuale.<sup>314</sup>

**290.** Përveç sektorit të arsimit, hulumtimet e mëparshme kanë treguar se mbulimi dhe cilësia e shërbimeve shëndetësore specifike për aftësinë e kufizuar të ofruara nga institucionet publike nuk janë përmirësuar në shkallë të gjerë në vitet e fundit, duke u shoqëruar me kapacitete të dobëta

309 Prishtina Insight (2025), [Përtej fjalimeve boshe: Kosova mbetet prapa standardeve në integrimin e personave me aftësi të kufizuara.](#)

310 Gazeta Blic (2025), [Rënie dramatike e pensioneve invalidore në Kosovë, 26.8% më pak përfitues.](#)

311 Klan Kosova (2025), [Punësimi, sfida kryesore e personave me aftësi të kufizuar.](#)

312 Katrori info (2025), [Sa po respektohet e drejta për punësim për personat me aftësi të kufizuar?](#)

313 UN Kosovo (2025), [social media post.](#)

314 Prishtina Insight (2025), [Përtej fjalimeve boshe: Kosova mbetet prapa standardeve në integrimin e personave me aftësi të kufizuara.](#)

profesionale të personelit mjekësor në punën me personat me aftësi të kufizuara, si dhe me diagnoza të shpeshta të gabuara të aftësive të kufizuara fizike dhe intelektuale.<sup>315</sup>

**291.** Në vitin 2025, një 13-vjeçar e sulmoi rëndë një person me aftësi të kufizuara mendore në Ferizaj, duke ngritur shqetësime serioze lidhur me sigurinë, mbrojtjen dhe më gjerësisht me sigurinë shoqërore të personave me aftësi të kufizuara në Kosovë.<sup>316</sup> Ky nuk është një incident i izoluar, por një model i përsëritur i dhunës ndaj këtij individi.

## **292. Rekomandimet**

- Kuvendi i Kosovës (KiK) duhet ta riinicojë dhe ta miratojë amendamentin kushtetues për inkorporimin e Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (CRPD) në nenin 22 deri në fund të vitit 2026;
- Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) duhet të sigurojë arsim gjithëpërfshirës duke e rritur regjistrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, duke e miratuar gjuhën e shenjave si gjuhë mësimi dhe duke publikuar të dhëna vjetore mbi pjesëmarrjen në shkolla dhe në shërbimet mbështetëse;
- Qeveria e Kosovës (QeK) duhet të sigurojë qasje të barabartë në votim për personat me aftësi të kufizuara duke i rishikuar udhëzimet për asistencë për votuesit, duke e trajnuar stafin e vendvotimeve dhe duke i dokumentuar e duke i raportuar publikisht të gjitha ankesat për mohimin e të drejtës së votës.

## **7.5 Të drejtat e komuniteteve jo-shumicë**

**293.** Kosova ka institucione të mirëvendosura në nivel qendror dhe komunal, si dhe një kornizë të përshtatshme legjislativë, për t'i garantuar të drejtat e komuniteteve jo-shumicë. Kushtetuta e Kosovës në nenin 3.1 (Barazia para Ligjit) përcakton se Kosova "është një shoqëri shumëetnike e përbërë nga komuniteti shqiptar dhe komunitetet e tjera". Komunitetet jo-shumicë të Kosovës përfshijnë komunitetin serb, turk, rom, ashkali, egjiptian, boshnjak dhe goran, si dhe komunitete të tjera.

**294.** Përveç Kushtetutës, të drejtat e komuniteteve jo-shumicë garantohen edhe në Ligjin Nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Anëtarëve të Tyre në Kosovë. Në këtë ligj, "diversiteti kombëtar, etnik dhe fetar" i Kosovës përkufizohet si "një burim force dhe pasurie për zhvillimin e mëtejshëm të një shoqërie demokratike". Në këtë kuptim, ligji përcakton masa të veçanta që mund ta sigurojnë zbatimin e statusit të barabartë dhe integrimin e komuniteteve dhe anëtarëve të tyre në shoqërinë e Kosovës. Për më tepër, në Ligjin Nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve (Ligji për Gjuhët), si gjuha shqipe ashtu edhe gjuha serbe e kanë statusin e gjuhëve zyrtare.

**295.** Në nivel komunal, gjuha e çdo komuniteti jo-shumicë e ka statusin e gjuhës në përdorim zyrtar nëse një komunë banohet nga një komunitet, gjuha amtare e të cilit nuk është gjuhë zyrtare dhe

315 Fondi Global për Aftësinë e Kufizuar (2024), [Analizë situatash mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në Kosovë](#).  
316 Klan Kosova (2025), [13 vjeçari rrah brutalisht personin me aftësi të kufizuara](#).

i cili përbën të paktën 3 për qind të popullsisë së përgjithshme të komunës përkatëse. Përdorimi zyrtar i gjuhës turke dhe rome në Komunën e Prizrenit është një rast ilustrativ i zbatimit të këtij ligji në praktikë. E njëjta gjë vlen edhe për gjuhën rome në Graçanicë.

**296.** Mekanizmat institucionalë të ngarkuar me mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve jo-shumicë në Kosovë përfshihen pjesërisht në Këshillin Konsultativ për Komunitete të Zyrës së Presidentit të Kosovës, Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim, si dhe në Institucionin e Avokatit të Popullit dhe Ministrinë për Komunitete dhe Kthim. Këshilli Konsultativ për Komunitete e lidh boshllëkun ndërmjet institucioneve publike të Kosovës dhe komuniteteve. Roli i tij qendror është t'i artikulojë pikëpamjet e komuniteteve lidhur me legjislacionin, politikat dhe programet relevante për komunitetet jo-shumicë, të garantojë funksionimin efektiv të organizatave përfaqësuese të komuniteteve dhe t'u ofrojë komuniteteve mundësinë për të marrë pjesë në nisma ligjore dhe politike.

**297.** Në vitin 2025, procesi i hartimit të Strategjisë së re për Përfshirjen e Komuniteteve rom dhe ashkali 2027–2031, së bashku me Planin e Veprimit 2027–2029, u iniciua zyrtarisht në bashkëpunim me Zyrën për Qeverisje të Mirë (ZQM) në kuadër të Zyrës së Kryeministrit. Në kuadër të këtij procesi, OJQ Voice of Roma, Ashkali and Egyptians (VoRAE) luajti një rol substancial duke e mbështetur dizajnimin dhe zbatimin e fazës së parë të hartimit. Në dhjetor 2025, OJQ VoRAE dhe ZQM bashkëorganizuan një punëtori gjithëpërfshirëse konsultative për ta vlerësuar zbatimin e strategjisë ekzistuese dhe për t'i përcaktuar prioritetet për kornizën e ardhshme. Punëtorja mbledhi përfaqësues të institucioneve qendrore, shoqërisë civile dhe ekspertë tematikë, duke u fokusuar në pesë fusha kyçe të përfshirjes socio-ekonomike: arsimin, punësimin, strehimin, shëndetin dhe mbrojtjen nga diskriminimi. Konsultimet identifikuan boshllëqe strukturore në kornizën aktuale, përfshirë mungesën e indikatorëve të matshëm, koordinimin e dobët ndërinstitucional dhe barrierat e vazhdueshme në qasjen në shërbime publike.<sup>317</sup>

**298.** Si në periudhat e mëparshme raportuese, zbatimi i Ligjit Nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve vazhdon të ngrejë shqetësime strukturore, veçanërisht në mjediset institucionale dhe në domenin gjyqësor. Një raport i publikuar në korrik 2025 nga OJQ IKD me titull "Efikasiteti gjyqësor në praktikë dhe të drejtat gjuhësore në sistemin gjyqësor" analizoi 226 seanca të zhvilluara gjatë një periudhe shtatëmujore në Departamentin e Posaçëm të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe në degën e Gjykatës Themelore në Graçanicë. Siç është theksuar tashmë në pjesën për të drejtën në një proces të drejtë gjyqësor dhe mjete efektive juridike, gjetjet tregojnë se mangësitë gjuhësore ndikojnë ndjeshëm në efikasitetin procedural dhe barazinë para ligjit. Disa seanca janë shtyrë për shkak të mungesës ose vonesës në përkthimin e dosjeve të lëndëve, duke konfirmuar se zbatimi i pamjaftueshëm i gjuhëve ndikon drejtpërdrejt në afatet gjyqësore dhe e minon qasjen efektive në drejtësi. Përtej shtyrjeve, raporti identifikon dobësi të vazhdueshme në cilësinë e përkthimeve në gjuhën serbe, të rrënjësura në mungesa afatgjata në arsim dhe kapacitetet institucionale, duke ngritur shqetësime lidhur me sigurinë juridike dhe garancitë për gjykim të drejtë.<sup>318</sup>

317 VoRAE (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

318 IKD (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

**299.** Pas përfundimit të procesit të emërimit të noterëve në maj 2025, të dhënat e Ministrisë së Drejtësisë tregojnë se aktualisht ka 137 noterë aktivë në Kosovë, të shpërndarë në 38 komuna. Megjithatë, përfaqësimi i komuniteteve jo-shumicë mbetet jashtëzakonisht i kufizuar. Nga numri i përgjithshëm i noterëve, vetëm një noter i përket komunitetit serb. Ky noter është emëruar gjatë fazës fillestare të krijimit të sistemit noterial dhe ushtron detyrën në komunën e Novobërdës. Analiza e OJQ ACDC tregon se në komunat me shumicë serbe-K, shërbimet noteriale ofrohen kryesisht nga anëtarë të komunitetit shqiptar-K, shpesh me ofrim të kufizuar të shërbimeve në gjuhën serbe.<sup>319</sup>

**300.** Në sektorin e policisë, stafi joshqiptar përbën 55 për qind të personelit, nga të cilët 35 për qind janë serbë-K. Megjithatë, shqetësimet vazhdojnë lidhur me nivelin e përfshirjes, pasi stafi serb, ndonëse i pranishëm në fuqinë punëtore, mbetet i nën-përfaqësuar në rolet vendimmarrëse dhe kryesisht i përjashtuar nga zinxhiri komandues. Veçanërisht, pozita e Komandantit të Rajonit Verior të Policisë mbetet e paplotësuar.<sup>320</sup>

**301.** Këto mangësi sistemike përkeqësohen nga një boshllëk i rëndësishëm institucional: gjatë pjesës më të madhe të vitit 2025, Qeveria dështoi të emërojë një Komisioner për Gjuhët.<sup>321</sup> Mungesa e një Komisioneri aktiv krijoi një vakum zbatimi brenda Zyrës së mandatuar për mbikëqyrjen e përputhshmërisë me Ligjin Nr. 02/L-37. Meqë mandati i Komisionerit kishte skaduar, aftësia e Zyrës për t'iu përgjigjur shkeljeve, për të nxjerrë rekomandime detyruese dhe për të kryer mbikëqyrje sistematike u kufizua në mënyrë materiale. Në praktikë, kombinimi i mangësive në nivel gjyqësor dhe dobësimit të kapaciteteve mbikëqyrëse e thelloi më tej boshllëkun e zbatimit, duke i bërë garancitë formale gjuhësore gjithnjë e më të brishta në praktikë.<sup>322</sup>

**302.** Gjetjet nga sondazhi publik i OJQ CASA-s me komunitetin serb tregojnë se pengesa më e përmendur për qasjen në shërbimet në nivel lokal është barriera gjuhësore, e identifikuar si shqetësimi kryesor nga 35.4 për qind e të anketuarve. Kjo pasqyron mospërputhje të vazhdueshme në zbatimin e garancisë kushtetuese të gjuhës serbe si gjuhë zyrtare, si dhe mangësi në zbatimin e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve. Ndërsa këto mangësi janë të dukshme në të gjitha institucionet, ato raportohen si më pak të theksuara në komunat me shumicë serbe sesa në nivel qendror. Pengesa e dytë më e përmendur, diskriminimi ose favorizimi (29.1 për qind), është dukshëm më e theksuar tek të anketuarit në veri të Kosovës (41.2 për qind krahasuar me 19.8 për qind në zonat e tjera), duke sugjeruar se marginalizimi politik dhe institucional, më shumë sesa vetëm gjuha, perceptohet në veri si barriera kryesore për qasje të barabartë në shërbime.<sup>323</sup> Në nivel qendror, të anketuarit raportojnë një efekt të kombinuar të barrierave strukturore, përfshirë diskriminimin, pengesat gjuhësore, mungesën e informacionit, kompleksitetin burokratik, korrupsionin dhe distancën gjeografike. Diskriminimi del si barriera primare më e përmendur në mostrën e përgjithshme (35.9 për qind), duke i nënvizuar perceptimet e vazhdueshme për trajtim të pabarabartë në ndërveprimet me institucionet shtetërore dhe duke e theksuar nevojën për forcim të llogaridhënies institucionale dhe zbatim efektiv të masave mbrojtëse kundër diskriminimit.

319 ACDC (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

320 ACDC (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

321 AKTIV (2025), [Raport mbi përdorimin e gjuhëve në Kosovë: zbatimi i ligjit në institucione.](#)

322 CASA (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

323 CASA (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

**303.** Në vitin 2025, mjedisi i sigurisë në veri të Kosovës vazhdoi të karakterizohej nga rritja e kontestimeve me ndikim të drejtpërdrejtë në marrëdhëniet ndëretnike, mosbesimin dhe peizazhin e përditshëm të qeverisjes në zonat me shumicë serbe. OJQ NSI vëren se gjatë vitit, Policia e Kosovës dhe autoritete të tjera të Kosovës, sipas raportimeve, ndërmorën një sërë ndërhyrjesh operacionale që kishin në shënjestër struktura dhe shërbime të drejtuara nga Serbia ose të lidhura me Serbinë. Këto veprime përfshinin hyrje të raportuara në zyra, urdhra për largimin e stafit nga vendet e punës, konfiskimin e dokumenteve dhe materialeve, si dhe vulosjen ose mbylljen e objekteve, duke prekur entitete si zyrat e administratës tatimore, zyrat e sigurimeve, qendrat e mirëqenies sociale, Shërbimin Kombëtar të Punësimit, ndërmarrjet publike serbe, institucionet sportive dhe rinore, si dhe Bibliotekën e Qytetit “Vuk Karadžić”.<sup>324</sup>

**304.** Mbyllje të ngjashme janë raportuar nga OJQ NSI se kanë ndodhur gjatë gjithë vitit. Ata raportojnë se më 15 janar 2025, rreth 35 institucione të drejtuara nga Serbia në jug të lbrit u hynë dhe u mbyllën, duke përfshirë organe të përkohshme komunale, zyra komunale, qendra të mirëqenies sociale dhe degë të “Pošta” (Postës). Këto mbyllje mund të kenë efekte të thella në të drejtat socio-ekonomike të banorëve. Veprime shtesë të raportuara vazhduan deri në maj 2025, duke përfshirë ndërhyrje në objektet e ujësjellësit, salla sportive (përfshirë gjatë stërvitjeve të fëmijëve) dhe Kryqin e Kuq të Kosovës, duke kulmuar më vonë gjatë vitit me marrjen/mbylljen e raportuar të objekteve të lidhura me “Službeni glasnik” në shtator 2025.<sup>325</sup>

**305.** Të dhënat e sondazhit të mbledhura në vitin 2025 tregojnë se anëtarët e komunitetit serb në veri të Kosovës e identifikojnë rikthimin e përfaqësimit etnik brenda Policisë së Kosovës në nivel komunal si një prioritet të rëndësishëm të sigurisë. Disbalanca aktuale pasoi dorëheqjen kolektive të zyrtarëve policorë serb dhe përfaqësuesve të tjerë institucionalë në nëntor 2022, një tërheqje e koordinuar politikisht e lidhur me mosmarrëveshjet rreth targave dhe me themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Pengesa ligjore e ndërlikon rikthimin e mundshëm, veçanërisht Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2023, i cili ndalon kthimin e zyrtarëve që kanë dhënë dorëheqje vullnetare; megjithatë, duke qenë se dorëheqjet kanë ndodhur para këtij Udhëzimi dhe mund të jenë bërë nën presion politik, zbatueshmëria e tij strikte mbetet e diskutueshme nga ana juridike. Çdo rikthim do të kërkonte përputhje me legjislacionin ekzistues, përfshirë verifikimet e sigurisë, duke i adresuar njëkohësisht shqetësimet lidhur me ndikimin politik. Neni 128 i Kushtetutës përcakton se përbërja etnike e policisë komunale duhet të pasqyrojë demografinë lokale, por zbatimi i tij mbetet i kufizuar nga tensionet më të gjera Kosovë–Serbi.<sup>326</sup>

**306.** Zhvillime paralele kanë ndikuar më tej në perceptimet e komuniteteve lidhur me sigurinë dhe qasjen institucionale. Që nga viti 2022, institucionet e Kosovës kanë ndërmarrë masa për mbylljen e institucioneve të administruara nga Serbia në të gjithë territorin, me të paktën 59 entitete të raportuara si të mbyllura deri në vitin 2025. Sondazhet e realizuara tek komuniteti serb tregojnë mbështetje të fortë, rreth tre të katërtat e të anketuarve, për rikthimin në institucionet e lëshuara në vitin 2022, përfshirë policinë, administratat komunale dhe organet gjyqësore. Në këtë kontekst, propozimet për rikthimin e besimit theksojnë një qasje hibride që e kombinon kthimin vullnetar të zyrtarëve të verifikuar, rekrutimin e synuar të komuniteteve jo-shumicë dhe forcimin e mbikëqyrjes dhe garancive për të drejtat e njeriut, së bashku me reforma më të gjera të qeverisjes së nevojshme për një polici të qëndrueshme dhe shumëetnike.<sup>327</sup>

**307.** Anëtarët e komunitetit serb dhe grupeve të tjera jo-shumicë vazhdojnë të përballen me barriera strukturore në qasjen në dokumentacion personal, gjë që e kufizon ndjeshëm aftësinë e tyre për të ushtruar

324 NSI (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

325 NSI (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

326 CASA (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

327 CASA (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

të drejta themelore dhe për të pasur qasje në shërbime publike, përfshirë ndihmën sociale, pensionet, regjistrimin e pronës, regjistrimin e martesës, shërbimet bankare dhe lirinë e lëvizjes. Këto sfida lidhen pjesërisht me zbatimin e paqëndrueshëm të marrëveshjeve të arritura në kuadër të dialogut të lehtësuar nga BE-ja, veçanërisht sa i përket njohjes së dokumenteve dhe vendimeve gjyqësore të lëshuara në Serbi. Ndërsa një vendim i Ministrisë së Punëve të Brendshme i nëntorit 2024 lejoi përkohësisht individët e regjistruar në regjistrat civilë serbë të aplikojnë për regjistrimin e të dhënave të lindjes, martesës dhe vdekjes në regjistrin qendror civil të Kosovës gjatë periudhës shkurt–prill 2025, kjo masë nuk krijoi një zgjidhje të qëndrueshme afatgjatë. Siç është theksuar në një vlerësim të BE-së, mosnjohja nga Kosova e pasaportave të lëshuara nga Qendra Koordinuese e Serbisë vazhdon të pengojë disa persona të zhvendosur të pajisen me letërnjoftime të përkohshme dhe ta regjistrojnë statusin e tyre civil. Praktikrat e paqëndrueshme ndërmjet zyrave të gjendjes civile, udhëzimet e kufizuara institucionale dhe trajtimi i raportuar diskriminues e dobësojnë më tej qasjen e barabartë në dokumentacion, duke e theksuar nevojën për procedura administrative të harmonizuara, zbatim të plotë të marrëveshjeve teknike dhe forcim të garancive kundër diskriminimit për të siguruar qasje efektive në identitet juridik dhe gëzim të barabartë të të drejtave.<sup>328</sup>

**308.** Për më tepër, sa i përket komunitetit serb, një sondazh i fundit i OJQ CASA thekson se problemet me qasjen në dokumentacion ua kufizojnë aftësinë për të udhëtuar<sup>329</sup> (44.7 për qind në veri dhe 32.5 për qind në jug); qasjen në pensione dhe ndihma sociale (36.8 për qind në veri dhe 27.8 për qind në jug); kufizon mundësitë e punësimit (32.9 për qind në veri dhe 36.4 për qind në jug); kufizon fillimin e një biznesi privat (22.4 për qind në veri dhe 25.8 për qind në jug); ndikon në aftësinë për të marrë kredi bankare dhe hipoteka (23.7 për qind në veri dhe 28.5 për qind në jug); si dhe ndikon në të drejtat pronësore (24.3 për qind në veri dhe 16.6 për qind në jug).<sup>330</sup> Faktorët e pafavorshëm të sigurisë, ata ekonomikë, politikë dhe të tjerë kanë bërë që 25.3 për qind e të anketuarve të planifikojnë të largohen përgjithmonë nga Kosova në tre vitet e ardhshme. Për më tepër, gjetjet e hulumtimit tregojnë se më shumë se një e treta e të anketuarve (34.5 për qind) janë të pasigurt nëse do të largohen nga Kosova në tre vitet e ardhshme, ndërsa 40.1 për qind e të anketuarve deklarojnë qartë se nuk planifikojnë të largohen nga Kosova.<sup>331</sup>

**309.** Sigurimi i përfshirjes së komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në administratën publike përmes kuotave të punësimit mbetet një masë thelbësore për avancimin e barazisë, përfaqësimit të drejtë dhe llogaridhënies institucionale. Zbatimi efektiv i këtyre kuotave është thelbësor për të garantuar që perspektivat dhe nevojat e këtyre komuniteteve të reflektohen në vendimmarrjen publike dhe në ofrimin e shërbimeve. Në vitin 2025, OJQ VoRAE ndërmoi një sërë aktivitetesh të synuara për ta mbështetur zbatimin e kuotave, përfshirë hartimin e Planit të Punës së Ekipit Ndërinstitucional për Punësim (Zyra e Kryeministrit), si dhe organizimin e tryezave të rrumbullakëta dhe prezantimeve të një databaze për punësimin e komuniteteve jo-shumicë në nivel qendror dhe komunal. Këto aktivitete mblodhën përfaqësues të institucioneve qendrore dhe lokale, organizatave partnere dhe anëtarë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Nisma u fokusua në mbledhjen sistematike, përditësimin dhe analizën e të dhënave mbi punësimin e këtyre komuniteteve, duke i forcuar kështu mekanizmat e monitorimit, transparencës dhe raportimit. Duke i identifikuar boshllëqet dhe duke e ndjekur progresin, databaza shërben si një mjet institucional për avancimin e barazisë në shërbimin civil. Përmbushja e kuotave të punësimit me pjesëmarrje konkrete të individëve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian është e domosdoshme për të siguruar që politikat e përfshirjes të tejkalojnë detyrimet formale ligjore dhe të përkthehen në përfaqësim dhe diversitet të matshëm brenda institucioneve publike.<sup>332</sup>

328 CASA (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

329 CASA (2025), [Raport politikash: qasja e serbëve të Kosovës në dokumentacion dhe identitet ligjor](#).

330 CASA (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

331 VoRAE (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

332 VoRAE (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

**310.** Në vitin 2025, Platforma Kombëtare për Raportimin e Diskriminimit vazhdoi të funksionojë si një mekanizëm formal për dokumentimin dhe adresimin e rasteve të trajtimit të pabarabartë dhe antigjipsizmit që i prekin komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Deri në dhjetor 2025, gjithsej 69 raste janë raportuar përmes platformës, duke përfshirë 20 paraqitje nga individë rom-K, 14 nga ashkali-K dhe 9 nga anëtarë egjiptian-K, ndërsa 23 raste nuk e specifikuan përkatësinë etnike dhe 3 u klasifikuan si “të tjera”. Nga rastet e raportuara, 35 u vlerësuan se nuk përbëjnë diskriminim pas shqyrtimit institucional, 33 përfunduan me një vendim apo konstatim formal, ndërsa 9 mbetën në shqyrtim pranë autoriteteve kompetente. Këto shifra tregojnë se platforma është funksionale dhe po përdoret në mënyrë aktive; megjithatë, sfida mbeten në forcimin e mekanizmave të mbrojtjes, rrugëve të referimit dhe përmbylljes procedurale, me qëllim të rritjes së efikasitetit institucional dhe besimit publik në mekanizmat kundër diskriminimit.<sup>333</sup>

**311.** Në vitin 2025, projekt-ndryshimet në Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi hynë në fazën e konsultimeve paraprake publike, pas vendimit të Qeverisë së Kosovës në vitin 2024 për ta nisur rishikimin, bazuar në një vlerësim ex-post që identifikoi efektivitet të kufizuar dhe boshllëqe në zbatim. Procesi i reformës synon ta forcojë zbatueshmërinë dhe ta harmonizojë më tej kornizën ligjore me standardet evropiane. Pas përfundimit të konsultimeve dhe formimit të një Qeverie të re në vitin 2026, grupi punues pritet të mblidhet sërish për t’i shqyrtuar dhe harmonizuar komentet e paraqitura, përpara se projektligji i rishikuar t’i dërgohet Qeverisë për miratim dhe më pas Kuvendit për shqyrtim parlamentar dhe votim përfundimtar. Veçanërisht, OJQ VoRAE kontribuoi në procesin e konsultimit duke e angazhuar një ekspert të jashtëm për t’i mbledhur dhe konsoliduar kontributet nga shoqëria civile dhe komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.<sup>334</sup>

**312.** Në kontekstin e forcimit të mbrojtjes kundër diskriminimit dhe avancimit të të drejtave të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, OJQ VoRAE ka hartuar një Manual për Antigjipsizmin si një mjet praktik udhëzues për institucionet publike në Republikën e Kosovës. Manuali synon t’i forcojë kapacitetet e nëpunësve civilë dhe zyrtarëve publikë në nivel qendror dhe lokal për ta identifikuar, parandaluar, adresuar dhe raportuar antigjipsizmin si një formë specifike e diskriminimit racor. Manuali ofron udhëzime të qarta dhe praktike për përdorim në punën e përditshme institucionale, veçanërisht në situata kur mund të ndodhë trajtim diskriminues në ofrimin e shërbimeve publike, komunikimin institucional ose proceset e vendimmarrjes. Ai gjithashtu i përcakton procedurat e reagimit institucional, mekanizmat e raportimit dhe kornizën ligjore përkatëse, përfshirë organet kompetente dhe kanalet zyrtare për adresimin e rasteve të diskriminimit në Kosovë. Për ta mbështetur zbatimin e tij, janë organizuar një sërë tryezash të diskutimit me zyrtarë publikë në nivel qendror dhe komunal. Këto shërbyen si platforma për prezantimin e Manualit, sqarimin e roleve dhe përgjegjësisë institucionale, si dhe shkëmbimin e përvojave praktike lidhur me trajtimin e rasteve të diskriminimit. Në përgjithësi, Manuali dhe aktivitetet shoqëruese përbëjnë një ndërhyrje të strukturuar që e synon forcimin e kapaciteteve institucionale për luftimin e diskriminimit racor dhe përforcimin e parimeve të barazisë dhe mosdiskriminimit në ofrimin e shërbimeve publike.<sup>335</sup>

333 VoRAE (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

334 VoRAE (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

335 VoRAE (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

**313.** Adresimi i antigjipsizmit dhe forcimi i ndërgjegjësimit ligjor brenda komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian mbeti një prioritet qendror i angazhimit të shoqërisë civile në vitin 2025. Në këtë kontekst, OJQ VoRAE organizoi 60 sesione informuese mbi antigjipsizmin dhe të drejtat kundër diskriminimit, duke arritur më shumë se 1,200 pjesëmarrës në komuna të ndryshme.<sup>336</sup>

**314.** Dhuna ndaj anëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian vazhdoi të shfaqet edhe gjatë vitit 2025, duke ngritur shqetësime jo vetëm për diskriminimin, por edhe për mekanizmat e reagimit institucional. Më 20 tetor 2025, u raportua një sulm fizik pranë SHMU "Yll Morina" në Gjakovë, ku një i ri nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian u sulmua. Një rrjet OJQ-sh e dënoi publikisht incidentin, duke e denoncuar si dhunën ashtu edhe dimensionin e saj diskriminues. Sipas prindërve të viktimës, u ngritën shqetësime për neglizhencë të mundshme institucionale nga Policia e Kosovës, përfshirë dështimin e pretenduar për të zhvilluar një hetim të plotë dhe për të verifikuar incizimet e disponueshme të kamerave të sigurisë. Prindi gjithashtu shprehu shqetësim lidhur me trajtimin mjekësor të ofruar, duke deklaruar se fëmija vazhdonte të përjetonte dhimbje dhe shqetësim psikologjik pas sulmit.

**315.** Dhuna me motiv etnik ndaj anëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian mbeti një shqetësim serioz për të drejtat e njeriut gjatë vitit 2025. Më 9 qershor 2025, një anëtar i komunitetit rom (M.M.) u sulmua brutalisht dhe në mënyrë çnjerëzore në Prizren, teksa po shkonte në punë për të siguruar jetesën e familjes së tij. Sulmi, i raportuar si i motivuar etnikisht, nënvizon vazhdueshëm vulnerabilitetin e individëve rom-K në hapësirat publike. Më 17 qershor 2025, një rrjet OJQ-sh, përfshirë VoRAE dhe organizata lokale të komunitetit në Prizren, reagoi publikisht ndaj incidentit, duke e sjellë rastin në vëmendjen e mediave dhe institucioneve dhe duke bërë thirrje për një reagim institucional efektiv ndaj dhunës me bazë etnike.<sup>337</sup>

**316.** Diskriminimi vazhdoi të ngrejë shqetësime serioze në Kosovë gjatë vitit 2025, veçanërisht kur fëmijët dhe adoleshentët nga komunitetet jo-shumicë janë objektivi i saj. Më 23 prill 2025, një rrjet organizatash të shoqërisë civile reagoi ndaj një incidenti gjatë një ndeshjeje futbollit U15 ndërmjet SHF Arsenalit dhe SHF Fushë Kosova, ku një familjar i një lojtari hyri në fushë dhe sulmoi verbalisht dhe fizikisht një të mitur (B.J.), anëtar i komunitetit ashkali. Reagimi theksoi nevojën urgjente për mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve nga diskriminimi dhe dhuna në mjediset sportive dhe bëri thirrje për masa parandaluese institucionale për të siguruar llogaridhënie dhe pjesëmarrje të sigurt në sportet e të rinjve.<sup>338</sup>

**317.** Gjuha e urrejtjes dhe intoleranca ndëretnike ndaj komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian vazhduan të shfaqen në hapësirën publike të Kosovës gjatë vitit 2025. Më 17 mars 2025, një rrjet organizatash të shoqërisë civile (përfshirë VoRAE dhe OJQ partnere) reagoi publikisht ndaj një interviste të publikuar në YouTube nga Robert Berisha, në të cilën u përdorën terma pezhorativë dhe ofendues ndaj komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Sipas raportimeve të mediave lokale, reagimi synonte ta adresonte normalizimin e gjuhës diskriminuese në hapësirën publike dhe të kërkonte llogaridhënie për përdorimin e gjuhës së urrejtjes.<sup>339</sup>

336 VoRAE (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

337 VoRAE (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

338 VoRAE (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

339 VoRAE (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

**318.** Komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në disa komuna vazhdojnë të përballen me barriera strukturore në ushtrimin e të drejtave pronësore, kryesisht për shkak të vendbanimeve informale, mungesës së regjistrimit kadastral dhe procedurave kufizuese të legalizimit. Shumë familje kanë jetuar për dekada në të njëjtën tokë, por nuk mund të sigurojnë certifikata pronësie për shkak të mungesës së dokumentacionit historik ose lejeve të ndërtimit, të cilat objektivisht nuk janë në gjendje t'i sigurojnë. Si pasojë, ato nuk mund të legalizojnë shtëpitë, të përfitojnë nga programet e rindërtimit ose të strehimit, të regjistrojnë trashëgiminë apo të marrin lidhje me shërbimet publike, duke mbetur të ekspozuara ndaj rrezikut të dëbimeve. Kjo situatë cenon të drejtën për gëzimin paqësor të pasurisë, të garantuar nga neni 46 i Kushtetutës së Kosovës dhe neni 1 i Protokollit Nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe mund të përbëjë diskriminim të tërthortë sipas Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, duke pasur parasysh ndikimin disproporcional ndaj komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian dhe efektin e tij në të drejtën për strehim adekuat.<sup>340</sup>

**319.** Gratë nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian vazhdojnë të përballen me pengesa në ushtrimin e të drejtave pronësore dhe të trashëgimisë, pavarësisht kornizës ligjore adekuate që garanton barazinë. Monitorimet tregojnë se prona shpesh regjistrohet vetëm në emër të anëtarëve burra të familjes dhe gratë shpesh heqin dorë nga trashëgimia për shkak të presionit familjar, mungesës së ndërgjegjësimit dhe barrierave administrative. Si rezultat, shumë gra mbeten ekonomikisht të varura dhe të paafta për të përfituar nga programet e strehimit, skemat e mbrojtjes sociale ose shërbimet financiare. Kjo praktikë cenon garancitë për barazi të përcaktuara në nenin 24 të Kushtetutës, Ligjin për Barazinë Gjinore dhe Ligjin për Trashëgiminë, si dhe është në kundërshtim me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, përfshirë Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe CEDAW.

**320.** OJQ Advancing Together (AT) ka dokumentuar raste në Kamenicë ku pesë familje rome të riatdhesuara janë përjashtuar nga skema e ndihmës sociale për shkak të mungesës së dokumenteve të identifikimit të Kosovës. Sipas raportimeve, gjithsej 15 familje rome në Kamenicë janë të prekura në mënyrë të ngjashme. Shumica e familjeve rome të riatdhesuara nuk janë në gjendje ta sigurojnë dokumentacionin e Kosovës për shkak të mungesës së dokumenteve përkatëse serbe të kërkuara për ta fituar shtetësinë e Kosovës. Pamundësia për t'iu qasur këtij dokumentacioni ua pamundëson këtyre familjeve qasjen në ndihmën sociale. Kjo ngre shqetësime në kuadër të garancive për barazi të përcaktuara në Kushtetutë dhe në të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, veçanërisht sa i përket ndalimit të diskriminimit dhe të drejtës për njohje para ligjit.<sup>341</sup>

**321.** Familjet rome dhe ashkali të riatdhesuara në Ferizaj dhe Obiliq vazhdojnë të përballen me pasiguri serioze në strehim. Disa familje jetojnë në banesa me qira pa garanci afatgjata, ndërsa të tjera përballen me rrezik dëbimi. OJQ Advancing Together (AT) ka dokumentuar një rast të një familjeje të detyruar të zhvendoset pas një dëbimi dhe të obliguar të paguajë një pjesë të konsiderueshme të të ardhurave për qira. Mungesa e zgjidhjeve të qëndrueshme të strehimit i vendos të riatdhesuarit në një gjendje të vazhdueshme të cenueshmërisë ekonomike dhe varësisë nga mbështetja humanitare. Mungesa e strehimit të qëndrueshëm cenon të drejtën për

340 AT (2026), input for the joint CSO report on Human Rights in Kosovo in 2025.

341 AT (2026), input for the joint CSO report on Human Rights in Kosovo in 2025.

respektimin e shtëpisë dhe jetës familjare sipas nenit 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe të drejtën për strehim adekuat sipas Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore. Gjithashtu, kjo situatë i minon politikat e riintegritit dhe ndikon në qasjen në punësim, arsim dhe shërbime sociale.<sup>342</sup>

**322.** Rasti i një familjeje rome të riatdhesuar në komunën e Gjilanit, e cila ka kërkuar leje ndërtimi për një shtëpi të financuar përmes një programi për ndihmë në strehim për kthim, ka mbetur i pazgjidhur për disa vite. Komuna ka refuzuar ta lëshojë lejen e ndërtimit duke u bazuar në një plan urbanistik që e parasheh ndërtimin e një objekti publik në atë zonë, por nuk ka iniciuar as shpronësim dhe as nuk ka ofruar zgjidhje alternative për strehim. Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës nuk e ka shqyrtuar ankesën brenda afateve ligjore të përcaktuara me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Dorëzimet e përsëritura, përfshirë kërkesat për trajtim urgjent, kanë mbetur pa përgjigje. Për shkak të mosveprimit të vazhdueshëm administrativ, OJQ Advancing Together (AT) ka paraqitur padi në emër të familjes pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, duke e kërkuar nxjerrjen e vendimit administrativ përkatës. Megjithatë, deri më tani nuk është ndërmarrë asnjë veprim procedural nga gjykata. Kjo mosveprimtari e zgjatur në praktikë e pengon familjen të ketë qasje në strehim adekuat dhe ndikon në mënyrë disproporcionale një familje rome të riatdhesuar, duke ngritur shqetësime për diskriminim të tërthortë në kundërshtim me nenin 24 të Kushtetutës dhe Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Pamundësia për të ndërtuar shtëpi në tokën e regjistruar cenon gjithashtu të drejtën për strehim adekuat sipas nenit 11 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore dhe e minon qëndrueshmërinë e procesit të kthimit.<sup>343</sup>

**323.** Në komunën e Klinës, shpronësimi i lidhur me zgjerimin e autostradës Pejë–Prishtinë prek njëmbëdhjetë familje serbe të riatdhesuara. Njoftimet zyrtare janë lëshuar vetëm në gjuhën shqipe dhe vlerësimet e pronës janë kryer pa njoftim paraprak apo pjesëmarrje të pronarëve të pronës. Disa familje jetojnë përgjithmonë jashtë Kosovës dhe nuk kanë mundur t'i marrin njoftimet brenda afatit 30-ditor të ankesës. Për më tepër, disa vlerësime të pronave raportohet se kanë përjashtuar elemente bujqësore si pemët frutore, gjë që ndikon drejtpërdrejt në nivelin e kompensimit. Mosofrimi i dokumenteve në të dyja gjuhët zyrtare cenon garancitë kushtetuese për përdorimin e gjuhëve dhe të drejtat e komuniteteve. Mungesa e njoftimit paraprak dhe e pjesëmarrjes ngre shqetësime serioze në kuadër të së drejtës për proces të drejtë dhe gëzimit paqësor të pronës të mbrojtur nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut.<sup>344</sup>

#### **324. Rekomandimet**

- Qeveria e Kosovës duhet të sigurojë zbatimin e plotë dhe të paanshëm të të drejtave gjuhësore, siç përcaktohet në Ligjin Nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve, duke alokuar burime të mjaftueshme për shërbimet e përkthimit në institucionet publike dhe duke siguruar pajtueshmëri në të gjitha komunat;
- Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës duhet të vendosë për të gjitha ankesat e pazgjidhura brenda afateve ligjore dhe të sigurojë që procedurat e shpronësimit të iniciohen pa vonesë në rastet kur lejet refuzohen, përfshirë sigurimin e

342 AT (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

343 AT (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

344 AT (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

kompensimit në përputhje me ligjin;

- Gjykata Themelore në Prishtinë duhet t’u japë prioritet rasteve të mosveprimit administrativ që prekin të drejtat themelore dhe të sigurojë shqyrtim të përshpejtuar brenda afateve të përcaktuara me ligj;
- Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP) duhet të iniciojë hetime ex officio në rastet e keqadministrimit dhe diskriminimit, përfshirë dështimet në procedurat pronësore dhe në qasjen në të drejta për grupet e cenushme;
- Ministria për Komunitete dhe Kthim dhe komunitat duhet të sigurojnë qasje në strehim dhe regjistrim civil për të riatdhesuarit dhe komunitetet e margjinalizuara, duke vendosur mbështetje emergjente për strehim, procedura të thjeshtuara dhe qasje të përkohshme në ndihmë sociale në pritje të dokumentacionit;
- Ministria e Drejtësisë (MD) duhet të sigurojë ofrimin efektiv të ndihmës juridike falas në rastet e diskriminimit, duke e rritur financimin, duke i zgjeruar kriteret e përfitimit dhe duke e monitoruar qasjen dhe rezultatet përmes raportimit publik vjetor.

## 7.6 Të drejtat e personave LGBTI+

**325.** Të drejtat e personave lezbike, gej, biseksualë, transgjitorë dhe interseks (LGBTI+) bazohen në parimet universale të barazisë dhe mosdiskriminimit të mishëruara në të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut (DUDNJ) pohon në nenet 2 dhe 7 se të gjithë personat kanë të drejtë për mbrojtje të barabartë para ligjit pa diskriminim. Në nivel traktatesh, Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (PNDCP) ofron mbrojtje të rëndësishme përmes nenit 2 (mosdiskriminimi), nenit 17 (mbrojtja e privatësisë) dhe nenit 26 (barazia para ligjit). Komiteti për të Drejtat e Njeriut i ka zbatuar këto dispozita në raste historike si Toonen kundër Australisë (1994), ku u konstatua se kriminalizimi i marrëdhënieve konsensuale mes personave të së njëjtës gjini shkel të drejtën për privatësi dhe ndalimin e diskriminimit; Young kundër Australisë (2003) dhe X kundër Kolumbisë (2007), lidhur me pensionet familjare; si dhe G kundër Australisë (2017), lidhur me njohjen ligjore të gjinisë. Sipas Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (PNDESK), Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore ka sqaruar në Komentin e Përgjithshëm nr. 20 (2009) se “statusi tjetër” përfshin orientimin seksual dhe identitetin gjinor. Ky interpretim përforcohet edhe në Komentin e Përgjithshëm nr. 14 (2000) dhe nr. 22 (2016), të cilat kërkojnë qasje të barabartë në shërbimet shëndetësore dhe në shëndetin seksual dhe riprodhues pa diskriminim. Standarde të ngjashme janë artikuluar edhe nga Komiteti për të Drejtat e Fëmijës (Komentet e Përgjithshme nr. 13, 15 dhe 20), Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave (Rekomandimet e Përgjithshme nr. 28 dhe 33), si dhe Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në kuadër të nenit 5. Këto norma detyruese plotësohen më tej nga Parimet e Jogjakartës (2006) dhe Parimet e Jogjakartës +10 (2017), të cilat ofrojnë udhëzime të detajuara për zbatimin e së drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut në lidhje me orientimin seksual dhe identitetin gjinor.

**326.** Në nivel rajonal, megjithëse Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) nuk i referohet shprehimisht orientimit seksual apo identitetit gjinor, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) ka zhvilluar një jurisprudencë të gjerë duke filluar me rastin Dudgeon kundër Mbretërisë së Bashkuar (1981), ku konstatoi se kriminalizimi i marrëdhënieve konsensuale mes personave të së njëjtës gjini është në kundërshtim me nenin 8. Që atëherë, Gjykata e ka zgjeruar mbrojtjen edhe në fusha të tjera, përfshirë njohjen ligjore të gjinisë (Christine Goodwin kundër Mbretërisë së Bashkuar, 2002; A.P., Garçon dhe Nicot kundër Francës, 2017), lirinë e tubimit (Identoba kundër Gjeorgjisë, 2015), lirinë e shprehjes (Bayev kundër Rosisë, 2017), si dhe njohjen e familjeve të së njëjtës gjini (E.B. kundër Francës, 2008; X dhe të tjerët kundër Austrisë, 2013; Pajić kundër Kroacisë, 2016; Taddeucci dhe McCall kundër Italisë, 2016). Në rastet Oliari kundër Italisë (2015) dhe Fedotova dhe të tjerët kundër Rosisë (2023), Gjykata konfirmoi se shtetet kanë detyrim të sigurojnë njohje dhe mbrojtje ligjore për çiftet e së njëjtës gjini. Ndërkohë, neni 14 i KEDNJ-së dhe Rekomandimi i Komitetit të Ministrave CM/Rec(2010)5 i forcojnë më tej detyrimet për ta luftuar diskriminimin në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor.

**327.** Neni 24 i Kushtetutës së Kosovës përmend në mënyrë specifike orientimin seksual dhe shprehjen gjinore. Kushtetuta e Kosovës nuk parasheh kufizime gjinore në të drejtën për martesë; neni 37 i saj njeht se secili ka të drejtë të martohet dhe të krijojë familje, sipas ligjit. Megjithatë, pavarësisht këtyre të drejtave kushtetuese për personat LGBTI+, legjislacioni i nevojshëm për të siguruar njohjen e këtij komuniteti në kushte të barabarta me të gjithë anëtarët e shoqërisë nuk është miratuar në draftin e ri të Kodit Civil. Kjo vjen si rezultat i dështimit të vazhdueshëm për të votuar në favor të bashkësive të të njëjtit seks në Kuvendin e Kosovës. Një situatë e tillë i ka penguar gjithashtu përpjekjet e personave LGBTI+, shoqërisë civile dhe komunitetit ndërkombëtar për të avancuar forma të mirëfillta të demokracisë në vend. Sipas OJQ CEL, shqetësimet kryesore strukturore të identifikuar gjatë periudhës raportuese 2025 e përfshijnë mungesën e vazhdueshme të një kornize ligjore për njohjen e gjinisë, mungesën e rregullimit dhe mbrojtjes specifike për personat interseks, dështimin për t'i njohur ligjërisht partneritetet e së njëjtës gjini, si dhe dobësitë e vazhdueshme në zbatimin dhe fuqizimin e mekanizmave ekzistues të mbrojtjes ligjore.<sup>345</sup>

**328.** Gjatë zgjedhjeve parlamentare të shkurtit 2025, OJQ CEL Kosova dhe OJQ Dylberizm monitoruan në mënyrë sistematike fushatat zgjedhore, me fokus të veçantë në gjuhën e urrejtjes dhe retorikën diskriminuese që i synonte komunitetet LGBTI+.<sup>346</sup> Si rezultat i këtij monitorimi, u paraqitën tetë ankesa pranë Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP). Shtatë ankesa u miratuan fillimisht, duke rezultuar në gjopa administrative në vlerë totale prej 44,100 euro. Pas ankesave të mëtejshme, Gjykata Supreme shqyrtoi katër raste dhe i rrëzoi vendimet përkatëse të PZAP-it duke u bazuar në lirinë e shprehjes. Megjithatë, tre vendime të PZAP-it u lanë plotësisht në fuqi, duke e konfirmuar ekzistencën e gjuhës së urrejtjes dhe duke mbajtur në fuqi gjopa në vlerë prej 15,000 euro. Këto vendime përfundimtare përbëjnë jurisprudencë detyruese që konfirmon se gjuha e urrejtjes ndaj komuniteteve LGBTI+ gjatë fushatave zgjedhore mund të sjellë sanksione ligjore sipas legjislacionit të Kosovës.<sup>347</sup>

**329.** Pas monitorimit të kryer nga OJQ CEL dhe OJQ Dylberizm në procese të ndryshme zgjedhore gjatë vitit 2025, janë identifikuar disa kandidatë me qëndrime publike homofobike dhe transfo-

345 CEL (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

346 Dylberizm (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

347 CEL (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

bike.<sup>348</sup> Pavarësisht listës së shoqërisë civile nga Dylberizm dhe CEL “Mos i voto homofobët!”, e cila synonte ta informonte publikun për kandidatët qëndrimet diskriminuese të të cilëve mund të përkthehen në pushtet institucional, shumë kandidatë nga parti të ndryshme politike arritën të sigurojnë ulëse në Kuvendin e Kosovës.<sup>349</sup> Mbështetja elektorale që i është dhënë këtyre individëve tregon se shoqëria vazhdon të strukturohet mbi parime homofobike dhe transfobike.<sup>350</sup>

**330.** Homofobia që qëndron në themel të sferës shoqërore në Kosovë vazhdon të përkthehet në dhunë dhe krime të urrejtjes ndaj individëve nga komunitetet LGBTI+. Si pasojë, pengesat në raportim e minojnë mbrojtjen efektive. OJQ CEL vëren se personat LGBTI+ hezitojnë ta raportojnë diskriminimin dhe dhunën për shkak të frikës nga viktimizimi dytësor dhe mungesës së besimit në institucionet për ruajtjen e konfidencialitetit. Në këtë kontekst, një rast i raportuar më herët që përfshinte torturë dhe trajtim degradues ndaj një personi LGBTI+ në vitin 2024 përfundoi në vitin 2025 me dënimin e tre autorëve me gjithsej 9.5 vite burgim. Megjithëse ky rezultat përbën një shembull të rëndësishëm të llogaridhënies, ai mbetet një rast i izoluar në krahasim me kontekstin më të gjerë të frikës dhe pasigurisë që përjetojnë personat LGBTI+ në raport me reagimin institucional.<sup>351</sup>

**331.** Mungesa e një arkitekture mbrojtëse për individët LGBTI+ ilustruhet më tej përmes mungesës së një strehe të dedikuar dhe të financuar nga shteti. Megjithëse raportet e mëhershme kanë treguar se Komuna e Prishtinës është zotuar për krijimin e një strehe të mbështetur publikisht për viktimat LGBTI+ të dhunës në familje, deri më tani nuk është arritur asnjë progres konkret<sup>352</sup> me mungesë të alokimeve buxhetore për krijimin e një strehe. Si pasojë, OJQ CEL vazhdon të ofrojë akomodim emergjent për të rriturit që nuk kanë qasje në një rrjet të sigurt mbrojtjeje sociale.<sup>353</sup>

**332.** Përgjatë dekadës së fundit, dukshmëria publike e personave LGBTI+ në Kosovë është rritur; megjithatë, kjo dukshmëri nuk është shoqëruar me mbështetje institucionale koherente dhe të qëndrueshme.<sup>354</sup> Ndërsa Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka financuar aktivitete vetëdijësuese për tre vite radhazi, këto nisma mbeten ad hoc dhe të paankoruara në një strategji gjithëpërfshirëse në nivel të Kosovës.<sup>355</sup> Angazhimi institucional duket se varet më shumë nga individët që mbajnë poste të caktuara sesa nga korniza të qëndrueshme politike të integruara në institucione. Kjo brishtësi u evidentua në vitin 2025, kur Lëvizja e Studentëve Queer tentoi ta shënojë Javën e Krenarisë duke e vendosur flamurin e Pride në rektoratin e Universitetit të Prishtinës, pavarësisht se e njëjta veprimtari ishte lejuar në vitin 2024 nën një udhëheqje universitare më mbështetëse.<sup>356</sup> Ky ndryshim i qasjes nënvizon mungesën e garancive strukturore dhe tregon se njohja simbolike mbetet e cenueshme ndaj ndryshimeve të qëndrimeve politike dhe administrative.

348 Dylberizm (2026), [Kush janë homofobët e Kuvendit të ri të Kosovës?](#)

349 Dylberizm (2025), [Mos i voto homofobët!](#)

350 CEL (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

351 CEL (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

352 Kosovo 2.0 (2025), [Të dukshëm, por jo të sigurt.](#)

353 CEL (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

354 Dylberizm (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

355 CEL (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

356 Lëvizja Studentore Queer (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

**333.** Në kontekstin e situatës së përshkruar më sipër, nismat për të drejtat e personave LGBTI+ në Universitetin e Prishtinës janë udhëhequr kryesisht nga aktorë studentorë dhe të shoqërisë civile, më shumë sesa nga politika institucionale. OJQ CEL Kosova, në bashkëpunim me Universitetin, organizoi një konferencë në ambientet universitare për prezantimin e hulumtimeve mbi çështjet LGBTI+ të realizuara nga studentët, si dhe dy ligjërata publike mbi mosdiskriminimin, përfshirjen sociale dhe të drejtat LGBTI+, në bashkëpunim me Departamentin e Sociologjisë. Paralelisht, Lëvizja e Studentëve Queer organizoi një panel diskutimi mbi përvojat e jetuara të studentëve queer, duke nxjerrë në pah se temat LGBTI+ mbeten kryesisht të kufizuara në hapësira të izoluara akademike, veçanërisht brenda Fakultetit të Filozofisë. Në fakultetet e tjera, angazhimi me këto tema është minimal, ndërsa perspektivat LGBTI+ mungojnë kryesisht në kurrikula.<sup>357</sup>

**334.** Në vazhdim të rritjes së dukshmërisë, Java e Krenarisë në Prishtinë u mbajt nga 9 deri më 14 qershor 2025 nën temën “Asnjë hap prapa”, duke shënuar edicionin e nëntë vjetor të saj. Java përfshiu një program të larmishëm, punëtori, diskutime, ekspozita arti, një shfaqje drag, dhe përfundoi me paradën e Krenarisë dhe një koncert, duke demonstruar angazhim të vazhdueshëm qytetar dhe dukshmëri për komunitetet LGBTI+ në Kosovë. Hapja zyrtare e Javës së Krenarisë u zhvillua në ndërtesën e Qeverisë së Kosovës, e organizuar nga Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Mundësitë e Barabarta dhe Kundër Diskriminimit, duke sinjalizuar njohje institucionale. Kryeministri në detyrë Albin Kurti e hapi ngjarjen.

**335.** Pavarësisht fushatave publike të organizuara nga OJQ CEL dhe OSHC të tjera, mbetet një boshllëk empirik në kuptimin e qëndrimeve shoqërore dhe përvojave të jetuara. Hulumtimi më gjithëpërfshirës kombëtar mbi pranimin shoqëror daton më shumë se një dekadë më parë, konkretisht në vitin 2015. Në mungesë të të dhënave aktuale longitudinale, është e pamundur të vlerësohet nëse rritja e dukshmërisë është përkthyer në ndryshime substanciale të qëndrimeve publike. Mungesa e të dhënave të fundit dhe të zbërthyer (disagreguara) jo vetëm që e errëson situatën reale në terren, por edhe e dobëson kapacitetin e institucioneve për të hartuar politika të bazuara në prova, të cilat synojnë uljen e diskriminimit dhe transformimin e normave shoqërore.

**336.** Një raport i fundit i OJQ ACDC mbi pozitën dhe cilësinë e jetës së komunitetit LGBTI+ në veriun e Kosovës gjen se padukshmëria, frika nga diskriminimi dhe dhuna, si dhe stigma e vazhdueshme shoqërore mbeten sfidat dominuese me të cilat përballen individët LGBTI+, veçanërisht në mjedise më të vogla dhe më konservatore.<sup>358</sup>

### **337. Rekomandimet**

- Kuvendi i Kosovës (KiK) duhet ta miratojë Kodin Civil pa vonesa të mëtejshme për ta siguruar njohjen ligjore të bashkësive të të njejtit seks dhe për të vendosur një kornizë të qartë ligjore për njohjen e gjinisë në përputhje me garancitë kushtetuese;
- Policia e Kosovës dhe Prokuroria e Shtetit duhet të sigurojnë hetim dhe ndjekje penale efektive të krimeve të urrejtjes dhe gjuhës së urrejtjes ndaj personave LGBTI+ duke i trajtuar me prioritet këto raste dhe duke publikuar të dhëna vjetore për incidentet e raportuara, ndjekjet penale dhe rezultatet e tyre;
- Qeveria e Kosovës duhet të themelojë dhe financojë një strehë të dedikuar dhe shërbime

357 Lëvizja Studentore Queer (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.  
358 ACDC (2025), [Padukshmëria, frika dhe stigma mbeten sfida kryesore për komunitetin LGBTI+ në veri të Kosovës](#).

mbështetëse për personat LGBTI+ që përballen me dhunë dhe gjendje të pastrehë, duke e përfshirë alokimin e një linje të veçantë buxhetore.

## 7.7 Personat në lëvizje

**338.** Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA) ndërmjet BE-së dhe Kosovës vendos themelet për bashkëpunimin ndërmjet BE-së dhe Kosovës në fushën e azilit, duke e synuar përafrimin me standardet e Konventës së Gjenevës të vitit 1951 për Statusin e Refugjatëve dhe Protokollit të vitit 1967. Sipas kësaj kornize, palët kanë rënë dakord ta forcojnë më tej bashkëpunimin dhe funksionalitetin e sistemit ekzistues të azilit. Kjo përfshin, ndër të tjera, miratimin dhe zbatimin e legjislacionit për t'i përmbushur standardet e Konventës për Statusin e Refugjatëve dhe Protokollit të saj, me qëllim të sigurimit të respektimit të parimit të moskthimit (non-refoulement) dhe respektimit të kërkuarve të azilit dhe refugjatëve. Palët gjithashtu do të fokusohen në bashkëpunimin në fushën e migrimit të ligjshëm, veçanërisht në rregullat e pranimit dhe në të drejtat dhe statusin e personave të pranuar, ndërsa Kosova do ta përafrojë legjislacionin e saj me acquis të BE-së në fushën e migrimit të ligjshëm.

**339.** Korniza vendore ligjore që mbulon të gjithë sektorin e azilit është vendosur. Kjo kornizë ligjore parasheh procedurat e pranimit dhe trajtimit fillestar të kërkuarve për mbrojtje ndërkombëtare; procedurat dhe standardet për shqyrtimin dhe vendimmarrjen mbi kërkesat për mbrojtje ndërkombëtare; rregullat e brendshme për funksionimin e Qendrës së Azilit; rregullat e punës së Komisionit Kombëtar për Refugjatë (KKR), si instanca e dytë administrative; si dhe Rregulloren për integrimin e të huajve, përkatësisht personave me status të mbrojtjes ndërkombëtare në Kosovë. Duke marrë parasysh ndryshimet në legjislacionin e Bashkimit Evropian për të huajt dhe nevojën për adresimin e boshllëqeve ligjore të hasura gjatë zbatimit të tij, Qeveria e Kosovës e ka hartuar Ligjin e ri për të Huajt, i cili është miratuar nga Qeveria në fillim të vitit 2024. Projektligji ishte paraparë t'i kalonte procedurat ligjore në Kuvendin e Kosovës, por për shkak të zgjedhjeve parlamentare në vitin 2025, procesi është pezulluar. Projektligji parasheh: (i) bazën ligjore për qendrën e përkohshme të pritjes për migrantë të inauguruar në gusht 2022; (ii) disa zgjedhje të reja ligjore, ndër të tjera "statusin e toleruar"; dispozita për identifikim, regjistrim dhe procedura referimi ose triazhimi që mundësojnë diferencimin në trajtimin e rasteve të azilit; si dhe (iii) forcimin e dispozitave ligjore për integrimin e personave që përfitojnë mbrojtje ndërkombëtare. Me futjen e këtyre garancive shtesë, autoritetet synojnë ta forcojnë mjedisin e përgjithshëm të mbrojtjes për të gjithë kërkuarët e azilit dhe personat nën mbrojtje ndërkombëtare. Një element tjetër i rëndësishëm është integrimi i refugjatëve dhe personave pa shtetësi si përfitues të projektligjit për Banimin Social dhe të Përbalueshëm. Ky ligj gjithashtu mbetet në pritje të miratimit. Nga ana tjetër, nuk ka pasur ndryshime legjislative në lidhje me të drejtat e fëmijëve dhe të drejtat e tjera sociale që mund t'i kenë ndikuar refugjatët.

**340.** Kosova vazhdon të jetë një rrugë tranziti për personat në lëvizje. Në vitin 2025, janë paraqitur 181 kërkesa për mbrojtje ndërkombëtare (kërkesa për azil) pranë Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migrim në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Ndiurma juridike gjatë procedurës së azilit është ofruar nga OJQ Programi për të Drejtat Civile në Kosovë (CRP/K), përmes një projekti të

financuar nga UNHCR. Shumica e kërkesave për azil janë pezulluar, pasi aplikantët kanë lëvizur më tej pa përfunduar procedurën e përcaktimit të statusit të refugjatit ose e kanë tërhequr kërkesën për mbrojtje ndërkombëtare.<sup>359</sup>

**341.** Zhvillimet në vitin 2025 ngrejne shqetësime në rritje lidhur me të drejtat dhe trajtimin e shtetasve të vendeve të treta të transferuar në Kosovë në kuadër të marrëveshjeve të jashtme për migracionin. Më 21 tetor 2025, Kryeministri në detyrë njoftoi se Kosova është e gatshme të strehojë azilkërkues të refuzuar nga Mbretëria e Bashkuar në këmbim të bashkëpunimit në fushën e sigurisë.<sup>360</sup> Më 11 dhjetor 2025 u konfirmua më tej se Kosova kishte filluar të pranonte individë në procedura deportimi nga Shtetet e Bashkuara, të cilët nuk janë me origjinë nga Kosova. Kjo pason një marrëveshje të qershorit 2025, e cila mundëson pranimin e përkohshëm të deri në 50 migrantëve në vit, me qëllim të deklaruar lehtësimin e kthimit të tyre në vendet e origjinës.<sup>361</sup>

**342.** OJQ CRP/K e ka mirëmbajtur faqen HELP <sup>362</sup>, duke ofruar informacion mbi sistemet e azilit dhe integritet në tetë gjuhë. Faqja HELP ofron informacione mbi mënyrën se si mund të kërkohet azili, ku mund të kërkohet ndihmë, si dhe perspektivat e integritet në Kosovë. Informacioni në këtë faqe është i natyrës së përgjithshme dhe mund të mos zbatohet në të gjitha rrethanat. Për ndihmë dhe këshillim shtesë, institucionet përkatëse ose UNHCR dhe OJQ CRP/K mund të kontaktohen lidhur me çështje apo nevoja specifike që mund të kenë personat në nevojë.<sup>363</sup>

**343.** Janë lëshuar gjithsej 72 vendime nga Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, nga të cilat 18 vendime ishin pozitive: 1 me status refugjati, 17 me mbrojtje subsidiare (të përkohshme) dhe 15 me zgjatje të mbrojtjes subsidiare, ndërsa 39 vendime ishin negative, prej të cilave 11 bazuar në merita, 16 tërheqje vullnetare dhe 12 për arsye procedurale. Personat e pajisur me mbrojtje subsidiare kanë ardhur nga vende të ndryshme të origjinës si Ukraina, Jordania, Siria dhe Palestina. Gazetarët ukrainas, të cilët kanë qenë nën mbrojtje të përkohshme për gati dy vite, kanë paraqitur aplikime për mbrojtje ndërkombëtare, duke marrë parasysh se mbrojtja e përkohshme mund të zgjatet për një periudhë maksimale prej dy vitesh sipas nenit 81 të Ligjit për Azilin. Autoritetet kanë siguruar se ata do të vazhdojnë të përfitojnë nga të drejtat sipas vendimit të Qeverisë; megjithatë, statusi i tyre ligjor duhet të jetë në përputhje me kërkesat ligjore. Aplikimet individuale janë shqyrtuar nga autoritetet e azilit dhe atyre u është dhënë statusi i mbrojtjes subsidiare. Siguria fizike dhe sociale në Qendrën e Azilit në Magurë është përmirësuar ndjeshëm gjatë vitit 2025.<sup>364</sup>

**344.** Duke i marrë parasysh njohuritë dhe aftësitë thelbësore të autoriteteve të fituara gjatë disa viteve në fushën e mbrojtjes së refugjatëve, përfshirë mbështetjen dhe ndihmën e drejtpërdrejtë të ofruar nga OJQ CRP/K dhe organizata të tjera vendore dhe ndërkombëtare, personat me status të njohur të mbrojtjes ndërkombëtare kanë pasur qasje më të lehtësuara në skemat e integritet si akomodimi, ndihma sociale, kurset e gjuhës dhe arsimit, ndihma mjekësore, furnizimi me artikuj ushqimorë dhe joushqimorë, mbështetja për mundësi punësimit si dhe qasja në ndihmë juridike falas. Qeveria ofron mbështetje për akomodim me qira dhe ndihmë sociale, ndërsa ndihma tjetër

359 CRP/K (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

360 The Guardian (2025), [Kosova ofron të bëhet vendi i parë që pranon azilkërkuesit e refuzuar nga Britania](#).

361 Reuters (2025), [Kosova fillon të pranojë të deportuar nga SHBA-të nga vende të treta](#).

362 [1] CRP/K (2025), [Statistics – ofruet i ndihmës juridike falas për aplikantët për statusin e mbrojtjes ndërkombëtare në Kosovë](#).

363 CRP/K (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

364 CRP/K (2026), monitorim i rregullt i Qendrës së Azilit në Magurë.

ofrohet nga organizata vendore dhe ndërkombëtare. Megjithatë, ende ekzistojnë sfida të shumta në gëzimin e plotë të të drejtave të tyre. Ekziston një varësi e vazhdueshme financiare e personave me status të mbrojtjes ndërkombëtare nga institucionet e Kosovës dhe organizatat mbështetëse, për shkak se ata ende nuk kanë arritur të gjejnë mundësi ekonomike për vetëqëndrueshmëri.<sup>365</sup>

**345.** Në praktikë, qasja financiare për refugjatët dhe azilkërkuesit shpesh përcaktohet nga diskrecioni i bankave individuale, duke çuar në mospërputhje dhe barriera përtej asaj që kërkohet ligjërisht. Si pjesë e përpjekjeve avokuese, stafi ligjor i OJQ CRP/K e ka monitoruar dhe e ka mbështetur nga afër zbatimin e vendimit të Bankës Qendrore të Kosovës për të mundësuar qasje në shërbime bazike bankare për personat nën mbrojtje ndërkombëtare. Në këtë kontekst, është ofruar mbështetje për pesë (5) persona me status të mbrojtjes subsidiare dhe dy (2) persona pa shtetësi për hapjen e llogarive bankare personale me shërbime bazike, pa hasur në pengesa administrative. Kjo përbën një hap të rëndësishëm në rritjen e përfshirjes financiare për një grup të marginalizuar që shpesh përjashtohet nga shërbimet formale.<sup>366</sup>

**346.** Për më tepër, Ligji Nr. 04/L-219 për të Huajt dhe ndryshimet e tij me Ligjin Nr. 06/L-036 përcaktojnë se personat që përfitojnë mbrojtje subsidiare në Kosovë, pas pesë vitesh qëndrimi të pandërprerë, kanë të drejtë të aplikojnë për leje qëndrimi të përhershme, e cila e hap rrugën ligjore drejt integritit të plotë në përputhje me Ligjin për Shtetësinë. Megjithatë, një akt nënligjor që e trajton këtë çështje nuk parashikon procedura për të huajt sipas nenit 86 të Ligjit Nr. 04/L-219 për të Huajt dhe Ligjit Nr. 06/L-036 për ndryshimin dhe plotësimin e tij, duke pamundësuar që mbajtësit e këtyre statuseve të aplikojnë për qëndrim të përhershëm, pavarësisht se kjo e drejtë garantohet nga legjislati në fuqi.<sup>367</sup>

**347.** Personat me status të mbrojtjes subsidiare nuk kanë të drejtë të pajisen me dokumente udhëtimi në mënyrë të njëjtë si ata me status refugjati. Sipas nenit 8 të Udhëzimit Administrativ (MPB) Nr. 02/2014 për Dokumentet e Udhëtimit për të Huajt, personat nën statusin e mbrojtjes subsidiare mund të pajisen me dokumente udhëtimi vetëm në raste të caktuara, gjë që e kufizon lirinë e tyre të lëvizjes, si: 1. në rast të sëmundjes së rëndë ose vdekjes së një anëtarit të familjes; 2. në rast të zgjidhjes së çështjeve të rëndësishme personale; 3. në rast të udhëtimit ndërkufitar nga institucioni arsimor i ndjekur nga personi deri në moshën 18 vjeç ose deri në përfundimin e arsimit; dhe 4. në rast të pjesëmarrjes në aktivitete kulturore ose sportive jashtë Kosovës.<sup>368</sup>

**348.** Pavarësisht zhvillimit të vazhdueshëm të platformës qeveritare online për qasje në të drejta dhe shërbime, si “e-Kosova”, refugjatët nuk kanë qasje në këtë platformë. Sistemi i bazës së të dhënave të platformës është i lidhur vetëm me Agjencinë e Regjistrimit Civil, e cila gjeneron të dhëna vetëm për shtetasit e Kosovës. Një tjetër pengesë është papajtueshmëria e kartave të tyre të përkohshme të qëndrimit dhe numrave personalë të identifikimit me sistemin e zyrave të punësimit, gjë që i pengon ata të regjistrohen për shërbime të ndërmjetësimit në punësim, trajnime

365 CRP/K (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

366 CRP/K (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

367 CRP/K (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

368 CRP/K (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

profesionale apo subvencione për punësim.<sup>369</sup>

**349.** Për më tepër, kapacitetet e kufizuara institucionale në aspektin e burimeve njerëzore që merren me integrimin e personave me status të mbrojtjes ndërkombëtare, fondet institucionale dhe koordinimi ndërmjet nivelit qendror dhe atij lokal janë identifikuar si sfida kryesore për një reagim efikas dhe efektiv ndaj personave në nevojë. Duke marrë parasysh se ky proces kërkon angazhimin e shumë sektorëve qeveritarë, si në nivel qendror ashtu edhe në atë komunal, përfshirë regjistrimin ligjor, akomodimin, arsimin, kurset e gjuhës dhe integrimin, punësimin, çështjet e dhunës me bazë gjinore, LGBTI+, çështjet e shëndetit mendor, etj., duhet t'i kushtohet vëmendje shtesë koordinimit dhe bashkëpunimit të rregullt institucional. Është e rëndësishme të theksohet se OJQ CRP/K dhe organizata të tjera relevante kanë luajtur rol katalitik në mbledhjen e të gjitha autoriteteve përgjegjëse për t'i përmbushur detyrimet e tyre publike dhe për t'iu përgjigjur në kohë personave në nevojë.<sup>370</sup>

**350.** Institucionet e Kosovës kanë vazhduar të tregojnë angazhim për adresimin dhe reduktimin e apatridisë (gjendjes pa shtetësi). Ky angazhim reflektohet në veprime strategjike dhe nisma legjislativë të orientuara drejt identifikimit, mbështetjes dhe njohjes ligjore të personave në rrezik të apatridisë (gjendja pa shtetësi).

**351.** Agjencia për Regjistrim Civil (ARC) ka përfshirë masa specifike në Strategjinë për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali, duke u zotuar për krijimin e një mekanizmi për identifikimin, parandalimin dhe mbrojtjen e personave lindjet e të cilëve mbeten të peregjistruara. Megjithatë, pavarësisht kësaj përfshirjeje strategjike, mekanizmi i premtuar ende nuk është krijuar.

**352.** Ndryshimet e propozuara në kornizën ligjore, përkatësisht në draft-Ligjin për Gjendjen Civile, draft-Ligjin për Shtetësinë dhe draft-Ligjin për të Huajt, synojnë t'i forcojnë mekanizmat mbrojtës, duke u ndikuar nga rekomandimet e UNHCR-së, OJQ CRP/K dhe ekspertëve të tjerë. Këto ndryshime propozojnë zgjatjen e afateve për regjistrimin e fëmijëve të lindur jashtë vendit nga shtetas të Kosovës, regjistrimin automatik të lindjeve përmes institucioneve shëndetësore, heqjen e gjobave lidhur me regjistrimin e vonuar të lindjeve, si dhe zgjerimin e të drejtave për personat pa shtetësi. Megjithatë, këto ndryshime ende nuk janë miratuar zyrtarisht nga Kuvendi i Kosovës dhe shqetësimet e identifikuar vazhdojnë ta pengojnë gëzimin e plotë të të drejtave të njeriut nga personat e prekur.

**353.** Përveç nismave legjislativë, Ministria e Punëve të Brendshme ka nxjerrë një vendim që u lejon qytetarëve të Kosovës të cilët i kanë regjistruar ngjarjet e gjendjes civile (lindje, martesë, vdekje) pranë strukturave paralele serbe që nga 10 qershori 1999, t'i regjistrojnë zyrtarisht këto ngjarje në Regjistrin Qendror Civil të Kosovës. Kjo nismë, e menaxhuar nga Agjencia për Regjistrim Civil (ARC), synon ta forcojë sundimin e ligjit dhe t'i formalizojë statutet ligjore të qytetarëve, me regjistrime të planifikuara nga 1 shkurt deri më 30 prill 2025.

**354.** Ka ende disponueshmëri të kufizuara të informacionit dhe të dhënave mbi personat e peregjistruar, gjë që paraqet një sfidë që prek veçanërisht komunitetet e marginalizuara si rom, ashkali dhe egjiptian. ARC nuk ka një bazë zyrtare të të dhënave për përmasën e popullsisë së peregjis-

369 CRP/K (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

370 CRP/K (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2025.

truar. Aktualisht nuk ka të dhëna zyrtare të disponueshme që ofrojnë informacion të detajuar mbi personat në rrezik të apatridisë (gjendjes pa shtetësi).

**355.** Sipas të dhënave, në kuadër të Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migrim, ekzistojnë 16 persona me status të njohur të apatridisë (gjendjes pa shtetësi).

**356.** Përpjekjet për promovimin e regjistrimit të lindjeve në Kosovë ndërmerren kryesisht nga OSHC-të me mbështetjen e partnerëve ndërkombëtarë, si dhe nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal përmes heqjes së të gjitha implikimeve financiare për komunitetet e cënueshme.

**357.** Zbatimi i nenit 32 të Ligjit Nr. 04/L-215 për Shtetësinë e Kosovës mbetet sfidues. OSHC-të i referojnë rastet që përfshijnë të rritur të lindur jashtë Kosovës te Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim – Divizioni për Shtetësi, në bazë të nenit 16, pavarësisht vendbanimit të përhershëm të aplikantit në Kosovë. Për më tepër, kjo krijon barriera që i pengojnë individët që i plotësojnë kriteret sipas nenit 32 të ushtrojnë plotësisht të drejtat e tyre të shtetësisë, duke e rritur rrezikun e tyre për t'u bërë pa shtetësi.

**358.** Sa i përket sfidave, barrierat ligjore dhe procedurale vazhdojnë të ndikojnë te personat në rrezik të apatridisë dhe personat pa shtetësi në Kosovë. Interpretimi dhe zbatimi jokonsistent i dispozitave relevante ligjore, veçanërisht në lidhje me regjistrimin e vonuar të lindjeve dhe konfirmimin e shtetësisë, ka çuar në procedura të zgjatura administrative, duke i lënë individët pa njohje formale ligjore. Për më tepër, Procedura për Përcaktimin e Statusit të Apatridisë (SSDP) kërkon forcim dhe ngritje të mëtejshme të kapaciteteve për ta siguruar efektivitetin e saj.

**359.** Procesi i rinovimit të lejeve të përkohshme të qëndrimit për personat pa shtetësi mbetet problematik, kryesisht për shkak të barrierave administrative dhe mungesës së një mekanizmi të qartë institucional për verifikimin dhe riafirmimin e statusit të apatridisë. Aktualisht, çdo rinovim kërkon një vendim formal administrativ që e rikonfirmon statusin e pandryshuar të apatridisë së individit. Kjo kërkesë e shton kompleksitetin e procedurave, duke shkaktuar vonesa të konsiderueshme në rinovimin e lejeve të qëndrimit dhe, si pasojë, duke e penguar qasjen në kohë në dokumente identifikimi dhe shërbime thelbësore për personat pa shtetësi.

**360.** Për më tepër, raporti i progresit i BE-së për Kosovën për vitin 2025 thekson sfidat zhvillimore të sistemit gjyqësor. Sistemi mbetet ende në zhvillim, me nevojë për mekanizma më të fortë për të siguruar integritetin, llogaridhënien, pavarësinë dhe efikasitetin e tij. Mosmarrëveshjet ligjore që lidhen me çështjet e identitetit nuk trajtohen me prioritet dhe mund të mbeten të pazgjidhura për shumë vite. Për më tepër, kur raste të tilla kthehen për rishqyrtim administrativ, organet administrative shpesh nuk i zbatojnë rekomandimet, duke e bërë të nevojshme rinisjen e procedurës. Kjo e vonon më tej zgjidhjen e rasteve, duke lënë potencialisht individët pa identitet ligjor dhe pa qasje në të drejta dhe shërbime themelore për një periudhë të zgjatur.

**361.** Gjendja lidhur me qasjen në ndihmë juridike për personat në rrezik të apatridisë mbetet kryesisht e pandryshuar krahasuar me vitin 2023. Këta individë vazhdojnë të varen kryesisht nga ndih-

ma juridike e ofruar nga OSHC-të, pasi kriteret e pranueshmërisë së Agjencisë për Ndhimë Juridike Falas përjashtojnë personat e rritur të peregjistruar që nuk posedojnë dokument identiteti. Për më tepër, për shkak të mungesës së stafit, Agjencia për Ndhimë Juridike Falas nuk është në gjendje t'i adresojë të gjitha nevojat për ndihmë juridike në këtë fushë. Në këtë kontekst, Agjencia, në kuadër të marrëveshjeve me organizatat që ofrojnë ndihmë juridike falas, mbështetet kryesisht në bashkëpunimin me to në fusha që përputhen me ekspertizën e tyre. Për t'i rritur kapacitetet e stafit të Agjencisë në regjistrimin e gjendjes civile dhe procedurat përkatëse, UNHCR dhe OJQ CRP/K po bashkëpunojnë ngushtë me Agjencinë përmes trajnimeve të synuara dhe bashkëpunimit të vazhdueshëm. Këto përpjekje e synojnë forcimin e reagimit institucional dhe përmirësimin e qasjes në ndihmë juridike për personat në rrezik të apatridisë. Në këtë kontekst, OJQ CRP/K ka luajtur rol thelbësor në ofrimin e ndihmës juridike falas dhe përfaqësimit gjyqësor për personat e peregjistruar, duke siguruar që të drejtat e tyre të njihen në procedurat administrative dhe gjyqësore.

**362.** Në vitin 2025, OJQ CRP/K i ka asistuar 100 persona në regjistrimin e vonuar të lindjeve dhe në fitimin e shtetësisë, si dhe ka identifikuar mbi 133 persona të peregjistruar që kanë nevojë për ndihmë juridike. Kjo mbështetje ka qenë thelbësore në adresimin e sfidave komplekse të apatridisë, duke prekur kategori të ndryshme të popullsisë, përfshirë gra, burra, fëmijë dhe grupe të cënueshme si të moshuarit.

### **363. Rekomandimet**

- Kuvendi i Kosovës duhet ta prioritetizojë dhe ta miratojë pa vonesë projektligjin për të Huajt, Ligjin për Shtetësinë dhe Ligjin për Gjendjen Civile, për ta siguruar një kornizë ligjore koherente për mbrojtjen e azilkërkuesve, refugjatëve dhe personave në rrezik të apatridisë;
- Ministria e Punëve të Brendshme duhet t'i harmonizojë aktet nënligjore me legjislacionin primar dhe të vendosë procedura të thjeshtuara administrative, përfshirë qasjen në shërbimet e E-Kosova dhe mekanizmat e thjeshtuar të rinovimit të lejeve të qëndrimit, për të siguruar qasje efektive në të drejta për refugjatët dhe personat pa shtetësi;
- Ministria e Punëve të Brendshme, komunat dhe Agjencia për Regjistrim Civil duhet ta sigurojnë regjistrimin dhe identifikimin ligjor të të gjithë individëve duke vendosur procedura të unifikuara për regjistrimin e lindjeve dhe përcaktimin e shtetësisë, me fokus të veçantë në komunitetet e marginalizuara dhe ato në rrezik;
- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Ministria e Punëve të Brendshme, komunat dhe Agjencia e Punësimit e Kosovës duhet ta sigurojnë integrimin socio-ekonomik të refugjatëve dhe personave pa shtetësi duke mundësuar qasje në shërbime të punësimit, trajnime profesionale, skema të banimit social dhe programe mbështetëse komunale;
- Ministria e Drejtësisë duhet të sigurojë qasje në ndihmë juridike falas për refugjatët, azilkërkuesit dhe personat në rrezik të apatridisë duke i zgjeruar kriteret e pranueshmërisë sipas Ligjit për Ndhimë Juridike Falas dhe duke e rritur financimin për ofruesit e ndihmës juridike.

## 8. PJESA D: ÇËSHTJE TË NDËRLIDHURA/ ÇËSHTJE SPECIFIKE LIDHUR ME TË DREJTAT E NJERIUT

### 8.1 Drejtësia tranzicionale dhe të drejtat e njeriut

**364.** Drejtësia tranzicionale në këtë raport kuptohet në përputhje me Zyrën e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut (OHCHR), e cila e përkufizon atë si një proces të bazuar në të drejtat e njeriut, që synon njohjen e viktimave, forcimin e besimit në institucionet shtetërore, përforcimin e respektimit të të drejtave të njeriut dhe avancimin e sundimit të ligjit si themel për pajtim dhe parandalimin e shkeljeve të ardhshme. Brenda kësaj kornize, drejtësia tranzicionale nuk kufizohet vetëm në llogaridhënie retrospektive; ajo përbën një projekt strukturor të konsolidimit demokratik. Prandaj, një qasje gjithëpërfshirëse dhe e përqendruar në të drejtat e njeriut është thelbësore për ta nxitur pajtimin ndëretnik dhe për ta mbështetur transformimin e Kosovës në një shtet më gjithëpërfshirës dhe institucionalisht të besueshëm.

**365.** Në nivel vendor, korniza ligjore që e trajton drejtësinë tranzicionale pas konfliktit në Kosovë përbëhet nga disa instrumente sektoriale. Ligji Nr. 05/L-060 për Mjekësinë Ligjore (në fuqi që nga prilli 2016) ka themeluar Institutin e Mjekësisë Ligjore dhe e obligon atë të lokalizojë, zhvarrosë dhe të përcaktojë fatin e personave të zhdukur. Ligji Nr. 04/L-172 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-054 rregullon statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, veteranëve, viktimave civile dhe të të mbijetuarve të dhunës seksuale të lidhur me konfliktin; megjithatë, kufizimet kohore të tij, veçanërisht njohja restriktive e rasteve menjëherë pas luftës 1998–1999, e kufizojnë fushën e mbrojtjes. Së fundmi, Ligji Nr. 08/L-177 (2023) e ka themeluar Institutin e Krimeve të Kryera gjatë Luftës në Kosovë, i cili ka për detyrë hulumtimin dhe dokumentimin e krimeve të kryera ndërmjet 1 janarit 1998 dhe 20 qershorit 1999. Në tërësi, këto masa pasqyrojnë një institucionalizim gradual të drejtësisë tranzicionale. Strategjia për Drejtësinë Tranzicionale, e miratuar në vitin 2024, e plotëson këtë kornizë institucionale së bashku me Planin e Veprimit për periudhën 2024–2026. Megjithatë, që nga viti 2025, një Plan i ri i Veprimit ende nuk është publikuar.

**366.** Që nga viti 2025, pas përpjekjeve të vazhdueshme të avokimit, Ligji për Sigurimin Shëndetësor garanton mbulim falas dhe të pakushtëzuar të sigurimit shëndetësor për të mbijetuarit e dhunës seksuale gjatë luftës. Kjo përbën një zhvillim të rëndësishëm në forcimin e qasjes në shërbime thelbësore dhe në zbutjen e pengesave afatgjata me të cilat janë përballur të mbijetuarit. Paralelisht, OJQ KRCT i ka dokumentuar rreth 1,400 raste të dhunës seksuale të kryera gjatë luftës në Kosovë, duke e nënvizuar si përmasën e shkeljeve ashtu edhe nevojën e vazhdueshme për re-agim institucional.<sup>371</sup>

371 KRCT (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve mbi të Drejtat e Njeriut në Kosovë për vitin 2025.

**367.** Në vitin 2025, nëntë raste që lidhen me të drejtën e viktimave të luftës për të përfituar pensione të dyfishta janë përfaqësuar dhe përgatitur nga OJQ KRCT në procedura gjyqësore, ndërsa disa prej tyre tashmë janë konfirmuar nga të trija shkallët e gjyqësorit në Kosovë. Këto konfirmime forcojnë një linjë në zhvillim të jurisprudencës, e cila njih se pensionet që rrjedhin nga kontributet e mëparshme përbëjnë të drejta pronësore, ndërsa pensionet e dhëna mbi bazën e statusit të viktimës shërbejnë për të njohur humbjen, kontributin dhe sakrificën e përjetuar gjatë luftës. Ky konsolidim gjyqësor mbështetet në precedentë të mëhershëm që kanë afirmuar të drejtën e viktimave për pensione të dyfishta.<sup>372</sup>

**368.** Avokimi nga OSHC-të dhe familjet e viktimave dhe personave të zhdukur në Kosovë ka kërkuar vazhdimisht zgjatjen e afatit për regjistrim për të mbijetuarit përtej afatit aktual. Megjithëse Qeveria e Kosovës ka rënë dakord që ta shtyjë afatin për viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës për të aplikuar për njohjen e statusit të viktimës, OJQ KRCT ka avokuar vazhdimisht që të mos ketë një afat të tillë dhe që vendimi për aplikim të mbetet në diskrecionin e vetë viktimave. Në prill 2025, afati për aplikim për njohjen e statusit u zgjat edhe për dy vjet të tjera, megjithatë KRCT-ja vazhdon të avokojë për heqjen e këtij afati për të mbijetuarit e dhunës seksuale të lidhur me konfliktin, në mënyrë që ata të mund të aplikojnë për njohjen e statusit pa kufizime kohore.<sup>373</sup>

**369.** Në vitin 2025, KRCT inauguroi “Dhomën e Sigurt” në Gjykatën Themelore në Prishtinë, e cila është projektuar për të ofruar siguri të shtuar dhe mbështetje psikosociale për të mbijetuarit që marrin pjesë në procedura gjyqësore lidhur me dhunën seksuale gjatë luftës. Dhoma e Sigurt siguron një mjedis të mbrojtur dhe të ndjeshëm ndaj traumës, si dhe mundëson dhënien e dëshmisë përmes lidhjes video, duke mbrojtur privatësinë e të mbijetuarve dhe duke ulur rrezikun e ritraumizimit gjatë procedurave gjyqësore.<sup>374</sup>

**370.** Në të njëjtën periudhë, Gjykata Themelore në Prishtinë shpalli edhe dy aktgjykime dënimi lidhur me dhunën seksuale gjatë luftës, duke dënuar tre kryerës me nga 15 vite burgim secilin. Me KRCT që ka ofruar mbështetje të plotë ligjore dhe psikologjike për të mbijetuarën, dënimet kumulative me burgim në këto raste kanë arritur në 58 vite. Për më tepër, gjatë vitit 2025 janë ngritur edhe dy aktakuzave të reja për dhunë seksuale gjatë luftës, duke e çuar numrin total të aktakuzave në 12, shumica e të cilave janë dokumentuar dhe përgatitur me përfshirjen e KRCT-së.<sup>375</sup> Duhet theksuar në këtë drejtim se, sipas Komisionit Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Viktimave të Dhunës Seksuale gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës, që nga themelimi i tij në shkurt 2018, statusi i të mbijetuarit u është njohur 1,840 aplikuesve (1,737 gra dhe 103 burra). Ndërkohë, janë refuzuar 351 aplikime (295 gra dhe 56 burra).<sup>376</sup>

**371.** Në procedurat administrative, KRCT-ja ka përfaqësuar mbi 50 përfitues dhe ka siguruar kompensim që tejkalon 61,000 EUR në pesë raste. Në çështjet që lidhen me pensionet e dyfishta, tre të mbijetuar kanë përfituar kompensim retroaktiv në vlerë totale prej 24,600 EUR.<sup>377</sup>

372 KRCT (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve mbi të Drejtat e Njeriut në Kosovë për vitin 2025.

373 KRCT (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve mbi të Drejtat e Njeriut në Kosovë për vitin 2025.

374 KRCT (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve mbi të Drejtat e Njeriut në Kosovë për vitin 2025.

375 KRCT (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve mbi të Drejtat e Njeriut në Kosovë për vitin 2025.

376 UNSG (2025), [Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm për Kosovën 2025](#).

377 KRCT (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve mbi të Drejtat e Njeriut në Kosovë për vitin 2025.

**372.** Në vitin 2025, Instituti për Krimet e Kryera gjatë Luftës në Kosovë e ka avancuar operacionalizimin e mandatit të tij; ai ka organizuar një konferencë akademike në shkurt dhe ka zgjeruar fondin e tij arkivor me materiale të digjitalizuara dhe koleksione personale nga donatorë rajonalë. Këto hapa përbëjnë një konsolidim substancial të kapaciteteve institucionale dhe kërkimore të Institutit. I themeluar në bazë të Ligjit Nr. 08/L-177, të miratuar në vitin 2023, Instituti është krijuar për të dokumentuar krimet e kryera gjatë luftës në Kosovë ndërmjet 1 janarit 1998 dhe 20 qershorit 1999, si dhe krimet e lidhura me luftën të kryera deri më 31 dhjetor 2000. Duke funksionuar si Agjenci në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, ai ka mandat të kryejë hulumtim, të mbledhë dhe menaxhojë të dhëna, të mirëmbajë databaza për krimet e luftës, të publikojë dëshmi të mbijetuarve dhe të përgatisë analiza statistikore. Instituti ka pranuar dokumentacionin e tij të parë zyrtar më 17 shkurt 2024, i cili përbëhej nga dëshmi për zhdukje me forcë të dorëzuara nga Kryetari i Shoqatës së Familjeve të Personave të Zhdukur në Kosovë.

**373.** Komuna e Prishtinës ka njoftuar lidhur me planet për hapjen e një Muzeu të Paqes në verën e vitit 2025, i paraparë si pjesë e Qendrës për Studime të Paqes dhe Avokimit që pritet të themelohet së shpejti. Ky muze i ri synon t'i pasqyrojë përpjekjet e gjata për paqe, duke dokumentuar jo vetëm mizoritë e luftës, por edhe qëndrueshmërinë pas konfliktit, pajtimin dhe përpjekjet për ndërtimin e paqes. Vetë Qendra, e cila është planifikuar të hapet në gusht 2025, do të mbulojë fusha si diplomacia, ndërmjetësimi dhe zgjidhja e konflikteve.

**374.** Më 17 qershor 2025, Prokuroria Speciale e Kosovës ka ngritur aktakuzë në mungesë ndaj 53 personave, përfshirë figura të profilit të lartë si Momir Stojanović, komandant gjatë luftës i Sigurimit Ushtarak të Korpusit të Prishtinës të Ushtrisë Jugosllave, dhe Franko "Frenki" Simatović, oficer i lartë në Shërbimin e Sigurisë Shtetërore të Serbisë. Këto aktakuza, ndër më të mëdhatë në historinë e Kosovës, janë ngritur për rastin e masakrës së Mejës, ku mbi 370 civilë shqiptarë të Kosovës u vranë.<sup>378</sup>

**375.** Në fillim të vitit 2025, Presidentja Vjosa Osmani e ka propozuar krijimin e një Komisioni Presidential për Drejtësinë Tranzicionale me mandat trevjeçar, i cili mund të zgjatet edhe për një vit. Sipas një projekt-statuti të siguruar nga OJQ BIRN, Komisioni do të fokusohet në periudhën nga janari 1998 deri në qershor 1999. Ky trup do të përbëhej nga njëmbëdhjetë anëtarë: përfaqësues të organizatave të viktimave të luftës, ekspertë të shoqërisë civile, specialistë të jashtëm dhe profesionistë të shëndetit mendor. Presidentja Osmani ka zhvilluar takime me përfaqësues të shoqërisë civile për përgatitjen e Komisionit, me bashkëpunim të planifikuar të vazhdueshëm me grupet e viktimave, shoqërinë civile dhe partnerët ndërkombëtarë. Megjithatë, ekspertët dhe organizatat e shoqërisë civile kanë ngritur shqetësime lidhur me pavarësinë dhe transparencën e Komisionit, duke pasur parasysh se ai krijohet me dekret presidencial dhe jo me miratim parlamentar. Kritikët gjithashtu theksojnë se mandati përjashton periudhën pas qershorit 1999, kur kanë ndodhur sulme hakmarrëse ndaj komuniteteve minoritare serbe dhe të tjerëve. Për më tepër, mbështetja në Strategjinë ekzistuese të Qeverisë për Drejtësinë Tranzicionale, e konsideruar nga disa si e paplotë, ka shkaktuar kritika. Organizatat për të drejtat e njeriut theksojnë nevojën për dispozita të qarta për mbështetjen e viktimave, veçanërisht të mbijetuarve të dhunës seksuale. Ndërsa Komi-

sioni mund të kontribuojë në pajtim, efektiviteti i tij do të varet nga angazhimi i gjerë shoqëror, garancitë e forta institucionale dhe një qasje gjithëpërfshirëse ndaj trashëgimisë komplekse të Kosovës.<sup>379</sup>

**376.** Debati mbi transparencën dhe integritetin e Dhomave të Specializuara të Kosovës ka vazhduar gjatë gjithë vitit 2025, me ekspertë dhe raporte mediatike që pretendojnë se mbajtja e shumicës së seancave me dyer të mbyllura bie ndesh me parimin e publikimit dhe transparencës. Sipas ekspertëve ligjorë të cilët kanë folur për OJQ BIRN, rreth 60 për qind e dëshmitarëve kanë dëshmuar në seanca të mbyllura për publikun, ndërsa mungesa e vëzhguesve të pavarur në seancat gjyqësore e vështirëson raportimin mbi punën e gjykatës, duke e thelluar kështu mosbesimin e publikut ndaj Dhomave të Specializuara të Kosovës.<sup>380</sup> Në lidhje me çështjen e transparencës dhe integritetit, OJQ HLCK ka publikuar një broshurë me titull: “Sa transparente janë Dhomat e Specializuara të Kosovës?”, ku ka theksuar gjetjet kryesore lidhur me sfidat e transparencës me të cilat përballlet ky institucion, përkatësisht se: (i) një pjesë e konsiderueshme e seancave gjyqësore mbahen të mbyllura për publikun, duke ngritur pyetje serioze mbi transparencën e gjykatës; (ii) mbyllja e seancave për publikun dhe kufizimi i qasjes së mediave në proceset gjyqësore e bën të vështirë mbikëqyrjen publike të vendimeve gjyqësore; (iii) publikut i mohohet e drejta për t’i dëgjuar dëshmitë e dëshmitarëve përmes redaktimit të plotë të dëshmimeve në disa raste, dhe jo vetëm të informacionit që ndikon në zbulimin e identitetit të dëshmitarëve të mbrojtur.<sup>381</sup>

**377.** Më 7 gusht 2025, mijëra veteranë të UÇK-së dhe mbështetës të tyre u mbledhën në Prishtinë për të protestuar kundër Dhomave të Specializuara të Kosovës. Demonstruesit, të organizuar nga Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së (OVL-UÇK), marshuan nën sloganin “Bashkë kundër padrejtësisë. UÇK është lavdi, jo aktakuzë”, duke shprehur kundërshtimin e tyre ndaj ndjekjes penale të ish-udhëheqësve të UÇK-së. Protestuesit akuzuan Dhomat e Specializuara për anshmëri dhe për përpjekje për të “rishkruar historinë” duke kriminalizuar rolin e UÇK-së në luftën për pavarësinë e Kosovës. Protesta theksoi pakënaqësinë e vazhdueshme të publikut me punën e KSC-së dhe ndikimin e saj të perceptuar në narrativën historike të Kosovës.<sup>382</sup>

**378.** Është themeluar një fond në Kosovë për të ofruar ndihmë juridike për individët e akuzuar pranë Dhomave të Specializuara të Kosovës, si dhe për mbështetje financiare për familjet e tyre.<sup>383</sup> Ndërsa fillimisht viktimat e njohura të krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit nuk kishin marrë mbështetje financiare përkatëse, Kosova konfirmoi në vitin 2025 se viktimat tani mund të paraqesin kërkesa përmes Programit Kombëtar për Kompensimin e Viktimave të Krimit, me garantimin e anonimitetit. Trajtimi i kësaj pabarazie ka qenë një prioritet i theksuar si nga Komisioni Evropian, ashtu edhe nga një numër i madh OSHC-sh.<sup>384</sup>

**379.** Në vitin 2025, Dhomat e Specializuara të Kosovës miratuan marrëveshje për pranimin e fajësisë në rastet e Sabit Januzit, Ismet Bahtijarit dhe Haxhi Shalës më 4 shkurt, ndërsa pak më vonë, më 21 shkurt, Presidentja Ekaterina Trendafilova miratoi modifikime të dënimeve për Januzin dhe Bahtijarin, duke u ulur dënimet me burgim në njohje të bashkëpunimit të tyre me gjykatën.

379 BIRN (2026), [Analizë për Balkan Insight: duke injoruar paralajmërimet, presidenti i Kosovës planifikon Komision për Drejtësi Tranzicionale](#)

380 Prishtina insight (2026), [Gazetarët në Kosovë përballen me pengesa të mëdha në raportimin e krimeve të luftës.](#)

381 HLC (2024), [Broshurë: sa transparente janë Dhomat e Specializuara të Kosovës?](#)

382 Balkan Insight (2026), [Veteranët e luftës në Kosovë protestojnë kundër Gjykatës Speciale në Hagë.](#)

383 Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar (2025), [Ndihmë Ligjore.](#)

384 Balkan Insight (2026), [Kosovo agrees to accept compensation claims from KLA war crime victims.](#)

Prokuroria e Specializuar më pas përmbylli paraqitjen e provave në gjykimin ndaj Hashim Thaçit dhe bashkëpandehurve më 16 prill, duke shënuar një moment të rëndësishëm procedural në këtë rast kompleks që lidhet me krime të dyshuara të luftës dhe krime kundër njerëzimit. Më 17 prill, Paneli i Gjykatës Kushtetuese të Dhomave të Specializuara vendosi mbi një referim kushtetues të paraqitur nga Salih Mustafa, duke konstatuar se nuk kishte shkelje të Kushtetutës së Kosovës gjatë procedurave të Dhomave të Specializuara; megjithatë, ky vendim u kritikua nga studiuesit ligjorë Kushtrim Istrefi dhe Robert Muharremi, të cilët në analizën e tyre *“Parimi i ligjit më të butë (‘lex mitior’) në gjykim para Dhomave të Specializuara të Kosovës: Ku qëndron ligjshmëria”* ngritën pikëpyetje mbi bazën ligjore dhe implikimet e tij. Më 14 korrik, Paneli i Apelit shpalli aktgjykimin në rastin e Pjetër Shalës, duke i vërtetuar dënimet për krime lufte, përfshirë ndalimin arbitrar, torturën dhe vrasjen, por duke e ulur dënimin nga 18 në 13 vite burgim. Menjëherë pas kësaj, më 16 korrik, Dhomat e Specializuara hodhën poshtë një mocion të përbashkët të mbrojtjes që kërkonte përjashtimin e disa akuzave për krime lufte ndaj Hashim Thaçit dhe tre ish-udhëheqësve të tjerë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, me arsyetimin se disa nga ngjarjet e pretenduara binin jashtë kornizës kohore të konfliktit të viteve 1998–1999. Gjykata e refuzoi këtë kërkesë, duke lejuar që procesi të vazhdojë mbi të gjitha akuzat.<sup>385</sup>

**380.** Gjatë vitit 2025, gjykatat vendore të Kosovës kanë mbajtur një angazhim të fokusuar për ndjekjen penale të krimeve të dyshuara të luftës të kryera gjatë luftës së viteve 1998–1999. Progresi i rëndësishëm është arritur në disa raste të profilit të lartë. Më 28 prill 2025, Gjykata Themelore në Prishtinë ka lëshuar urdhër-arreste për 20 shtetas serbë të dyshuar për përfshirje në krime lufte në Gjakovë, përfshirë vrasjen e 106 civilëve shqiptarë të Kosovës. Ky veprim sinjalizon përpjekje të ripërtërira të sistemit gjyqësor për të hetuar dhe për të mbajtur përgjegjës kryerësit e mizorive masive të periudhës së luftës.<sup>386</sup>

**381.** Në korrik 2025, Gjykata Themelore e dënoi Muhamet Alidemajn, një ish-polic serb, me 15 vite burgim për rolin e tij në masakrën e marsit 1999 ndaj rreth 130 personave në Izbicë. Alidemaj u shpall fajtor për pjesëmarrje në vrasje, të cilat ishin pjesë e një fushate më të gjerë dhune kundër shqiptarëve të Kosovës gjatë luftës. Gjithashtu, në një rigjykim të pjesshëm të rastit “Drenica 1”, Gjykata Themelore liroi nga akuzat Sylejman Selimin dhe Jahir Demakun lidhur me rrahjen e një të burgosuri në një qendër ndalimi të UÇK-së në Likoc në vitin 1998. Megjithatë, dënimet e tyre të tjera për krime lufte mbeten në fuqi, duke reflektuar kompleksitetin dhe sfidat në ndjekjen penale të rasteve të krimeve të luftës.<sup>387</sup>

**382.** Më 31 korrik 2025, Gjykata Themelore e ka dënuar Milos Pleskovicin, shtetas serb, për krime lufte lidhur me vrasjen e tre civilëve shqiptarë të Kosovës pranë Prizrenit në shtator 1998. Pleskovic është dënuar me 15 vite burgim. Gjykata ka konstatuar se ai dhe individë të tjerë me uniforme ishin të vendosur në kodrat përreth Prizrenit gjatë konfliktit dhe janë përgjegjës për këto vrasje. Gjithashtu, më 28 korrik, Gjykata Themelore në Prishtinë ka dënuar në mungesë dy ish-anëtarë të policisë serbe, Dragan Deniq dhe Ivica Rajković, për përdhunimin gjatë luftës të një gruaje shqip-

385 Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar (2025), [Paneli gjyqësor miraton marrëveshjet për pranimin e fajësisë.](#)

386 Balkan Insight (2025), [Kosova lëshon urdhër-arrest për të arratisurin, ‘kingpin’-in serb Radojiçiq.](#)

387 HLC (2025), Gjykime në mungesë për krime lufte: midis statistikave dhe realitetit të drejtësisë.

tare të Kosovës në maj 1999. Të dy janë dënuar me nga 15 vite burgim. Gjykata ka gjetur se ata, së bashku me anëtarë të tjerë të forcave policore, kanë kryer abuzim seksual dhe kanë marrë pjesë në dëbimin e civilëve shqiptarë të Kosovës, plaçkitjen e pronave të tyre dhe kryerjen e akteve të tjera çnjerëzore.

**383.** Në gusht të vitit 2025, Gjykata Themelore në Prishtinë ka urdhëruar paraburgim njëmuor në dy raste të veçanta për krime lufte. Më 14 gusht, gjykata e ka vendosur paraburgimin e Ramadan Morinës, një shqiptar i Kosovës i dyshuar për përfshirje në masakrën e marsit 1999 ndaj 34 civilëve shqiptarë në Burim. Morina, i cili kishte jetuar në Serbi, është arrestuar me të hyrë në Kosovë, ndërsa gjykata e ka arsyetuar vendimin me dyshimin e bazuar për pjesëmarrje në vrasje dhe rrezikun e arratisjes si baza për caktimin e paraburgimit.<sup>388</sup> Në një rast të veçantë, gjykata gjithashtu ka urdhëruar ndalimin e S.S., i dyshuar për kryerje të krimeve të luftës në Vushtrri gjatë luftës. Sipas dokumenteve të rastit, S.S. dyshohet se ka bashkëpunuar me persona të tjerë me uniformë si pjesë e njësive rezerviste të mobilizuara të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë, duke marrë pjesë në vrasjen e civilëve të paarmatosur. Ai gjithashtu akuzohet se ka udhëhequr një operacion më 6 prill 1999 që ka përfshirë plaçkitjen dhe djegien e shtëpive, si dhe kryerjen e akteve të dhunës fizike dhe seksuale ndaj civilëve.<sup>389</sup>

**384.** Pas inaugurimit të tij në nëntor 2024, Muzeu i të Mbijetuarve i themeluar nga Jahjaga Foundation ka konsoliduar rolin e tij gjatë vitit 2025 si një hapësirë qendrore memoriale dhe avokuese për të mbijetuarit e dhunës seksuale të lidhur me konfliktin (CRSV) në Kosovë. Gjatë vitit 2025, Muzeu ka vazhduar programimin e tij përmes ngjarjeve publike, ekspozitave dhe aktiviteteve përkujtimore, duke e ruajtur dukshmërinë për rreth 20,000 të mbijetuar të dhunës seksuale gjatë luftës. Në raportimet për vitin 2025, ky muze gjithnjë e më shumë referohet si një hapësirë e përhershme memoriale që kontribuon në shkatërrimin gradual të kulturës së heshtjes lidhur me dhunën seksuale gjatë luftës dhe në institucionalizimin e kujtesës në sferën publike të Kosovës.<sup>390</sup>

**385.** Në vitin 2025, Muzeu i Fëmijëve të Luftës është hapur nga YIHR KS si një hapësirë alternative e kujtesës, e dedikuar individëve fëmijëria e të cilëve është ndërprerë gjatë luftës në Kosovë. Kjo nismë synon të vë në pah përvojat e marginalizuara të luftës dhe të kontribuojë në drejtësinë simbolike përmes njohjes dhe ruajtjes së narrativave personale. Ekspozita inauguruese, e titulluar “Loja e ndërprerë”, paraqet dëshmi të fëmijëve që kanë jetuar gjatë luftës, duke dokumentuar përvojat e zhvendosjes, frikës, fshehjes dhe ndërprerjes së jetës së përditshme. E zhvilluar gjatë një periudhe pesëvjeçare, muzeu synon të shërbejë si platformë për reflektim, njohje dhe pajtim, duke theksuar rëndësinë e përballjes me përvojat e së kaluarës për të parandaluar përsëritjen e tyre.<sup>391</sup>

**386.** Në vitin 2025, përkujtimi i fëmijëve të vrarë ose të raportuar si të zhdukur gjatë luftës së viteve 1998–1999 mbetet i planifikuar zyrtarisht për zbatim në kuadër të Strategjisë së Qeverisë për Drejtësinë Tranzicionale 2024–2034. Plani i Veprimit 2024–2026 vazhdon të përcaktojë periudhën 2025–2026 si afat synim për themelimin e “Memorialit për fëmijët e vrarë dhe të zhdukur gjatë luftës.”<sup>392</sup>

388 HLC (2025), Gjykime ne mungesë për krime lufte: midis statistikave dhe realitetit të drejtësisë.

389 HLC (2025), Gjykime ne mungesë për krime lufte: midis statistikave dhe realitetit të drejtësisë.

390 YIHR (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve mbi të Drejtat e Njeriut në Kosovë për vitin 2025.

391 YIHR (2025), [Hapja e Muzeut të Fëmijëve të Luftës](#).

392 YIHR (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve mbi të Drejtat e Njeriut në Kosovë për vitin 2025.

**387.** Një zhvillim procedural lidhur me kornizën për Personat e Zhdukur ndodhi në janar 2025, kur Prishtina dhe Beogradi ranë dakord për Termat e Referencës të Komisionit të Përbashkët të Dialogut për Personat e Zhdukur. Megjithatë, një takim i planifikuar më 15 janar 2025 u anulua dhe nuk ekziston asnjë regjistrim publik që Ligji për Personat e Zhdukur të jetë ndryshuar në përputhje me zotimet e Strategjisë.<sup>393</sup>

**388.** Në vitin 2025, nuk ka informacion publik që tregon se vendi vakant në kuadër të Komisionit Qeveritar për Personat e Zhdukur, në veçanti ulësja e rezervuar për përfaqësues të komuniteteve jo-shumicë, është plotësuar. Përbërja e Komisionit, rrjedhimisht, duket e pandryshuar. Ky vend vakant, i evidentuar për herë të parë në vitin 2020 nga OJQ MPRC, vazhdon të mbetet i pa plotësuar, pavarësisht mandatit të Komisionit për të koordinuar dhe mbikëqyrur përpjekjet për të sqaruar fatin e personave të zhdukur pa diskriminim mbi bazë etnie, feje apo statusi tjetër.<sup>394</sup>

**389.** Deri në dhjetor 2025, janë përmbyllur 267 raste në favor të familjeve të personave të zhdukur. Megjithatë, sfida të rëndësishme vazhdojnë të mbeten dhe ende ka 1,590 persona të zhdukur si pasojë e luftës. Megjithëse legjislacioni njih të drejtën e familjeve për të përfituar pensione dhe benefite sociale, statusi i pazgjidhur ligjor dhe procedurat komplekse administrative shpesh e pengojnë ushtrimin efektiv të këtyre të drejtave. Vonesat në përcaktimin e statusit dhe në dokumentacion vazhdojnë të lënë shumë familje pa mbështetje të qëndrueshme financiare.<sup>395</sup>

**390.** Familjet e personave të zhdukur kanë të drejtë ligjore për informim të shpejtë, të saktë dhe gjithëpërfshirës lidhur me proceset hetimore dhe mjeko-ligjore. Në praktikë, megjithatë, informacioni shpesh vonohet, jepet në mënyrë të fragmentuar ose komunikohet në mënyrë jokonsistente. Përditësimet janë më shpesh reaktive sesa periodike, ndërsa familjet mund të varen nga kanalet joformale në vend të komunikimit të strukturuar institucional. Kjo zbrazëti e informacionit minon besimin në autoritetet përgjegjëse dhe dobëson besimin në integritetin e procesit.<sup>396</sup>

**391.** Korniza ligjore i përcakton qartë rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve që merren me personat e zhdukur. Megjithatë, koordinimi ndërmjet shërbimeve mjeko-ligjore, organeve hetimore, autoriteteve të prokurorisë dhe institucioneve të politikëbërjes mbetet i pamjaftueshëm. Mekanizmat e shkëmbimit të informacionit janë të fragmentuar, procedurat nuk janë të harmonizuara dhe proceset paralele shpesh funksionojnë pa integrim efektiv. Këto mangësi kontribuojnë në vonesa, përsëritje të punës dhe ulje të efikasitetit institucional në sqarimin e fatit të personave të zhdukur.<sup>397</sup>

**392.** Zhdukja me forcë dhe krimet e ndërlydhura kriminalizohen në bazë të legjislacionit vendor, ndërsa institucionet shprehin formalisht përkushtim ndaj llogaridhënies. Megjithatë, në praktikë, vetëm pak raste rezultojnë me aktakuza ose dënime. Hetimet shpesh janë të zgjatura, me mungesë burimesh ose të kufizuara nga sfidat provuese, duke përforcuar perceptimin tek familjet se

393 YIHR (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve mbi të Drejtat e Njeriut në Kosovë për vitin 2025.

394 YIHR (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve mbi të Drejtat e Njeriut në Kosovë për vitin 2025.

395 MPRC (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve mbi të Drejtat e Njeriut në Kosovë për vitin 2025.

396 MPRC (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve mbi të Drejtat e Njeriut në Kosovë për vitin 2025.

397 MPRC (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve mbi të Drejtat e Njeriut në Kosovë për vitin 2025.

drejtësia mbetet kryesisht deklarative dhe jo funksionale, si dhe se pandëshkueshmëria vazhdon të mbizotërojë.<sup>398</sup>

**393.** Familjet e personave të zhdukur njihen formalisht si bartës të të drejtave dhe si palë kyçe në proceset e drejtësisë tranzicionale. Megjithatë, pjesëmarrja e tyre shpesh kufizohet në konsultim pa ndikim domethënës në vendimmarrje. Në shumë raste, familjet informohen për vendimet pasi ato tashmë janë marrë, në vend që të përfshihen në mënyrë aktive në përcaktimin e prioriteteve hetimore, proceset e zhvarrosjes apo strategjitë institucionale. Si rrjedhojë, pjesëmarrja rrezikon të mbetet simbolike dhe jo substanciale.<sup>399</sup>

**394.** Politikat e njohin nevojën për mbështetje psiko-sociale për familjet e personave të zhdukur. Megjithatë, në zbatim, shërbimet mbeten të shpërndara në mënyrë të pabarabartë, të kufizuara në shtrirje dhe të financuara në mënyrë të pamjaftueshme. Familjet në zonat rurale ose të largëta përballen me pengesa të veçanta në qasjen ndaj mbështetjes së vazhdueshme dhe të specializuar, duke ulur efektivitetin praktik të zotimeve politike në këtë fushë.<sup>400</sup>

### **395. Rekomandimet**

- Ministria e Drejtësisë duhet të sigurojë një dallim të qartë ligjor ndërmjet pensioneve dhe reparacioneve për viktimat e luftës, në mënyrë që të mbijetuarit dhe familjarët të mos detyrohen të zgjedhin ndërmjet përfitimeve sociale dhe kompensimit për shkeljet e të drejtave të njeriut. Ky dallim duhet të sanksionohet ligjërisht për të parandaluar përjashtime diskriminuese;
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) duhet të rrisë transparencën në procedurat për krimet e luftës duke siguruar qasje publike në proceset gjyqësore që nuk janë të ndjeshme dhe duke përmirësuar raportimin publik. Redaktimet dhe seancat e mbyllura duhet të kufizohen vetëm në rastet kur është e nevojshme për mbrojtjen e viktimave dhe dëshmitarëve, dhe jo për të kufizuar mbikëqyrjen publike;
- Instituti për Krimet e Luftës dhe Ministria e Drejtësisë duhet të forcojnë bashkëpunimin rajonal për dokumentimin e të gjitha krimeve të lidhura me luftën dhe rasteve të personave të zhdukur, duke siguruar bashkëpunim gjyqësor ndërkuftar. Kosova dhe Serbia duhet të angazhohen në marrëveshje ligjore të mirëfillta për të lehtësuar ndjekjen penale dhe ekstradimin e kriminelëve të luftës;
- Qeveria e Kosovës dhe institucionet përkatëse duhet të rishikojnë kornizën kohore zyrtare lidhur me viktimat e luftës, për të siguruar që proceset e drejtësisë tranzicionale të pasqyrojnë përvojat e të gjitha komuniteteve të prekura.

398 MPRC (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve mbi të Drejtat e Njeriut në Kosovë për vitin 2025.

399 MPRC (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve mbi të Drejtat e Njeriut në Kosovë për vitin 2025.

400 MPRC (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve mbi të Drejtat e Njeriut në Kosovë për vitin 2025.

## 8.2 Korrupsioni dhe të drejtat e njeriut

**396.** Shqyrtimi i korrupsionit përmes një qasjeje të të drejtave të njeriut e mundëson vlerësimin e mënyrës se si praktikat korruptive veprojnë në nivele institucionale dhe strukturore, duke cenuar përfundimisht ushtrimin efektiv të të drejtave të mbrojtura. Në raportin e saj për vitin 2025, OJQ Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) e konceptualizon korrupsionin jo vetëm si një vepër penale, por si një fenomen që mund të përbëjë shkelje të të drejtave të njeriut. Në përputhje me një kuptim ndërkombëtar, kjo qasje e trajton korrupsionin si një zinxhir shkakësor, në të cilin akti i korrupsionit lidhet në mënyra të ndryshme me cenimin e një të drejte të caktuar të mbrojtur. Rrjedhimisht, shkeljet mund të jenë të drejtpërdrejta, të tërthorta ose strukturore. Në këtë kuadër, kur korrupsioni rezulton në mohimin ose kufizimin e të drejtave të mbrojtura dhe shteti nuk e ushtron kujdesin e duhur për ta parandaluar, hetuar apo sanksionuar një sjellje të tillë, atëherë mund të lindë përgjegjësi sipas së drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.<sup>401</sup>

**397.** Megjithëse jurisprudenca ndërkombëtare nuk ka njohur në mënyrë eksplicite një “të drejtë për të qenë i lirë nga korrupsioni”, garancitë ekzistuese të të drejtave të njeriut ofrojnë një bazë normative për ta trajtuar korrupsionin si një fenomen që i cenon të drejtat. Në këtë drejtim, Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) (2025) argumenton se instrumentet ndërkombëtare dhe garancitë kushtetuese pasqyrojnë këtë ndërlidhje, pasi disa shkelje të të drejtave të njeriut rëndohen kur kryhen përmes shpërdorimit të pozitës zyrtare, ndërsa vetë vepra penale e keqpërdorimit të detyrës zyrtare përfshin si element edhe shkeljen e të drejtave të një personi tjetër. Njëkohësisht, edhe pse Kosova ende nuk e ka nënshkruar Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit për shkak të pamundësisë për t’iu bashkuar konventave të OKB-së, Koalicioni i Shoqërisë Civile për UNCAC vlerëson se Kosova ka krijuar një bazë solide për ndërtimin e një infrastrukture ligjore dhe institucionale për luftimin e korrupsionit përmes masave legjislative. Për më tepër, Kosova ka themeluar Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit në përputhje me nenin 142 të Kushtetutës. Kjo agjenci është përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të disa ligjeve kyçe që lidhen me parandalimin e korrupsionit, përfshirë: Ligjin Nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik; Ligjin Nr. 08/L-108 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave; Ligjin Nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve; Ligjin Nr. 08/L-168 për Prokurorinë Speciale.

**398.** Në një raport të publikuar në korrik 2025, GLPS vuri në dukje se janë bërë përpjekje në hartimin e Strategjisë Kombëtare Kundër Korrupsionit dhe Planit të Veprimit 2024–2027, por miratimi i saj është vonuar ndjeshëm dhe ka mbetur i paaprovuar gjatë periudhës së raportimit, pavarësisht zotimeve të mëhershme për ta finalizuar deri në dhjetor 2023.

**399.** Së fundi, gjatë vitit 2025, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit e ka rritur dukshmërinë dhe njohjen e saj ndërkombëtare. Në shkurt, ajo u angazhua në shkëmbime të strukturuar me Autoritetin Kundër Korrupsionit të Italisë në kuadër të projektit të BE–Këshillit të Evropës PECK III, ndërsa në maj organizoi një ligjëratë të hapur. Në prill, Agjencia e prezantoi metodologjinë e saj

401 IKD (2025), Korrupsioni si shkelje e të drejtave të Njeriut.

gjithëpërfshirëse për hartëzimin e rrezikut të korrupsionit, që i mbulon 159 institucione publike dhe ndërmarrje shtetërore, në një punëtori të Council of Europe në Strasburg.<sup>402</sup> Këto hapa e kanë forcuar pozitën ndërkombëtare të Kosovës në përpjekjet kundër korrupsionit dhe e kanë sinjalizuar një zhvendosje institucionale drejt rritjes së transparencës dhe ndërtimit të kapaciteteve..

**400.** Në shkurt 2025, Transparency International rikonfirmoi renditjen e Kosovës në vendin e 73-të, me një rezultat prej 44 pikësh (nga 41 në vitin 2024), duke e renditur atë të dytën në Ballkan. Megjithatë, ky përparim modest u shoqërua me paralajmërime për mungesa buxhetore në Këshillin Prokurorial të Kosovës, i cili mori 17.3 milionë euro nga 19.8 milionë euro të kërkuara, duke penguar punësimin e prokurorëve dhe stafit. Gjithashtu, përditësimi i marsit 2025 nga Transparency International theksoi se disa rekomandime reformuese mbeten të pazbatuara, përfshirë miratimin e protokolleve të shërbimit publik të ndjeshme ndaj gjinisë, rritjen e transparencës në rekrutimin publik dhe forcimin e mbikëqyrjes së proceseve zgjedhore.<sup>403</sup>

**401.** Në vitin 2025, Kosova gjithashtu avancoi në zhvillimin e një mekanizmi digjital për raportimin e korrupsionit, të frymëzuar nga modeli "Clean Portal" i Koresë së Jugut dhe i zbatuar në bashkëpunim me Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP). Kjo nismë synon t'ua mundësojë qytetarëve raportimin më të lehtë të rasteve të korrupsionit dhe ta përmirësojë reagimin institucional.

**402.** Në fillim të vitit 2025, Prokuroria Speciale e Kosovës e thirri Kryeministrin Albin Kurti në lidhje me një hetim për korrupsion lidhur me rezervat shtetërore. Edhe pse nuk ishte i akuzuar zyrtarisht, ai refuzoi të paraqitej, duke këmbëngulur se mund të intervistohet në zyrën e tij. Më 4 mars, ai përsëri refuzoi të dëshmonte pavarësisht një urdhri gjykate, duke e cilësuar publikisht thirrjen si të motivuar politikisht. Kritikën e tij ndaj prokurorisë u kundërshtuan nga media dhe ekspertë ligjorë, të cilët paralajmëruan për rreziqet ndaj kredibilitetit institucional. Më 2 prill, Gjykata Themelore në Prishtinë i shqiptoi atij një gjobë prej 250 eurosh për mosrespektim të urdhrit, një ndëshkim që ai e minimizoi, duke nxitur më tej debat mbi transparencën.<sup>404</sup>

**403.** Prokuroria Speciale e Kosovës ka ngritur aktakuzë ndaj Faruk Mujkës, ish-nënkryetar i Komunës së Mitrovicës së Jugut, dhe Hysen Muzliukës, ish-drejtor i Gjeodezisë, Kadastrës dhe Pronës, për akuza të korrupsionit dhe keqpërdorimit të pozitës zyrtare. Aktakuza lidhet me një shkëmbim të kontestuar pronësor që përfshin ndërtesën e ish-bibliotekës komunale në Mitrovicë. Sipas prokurorisë, të pandehurit kanë paraqitur në mënyrë të pasaktë statusin ligjor të pronës së qytetit si pronë komunale, pavarësisht se Kuvendi Komunal e kishte përcaktuar dy herë si pronë me interes të veçantë publik. Rasti buron nga një raport investigativ i vitit 2022 nga KALLXO.com, i cili zbuloi se ish-salla e leximit e Bibliotekës së Qytetit të Mitrovicës ishte shndërruar më pas në një kafene me pronësi private pas transaksionit pronësor.<sup>405</sup>

**404.** Në maj 2025, një rast i rëndësishëm i sinjalizuesit i ka nxjerrë në pah dobësitë në zbatimin e kornizës për mbrojtjen e sinjalizuesve në Kosovë. Auditori komunal Shyqeri Krasniqi nga Komuna e Fushë Kosovës u shkarkua pas zbulimit të parregullsive serioze në prokurim në kontrata me vlerë

402 Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (APK, 2025), [Kosova prezanton progresin në parandalimin e korrupsionit në punëtorinë e Strasburgut](#).

403 YIHR (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve mbi të Drejtat e Njeriut në Kosovë për vitin 2025.

404 Balkan Insight (2025), [Kryeministri i Kosovës refuzon të dëshmojë për dyshimet mbi keqpërdorimin e rezervave të Kosovës](#).

405 BIRN (2026), (2026), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve mbi të Drejtat e Njeriut në Kosovë për vitin 2025.

rreth 830,000 euro për objekte sportive. Pavarësisht investimeve të konsiderueshme, objektet u bënë të papërdorshme për shkak të defekteve strukturore si çatitë që rrjedhin dhe kontaminimi me myk. Shkarkimi i tij ngriti shqetësime serioze për hakmarrje, duke e theksuar cenueshmërinë e sinjalizuesve dhe mungesën e masave të mjaftueshme mbrojtëse për personat që e denoncojnë korrupsionin.

**405.** Në gjysmën e parë të vitit 2025, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit i ka intensifikuar aktivitetet e saj mbikëqyrëse duke dorëzuar 48 kallëzime penale ndaj zyrtarëve publikë, përfshirë katër deputetë të Kuvendit, për mosdeklarim të pasurisë. Disa nga kallëzimet lidhen me apartamente të padeklaruar, të ardhura dhe dhurata. Agjencia gjithashtu i ka përgatitur mbi 70 kallëzime të tjera për dorëzim deri në mesin e vitit. Raportimet nga sinjalizuesit janë rritur ndjeshëm, me mbi 50 raste të raportuara vetëm në gjashtëmujorin e parë të vitit, duke e tejkaluar tashmë numrin total të regjistruar në vitin 2024. Kjo rritje e pasqyron si rritjen e ndërgjegjësimit publik, ashtu edhe rritjen e mosbesimit në integritetin e elitave politike.

**406.** Gjatë vitit 2025, organizatat e shoqërisë civile që i monitorojnë institucionet kanë vazhduar ta theksojnë inercinë gjyqësore në gjykimin e rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë. Raportet e GLPS-së dhe organizatave të tjera kanë evidentuar vonesa të gjera, hedhje poshtë të rasteve dhe zbatim të kufizuar të vendimeve në proceset gjyqësore që përfshijnë zyrtarë të lartë. Këto gjetje kanë forcuar perceptimin publik se politikanët dhe zyrtarët e nivelit të lartë mbeten “të paprekshëm”, ndërsa qytetarët e zakonshëm përballen me pasoja më të rrepta ligjore. Këmbëngulja e këtij standardi të dyfishtë ka kontribuar në rënien e besimit publik në paanshmërinë dhe pavarësinë e gjyqësorit.

#### **407. Rekomandimet**

- Gjykatat duhet ta zhvillojnë një praktikë më të konsoliduar të interpretimit të rasteve të korrupsionit përmes një qasjeje të të drejtave të njeriut, duke vlerësuar jo vetëm elementet formale të veprës penale, por edhe ndikimin substancial të saj;
- Këshilli Prokurorial i Kosovës duhet ta forcojë llogaridhënien në rastet e korrupsionit duke i rritur kapacitetet e prokurorisë, duke siguruar trajtim të shpejtë të rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë dhe duke i zbatuar masat për mbrojtjen e sinjalizuesve, përfshirë rikthimin në punë dhe mjetet juridike në rastet e hakmarrjes.

### **8.3. Mjedisi dhe të drejtat e njeriut**

**408.** Të drejtat e njeriut dhe mjedisi janë të ndërlidhura ngushtë. Të drejtat e njeriut nuk mund të ushtrohen plotësisht pa një mjedis të qëndrueshëm, të sigurt dhe të shëndetshëm. Efektet negative të ndryshimeve klimatike e kërcënojnë gëzimin e plotë të të drejtave të njeriut, përfshirë të drejtën për një mjedis të qëndrueshëm, të sigurt dhe të shëndetshëm, si dhe të drejtën për jetë, ujë, kanalizim, ushqim, shëndet, banim, vetëvendosje, kulturë dhe zhvillim. Në korrik 2022, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së e miratoi një rezolutë në të cilën deklarohet se “çdo person

në planet ka të drejtë për një mjedis të shëndetshëm". Kjo rezolutë përbën një vendim historik që shpall në mënyrë eksplicite qasjen në një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm si të drejtë universale të njeriut, duke u bërë thirrje palëve të ndryshme që t'i rrisin përpjekjet për zbutjen e krizës klimatike, përfshirë shtetet, organizatat ndërkombëtare dhe bizneset. Në korrik 2025, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë lëshoi një opinion këshillues mbi detyrimet e shteteve në lidhje me ndryshimet klimatike, duke i njohur ato si një kërcënim "urgjent dhe ekzistencial" dhe duke konfirmuar se shtetet kanë detyrime të detyrueshme sipas së drejtës ndërkombëtare për të parandaluar dëme të konsiderueshme ndaj sistemit klimatik. Gjykata theksoi se mosushtrimi i kujdesit të duhur apo mosmarrja e masave adekuate për reduktimin e emetimeve të gazrave serrë dhe mbrojtjen e popullsisë mund të përbëjë akt të paligjshëm ndërkombëtar, duke afirmuar se mbrojtja e mjedisit është parakusht për gëzimin e të drejtave të njeriut.

**409.** Kushtetuta e Kosovës nuk e njuh në mënyrë eksplicite të drejtën për një mjedis të shëndetshëm. Megjithatë, ajo përcakton në nenin 52 se "Natyra dhe biodiversiteti, mjedisi dhe trashëgimia kombëtare janë përgjegjësi e secilit" dhe se "secilit duhet t'i jepet mundësia të dëgjohet nga institucionet publike dhe t'i merren parasysh opinionet e tij për çështjet që ndikojnë në mjedisin në të cilin jeton". Ligji Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Ligji Nr. 08/L-025 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, si dhe më së fundi Ligji Nr. 08/L-250 për Ndryshimet Klimatike përbëjnë instrumente të rëndësishme ligjore për mbrojtjen e mjedisit në Kosovë. Gjithashtu, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) nuk e njuh në mënyrë të drejtpërdrejtë të drejtën për një mjedis të shëndetshëm. Megjithatë, një sërë standardesh ndërkombëtare të zhvilluara nga Këshilli i Evropës, përfshirë KEDNJ-në, Kartën Sociale Evropiane dhe Konventën e Bernës për ruajtjen e jetës së egër evropiane, janë përdorur me sukses për t'i avancuar çështjet mjedisore në të gjithë Evropën.

**410.** Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) ka vendosur mbi më shumë se 300 raste të lidhura me mjedisin, ku ka aplikuar koncepte si e drejta për jetë, jeta familjare dhe liria e shprehjes në një gamë të gjerë çështjesh mjedisore, përfshirë ndotjen, katastrofat natyrore ose të shkaktuara nga njeriu dhe qasjen në informacion mjedisor. Në vitin 2024, Dhoma e Madhe e nxori aktgjykimin historik në rastin Verein KlimaSeniorinnen Schweiz dhe të tjerët kundër Zvicrës, duke konstatuar se Zvicra nuk i kishte përmbushur detyrimet e saj pozitive sipas KEDNJ-së në lidhje me ndryshimet klimatike, duke shënuar për herë të parë njohjen se mosveprimi adekuat në zbutjen e ndryshimeve klimatike mund të përbëjë shkelje të të drejtave të Konventës. Në vitin 2025, Gjykata e avancoi më tej jurisprudencën e saj duke konstatuar shkelje të së drejtës për jetë në rastin Cannavacciuolo dhe të tjerët kundër Italisë, për shkak të ekspozimit afatgjatë ndaj ndotjes toksike nga mbetjet. Ndërkohë, Komiteti i Ministrave e filloi mbikëqyrjen e zbatimit të rastit KlimaSeniorinnen, duke pranuar parashtrësia shtesë në korrik dhe duke planifikuar shqyrtim të vazhdueshëm në shtator, gjë që tregon mbikëqyrje të vazhdueshme ndërkombëtare mbi veprimet shtetërore në fushën e klimës. Po ashtu, në maj 2025, Gjykata shpalli të papranueshme dy aplikime të lidhura me klimën, duke treguar se parimet e vendosura në rastin KlimaSeniorinnen tashmë po aplikohen në vendime të thjeshtuara procedurale. Ndërkohë, aplikime të reja në vitin 2025, përfshirë raste nga Mbretëria e Bashkuar që fokusohen në masat e adaptimit, tregojnë se palët po fillojnë ta testojnë kornizën e Gjykatës përtej zbutjes së ndryshimeve klimatike, duke përfshirë edhe përgjegjësinë më të gjerë klimatike. Këto zhvillime përbëjnë pika të rëndësishme reference për qytetarët dhe organizatat e shoqërisë civile në Kosovë që punojnë në fushën e mjedisit, pasi gjykatat vendore pritjet të marrin parasysh jurisprudencën e Strasburgut gjatë shqyrtimit të çështjeve që lidhen me mbrojtjen e mjedisit dhe ndryshimet klimatike

**411.** Në vitin 2025 është shënuar progres në operacionalizimin e Agjendës së Gjellbër për Ballkanin Perëndimor, me ndikim të drejtpërdrejtë edhe për Kosovën. Këshilli për Bashkëpunim Rajonal (RCC) e ka lansuar rishikimin e parë të Planit të Veprimit (2021–2030), i cili përfshin 58 veprime prioritare që e mbulojnë dekarbonizimin, ekonominë qarkore, uljen e ndotjes (de-pollution), bujqësinë e qëndrueshme dhe biodiversitetin. Kosova gjithashtu pritet të përfitojë nga projektet e reja rajonale të lansuara në mars 2025, veçanërisht ADAPT 2.0 dhe Greening the Western Balkans, të cilat synojnë forcimin e mbrojtjes së biodiversitetit dhe reziliencës klimatike. Këto nisma ofrojnë mundësi për Kosovën që të avancojë zbatimin e Ligjit për Ndryshimet Klimatike dhe t'i plotësojë përpjekjet kombëtare në fushat e cilësisë së ajrit, menaxhimit të mbeturinave dhe vlerësimit të ndikimit në mjedis.

**412.** Monitorimi në kohë reale i cilësisë së ajrit mundësohet përmes një rrjeti prej 12 stacionesh për monitorimin e ajrit të vendosura në mënyrë të shpërndarë gjeografikisht në komunat e Kosovës. Kjo mundëson matjen në kohë reale të cilësisë së ajrit në Kosovë. Qasja në të dhënat nga këto 12 stacione sigurohet përmes platformës së Indeksit Evropian të Cilësisë së Ajrit të Agjencisë Evropiane të Mjedisit (EEA). Monitorimi i ajrit kryhet në bazë të Ligjit Nr. 08/L-025 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja dhe legjislacionit sekondar të miratuar për këtë qëllim, përkatësisht Udhëzimit Administrativ Nr. 09/2023 për mënyrën e monitorimit të cilësisë së ajrit, mbledhjen e të dhënave, kriteret dhe metodologjinë. Pavarësisht disa përparimeve në përmirësimin e cilësisë së ajrit, ajo vazhdon të përbëjë një rrezik të madh për shëndetin publik, në një kontekst të vonësave në zbatimin e plotë të masave të duhura për zbutjen e ndotjes së ajrit.

**413.** Cilësia e ajrit në Kosovë përbën një shqetësim të madh për shëndetin publik, me një përqendrim mesatar të PM2.5 që është 2.4 herë më i lartë se vlera udhëzuese vjetore e Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH). Një faktor kyç që kontribuon vazhdimisht në këtë gjendje është varësia nga energjia e prodhuar nga qymyri, si dhe praktika e djegies së lëndëve të ngurta, përfshirë drutë për ngrohje dhe gatim në amvisëri. Një analizë e trendit diakronik që mbulon periudhën 2018–2025 tregon se cilësia e ajrit, e matur në mikrogramë për metër kub, mbetet vazhdimisht mbi kufijtë udhëzues të OBSH-së prej  $10 \mu\text{g}/\text{m}^3$ , me vitin 2025 që shënon nivele të pashëndetshme. Kjo situatë ka shtyrë Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të u bëjë thirrje qytetarëve, veçanërisht grupeve të cënueshme, që t'i kufizojnë aktivitetet në ambient të hapur, ta shmangin hapjen e dritareve dhe të përdorin maska mbrojtëse. Në dhjetor 2025, Kosova është renditur ndër 10 qytetet më të ndotura në botë.<sup>406</sup> Nivelet e Indeksit të Cilësisë së Ajrit (AQI) në Prishtinë u rritën në nivele "të pashëndetshme" (167), duke e shtyrë Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të lëshojë këshilla urgjente për qytetarët, veçanërisht për grupet e cënueshme, që t'i kufizojnë aktivitetet në ambient të hapur, ta shmangin hapjen e dritareve dhe të përdorin maska mbrojtëse.

406 AQI (2025), [10 dhjetor 2025: Kosova ndër dhjetë qytetet më të ndotura në botë.](#)

Viti	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	Udhëzimet e OBSH-së
Indeksi i cilësisë së ajrit në µg/m <sup>3</sup>	30.4	23.5	20.0	14.7	19.0	19.4	24	52 µg/m <sup>3</sup>	10

**Figura 3: Cilësia e ajrit në Kosovë (PM2.5) midis viteve 2018 dhe 2025**

**414.** Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike theksoi në vitin 2025 se ekspozimi i zgjatur ndaj grimcave të imta (PM2.5) lidhet me sëmundje kardiovaskulare, kancer në mushkëri dhe rritje të shkallës së vdekshmërisë, duke nënvizuar urgjencën për uljen e varësisë nga qymyri dhe përdorimi i lëndëve të ngurta djegëse.<sup>407</sup> Pavarësisht kësaj njohjeje, burimet kryesore të ndotjes së ajrit vazhdojnë të burojnë nga emetimet e djegies së lëndëve të ngurta, përfshirë qymyrin dhe drurin, si në nivelin familjar ashtu edhe në sektorin e energjisë që mbështetet në termocentrale me qymyr. Dy termocentralet ekzistuese, Kosova A dhe Kosova B, janë të vendosura në Obiliq, një komunë fqinje me Prishtinën, dhe për këtë arsye kontribuojnë ndjeshëm në ndotjen e ajrit mbi kryeqytet. Duhet theksuar se këto termocentrale renditen si ndër më të ndoturit në Evropë, përkatësisht në vendin e parë dhe të tretë për nivelin e ndotjes. Së bashku, ato emetojnë katër herë më shumë PM2.5 sesa shumica e termocentraleve të tjera me qymyr në rajonin e Ballkanit. Ndërsa ato përbëjnë një pjesë kyçe të infrastrukturës energjetike të Kosovës, ndotja që gjenerojnë ka ndikim të rëndë në mjedis dhe shëndetin e njeriut.

**415.** Përveç rreziqeve për shëndetin e njeriut, ndotja e ajrit është gjithashtu e dëmshme për mjedisin natyror. Përbërjet kimike si oksidet e azotit dhe amoniaku, të lëshuara në tokë dhe ujë, shkaktojnë çekuilibra kimikë dhe çrregullime të rëndësishme në ekosistemet natyrore dhe biodiversitetin. Ndikime të tjera përfshijnë erozionin e ndërtesave dhe reshjet acide, të cilat kontribuojnë në dëmtimin e bimëve, pyjeve dhe kulturave bujqësore. Një burim veçanërisht i rëndësishëm për ngrohjen globale dhe ndryshimet klimatike janë emetimet e gazrave serrë.

**416.** Tre projektet e hidrocentraleve në lumin Deçani, Lumbardhi dhe Belaja kanë qenë objekt i një mosmarrëveshjeje ligjore ndërmjet Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës së Kosovës dhe investitorit austriak të hidroenergjisë KelKos, tash e shumë vite. Në korrik 2024, Qendra për Litigim Strategjik në Kosovë, që vepron në kuadër të OJQ-së GLPS, së bashku me OJQ-në "Pishtarët" dhe tre qytetarë nga Deçani, kanë paraqitur një rast në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës duke pretenduar, ndër të tjera, shkelje të nenit 52 (Përgjegjësia për mjedisin) të Kushtetutës. Parashtruesit konsiderojnë se Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme e kanë interpretuar në mënyrë arbitrare Ligjin Nr. 04/L-147 për Ujërat dhe e kanë shpërfillur dëmin e dukshëm mjedisor të shkaktuar nga këto tre hidrocentrale. Deri më tani, Gjykata Kushtetuese ka konstatuar vetëm një herë shkelje të nenit 52 të Kushtetutës, në vitin 2010. Mbetet për t'u parë se çfarë qëndrimi do të mbajë ajo lidhur me rastin e hidrocentraleve të Deçanit.

**417.** Strategjia e re Energjetike e Kosovës (2022–2031) e shmang zhvillimin e mëtejshëm të hidrocentraleve për shkak të shqetësimeve mjedisore. Ky është një hap i rëndësishëm përpara, i cili e bën Kosovën të parën në rajon që e ndalon promovimin e ndërtimit të hidrocentraleve të reja. Strategjia parashikon rritje ambicioze të energjisë së ripërtëritshme, duke e synuar neutralitetin klimatik deri në vitin 2050. Nënshkruesit e Agjendës së Gjelbër angazhohen për dekarbonizim deri në vitin 2050, duke e synuar përfundimin e përdorimit të të gjitha lëndëve djegëse fosile: naftës, gazit dhe qymyrit.

**418.** Në maj 2025, Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) publikoi raportin *Çmimet e Energjisë dhe Subvencionet në Ballkanin Perëndimor: Reformat për një të Ardhme të Drejtë dhe të Gjelbër*, i cili ofron njohuri të reja mbi peizazhin energjetik të Kosovës. Raporti konfirmon se gjatë periudhës 2018–2023, Kosova ka përballuar rreth 2.2 miliardë euro në mbështetje implicite për konsumatorët e energjisë, kryesisht përmes tarifave të energjisë elektrike nën koston reale, me një mesatare prej 29.5 €/MWh krahasuar me kostot e referencës në treg prej 105.5 €/MWh. Gjithashtu dokumentohen 141 milionë euro në subvencione të kryqëzuara brenda sektorit rezidencial dhe 608 milionë euro në transferta direkte fiskale për sektorin e energjisë gjatë së njëjtës periudhë, me kulm në vitin 2022, kur këto subvencione përbënin 2.8% të BPV-së. Një pjesë e konsiderueshme e këtyre transfertave ka vazhduar ta mbështesë përdorimin e lëndëve fosile përmes përjashtimeve doganore, lehtësimeve tatimore dhe subvencioneve për ngrohje dhe energji elektrike të bazuar në qymyr. OECD paralajmëron se mbajtja e këtyre subvencioneve dëmton financat publike, shtrembëron sinjalet e çmimeve dhe vonon investimet në energji të ripërtëritshme. Megjithatë, theksohet se reforma e subvencioneve duhet të shoqërohet me mekanizma të fortë të mbrojtjes sociale për të zbutur ndikimin e rritjes së çmimeve mbi popullatat e cenueshme. Instrumentet e propozuara përfshijnë transferime të synuara në para ose kupona energjetikë, të cilët janë më efikasë se subvencionet universale dhe ruajnë nxitjet për kursim të energjisë, duke harmonizuar efikasitetin fiskal me objektivat mjedisore.<sup>408</sup>

**419.** Në mënyrë të rëndësishme, raporti i OECD-së integron një qasje të ndjeshme ndaj gjinisë, duke njohur se gratë bartin në mënyrë disproporcionale kostot e fshehura të sistemeve joefikase të energjisë. Si menaxhere kryesore të energjisë në amvisëri, ato përshtatin përdorimin, oraret dhe buxhetet në përgjigje të ndryshimeve të çmimeve. Nën at beqare, të moshuarit dhe amvisëritë e udhëhequra nga gratë shpesh përballen me pengesa të shtuara: qasje të kufizuar në asistencë, barriera burokratike dhe mungesë të mjaftueshme të informimit dhe shtrirjes institucionale. Prandaj, OECD rekomandon që politikat energjetike dhe sociale të jenë të ndjeshme ndaj gjinisë, për shembull: ofrimin e granteve për efikasitet energjetik të dedikuara për gratë, përfshirjen e synuar të grave në trajnimet për punë të gjelbra dhe uljen e pengesave sistematike për qasje në mbështetje. Këto masa do të ndihmonin në përafrimin e tranzicionit energjetik me imperativat e të drejtave të njeriut dhe barazisë.<sup>409</sup>

**420.** Në vitin 2025, sektori i energjisë në Kosovë ka kaluar nëpër ndryshime të rëndësishme rregullatore dhe të tregut. Në mars, Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRE) e ka miratuar një strukturë

408 OECD (2025), [Çmimet e energjisë dhe subvencionet në Ballkanin Perëndimor: reforma për një të ardhme të drejtë dhe të gjelbër](#).

409 OECD (2025), [Çmimet e energjisë dhe subvencionet në Ballkanin Perëndimor: reforma për një të ardhme të drejtë dhe të gjelbër](#).

të re tarifore të energjisë elektrike, e cila ka rezultuar në një rritje mesatare prej 16.1 për qind. Duke filluar nga 1 maji, konsumi deri në 800 kWh në muaj është tarifuar me 7.79 centë euro për kWh, ndërsa konsumi mbi këtë prag është tarifuar me 14.45 centë euro për kWh. Tarifat mbeten subjekt i rishikimit vjetor nga ZRE.<sup>410</sup> Rritja erdhi pas vendimit të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRE) të 11 prillit, për t'i rritur të hyrat maksimale të lejuara për Kompaninë Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike (KESCO), operatorin e sistemit të transmetimit (KOSTT) dhe kompaninë e shpërndarjes (KEDS). ZRE ka theksuar dobësi strukturore në sektorin energjetik, përfshirë varësinë nga linjiti për mbi 77 për qind të furnizimit, fleksibilitetin e kufizuar të termocentraleve ekzistuese për ta mbuluar kërkesën në pikat e pikut, varësinë në rritje nga importet dhe ngarkesën në rrjetin rajonal të energjisë.<sup>411</sup> Ky rregullim ka nxitur reagime të forta publike dhe institucionale. Ministria e Ekonomisë i ka bërë thirrje Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRE) që t'i përjashtojë familjet që konsumojnë nën 800 kWh në muaj, ndërsa edhe Zyra e Presidencës ka shprehur kundërshtim ndaj vendimit. Organizatat e shoqërisë civile organizuan protesta në Prishtinë, ku policia arrestoi aktivistë në disa raste më 2 prill, 5 prill dhe 11 prill, protesta e fundit e udhëhequr nga grupi "Asnjë Cent më Shumë". Më 30 prill, Avokati i Popullit rekomandoi pezullimin e zbatimit të tarifave të reja deri në shqyrtimin ligjor të tyre.<sup>412</sup>

**421.** Reforma të tjera hynë në fuqi më 1 qershor, duke kërkuar që ndërmarrjet e mëdha, të përcaktuara si ato me më shumë se 50 punonjës ose me qarkullim vjetor mbi 10 milionë euro, të dalin nga sistemi i tarifave të rregulluara dhe ta blejnë energjinë elektrike drejtpërdrejt në tregun e hapur. Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë së Kosovës e kundërshtoi masën, duke argumentuar se pragjet e vendosura janë joproporcionale me kushtet ekonomike lokale, dhe kërkoi shtyrjen e zbatimit të saj për një vit.<sup>413</sup>

**422.** Korniza ligjore u qartësua në mesin e vitit 2025, kur Dhoma e Apelit e Gjykatës Komerciale mbështeti procesin e liberalizimit të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRE), duke e përmbysur një vendim të mëparshëm të shkallës së parë. Pas këtij vendimi, ZRE njoftoi se nga 16 gushti 2025, bizneset që nuk kanë kontrata me furnizues të licencuar të energjisë elektrike do të përballen me shkëputje të furnizimit. Kjo masë pritej të prekte mbi 1,000 kompani. Ish-kryeministri Avdullah Hoti e kritikoi vendimin, duke paralajmëruar se rreth 1,300 biznese mund të përballen me kosto dukshëm më të larta dhe duke vënë në pikëpyetje drejtësinë e procesit dhe reagimin e qeverisë.<sup>414</sup> Si rezultat, shoqatat e biznesit raportuan rritje të presionit ekonomik. Aleanca Kosovare e Bizneseve (AKB) paralajmëroi se qindra kompani ishin në rrezik, duke përmendur raste të shkëputjes nga furnizimi me energji, largimeve nga puna dhe planeve për zhvendosje të aktivitetit. AKB e përshkroi ndikimin në sektorin privat si të paprecedent si në shkallë ashtu edhe në ashpërsi.<sup>415</sup>

**423.** Çështjet mjedisore kanë qenë gjithashtu të theksuara gjatë vitit. Në shkurt 2025, organizatat mjedisore ngritën shqetësime për ndotje të rëndë përgjatë lumit Drini i Bardhë, siç është trajtuar në seksionin A të këtij raporti. Për më tepër, lumi Sitnica mbetet lumi më i ndotur në Kosovë. Raportimet hulumtuese dhe vlerësimet e ekspertëve konfirmojnë se përgjatë rrjedhës së tij prej 90 kilometrash, lumi vazhdon të pranojë ujëra të zeza urbane të patrajtuara nga komunat kryesore,

410 Prishtina Insight (2025), [Zyra e Rregullatorit të Energjisë në Kosovë përcakton tarifën e energjisë pas rritjes së kundërshtuar të çmimeve](#).

411 Balkan Insight (2025), [Rregullatori i Kosovës lejon rritje të madhe të çmimit të energjisë pavarësisht protestave](#).

412 Reporteri (2025), [Avokati i Popullit i kërkon ZRRE-së të pezullojë vendimin për rritjen e çmimit të energjisë elektrike](#).

413 Prishtina Insight (2025), [Reforma e tregut të energjisë i lë bizneset e mëdha në Kosovë në vështirësi](#).

414 Periskopi (2025), [ZRRE: Nga 16 gushti, furnizimi me energji elektrike për konsumatorët pa kontratë do të ndërpritet](#).

415 Prishtina Insight (2025), [Reforma e tregut të energjisë i lë bizneset e mëdha në Kosovë në vështirësi](#).

përfshirë Prishtinën, Lipjanin, Fushë Kosovën, Obiliqin dhe Graçanicën.<sup>416</sup>

**424.** Partnerët ndërkombëtarë kanë kontribuar në forcimin e kapaciteteve institucionale në këtë fushë. Në mars, Agjencia Suedeze për Mbrojtjen e Mjedisit nisi një projekt trevjeçar për ndërtimin e kapaciteteve në mbrojtjen e mjedisit (2025–2027). Projekti përfshin krijimin e një portali të përbashkët të metadata-ve për të dhënat mjedisore, përmirësimin e menaxhimit të parqeve kombëtare dhe harmonizimin me direktivat mjedisore të BE-së në kuadër të Kapitullit 27, përfshirë rregjetin Natura 2000 dhe Konventën e Aarhus-it.<sup>417</sup> Përveç Swedish Environmental Protection Agency, edhe European Union Office in Kosovo ka kontribuar në mbështetjen e sektorit energjetik. Më 19 gusht 2025, kjo zyrë njoftoi disbursimin e një shtese prej 7.5 milionë eurosh në kuadër të Paketës së Mbështetjes për Energji (IPA 2023), duke e çuar ndihmën totale të BE-së për energjinë në 75 milionë euro. Sipas Zyrës së BE-së, këto fonde kanë mbështetur mbi 200,000 familje për pagesën e faturave të energjisë, kanë mundësuar renovime për efikasitet energjetik në më shumë se 3,600 shtëpi, kanë financuar rinovimin e 28 ndërtesave të banimit ku jetojnë familje të cenueshme, si dhe kanë pajisur 40,000 familje dhe 154 biznese me panele diellore dhe pajisje efikase energjetike. Kjo masë është pjesë e mbështetjes më të gjerë të Bashkimit Evropian për tranzicionin e Kosovës drejt energjisë së pastër, dekarbonizimit dhe forcimit të sigurisë energjetike.<sup>418</sup>

#### 425. Rekomandimet

- Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Ministria e Ekonomisë duhet të miratojnë dhe zbatojnë masa detyruese për uljen e ndotjes së ajrit, duke vendosur objektiva vjetore për reduktimin e PM2.5, duke zbatuar kufij të emetimeve për termocentralet Kosova A dhe Kosova B, si dhe duke publikuar të dhëna mujore për cilësinë e ajrit të shoqëruara me masa korigjuese;
- Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës duhet t'i forcojë mekanizmat e zbatimit për ta ndaluar ndotjen industriale, veçanërisht nga termocentralet me qymyr Kosova A dhe Kosova B;
- Ministria e Ekonomisë duhet të ridrejtojë mbështetjen financiare drejt asistencës së synuar energjetike për familjet e cenueshme dhe investimeve në energji të ripërtëritshme, duke siguruar raportim publik vjetor mbi reduktimin e subvencioneve dhe rritjen e kapaciteteve të energjisë së ripërtëritshme.

## 8.4 E drejta për barazi dhe mosdiskriminim

**426.** Parimi i mosdiskriminimit përbën një normë themelore të së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe është i përfshirë në instrumente kyçe, përfshirë Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike dhe Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore. Në nivel rajonal, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut ofron mbrojtje përmes nenit 14, i cili ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave të Kon-

416 Kosovo 2.0 (2025), [Sitnica: helmi që rrjedh](#).

417 Natur Vards Verket (2025), [Kosova – aktivitetet forcojnë mbrojtjen e mjedisit](#).

418 UNMIK Media observer (2025), [Edicioni i mëngjesit, 26 gusht 2025](#).

ventës. Për më tepër, neni 1 i Protokollit Nr. 12 të KEDNJ-së vendos një ndalim më të gjerë dhe të pavarur të diskriminimit në lidhje me “çdo të drejtë të përcaktuar me ligj”, duke zgjeruar mbrojtjen përtej të drejtave të garantuara në mënyrë specifike nga Konventa. Brenda këtij kuadri, Kosova ka detyrim ligjor të sigurojë mbrojtje kundër diskriminimit për të gjithë individët nën juridiksionin e saj, përfshirë në baza si raca, përkatësia etnike, gjinia, mosha, feja, orientimi seksual dhe karakteristika të tjera të mbrojtura.

**427.** Kushtetuta e Kosovës e vendos barazinë dhe mosdiskriminimin si parime themelore kushtetuese. Neni 3 përcakton barazinë para ligjit si një parim udhëheqës për ushtrimin e autoritetit publik. Neni 24 garanton në mënyrë eksplicite barazinë para ligjit dhe ndalon diskriminimin. Për më tepër, barazia dhe mosdiskriminimi rikonfirmohen ndër vlerat themelore kushtetuese në nenin 6, të cilat përbëjnë bazën normative të rendit kushtetues.

**428.** Përveç kësaj, kuadri legjislativ përbëhet nga një sërë ligjesh dhe rregulloresh. Kjo përfshin Ligjin Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore, Ligjin Nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Kodin Penal Nr. 04/L-082. Ligji Nr. 05/L-019 për Institucionin e Avokatit të Popullit i ka dhënë Institucioni i Avokatit të Popullit në Kosovë mandatin për ta promovuar dhe monitoruar trajtimin e barabartë pa diskriminim në bazë të arsyeve të mbrojtura me ligj. OIK gjithashtu paraqitet si *amicus curiae* në proceset gjyqësore që trajtojnë të drejtat e njeriut dhe mbrojtjen nga diskriminimi. Për më tepër, Udhëzimi Administrativ Nr. 2007/08 për Themelimin e Njësive për të Drejtat e Njeriut në Komuna ka paraparë krijimin e këtyre njësive në nivel komunal, të përbëra nga të paktën tre zyrtarë, përfshirë koordinatoren e njësisë. Në fund, Zyra për Qeverisje të Mirë (ZQM) së bashku me Grupin Ndërmintor të Punës për të Drejtat e Njeriut përbëjnë një mekanizëm tjetër institucional që synon koordinimin e përpjekjeve kundër diskriminimit ndërmjet institucioneve.

**429.** Në dhjetor 2025, Qendra Kosovare për Studime Gjinore dhe Iniciativa për Stabilitet në Kosovë publikuan një studim të titulluar “Paragjykimi në derë”, i cili e aplikon metodën e testimit të situatës për ta zbuluar diskriminimin në fazat e hershme të rekrutimit. I realizuar në nëntor 2025 në 18 kompani dhe 25 vende pune në sektorë si hoteleria, logjistika, administrata dhe shërbimet e pastrimit, studimi paraqiti aplikime të barazuara që ndryshonin vetëm në një karakteristikë të mbrojtur (gjini, etni ose orientim seksual) për ta vlerësuar trajtimin e diferencuar. Gjetjet tregojnë modele të qëndrueshme të trajtimit të pabarabartë: gratë rome-K përballen me shqyrtim më të rreptë, oferta më të ulëta pagash dhe orientim drejt pozicioneve më pak të favorshme pavarësisht kualifikimeve të barabarta ose më të larta; burrat heteroseksualë marrin oferta më të shpejta dhe më konkrete pune krahasuar me burrat homoseksualë; ndërsa gratë orientohen drejt roleve me status më të ulët dhe u bëhen pyetje jo-profesionale dhe ndërhyrëse që nuk u bëhen kandidatëve burra. Hulumtimi gjithashtu identifikon dobësi strukturore në praktikën e rekrutimit, përfshirë varësinë nga kanalet informale të komunikimit dhe mungesën e transparencës, të cilat rrisin diskrecionin dhe krijojnë kushte për filtrime diskriminuese. Këto gjetje tregojnë se diskriminimi në tregun e punës në Kosovë shpesh ndodh në pragun e punësimit, dhe jo vetëm brenda marrëdhënieve formale të punës.<sup>419</sup>

419 Europe House (2026), [Paragjykimi në derë: Zbulimi i diskriminimit përmes testimit të situatave në tregun e punës.](#)

**430.** Në vitin 2025, Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut – Kosovë (YIHR KS) në partneritet me Agjencinë e Kosovës për Ndihmë Juridike Falas finalizuan Udhëzuesin për Trajtimin e Rasteve të Diskriminimit, një dokument i ri i hartuar për të standardizuar procedurat për identifikimin, trajtimin dhe zgjidhjen e ankesave për diskriminim, me qëllim që mjetet juridike të bëhen më të qasshme dhe më efektive.

#### **431. Rekomandimet**

- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Inspektorati i Punës duhet të monitorojnë dhe sanksionojnë praktikën diskriminuese të rekrutimit duke vendosur inspektime të rregullta, duke kërkuar procedura transparente të punësimit dhe duke publikuar raporte vjetore mbi gjetjet e diskriminimit në tregun e punës;
- Ministria e Drejtësisë dhe Agjencia e Kosovës për Ndihmë Juridike Falas duhet ta operacionalizojnë Udhëzuesin për Trajtimin e Rasteve të Diskriminimit duke e siguruar zbatimin e tij të detyrueshëm në të gjitha institucionet, duke i trajnuar zyrtarët përkatës dhe duke publikuar të dhëna vjetore mbi ankesat për diskriminim, rezultatet e tyre dhe qasjen në mjete juridike.

**Katalogimi në botim – (CIP)**

**Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”**

342.7(496.51)“2025”(047)

Raporti i shoqërisë civile për të drejtat e njeriut : në Kosovë në vitin 2025 /  
YIHR Kosovo. - Prishtinë : YIHR Kosovo, 2026. - 113 f. ; 24 cm.

**ISBN 978-9951-9122-9-7**

ISBN 978-9951-9122-9-7



9

789951

912297



